

BIBLIOTEKA

398

K 81

MUSINE  
KOKALARI

...SA U TUNT  
JETA

398.8 (1-21)

14

398

K 81

Musine Kokalari

...SA U TUNT  
JETA



54302

Shtëpia Botuese "Globus R."

Tirane, 1995

Për botimin e këtij libri ndihmoi  
Fondacioni Hanns Seidel

50642



## PARATHENIE

Musine Kokalari lindi në shkurt 1917, hapat e para i hodhi në kalldrëmin e Gjirokastrës. U shqua që e vogël për aftësinë vëzhguese dhe talentin e rrallë për të shkruar. Në shkollën e mesme, shkrintari i shquar Petro Marko i habitur me talentin, lirizmin e ndjenjën humane të vajzës së re i rekomandoi asaj të shkruante me pseudonimin "Muza" te gazeta "SHTYPI".

Në Romë, Musinea mbaroi universitetin në degën e letërsisë dhe arteve të bukura me një temë për Naim Frashërin ku u vlerësua shkëlqyeshëm. Gjatë viteve talenti i saj shpërtheu dhe gjeti vetveten te folklori, te gjuha e folur shqipe, duke krijuar kështu një zhanër ku kishte një shkrije mes letërsisë artistike dhe studimit. Kjo bie në sy në tre veprat e saj "Siç më thotë nënua plakë", 1941, "Rreth vatrës", 1944, dhe "Sa u tund jeta", 1944.

Këto vepra tërhoqën vëmendjen e lexuesve e të intelektualëve të kohës si dhe të albanologut të shquar gjerman Lamberc, i cili e vlerësoi lart ashtu si dhe Gjergj Fishtën.

Musine Kokalari është antare nderi në Akademinë Italiane bashkë me Gjergj Fishtën. Emri i saj ndodhet në enciklopedi të huaja italiane, franceze dhe së fundi në një libër bibliografik të Robert Elsie në Gjermani.

Sa më shumë vezullonte talenti i saj, aq më shumë e ndiqnin tragjeditë familjare dhe vetiake. Familja Kokalari themeloi të parën shtëpi botuese të tipit evropian "Menagjeritë Shqipëtare", ku u botuan veprat e Gëtes, Shilerit, Shekspirin, Servantesit, etj. Edhe botimi i parë i librit "Sa u tund jeta" u bë nga kjo shtëpi botuese.

Musinea formoi Partinë Socialdemokrate më 1943. Në janar 1944 botoi gazetën "Zëri i Lirisë" dhe në numrin e parë të saj paraqitet programi i partisë. Në 12 Nëntor 1944 i pushkatohej pa gjyq dy vëllezërit intelektual Muntaz e Vesim Kokalari. Vëllai i vogël Hamiti, autori i "Kosova, djepi i shqiptarizmit", shpëtoi rastësisht nga që ishte sëmurë me tifo. Në mars 1945 me një grup intelektualësh të kohës formuan të parën opozitë antikomuniste "Bashkimi Demokratik" dhe Musinea hartoi të parin Memorandum drejtuar aleatëve ku kërkonte anulimin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit si antidemokratike. Por aleatët u përgjigjën me heshtje. Kjo dha shkas që "Bashkimi Demokratik" të konsiderohej si bllok që kërkonte pëmbysjen e pushtetit. Musinea u arrestua më 23 Janar 1946. Më 2 Korrik dënohet me 20 vjet burg si armike e popullit. Mbas burgut u internua në Rrëshen.

Edhe në burg dhe internim nuk rreshiti së punuari, mbledhte përralla e folklor. E sëmurë nga kanceri, e tretur si qiriri, si një hije e vërtetë largohet

nga spitali përnë Rrëshen ku vdes. Arkivolin e transportoi një kamion zhavori. U varros pa pasur pranë të afërmit e saj. Sot është "Martire e demokracisë".

Kujtdo i dhimset tragjedia e vajzës së re. Më kujtohet se si një ditë nënua plakë e heshtur, e përlotur dhe e thinjur, si e dalë nga legjendat më mori me vete për të parë në burg Musinenë, vajzën e saj të vetme. Kisha në duart e mia femënore një tufë zambakësh të bardhë, të cilave u ranë petalet nga era e ftohtë e Burelit dhe nuk arritën kurrë të halla ime e burgosur e vetmja femër në atë ferr.

Në këtë botim të dytë të librit "Sa u tmt jeta" nga shtëpia Botuese "Globus R." dua të falenderoj dhe Fondacionin "Hanns Seidel", që ndihmoi në botimin e kësaj vepre vërtet të mrekullueshme.

**Artemis KOKALARI**  
Tiranë, më 23.3.1995

## Shënimi i botuesit

*Një emër yll i pavenitur, Musine-ëndërra grabitur. Këtë libër po e botojnë thujtase si origjinali, që të na vish siç ke gënë: shkrimtarja e parë shqiptare, jargavan i freskët uji, nuse me vello qielli. Gjuha jote kullon mjaltë e flori, ndjenjat e tua burojnë vetiu e ne pimë e s'ngopemi.  
Nderime Musine!*

**Petraq RISTO**

## E GJETA...

Ja, përpara sive keni një udhë të ngushtë. Në funt të saj hapet një shesh i vogël. Në anë të djathtë është një portë e madhe me di sufa dhe në të mëngjertë një tjetër. Ati afër një fik i egër. Mure të larta rethojnë shtëpitë me di kate. Ballët e ture bien në avli me penxheret veshur me kafase.

Shtëpia me portë të madhe është m' e re dhe brënda një avli e kselhasur. Në të hirë, nga një anë është pusi dhe në tjetrën, një derë e vogël, që të shpie në kopsht. Shtrati me erdhni mbulon një pjesë të madhe dhe degat e saja varen nëpër mure.

Asnjë shamata nuk dëgjohet... është mëngjes dhe burat kanë dalë pazarit. Dera është e hapur dhe duken shkallat e brëndëshme.

Teto Qibrua është ulur tek praku i derës. Përpara ka një kanistër me këmishë të lara. Po vë gjërat kallëp-kallëp. Ja, një këllëf i pa fërkuar mirë, xhurapet e plakut për të qepur, këmisha e vajzës çjerë nga teli dhe fanella e djalit bërë copëra, shportë. Nikoqirja me dorën e mëngjertë i vë më një anë dhe nga një herë ngre kokën lart. Qielli u-vesh me re të zeza dhe mbi mur ecën macja me të katra. Ajo vrëri vetullat, shtëmëngi jemenin e kokës me dorën e djathtë dhe ra në mendime.

Çak...çak...çak, ra porta. "Kush është? Nduk mandallin" foli teto Qibrua nga vëndi. Hiri Haxho kapetaneja...e marrë si nga hera, pa e dashur kallogreja. Me të parë shoqen, nisi nga dërëlizmat: "hajde, hajde moj nikoqire, më ke larë këmishët...Lum ti e lumura, që ke ujë plot. Mua me një më pikon muslluku. Se si do vejë halli...! Eh! po ka Perëndia për të gjithë..." Kështu, duke folur, me duar e me këmbë, zuri vënt pranë saj.

U-pjetën me njera jetrën, si zakoni edhe thanë ç'kishin për të thënë. Të mira e të liga, ato që ka kjo botë me halle. Më në funt, teto Qibrua maçalisi fjalën: "ta thom a mos ta thom?" Kështu mendonte me vete. "Më mirë t'ja thom". Mendonesh nëna, se vajzai u-bë për burë. I mbushi të shtatëmbëdhjetat.

- "Thuajmë Haxho të keqen" e pjeti Qibrua, "nuk është koha për Xhemon për në shtëpinë e botës? Do të thuaç se e kam të vogël? Jo...mendohu një herë se kur jemi martuar ne. Keq më vjen të heq vajzën nga sitë, po të keqen, mirë ta kem dhe në shtëpi të saj. Djemtë m'u-bënë për nuse dhe më mirë vëlleshat pa kunata brënda. Xhemon, sa për ashtu e kam bello, as dhez, as shuan, po të keqen nuset i kanë halë në si motrat e burave".

- "Ke hakë, ke hakë, moj Qibro" u-përgjegj Haxhua - "mos dëgjo se ç' thotë njera e tjetra, se vëndet e mira nuk gjenden gjithënjë".

Për...për... pikat e shiut... u lagnë drasat e avlisë. Të di gratë u-futnë

brënda derës dhe atje s' e prenë fjalën.

- "Ja, moj Haxho, e po mendonet njeriu" nisi prapë Qibrua "e di, për Perëndi, për kokë të djelme, s' më hin gjumë në si. Po ku janë vëndet e mira? Tek djali i Muhtar agajt... uh, të keqen. Janë një radhë dhe mallin që kanë. diqint thela. Kush ta marrë më parë. Tek djali i Sefer efendiut... dizet bushtra dhe dizet fatpadala brënda. Tek Hisenja efendiut... janë me një milë të mira, po një motër u ka vdekur nga koll e ligë. Djali i ditë dhe ai i lumit. Gjithënjë oh e ih. Plaku ka zënë buxhakë. E po unë s' martoj vajzë për të qeverisur të sëmurët. Lipsur të jetë dhe ai mall."

Pushuan për një copë herë. Teto Qibrua zboi pulat nga avlija. Shkretëtirat, që bëjnë munxur nga të gjitha anët. N' atë kohë Xhemileja xërmoi nga sipër, me fshesë dhe me farasha në duar. I kumbisi në funt të shkallës, bëri buzën në gas, kur pa teto Haxhon. E don keq. I zuri dorën dhe ajo e puthi në të di faqet.

- "I mbarove punët sipër moj vajzë?" e pjeti nëna Xhemilenë "nasqirise mirë? I vure gjërat nëpër vënde? Shtëpitë u-bënë për të larë. Më kujto, pastaj t' i flas Hedo evgjites të vijë nesër. Ikë vajzë të keqen dhe na ndërto nga një filxhan kafë... na... hiqma këtë kanistër nga përpara. Vure në funt të shkallave dhe kur të veç sipër, shpjere. Këto gjërat që janë këtu, vuri mbi tahtaposh se duan qepur".

Xhemilja bëri si i tha nëna dhe pastaj u-fut në qilar.

"Hë, e gjeta" i tha Haxhua, "e di që Mirteza agaj zë nuse te djali? Ç' shtëpi e ç' shtëpi që është. Nuk është dëgjuar kurë, njeri s' e ka marrë në gojë. Ai burë, kur shkoi udhës, i ngrihet pazari në këmbë. S' ka parë kafënë me si, as në të ri, as në pleqëri. Po ajo zonjë... nikoqire me nam. Ka shkuar me atë vjehër pastaj. Motrat e saja atje ku kanë vatur, të mira kanë dalë. Pastaj, ara kanë plot, një radhë diqane në krie të pazarit. Niqet janë të mira. Djali është në punë të tij. I të pirit jo, i kartave jo. E ç' do më shumë? Të gjitha të mirat..."

Xhemua ven' e vin në qilar. Një këmbë te dera dhe dëgjon se ç' thonë plakat, dhe një këmbë tek zjarri, e shtin xhezvenë. E ndërtoi kafënë, vuri filxhanet në tepsi dhe ja u-shpuri.

Të di plakat e prenë fjalën. Nëna i tha vajzës të krente kazanin n' avli dhe ta vin te luku. Vu e vu, në të parë, pastaj, përpikat, mirë thonë shiu i beharit si vrap i gomarit. Ati bie e ati pushon prapë.

Teto Haxhua dhe teto Qibrua, fjala fjalës thanë si do ta bënin punën. Haxho kapetaneja, do ven me krushqi tek xhiko Ruhua. Kjo kaq herë u-ngre për të ikur, se dreka, po breronte. Shiu dha e dha, bëri atë të tijne dhe më në funt pushoi. Qielli u-qërua me njëherë. U-bë qelq dhe dielli ndriçoi. Macja dolli prapë majë murit dhe lëpihesh. Pulat e lagura erdhën nëpër avli.

U-ngre Haxhua... e ç' të prite më! Qibrua e positi një mijë herë shoqen e saj... pa ajo e dinte dhe vetë. E përcollti gjer tek porta. Thanë të falat e të përfalat. Njera zuri udhën dhe tjetra hiri brënda. I raftë pika, i raftë,



nikoqires. Dreka, dhe ajo s'kish bërë gjellën. Mirë që kish mishtë të zier dhe tëk-e-tëk grijti ca patate. Një qebap e shko tutje.

Koh' e drekës. Këmbë dëgjoheh në sokak: burërija kthehet nga pazari. Teto Qibrua hoqi tenxherenë nga zjari dhe Xhemilja shtroi sufranë.

Plaku dhe djemtë pritëshin të vinin në shtëpi. Nën e vajzë zunë kuvëndin. Të dija lilitnin, po në mënde një gjë tjetër kishin...

## S'JA GJEN ÇIFTIN...

...Pik...pik...pik...pikat e shiut binin mbi drasat e çatisë. S'pushojti çikë dhe Haxhua gjithë natën s'mbylli sinë.

Ndaj të gdhirë...plaka u-ngrë shpejt. Me majat e gjishtreve u-afrua tek penxherja. Zgjati kokën jashtë dhe pa anë mb'anë. Ç'të shikojë? Malet e Lunxhërisë, vënde vënde të larta, vënde vënde më të ulta, zbardhonin. Teto Haxhua ktheu kokën nga e mëngjerta...grika e Tepelenës, qelq. Bregu i Baba Manes dukesh mirë...Shquante teqeja me qiparizet anë mb'anë. Poshtë bregut, qisha e Varoshit, me mezare të bardha. Më në funt ngriti kokën lart, qielli ishte i kulluar. Kur u-bë kjo kohë, tha me vehe.

Teto Haxhua xërmoi përposh dhe vate në qilar. Bëri punët e mëngjesit. I ndërtoi kafenë plakat dhe ja shpuri në qoshk. U-përmbistë, se i kish marë shpirtin gjithë jetën. I kishte ngrënë kokën. E kish plasur me gërnjë. Hodhi të rit e saj për të. Gjithë natën e natës e kish shkuar jashtë. Pinte, si i dilte nga hundët, lonte sa linte dhe këmishën e krahave. Të gjitha taksirate ishin për gruan e zezë! Pikërenës! Uh, moj korba, le t'i lëmë këto. Se si erdh, fjala, po s'janë për të thënë. Pastaj, nikoqirja vate prapë në qilar dhe lau enët e darkës. Qenë bërë tenxheretë, si mos o Zot. I fërkoj e i fërkoj me hi, sa i ranë gjishtëret. I vuri gjërat nëpër vënde dhe fshiu dëndivanin. Me fshesë doli gjer tek porta. Dëgjojtë këmbët e plakat që dilte. E ndoqi nga prapa dhe e porositi për kallamboq...e po ç'të prite akoma.

Teto Haxhua, si fshiu vërat e guxhëvërat, u-fut në qilar. Lau duar e faqe dhe u-ngjit sipër. Vate në dhipato. Hapi sundukun e math dhe kreu gjërat. Hoqi robat e punës dhe i shkundi një çikë. I vuri mbi juk dhe veshi fanellën e leshtë. Ind'e majëlesh. E kish të prurë nga Stambolli. Mbi të holli këmishën e bardhë, plihur' e dorës. Ndreqi mirë jakanë. Pastaj i kallu mëngët jelekut. Mori nga fundi i sundukut çitjanet kashmer dhe i veshi. Lidhi frakazonin tek mesë dhe ndreqi mirë ormaçet. Xërmoi andej dhe në mes të odasë lidhi brezin dhe ngriti me të pëqin me harxhe të zeza. Ishin të qindisura me notra të ibrishimtë.

Tek zuri të dil, i erdhi në mënde që s'kish lidhur jemenin e ri. E hoqi

të vjetrin nga koka, dhe e shkundi mir'e mirë. E lidhi prapë atë. E po, s'ven prapë në dhipato kjo... sikur dhe ta paguajë. Pastaj mirë e kishte këtë se dhe i riu e shtrëngonte një çikë:

Merak madhe kjo plakë. Prapë vate dhe erdhi nëpër odara. Mbilli xhamet, uli perdhete dhe xërmoi përposh. Tek fundi i shkallës veshi xhurapet. Kreu nga ndënë shkalla këpucët vello. Fu...fu...i friu me frimë tozet dhe i veshi. Tek dera, hodhi ferexhenë. Në të dalë, jashtë, u-fut tek gropa e musllukut dhe mblodhi mirë fitin. Pikonte shumë i shkreti. Mbilli der e portë, vuri hapsin në brez dhe mori udhën për te Mirteza Agaj.

Udhët ishin plot. Burërija, kolle kolle dilte pazarit. Fëmila me gjim në dorë, vente për ujë, ku ati e ku këtu. I shkreti, se pa të s'benet gjë dhe hajde gjeje. Pëter pëter e vogël sa një bobollaqe, erdhi tek urat e mbëdha. I dolli shpirti, i u-këput mesi. Kur pa së largu Hamson u-pu-pu ja bëri. Sikur ta pjetete ajo se ku ven, ç'fi thosh kjo? Hop, shtrëngoi udhën dhe bëri sikur s'e pa. Kështu e hodhi hendekun.

Dielli kish rënë di pashe kur ajo u-afrua shtëpisë së Ruhos. Tek porta e zuri një fluturillë dhe i kërcente zëmra si pulë. Xhur i venin djersët. Vuri sinë tek... vrima e portës dhe pa brënda në avli. T'i bin e po mos t'i bin? Po të qenë burat brënda? Po, një oda për njerëz do ta kishin si gjithë bota. U-ndreq dhe tak tak ra. Dëgjoi këmbë dhe vetë e zonja e shtëpisë ja hapi portën.

- "Urdhëro, urdhëro brënda moj xhiko, Haxho", i tha Ruhua, "Miserdhe. Po ç'na je bënë? Pse na ke humbur?" Të dija krah më krah erdhën në divan. Teto Haxhua hoqi ferexhenë dhe e vuri mbi minder. Hapi jemeninë që kish ndënë sqetull dhe kreu sheshelat. I veshi dhe duke vështruar andej këndeje u-fut në odan e mirë. Të dija u-uhnë mbi minder dhe u-pjetën. Kishin kohë pa u-parë, pastaj Ruhua qe mbillur brënda nga ziri i djalit të kumatës së vogël.

Kur u-ngre nikoqirja e shtëpisë të ndërtonte kafënë, Haxhua pa mir'e mirë odanë. Llams e feks. Dishemetë vetëtinin...përt'i i lëpirë me gjuhë. Hodhi sitë nëpë mure...veshur sichade. Zuri përdhetë me dorë, tendosi çarçafet e minderit. Vuri re tantellat me kokoshë. Radhë radhë rinin. Hiri Ruhua në oda, ajo ktheu kokën ngapenxhereja dhe i tha: "e dëgjove shinë sonte? Breroi gjithë natën. E kush pandehu të gshihesh kjo kohë sot!"

Pijtin kafënë dhe Haxhua ziente nga brënda. Sa ta thosh të shkretën fjalë. E pastaj, s'i delte fjala nga goja. Ç'pësoi kështu? Ajo që kish bërë gjithë krushqit' e botës? E humbi si Xhaferi simiten.

- "Ruhua" i tha kjo, "kam një fjalë për të thënë, po të keqen këtu ta thomi dhe këtu ta lëmë. E kupton dhe vetë që këta të ardhur mëngjes, mëngjes, ka një mana".

- Hajli qoftë moj Haxhi. Urdhëro e folë" u-përgjegj Ruhua, "këtu e thomi dhe këtu e lëmë".

- "Të thom Ruhua" dhe hop luajti nga vëndi Haxhua, "kam ardhur me

një krushqi tek djali;" dhe cak shpoi minderin me gjëlperë "me vajzën e Haxhi efendit". Fshiu djersët e ballit. "Dëgjuan që i zë nuse djalit dhe Zoti ta gëzofte. E ke të vetëm, të të rojë dhe e lënç prapa. Unë ju dua te mirën të di par anëve".

- "Mirë thua moj Haxho ... po ja..." zuri të flite Ruhua...

- "Lermë Ruho të sos fjalën" dhe i ra në krahë. "Eshtë një vajzë, për kokë të vajzës. Njeri s' e ka. Ç' ta shoç, si drita. Ka di kosa nga prapa, ashër e pisë të zeza. Ka një si e një vetull që të pret. Surat grumbullore. Ka di të shkreta faqe, që s' i shuhen. E bardh e kuqe. Ka një qafë si zorkadhe, me një shtat barjak. S' të hiqen sitë tek hin e del."

- "Nuk e shaj moj Haxho" u-përgjegj Ruhua "e di, vajza është e mirë, se e kam parë dhe vetë kur ish e vogël. Po tani s' kam në mënde të zë nuse se djalin e kam të vogël. Po dhe këtë e hedh në tok me të tjerat". U-ngre në këmbë, uli perdhetë se zuri e hinte dielli në oda. Ndreqi çiltënë e anës dhe zuri vendin e parë.

- "E di moj Ruho" nisi prapë Haxhua të "thom për kokë të djelme, që më të mirë se këtë, s' ke ku të gjeç. E mirë e nga njerëz të mirë. E çapit e vrapit e gërshërës e gjëlperës. Ç' i she siri, ja bën dora. Gojë ka e gojë s' ka. S' i dëgjonet zëri kallogresë. Mban shtëpinë në kraha dhe me gjithë ata bura. Punon, se nëna s' i ka dhënë ditë të bardhë. I ha mishtë. E ka futur në këmishë, në drekë e në darkë. Hullon e pikëllon si një plakë. Ç' të thom. Do të hapç shtëpinë". Në mes të fjalëve, i kërkoi një qelq me ujë! Sa vate erdhi ajo, Haxhua u-mendua një çikë. Piu ujët dhe u-ngre në këmbë. Ashtu siç ishte i thotë prapë "pastaj s' i ka hapur faqen. S' e kanë rritur me çu-çu-çu-ra si ca. Me palë e me roba që, sa të rojë, nuk do ti bëç gjë. Sepetet për t' i vënë gjunë..." dhe zuri të dilte...

- "E kam në mënde vetë, moj Haxho. Po deshe e u-ngrite. Ri dhe një çikë. Eshtë shpejt".

- "Plot ndënj'a" i tha kjo, "shi të thom dhe një herë, për kokë të djelmeve s' ja gjen çiftin; se nus' e ligë të prish shtëpinë. Po ti e di vetë. Do më uroç natë e ditë".

Nga mesi i odasë, duke folur të dija bashkë erdhën në divan. Ruhua i mbajti ferexhenë dhe të dija duallnë në avli. Ecnë krah më krah, po Haxhos s' i rihesh pa folur. "Plot lule më ke" i tha Ruhos "e mua m' u thanë të gjitha. E unë s' kam ujë për të pirë moj derë-bardhë e jo t' ja hedh luleve. Dëgjo, më ruaj ca farë për mot, nga kjo gol' e ujkut. A ma tufë ma ke vasilikonë dhe livandon. Ri moj korbë, mos i këput degat. Ç' i do, unë jam plakë. Po kjo manxuranë pse është bërë kështu? Karafilin s' ma ke gjë. Trandafilet të kanë hapur të gjitha. Mashalla, plot ke. Do të bëç gjë gjilap sivjet? Ta k' anda avlija."

Ruhua i dha ca degë vasiliko dhe ca trandafile të bardha. I hapi portën, thanë moshëndeten dhe u ndanë.

Haxhua dolli jashtë e lehuar. Të keqen, hoqi një barë nga krahut. Dhëntë Zoti e u mbaroftë. Tani mendonte se si do ta bënte gjith' atë udhë.

Ec' e ec e s'kish të sosur. Ja dha këmbëve dhe eci anës e anës. Me nder zotri s'uaaj, për një çikë e shtipi një gomar. Për qime shpëtoi. Dëgjoi një, që pjete sa e shit barën e druve. Pesë lekë i tha fshatari. U, pika në kokë, tha me vehte, e shesin gjënë, sikur është ball' i dimrit.

E përcëlloi dielli, se i bin në taban të kokës. Vate prapa e prapa bashtesë së Teqesë, gjeti nipin me lakra në duar. E vuri përpara dhe bëri një copë udhë me të.

I u-afua shtëpisë. Në krie të udhës, ngriti perçenë: Tek porta hoqi petën dhe në avli fundin. Te dera gjeti mastrapan me ujë. I hodhi një grusht surarit. Vdiq, për atë Zot, që është një.

Bulçim... një er' e ngrohët frinte. Degët e shegës, që ishte në funt të bashtesë, tundeshin ngadalë. Pllup, pllup ati këtu, binte nga një lule e thatë. Qent e Hisenj efëndiut hamulitnin prapa shtëpisë kur teto Haxhua hiri brënda...

## DALTE NGA GOJA T'ENDE E VAFTE NE VESH TE PERENDISE

Ditët lukuriseshin dhe vapa sa ven e shtohesh. Xhuxhullja nga të katër anët. Bënte dëkën njeriu. Dukesh sikur rinte në furë. Shiu që kish rënë ditët e para, pushoi dhe era u-pre. Në Gjirokastrë bënte një vapë si mos kurë.

Haxhua mbeti udhëve. Dilte në kërcë të vapës dhe pa frimë kthehesh në shtëpi. U-shqijë, u-nduk, sa grisi dhe këpucët. Do mbarohesh kjo krushqi? Ajo këtë donte.

Qibrua, punonte si e marë nëpër shtëpi. Dhe ajo e kish mënden tek krushqija. Bin e ngrihesh po mendja si turjele, i punonte. Një javë më parë kish vënë të lierat. Sa i shkretoi dhe i mbaroi! Lindi dhe një herë. Ergatja që për lumë. Copa copa i la muret. I plasi buzën. Nga të gjitha anët u bëri kalivare dhe vënt s'u la pa pikuar. Zonja e shtëpisë, kur e pa kështu u përvesh dhe bëri fundërat vetë. I ranë duartë sa i kulluan gjak të zezat gjishtëre. I ra bretku, ç' tju thom...

Xhemo kanakarja punonte si nga hera. Vështronte nënën që qe xhind. Po kjo s' i flite fare, se i hidheshin në kokë pastaj. Gjithë ditën e ditës një fjalë dëgjonesh në shtëpi: "plaç të preftë, kokën hangërçë, çit moj shkretëtire".

Kështu shkoi dhe kjo ditë. Të nesërmen teto Qibrua poqi kafënë dhe e hodhi në guf. Mori llostin dhe zuri ta shtipte. Dum...dum...dum...dum...dëgjoheshin të goditurat. Duartë i ulte, i ngrinte, po mënden e kish gjetkë. I vini përpara sive ëndërrat e natës së shkuar.

Gjëpora e gjëpora. Pushoi një çikë, dhe dhangasi me dhënë gjishtin e math të dorës së djathtë dhe u-mendua. I u-kujtua: kish veshur çitjanet kashmer dhe ecënte. Uf e uf me të vrapa. Se ku ven as ajo vetë nuk e dinte. I zihesh frima, kur nëpër këmbë fësht i shkoi një gjë. S' e vuri re mirë. Me dorë ngriti këmbët e çitjaneve dhe pa. Nuk foli po uluriti. Një llahtarë e madhe. Një gjarpër i madh dhe i trashë sa dora. E mblodhi veten menjëherë dhe rrëmbeu nga sheshi një shkop të math dhe bam e bam i ra kaqë herë me radhë. Për të folë mos qoftë. e vrau. Di copa e bëri.

U, pika në kokë! Endër aspo. Zuri prapë kafënë dhe dum...dum Hasn, thonë gjarpëri, po ja e vrau. Ashtu qoftë. Po prapë endër. Kështu foli me vehte. I la më një anë endërat. Me gjisht mori një çikë kafë. E futi në gojë dhe e maçalisi. Kish akoma brobollo. S' qe bërë mirë. Edhe një qint të tjera. I vanë shpatullat, po s' e la për gjismë dhe as vajzës s' i foli gjë. Më në funt u-bë. Me një lugë të dhoktë e hoshi kafënë në bocë dhe e mbushi mirë. E kruajti gurin dhe ato që mbenë në funt i hodhi në një anë të sahanit. I vuri kapakun. U-ngrë në këmbë, shkundi tamllan e çitjaneve, mori gjërat dhe i shpuri në qilar. I vuri nëpër vënde.

- "Ç' u-bë kjo vajzë? Katër sahat!" tha me vete, "haronet në punë". Vate erdhi ca herë dhe futi kokën tek dollapi. Ashtu në këmbë mori ca kapshata bukë, një çikë djathë dhe ca frito qepë. Kur u-shtip mirë fshiu buzët dhe doli në avli. Tëkë...tëkë...tëkë... thiri pulat dhe u hodhi kallamboqin. Më në funt kreu kokën jashtë portës. Po kush shkonte udhës...u Hanua...ven për ujë...mirë që e pa.

- "E ku vete moj Hano kështu mëngjes mëngjes? Pse nuk na je dukur fare? Pse s' vjen kurë këtej për ujë? Ne jemi gjithonte dhe nga një herë s' prish punë".

E futi brënda. I mori gjimin nga dora dhe i foli Xhemos. "Mbushe vajzë këtë" i tha, dhe me Hanon bashkë u ulnë mbi minder të dëndivanit.

Nuk mënojt shumë, kur Xhemileja erdhi me tepsi. U dha kafënë të dijave dhe për vehte u-ngjit sipër. Kur e piu Qibrua e ktheu me qenar filxhanin e saj, dhe "të keqen Hano" i tha "ma shiko një çikë. E di që e ke për gjëmë, po të marça sëmundlën, prapë nuk të thom". Deshi s' deshi gruaja e botës, nuk i tha dot se jo. I zuri guri këmbët.

Hanua e la pak filxhanë. Pastaj e mori në dorë dhe "të mirë e ke" i tha. "Një udhë ju bie, po hë për hë të mbidhur e keni. Një kartë me ca para do març. Gjë ka për të hirë në shtëpi. Keni njeri të sëmure? Jashtë shtëpisë bie, po s' është gjë. Mos u bën merak" dhe vështroi shoqen. Ajo e dëgjonte me kokë ultë. "Po tjetër s' ka gjë?" e pjeti. "Zëmrën e ke një çikë të holasur" zuri prapë ajo, duke rotulluar filxhanin. "Një gjë ke në mënde dhe shumë veta janë në mes. Ca gojë të liga të heqin. Po prapë ti e ke për të fituar davanë. Një gas keni në shtëpi... dhe për së shpejtë. Hu... hu...s' ke gjë tjetër moj nikoqire", dhe i dha filxhanin.

U gëzua Qibrua. "Dhëntë Zoti e u bëftë e daltë puna nd' anë. Hanua, sa për ashtu gjithënjë ja kish gjetur. Janë ca që s'besojnë. Gjithë se kush ka mënden e saj. "Të mirë paç moj Hano" i tha gruas që i rinte pranë "ashtu qoftë. Daltë nga goja t'ënde dhe vafhtë në vesh të Perëndisë. Edhe ti për gaze t'arça. Eqremin për së shpejti ta gëzoftë Zoti me një djalë".

Ndënjën sa ndënjën, pastaj u ngritën. Hanua mori gjimin me ujë dhe iku. Qibros i-u ngroh zëmra. U ul në krie të minderit në dëndivan dhe nisi nga të qepurat. Hidh një gjëlpërë e mendonesh "mbase më heqin vajzën që u heqin osh" e zvara. U thafçin gojë e liga."

Dreka... erdhën djemtë nga pazari dhe u ulnë në bukë. Plaku u mënuua. Xhemileja ngriti sufranë nga sheshi: musakanë e vuri nd' anë zjarit dhe skorllanin në dollap... Kur i erdhi babaj nga jashtë, u ngjit me një herë sipër. Qe me inate. Njeri s'i foli me gojë. E kush i dil përpara! Hë në ja mbante dhe teto Qibros... Atje, vajza i shpuri për të ngrënë, me një tepsi. Kur hangri mir' emirë, Xhemileja nasqirisi gjërat dhe hoqi derën. Haxhi efendiu ra për gjumë. Flin nga një çikë ditën.

Pasdreke... teto Qibrua u ul në krie të divanit, me kanistër përpara. Zuri të mbadhoste xhurapet po koka i mbeti nga udha si do që kish gjith' ato gjëra për të qepur. Xhemileja, me tantellë në dorë, yate tek Zulua. Mirë që e kish atë shoqe e shkonte kohën me të.

Në krie të udhës u duk Haxhua. Qibrua me ta parë, la gjëlpërën në dhe e u ngrit me një herë. Tatëpjetë, shkallave me një frimë, u gjent tek porta. Ajo ecënte si patë dhe kjo e vështronte në si. Ja bënte me duar, i tunte kokën po ajo s'don të din. Se prishte terezinë dhe vinte rëndë rëndë. Shët, ja bënte duke vënë gjishtin në gojë.

M'e të hirë portën, përpoqi duartë dhe i tha "e she që ta mbarova punën! E pe! Nuk të thaçë që fli në një krah? E pe Haxho kapetanen?". Ç'e mbaje, apo s'qe e zonja për krushqi, po të vërtetën, atje ku ja donte shpirti. Qibrua, u druall nga gazi dhe i fekëstinin sitë. Hapte e mbidhte duartë dhe ljala nuk i dilte nga goja. Haxhua e pa dhe i tha "mbaje veten moj nikoqire. Dëgjo, ljalën mos e hap shpejt se kështu është puna. Dëgjomë këtu, se djalin e ka në dhënt dhe pret sa t'i vijë në shtëpi. Për së shpejti kemi nishanë."

Qibrua u bë lejmon nga surati. E humbi nga gazi. Bashkojti duartë, i vuri mbi gjoks dhe e vështroi Haxhon në si. Thoni si të doni, i dukesh e pa besuar. Asaj i tha: "Uh, moj korbë, e lermë të të puth". S'din se ç' të bënte. Nuk zinte vënt dhe nuk shih se ku hidhte këmbën. I hodhi duartë. Ç'e mbaje zonjën e shtëpisë, nënën e vajzës. Gazi i dolli mbi roba.

Teto Qibrua dolli tek porta dhe i foli vajzës. Dërgoi e thiri motrat për darkë. Nuk harojti kunatat. E po gazi, s'shkohet vetëm. Atë natë mbajti dhe Haxhon. Nuk i u ndënj. Përpjetë shkallave e u gjënt sipër. Hiri në odan e madhe. Hapi derën me kadalë. Në funt të odasë ndënji e menduar dhe pa efendinë që flinte. Ta zgjon a po mos ta zgjon? Si të bën tani? Si t'i flit? Kër...

hapi me forcë musandaranë. U ngre plaku dhe Qibrua u ul në fund të minderit. Ja tha burit, tëk e tëk, me radhë, si ka urdhëruar Zoti. Ai e dëgjojt mirë, u ngre përgjisëm dhe s'foli fare, po sitë i qeshnë. "Për hair, t'na trashëgonet moj grua, kjo bilë". U-përgjegj ashtu nëpër dhëmbë.

Për darkë të gjithë u mbluadhnë dhe, pas bukë u futnë në oda të madhe. Gjithë natën, qeshnë e u kukurisnë. Të gjithë u gëzuan. Për gjumë ranë pa kohë po njeri s'mbidhi sinë. Vapë, vapë dhe mbi të gjitha u duadhnë dhe tahtabiqet. Qibrua, ktheu nga një anë, ktheu nga tjetra anë, s'flin fare. S'kish natë më të gëzuar për të. Hoqi një barë nga krahajat. Vajza kur ritet, është perdhe në si për nënën, ferë në derën e babajt. Pastaj edhe pse të mos gëzohesh? E zuri mirë.

Xhemileja... dhe ajo nuk flinte. I dukesh e pabesuar. Nga mendonesh, nguqesh në surat dhe një vapë i hipënte. E kishin zënë tek buri! Mendonte të nesërmen...kur t'i vinte Zulua...kur ta mirnin vesh kushërirat..Seqineja, ajo buzështurëmbëra. Do pëlciste. Pastaj kur të vinin për të uruar. Më tutje do martohesh ... do lin nënë e baba. Kështu duke mentuar e dhifisi gjumi.

Ndaj të gdhirë...Të gjitha flinin kokë më kokë. Udhët qenë mbushur, kur zonja t u ngrënë nga gjumi.

Dit' e re e punë të ra. Qibrua i hoqi hekurin portës dhe lëshojti pulat. Të tjerat dorë me dorë, mbaruan shpejt nga punët. Në shtëpin e Haxhi efendiut qe gazi i vajzës.

## U! U! E KUR KESHTU?

Vapë... mbi vapë. U poq njerëzia. Vdiqnë. Gratë dilnin për hatëre kur ngrihesh dielli dhe plot habere të ra binin në shtëpi. Djal' i Hasaf efendiut ndau gruan. E kish të prapë. Hasibesë në Palorto i vdiq djali në Amerikë. Gjithë jetën kish mbetur andej, pa kartë e pa para. Xha Meteja, ra nga shkallat dhe theu një këmbë. Tek mulla Seferi në Manalat, u ndanë vëllezëria. Kunatat u zunë e u vranë, sa nxuarnë gjak. Mëhaleja u ndau gjënë. Mirë thonë që njeriut, nga vapa i bën mëndja fiu.

Në shtëpin e Beqir efendiut hinin e dilnin graria se Zoti i gëzoi me një djalë. Ç' e mbaje plakun, u-bë baba-madh. Kur i dhanë sihariqet, zuri me dorë një çikë flori, dhe një pendeliron ja vari tek jastëku. Nënua, gdhihesh tek këmbët e djepit.

Dhjetë vjet martuar kish Haxhiu me Manushaqen. Fëmijë s'kishin bërë. Shtëpia kish rënë në të zeza. Një herë u hap fjalë se donin ta ndanin nusen për këtë punë. Po qe e reme. Ajo e zezë, s' kish lënë jatri pa bënë, s' kish lënë jatro pa marë. Pa le ato grarishtet. Po mirë thonë, Zoti mënon, po nuk haron.

Të gjitha gratë vinin për të uruar, me duar plot. Tek koka e lehonës,

kutitë me llokume rinin rradhë rradhë. Nëna e nuses kish bërë plot vogëlina. Të ngrënat s'ja la pas. Vërtet vitet kishin shkuar, por prapë që protare. Don ta gëzonte vajzën si gjithë nënat.

Vjehra vështronte nusen në si. Hë atë e hë këtë dhe hop djalin në duar. Me hakë, s'kish parë të vogël me si. Djali qante dhe kjo ja fute tek sisa nënës.

Odaja që plot. Safua e Bejkos kish zënë krejnë. Në krah i rinte Shefkua. Falesh. Më poshtë, gjithënjë në radhë që ulur halla e nuses. Pastaj plot gra të tjera.

Penxheretë qenë hapët dambano. Një erë e ngrohtë frinte... Bulçim. Në mes të fjalëve Safua thotë "e muartë vesh.. Haxhi efendi u zuri vajzën tek buri".

- "U...u...u e kur kështu?" tha Shefkua, që me një i ikënte jemeniu nga koka. "Tek kush e zuri?" Si është kjo vajzë? Kush që krushqarja?"

- "Tek djali i Mirteza agajt" u-përgjegj një nga fundi i radhës. Nga flite, i dilnin pështimat nga goja. Një surat pillaçko, një hundë poçe. Përçmakë. Ç'ta shihje. Të vinte anicirë ti hidhje sitë. Në kokë kish lidhur dhe një gas të verdhë, pa dukesh nga surati sikur kish lënguar gjithë jetën. E leshrat nëpër surat si mos o Zot.

- "U...u...", tha prapë Shefkua "i mirë ki djalë. Pastaj ka atë baba nikoqir" dhe mblodhi buzët, "atë nënë kapetane" dhe luajti nga vëndi. U bë dillë nga surati, e me një shkumonte. Qe hapur fjalja se don të zinte vajzën e saj atje. Kjo s' e bëri veten.

- "Djali është i mirë" kërcëu gojë-shtrëmbëta "po nëna e mbiti. I zuri atë shahtizmeno. Se she kur në shoqe, si gjithë bota. Pastaj moj të keqen, thonë që është e madhe. I ka vjeçët ndënë lëkurë. U nxiu sinë para. Janë malldarë ata. Ajo është motër në di vëllezër"

- "Mbaje gojën moj nikoqire" hidhet Bekua një thatime që rrin për karshi. I qenë bërë sitë shkëndila, "është turp të març botën në gojë" dhe hop u bë flak e kuqe nga surati. "Vajza as e shahtisur është dhe as e mbetur brënda. Eshhtë e mirë e zgjedhurë.

Mbi gjithë shoqe. Po njeriu le të vështrojë veten dhe vajzat që ka në shtëpi". Dhe prapë s'foli. Thoni si të doni, e goditi me pambuk. Po ç'është kjo, që njeriu tek të rijë, të marrë botën në gojë?

- "U ç'ke moj nikoqire, që flet kështu? Ato që më thanë, ato thom dhe unë" u përgjegj prapë, ajo që ngriti për një çikë gajtanaqë. "Shët... shët..." i tha njera e tjetra..."është dajkëla e vajzës..." Ajo e pipi se e pa që shkau.

Gra të tjera erdhën dhe të gjitha një fjalë kishin në gojë. Djali i Mirteza agajt zuri nuse të mirë, vajza e Haxhi efendiut pati fat. Vajza është si nuri, punëtore e madhe dhe nga shtëpi e mirë. Ç'fat që pati gomarja. U... mi, ç'ka, goban...është!

- "Kush e bëri krushqinë?" pjeti njera. "Haxhua", u përgjegj tjetra,



“ajo e ngaherëshmja. Kapetane. Gjuhën e ka një çikë të gjatë, po krushqit di e i bën mirë. Pastaj me Qibron e Haxhi efendiut, janë mjalt’ e gjalpë. Duhën keq”.

Në të perënduar...të diellit në funt te shkallave u dëgjua një kuvënd. Dëgjohej zëri i Haxhos. Ajo flite dhe të gjitha ngritnë veshët po uah e uah bëri djali, dhe s’muarnë vesh se ç’tha.

Teto Haxhua hiri odanë dhe të tëra bashkë e vështruan në si. Më tundesh e më shkundesh. U ul. U pjet me zonjën e shtëpisë, me njerën, me tjetrën. U afrua tek lehona e pjeti dhe atë. Me qenar i futi ndënë jorgan akllas kutin e llokumeve. Nuk i u ndënj më, dhe vate te djepi. Ngriti buzlën. Tek koka e jastëkut, nënua i kish qepur nazarllëkun me ruaza. Një dhëmb të ulkut, një këmbë të hamorillës, një pisqollë të voçkël, një copë dru nga çerçem i shkretë. S’i kish lënë gjë pa vënë. Pa djalin dhe “Mashalla!” tha dhe pthë pthë pështiu “mos marçç si, more dit-shkurtër. Tërë baba-madhi. U të raftë pika, të raftë. Që tani i ke hapur sitë! Duket që fëmila e sotme ka shejtanin në bark. E në kohën t’onë, donin dizet ditë” dhe i mbuloi suratin. Më në funt iu kthie plakës dhe e pjeti, se ç’emër i kish vënë.

- “Emrin e plakut” tha ajo.

- “E gëzofhtë, e gëzofhtë” u pergjegj teto Haxhua.

“Tani që zuri nga fëmila, bëftë dhe të tjerë. Sa doli frika, sa u hapën udhët... se këto kallogrera kur zënë, bëjnë si krimbat”, dhe gër gër. Kur nis Haxhua të flasë, të bie në kokë.

U ul në shesh dhe prapë nisi nga kuvëndi. “Me zi erdha korba! Ç’është kjo vapë kështu! Për Perëndi, me një na i bën mëndja fiu. Sa të bjerë një shi, se plasnë njerëzia. U erdhi siri në mes të faqes dhe s’dinë ku të gjejnë një komb ujë”.

- “Moj Haxho” i thotë Shukua “po pusho një çikë korbë. Lerna radhë dhe neve. Thujajna një herë se si e bëre këtë krushqi. Këtë radhë punove ndënë dhe”.

- “Eh” tha Haxhua “qe e thëna. Qe per të bënë. Janë punët e Zotit. E di se ç’u bë kjo krushqi! S’ka të sharë. Pse nuk ju pëlqejti? Djali apo vajza? Kush nuk është i mirë? Kjo është krushqija e fundit. U lodha tani. U plaka. Pastaj këto të ratë e sotme, s’pëlqejnë njeri”.

Me fjalë e me kuvënd, erdhi darka. U ngrënë gratë dhe iknë. Bashkë me to dhe teto Haxhua.

Natë...burat u kthien nga pazari. Gratë mbidhnë kotecet dhe futnë gjërat brënda. I hodhnë një si shtëpisë nga të gjitha anët. I vunë hekurin portës, i hodhnë hapsin haurit dhe i vunë katarahun derës.

Kudo një fjalë, kudo një kuvënd. Në qilar për këtë krushqi flitnin dhe në bukë po ashtu. Hiri në vesh të burave. Një shante vajzën, një shante djalën. Një lëvdonte shtëpinë e një pasurinë. Nën at me vajza brënda tundnin kokën dhe mirrin frimë thellë. Mendonin dhe kishin zili. Vajzat e pa martuara bënin

tantellë dhe kishin haset shoqen e ture. Gjuhët e liga shanin, shtrigat, zëmërngushtat u ziente përbrënda.

Kështu e ka kjo botë. Çdo vajzë e ka fatin në kamare, çdo vajzë do t'i vijë dita të martohet. Do vëjë në punë të saj, në shtëpin e jetës. Kështu mendonin nënat, kështu mendonin të pa martuarat.

## DITA E NISHANIT ...

Në shtëpin e Haxhi efendiut, vinin gjërat nëpër vënde. Një javë të tërë kishin që lanin e fshinin. Kruajtën nga të gjitha anët. Brezat i bënë me boja, gjirmën e odas se mirë e liejtin me neft. Teto Qibrua u bë cop' e çikë. Gjithë ditën' e ditës sokëllinte. Hë atë, hë këtë. U mori shpirtin të gjithave nga merakllëku. Me të drejtë, kishte nishanin e vajzës. Gaz' i parë.

Vapa e madhe, që përcëllci njerëzinë, u ul. Kish di ditë që bin shi. E ç'shi. E ku goditi i shkreti? Do të bëneshin këmbë këmbë, jasht' e brënda.

U-gdhi e nesernja, dita e ënjte, e që në mëngjes priteshin krushqit. Haxhi efendi u veshur me të ngushta. Qosteku, di gjisht' i gjerë, dërguar kunati nga Amerika, i varesh nga xhepi i jelekut. Me cingar në gojë, me duar prapa ven e vin nga krej' i odasë në funt e nga fundi në krie. Në odan e mirë, kishin shtruar sininë. Tabaqet me hasude i kishin vënë në mes. An' e mb'ane tabaqet me zariko dhe me bajama të qëruara. E mollë - fiq - dardhë. Një milë të mira. I vritnin të trasha. Edhe pse jo? kur njeriu e ka xhepin të ngrohët.

Dajkot, xhaxhallarët, dhe ata venin e vinin. Në odanë tjetër teto Qibrua, veshur me roba të ra, rinte mbi gjëmbe. Motrat e saja dhe Haxhua herë pas here vështronin jashtë. U mbeti koka nga udha.

Këmbë u-dëgjuan në avli. "Erdhën" uluritën të vogjëlit e mëhalesë. Muret ishin veshur anë mb'anë. Gjijtonet rinin prapa portrave me futa në kokë. Njëzet e pesë veta bëheshin burat dhe gjashtë të vogjëlit. Xhaxhai i Xhemos i pritë tek porta, tjetri tek dera dhe Haxhi efendi u në krie të shkallave. U dha dorën të gjithëve.

U futnë në oda dhe zunë vënt sipas shkallës. U prunë glikonë dhe kur e hangërnë me një zë thanë "të na trashëgonen". Pijtin kafënë, ndënjnë pak dhe pastaj u ulnë për të ngrënë hasudenë.

Të gjithë hanin. Kush flite, kush qeshte, dhe kush fute nëpër xhepe nga një filxhan o lugë. Të zotët e shtëpisë, shinin apo s' shinin? Bënin sikur jo... Në këtë kohë dajkua i djalit, Hämza efendi u xhaxhajt të vajzës' dha një kuti, futur në jemi të mëndafshhtë. Edhe ai i dha në dorë një kuti po, si ajo. Shtrënguan dorën njeri jetrit duke uruar dhe bënë buzën në gaz.

Ustrefi vate andej... u lëshutnë gratë. Teto Qibrua e mori nishanin në

dorë. Zgjidhi kordhelen e kuqe, hapi jemeninë dhe kreu kutin' e ergjëntë. Ngriti pambukun, përhapi zaharin dhe rizin dhe mori pesë lirëshen me zinxhir të florinjte. E ngriti dorën lart dhe të gjitha e panë me si, e pëlqien. "Po ju ç' u dhatë?", pjeti njera "Një unazë të florinjte, me një gur të xhevahirtë" - u përgjegj halla. Mori nga krahu vëllershën dhe vanë andej.

Ku ishte Xhemileja? Ku qe futur? Kishte zënë rëzat. I vinte turp, të dilte në shesh. Zulua i riinte pranë dhe e ngite. Të dia bashkë qenë futur në penxhere të odos së dimrit. Dukesh udha. N'atë kohë, dera u hap dhe e një herë të di vajzat xërmuan. Në këmbë. Xhemiles, i ra një të kuq në surat, kur pa nënën. Ajo i u afërua, i vari florin në qafë, e puthi në ballë dhe e vështrojti në si. "Të më trashëgoneç" i tha. Ajo s' foli fare. Iputhi dorën nënës dhe hallës.

Sa gas i math qe atë kohë për nënën. Nuk ngopesh së shikuari vajzën. Xhemo kanakaren, motrë në di vëllezër. Sa herë natën i kish dalë gjumi, kur mendonte se vajza iu rit. U bë për shtëpin e botës. Sa herë kishte psherëtitur thellë, kur mendonte se vëndet e mira nuk gjëndeshin kollaj. Tani që kjo punë u bë vëndi u gjënt, një gjë ndjente në zemër. Ishte e gëzuar po i vinte një si të qarë. Gëzonte, gëzonte që vajzën e zuri mirë, po mendonte që do ta hiqte nga shtëpia. Mbushi sitë me lot dhe u kthie, me kumatën në krah, në odanë ku qenë dhe gratë e tjera.

Në këtë kohë, burat u ngrënë si pijtin kafënë dhe "t'ikim" thanë në një gojë.

Në krie të shkallave, zonja e shtëpisë, u dha nga një jemeni me pemë, të gjashtë të vogëlve. Ata të gëzuar, xërmuan shkallat. Kutja i rëndonte e se ngrinte dot dhe kutja nuk i pritësh sa të shinte se ç' kishte brënda. Duke shtirë njeri-jetrin muarnë udhën për në shtëpi. Erdhën tek Mirteza agaj. Dhe tek djali qenë mbledhur kushurirat. Të gjitha e panë nishanin. Cave ua zuri sinë, e cave jo. Fëmila u futnë tek nënat e ture dhe lanë jemenitë me pemë. Shpejt jashtë. E kishin mënden tek lodra.

Bura e gra ishin nëpër këmbë, në të di anët. Di shtëpi ishin të gëzuara e Mirteza agajt dhe ajo e Haxhi efendiut. Kushurinj e kushurira ndënjën për drekë e darkë. Nga pas drekeja në të di shtëpitë, desh Perëndia ishin të gëzuara, zunë këngën.

Tek Nexhipi ja thoshin:

*Ç' thanë për mua, për t'inë,*

*Trendelin' oj trendelinë.*

*Dojnë të prishnin krushqinë,*

*Trendelin' oj trendelinë.*


*Dhan' e dhan' e dot s'e prishnë,*

*Trendelin' oj trendelinë.*

*Kot që vejn' e kot që vijnë,*

*Trendelin' oj trendelinë.*

*Neve kishmë dashurinë,*



*Trendelin oj trendelinë.*

Pa mbaruar mirë këtë, nisnë tjetrën:

*Moj muse koqe lajthi,  
Ato që thanë për ti  
T'u bëfçin kurban e hi.  
Gjithë bota fjalë thanë  
Xhiko muse moj sulltanë.  
Ne të zumë e s' të lamë  
Xhiko muse moj sulltanë.*

N'atë kohë, hiri Nexhipi n'oda dhe të gjitha gratë i vanë pranë. S'e lanë të ven prapë andej. Me pahir e muarnë në valle dhe zunë këngën:

*Në pazar dolla një çikë,  
Sos një çik' e gjismë ditë,  
Në saraj më vanë sitë,  
Paçë një vasho një dritë  
Soje, soje vin stolitë.  
Me pasqirë të florinjitë.  
Mos m'u fshih ah moj jezitkë,  
Ne të di jemi fëshnikë.  
Kemi lerë në një ditë,  
Në një dit' e në një çikë.*

Vërtet e zunë Nexhipin, po se linin t'ikënte. "Aman" u thosh, "do vete në pazar, se kam punë. "Edhe një këngë tjetër" i tha nëna dhe "ikë pastaj, djalë të keqen".

*T'erdhi koha çupë të martoneço,  
Dale bandill, dale, jam e vogëlo.  
Dimbëdhjetë vjeç, pa sosuro.  
Dale bandill dale, jam e vogëlo.  
Jam e vogël bandill e s'më lenë shoqeto.*

"Tani edhe një këngë për mua" foli halla, duke hirë derën e odasë, "s' dua fjalë, se shokët ati i gjen dhe s't'ikin. Hajde de, merjani" dhe e zuri Nexhipin nga dora:

*Ç' kam di qelqe me rak.,  
Thom t' i pi, thom mos t' i pi,  
Thom t' i lë për me dolli.  
Mos i mbushni fare plot,  
Se jam djal' e s' i pi dot  
Po t' i mbushni një gjithë firë*

*Se jam djal' e s'më bën mirë.*

Në shtëpin' e vajzës dhe atje kërcite kënga. Gjëmonte shtëpia dhe zëri  
i Zulos dëgjonesh mbi të gjitha:

*Uromë baba, uromë  
Gëzomë baba, gëzomë  
Sot që ndruamë nishanë. (di herë).  
Uratë paç moj bilë,  
M'u plakç, m'u trashëgofc,  
M'u bëfç një zonj' e madhe.*

Seqineja, që kamarosesh, nga ven' e vin në valle nisi:

*Ç' punë më punove sot,  
Moj Xhemo, moj zëmëro.  
Mblodha karafilet,  
Nexhip të di sit' e mi.  
Mblidhmë dhe mua nj'a di  
Xhemile moj zëmëro.  
Më qërtojnë në shtëpi,  
Nexhip të di sit' e mi.  
S' të qërtojnë vallahi,  
Moj Xhemo, moj zëmëro.  
Më qërtojnë për Perndi,  
Nexhip të di sit' e mi.  
Mos më bën të vi ati  
Moj Xhemo, moj zëmëro  
Të t' i shkul me gjith kuti  
Moj Xhemo, moj zëmëro.*

Muarnë në valle Xhemilenë dhe nishë një tjetër këngë:

*U ngréçë nga gjumi,  
Dolla te divani,  
Paçë Nexhip benë,  
Që dil nga diqani.  
I holla sevdanë,  
M'u te xhamadani.  
Burë do ta mar moj  
Më therë mekani.*

Pa e këputur zunë tjetrën:

*Moj moll' e kuqe majhoshe  
Kur më doje, pse s'më thoshje.*

Të dua o mik të dua,  
Sit' e vetullat e tua,  
Më shtunë në stromë mua,  
Sa lëngova di tre muaj.  
Di tre muajt' e beharit,  
Të gushitit, të allonarit.

Jo vetëm pas dreke, po dhe pas darke kënduan-me zë. Më në funt ja kthien kaurçe:

*Dridhe përdridhe,  
Shaminë me lule  
Hidhe moj hidhe  
Hidhe përbi krie  
Se j' e bardh' e nxie.*

Nuk u lodhnë me kaqë:

*Filxhani larë me bojë,  
Keshë mall pa të kërkojë,  
Nga bukurija të dojë.  
Të dojë nga bukurija,  
Vashë leshëra-mavrija.  
Moj të keshe mënt' e mija.  
Mënt' e mija moj t' i keshe  
Saraf në Stamboll do jeshë  
Treqint lira do t' i keshe.  
Do t' i mbaje nëpër xhepe  
Nëpër xhepe, në jeleqe  
Nëpër xhepe do t' i vije  
Ver' e raki do t' i pije.*

“Pa këndonin një herë atë këngën, të shkretën si e thonë... Në goj' e kam e se gjej dot” foli Qibrua. “Atë të birbilit...”

*Birbili këndon në mal, ja tha Zuluva  
Zëmërën ma mer.  
Vajza në bashte të madhe,  
Lotët po i derdh (di herë)  
Bashteja me protokale,  
Birbili ja thosh,  
Qante vajza për birbilë  
Për një palo zok (di herë).  
Që këndonte aqë mirë  
Sa që s' dujon dot.*

Kënduan dhe këtë:

*Dolla një dit' në bashte  
Trandafil' manushaqe  
Mora erën e luleve  
Trandafil' manushaqe  
E bukur lule që je  
Trandafil' manushaqe  
Të bukur erë që ke  
Trandafil' manushaqe  
Je fshehur ferave  
Trandafil' manushaqe  
Fshehur' e njeri s'të sheh  
Trandafil' manushaqe  
Diell dhe erë s'të reh  
Trandafil' manushaqe*

Kënga kreu këngën:

*Dolli Nexhipi te fura,  
Kish fustanë tura-tura.  
Thoni gjithë mashalla,  
Bej-efendëm, çak-jasha.  
Dolli Nexhipi te shega,  
Kish fustanë dega-dega,  
Thoni gjithë mashalla,  
Bej-efendëm, çak-jasha.*

Sa mbarohesh njëra, zihesh tjetra.

*Më thanë se u sëmure,  
Aman mike, aman nure,  
Aman moj se më sëmure,  
Moj të math maras më vure,  
Aman mike, aman nure  
Aman moj se më sëmure,  
Në diçan erdh e më thanë,  
Aman mike, aman nure  
Aman moj se më sëmure,  
Tre para bleva zhivanë,  
Aman mike, aman nure  
Aman moj se më sëmure,  
Do ta pija po s'më lanë,  
Aman mike, aman nure  
Aman moj se më sëmure.*

*Nënë qenj'a me vëllanë,  
Aman mike, aman nure  
Aman moj se me sëmure.*

Kujto një teto Qibrua e ze Seqineja.

*Lale-lule,  
Çupë ku je.  
Ja tek jam ç'më do more  
Hajde të vemi përpyetë  
Hajde ti pa u vi vetë.  
Hajde të vemi në stan,  
Hajde ti që je çoban.  
Hajde të vemi me dhi.  
Hajde ti këmishë zi.*

Po dhe teto Haxhua s'bin poshtë. Vetë këndonte.

*N'atë qoshk që rrije t'inë  
Fatime moj lule,  
Rin beu të bën sehër  
Fatime moj lule.  
Të bën sehër dollomanë  
Fatime moj lule.  
Dollomanë me kollxhaqe  
Fatime moj lule.  
Me njëzet e di barjaqe,  
Fatime moj lule.*

“Edhe një” thanë “dhe sado kënduam”

*Hanko kur do vesh te nëna  
Hanko e Tiranëso  
Çup e Elbasanito  
Jo sonte po nesër mbrëma.  
Hanko e Tiranëso  
Çup' e Elbasanito.  
Më preu beu një par mënga.  
Hanko e Tiranëso  
Çup' e Elbasanito.  
Prer e qepur allafrenga  
Hanko e Tiranëso  
Çup' e Elbasanito.  
Keshe di tase në dorë.  
Hanko e Tiranëso*



Çup' e Elbasanito.  
 Hanko e Tiranëso  
 Një me akull, një me zborë  
 Hanko e Tiranëso  
 Çup' e Elbasanito.  
 Hanko mos shko nëpër vare,  
 Hanko e Tiranëso  
 Çup' e Elbasanito.  
 Se të vdekurit i ngjalle  
 Hanko e Tiranëso  
 Çup' e Elbasanito.  
 Hanko mos shko nëpër sheshe  
 Hanko e Tiranëso  
 Çup' e Elbasanito.  
 Se të vdekurit i qeshe  
 Hanko e Tiranëso  
 Çup' e Elbasanito.

Kënduan sa iu ngjër zëri. Dhe kënduan gjithë natën. E jashtë s' dëgjohej gjë tjetër veçse avazi i saj që përhapej nga një mëhallë në tjetrën gjer sa humbite fare.

Pa kohë kënga u-pre. Gratë ranë për gjumë me fëmijët pranë. Llambat u-shuan dhe shtëpia mbeti xëc e si e vdekur. Jashtë dëgjohej të hamuliturat e qenve. Ndonjë mace që zihesh me një tjetër e mjaulisnin mbi çatira. Ilet se venin e rralloheshin dhe herë pas here dëgjohej zëri i kokoshëve që njeri pas tjetrit e lëshonin zënë.

## SA TE VIJE...

Nishani u-bë, po fjalët e botës moj të keqen, s' u-sosnë. Të pesëqintat i vunë sipër vajzës. I marçin të keqen' e këmbës, i marçin. Tëto Qibrua, e humbi. Me një prishës gjaku. I vinte plasëlë se vajzën, as të çalë e kish, as më të ligë nga shoqet. Po me gjithë këto, nga një herë i hipënte një frikë. Zoti na ruajtë, nga gojët e botës. Sa vajza janë zënë tek buri, me nishan dhe prapë janë lënë.

Në shtëpin e Mirteza agajt, zonja e shtëpisë mendonesh. I hoqnë mënden e kokës, njera e tjetra. Njera ja hiqte nusen që zuri, dajkëta i thosh pse u-shpejtove, motrat i jipte gairët "hë, ç' je e marë, janë fjalë pa bina". Kë të besonte e zeza? Vërtet Xhemilenë e kish parë kur ishte e vogël, po njeriu

ndrishon me vite. Pastaj thosh me vete: "Si i ka hujet? Nëna e saj e urtë ka dalë, po nga një herë trandafili bën gjëmb dhe gjëmbi bën trandafile. Bukurija, s'hin në punë dhe aqë. Ajo shkoi e ikën po të siferurit është gjithë puna.

Nuse mirë të nderon dhe nuse ligë të prish shtëpinë.

Teto Ruhua, me dridhmë i dërgoi fjalë teto Qibros, që brenda javës do ven për të parë nusen.

Teto Qibrua, mblodhi kunatat dhe motrat e të gjitha bashkë hulluan një ballkava të mirë. "Sa të më vijë dhe kjo krushkë" thosh me vete "e të mbledh mënden. Vdiqa në këmbë nga njerzit. Në gaze u-vaqca".

Dërgoi e thiri Qaton, djalin e furxhiut. I dha tepsinë e bakllavasë. E porositi një milë herë "të marça të keqen Qato, t'u bëfça kurban, ki një çikë mënden. Shi se po ma bëre këtë të mirë, xhoxh do të të jap. Thuaj dhe furxhiut". Ndënji në këmbë tek porta sa u fut ai te sokaku. Në darkë, kur erdhi tepsija nga fura, tundi kokën. Vuri buzën në gaz: që goditur. I hodhi sherbetin dhe e la sa e piu mirë. Pastaj mori ksitrën dhe tëk e tëk i kreu thelat. I vuri në tabak, dhe e qiçiti në dollap.

Të nesërmen u-ngre me llambë. Pa Xhemon që flinte. I vin keq ta zgjonte. Dhe ajo kallogre u-rop gjithë ditën. I kulloi gjaku në këmbë dhe shkriu si qiriri këto ditët e fundit. Hajde eja me kafë dhe shtëpitë të larta. Të hanë shkallat. Mëngjes për mëngjes, lante tatëpjetelat. Motrat që thiri për punë, më shumë bënë rëmullë. Me një rallë fëmilë dhe gjarpërinj. Po punët duheshin bërë tani, pa ato vanë e shkuan: "Xhemo, Xhemo" dhe nëna e tundi me dorë "ngreu të keqen se kemi plot punë për të bërë". S'përmendesh dhe ajo e lëshoi zënë më shumë akoma. E tundi dhe një herë mir" e mirë dhe prapë i foli: "u pika në kokë, akoma do të fleç moj gjumashe...puna është në dhe. Hë, ngreu tani". Ajo llahtarisi dhe hop u-ngre me një herë. Ashtu e përgjumur nisi nga nasqirizmat.

Burat akoma flinin. Nën'e vajzë, të dia bashkë zunë nga puna. E madhja bëri ashtëlinat. Lëshojti pulat, kreu ujë nga pusi, fshiu avlinë dhe portën jashtë. U fut në qilar si zakoni. Kreu hapsin nga xhepet e çitjaneve. Hapi dollapin, mori një kërcë bakllava. E maçalisi. Lëpiu gjishtin uth... "është goditur tha..."

Me drekë bashkë, u mbaruan të gjitha punët.

Pas-dreke... e para nga të gjitha erdhi Haxhua. Dhe ajo rinte mbi gjëmba. Sa të vinte kjo krushkë. Nuk ishte kjo krushqarja? Si kur të ngjante nonjë gjë, nuk e zinte dhe këtë turpija? U pu pu mos o Zot. Lark qoftë dhe nga magjitë. Nuk qe ajo që e shpuri vajzën në qiell? Vërtet Xhemua s'kish të sharë, po siri është damar-damar. Për një çikë, erdhën motrat dhe kunatat.

Të gjitha ishin veshur e ngjeshur mirë. Xhemilesë i huadhnë një sade si në portokali. Mëndafsh nga i Amerikës. Ja kish prurë, dajko-madhi kur erdhi për herën e parë. Halla e saj, që dinte gjëlpërë ja kish prerë. A po s'ja kish goditur. Në krie ja kish bërë fruda-fruda dhe përpara me një fletë. Zulua

i krehu leshërat, i kreu kapetat në surat. Ajo e ndreqte e kësaj i dridhesh buza dhe i binin djersë të ftohta.

Në nëntë të ditës, ra porta. "Erdhi" thanë me njera-tjetrën. Teto Qibrua dolli vetë gjer në funt të avlisë. E priti krushkën. I priti më mirë, se Teto Ruhua kish ardhur vetë e dita. Ato përpara dhe ajo pas, vanë sipër, ku motrat e saja dhe kunatat ishin nëpër këmbë u duallnë përpara. Krushkat zbuloheshin dhe njera u-mirte petën, tjetra fundin. Tek bënin gjërat kallëp, pjetnin njera-tjetrën: "po kjo me të çila është?" Të gjitha bashkë u-futnë në oda me rollan në zemër. Të shtëpisë u vunë çiltënë krushkave dhe zonja Ruho me kunatën e madhe u-uhnë në krie të odasë. Nezaqeti mbilli penxherenë që u binte pas krahave. Krushkat u-pjetën më parë me Xhiko Qibron, me Haxhon në funt fare me të tjerat. Zonja Ruho, rin sa rin dhe vin buzën në gaz, dhe hop hidhte sitë nga dera.

Xhemileja, nga odaja tjetër, dridhesh e tëra. Me një i dilnin lotë nga sitë. Zulua i rinte pranë dhe kërkonte t' i hiqte frikën. Don ta bënte të qeshte, po ajo s' don të dinte. E sa herë u-bë për të vajtur andej! Hidhte ca çape dhe kthehesh prapë. Nëna e saj, nga një anë kuvëndonte me krushkat, dhe nga ana tjetër e kish mënden tek vajza. Priti e priti, pa se u zgjat puna. Me qenar u-ngre nga vëndi dhe vate n'oda tjetër. I dha një tëllësëm të mirë dhe u-kthie prapë në oda.

Nuk shkoi shumë, kur hiri Xhemileja. I dridheshin këmbët. Sadeja portokali i kish qe. Zinxhiri i florinjte, i shquante në qafën e bardhë. Të verdhët e suratit u-bë të kuq, kur po afrohesh tek vjehra. Mirte frimë thellë dhe dëndur. Zëmëra i kërcente si pulë. Leshrat e zeza pisë e të krehura mirë, vetulla pë, ai si i math, ajo gojë si kuti: Dukesh si kokon e Stambollit. Kur erdhi përpara zonjës Ruho, theu gjurin e këmbës së mëngjërtë dhe i zuri dorën. Kështu bëri dhe me krushkën tjetër. Të dia e vështruan mir' e mirë dhe "ulu vajzë" i tha vjehra. Xhemileja zuri vënt në funt të minderit me kokë ulët. Teto Ruhos i dolli gazi mbi roba dhe buzët i venin fite-fite. E pjeti nusen dhe ajo u-ngrit në këmbë.

Teto Qibrua që qe prerë nga surati, luajti nga vëndi. Nga ana tjetër e minderit, Haxhua u-shkrifërua. Nisnë kuvëndin me gas. Xhemileja vate andej, mori tepsinë me gliko dhe ja dha vjehrës më parë... e të tjerave. Hodhi çape, prapa e prapa dhe kur pruri kafënë, me tepsi zbrazur ndënji shtruar në funt të odasë. Nuk i dridheshin këmbët si më parë. Të kuqt' e shumë i iku, po sitë i mbante të mbërthier në dhe. Në funt mblodhi fëlxhanet dhe vate andej.

Flitnin të gjitha po të shtëpisë një çikë më me tertip. Një nga kunatat e teto Qibros, pruri fronin dhe e vuri përpara krushkave. Bakllavaja në mes dhe të gjitha u-afruan një çikë.

- "Urdhëro Xhiko Ruho" i tha teto Qibrua-"ha si në shtëpinë t'ënde. Dhe zotrote" i u kthie krushkës tjetër. "Merr këtë thellë nga mesi, që ka lënk. Do ta hani, për kokë të fëmilës, se më mbetet hatëri. Ato jo, e këto po, deshnë, s' deshnë, e hangërnë të gjithë thellën. Në kapshatën e fundit thanë "të na

trashëgohen dhe në të pa martuarve". "Amin" u-përgjegj teto Qibrua.

Pas të ngrënit, nisnë prapë nga kuvëndi.

- "U shtrënjcua jeta" u-hodh Haxhua, që me zi priste sërënë të fliste dhe të hapte gojën si e ka zakon, "e në kohët e para, hante qeni petulla. Njeriu me një frangë ngrinte pazarin dhe mbushte shtëpinë me një milë të mira. E tani jo tallruea që s'ka duk po edhe anapolona t'ikën nëpër duar. Sa të hapçç e të mbidhç sitë. E ç'bleve thua. As ti vetë nuk di..."

- "E tha zonja Ruho moj mirë ne, po fukaraja e zezë ç'bënet? Si ngrisen e si gdhihen? Të këputin shpirtin. E kujtja t' i japçç më parë, se mos janë një e di, po deti. Pa le sivjet të ftohtit që na bëri në të dalë të dimërit. U tha njerëzia. Mbenë pa dru e pa thingjill. Derman në pazar. E paguan thingjillin si frëngu pulën".

- "Me hakë", hidhet teto Qibrua "po jeta kështu e ka. Një fjalë është ajo për njerinë që s'ka se është mësuar. Do të thuaç fukara, e po jo dhe kështu gjithë jetën. Po unë kam parë zonja të mira, që kanë hedhur çarçafin e bardhë në kokë dhe kane dalë portë më portë me torve në krah. Po kjo s' durohet. Po janë ca që s' duan të punojnë. Po ne ç'jemi që lodhemi gjithë ditën e ditës në shtëpi. S'rimë kurë me duar lidhur. E le t' i lëmë këto, po sivjet ç'është kështu? Në dimër na griu të ftohtit e në behar na plasi vapa. Po kjo e zezë Gjirokastër pa ujë? Gur e mur. Vdiqnë njerëzia, iu shqie siri. E u-benë bucelat me ujë, sa s'blenen. Një ditëzaj, përpara beledjesë i ndajtën fukarasë nga një okë kallamboq, që mbihtë mbi gur, mbihtë. U-vranë. Po ngoset ulku me miza".

E kështu, fjalë-fjalës erdhi darka. U-ngre Zonja Ruho bashkë me kunatën. Xhemileja u mbajti ferexhenë. Të gjitha i përcuallnë gjer tek porta. Nusja u zuri dorën. Ato muarnë udhën.

Të shtëpisë erdhën në oda. Mbi jastëk tek vëndi i Zonjës Ruho, gjenë një copë të pa prerë, si në lilak. Për roba kjo. E mirë, nishan. Më tutje, një palë xhurape dhe një gas si në bar të njomë. Këto ishin nga xhikua e madhe.

- "Lerja për palë i tha Haxhua Qibros".

- "Për palë po çë, ja ktheu, Tani s'është kohë për të prerë roba të ra. Ka plot sapima nëpër udhë. Të grisi një herë ato pa ka Perëndia".

Nuk shkuan shumë kur u ngrënë e iknë dhe kushërirat... Xhemileja zuri nga punët e darkës. Vuri gjërat nëpër vëndë. Teto Qibrua kur mbeti vetëm, mori frimë thellë. I dolli frika. Tani bota, le të flitnin sa të donin, se kish për pesë. E vuri festen mbi si.

Në darkë erdhën burat...Dhe ata, hë, pritnin me gojë hapët. Teto Qibrua ua tha një nga një të gjitha dhe ata u-gëzuan. Hangërnë bukë me oreks. Të gjithë bënin sa bënin dhe vështronin në si Xhemilenë. Asaj i hipënte një të kuq në surat. I vinte ashtu nga babai, pa nga vëllezërit, s' don të dinte.

Të gjithë mendonin se do vinte një ditë, që do të ndaheshin. Shuquri, vëllaj i vogël, mbushi sitë me lot. Tani i kujtohesh, kur qenë të vogjël, ziheshin me motrën. Nga leshërat ndukeshin. "Sa të ritesh" i thosh ki le të lipsesh se

s' të duam këtu. Ajo i hidhte graxhot dhe hë ja bënte, duke i krier gjuhën jashtë. Pastaj i binte grushteve dhe ulurinte nëpër shtëpi. "S' dua, s' dua, hë, këtu do të ri gjithënjë. Të pëlcaç, të pëlcaç. Nana foli Shuqurit."

Nata i mblodhi njerëzinë. Gjumi shtrin kokollat e grave. Teto Qibrua sa ra e zuri gjumi dhe në shtëpi tjetër zonja Ruho qe më tuje. Me gas në zemër, zgullosoi krahat e Nexhipit, si nga nata. Qe e zotëruar pas tij edhe tani që u-bë i madh. Djal' i vetëm, gaz' i nënës e i babajt, binaja e shtëpisë. E kish si dritën e sive, se djali i vetëm fill' i këputur.

## NIGJAHU ...

Behari iku... gusht' e gunë dhe vjesht' e lugë. Janë ditët e para të vjeshtës. Vapa u-pre dhe shirat zunë. Mbanin di tre ditë me radhë dhe koha prapë hapte. Gratë zunë punë të ra. Se gjithë beharit bënë petrat e osat. S' haruan trahananë. Haen të shkretat dhe dimëri i ka këto. Leshërat i lajtën, stromët i shtunë dhe i vunë ne juk.

Ditët sa më shumë shkonin, aqë më shumë shirat u-dëndëruan. Fletët e pemëve u-sverdhuar, lulet e kutive u-thanë dhe rushtë u-ëmbëlçuan.

Nikoqiret ngritnë munderet nga dëndivanet dhe i shpunë në oda të zjareve. Hoqnë çarçafet e bardha dhe shtruan makatet. Hapnë mesëlat dhe krejtin çullet. Hoqnë perdetë e holla nga penxheretë dhe vunë të trashat. Dimëri afrohesh dhe të ftohëtit pritesh.

Tek Haxhi efendiu shkundnë anë mb' anë shtëpitë. Gjë s' lanë pa bërë. Kishin vajzë për të martuar dhe s' dihesh kur e mirnin.

Një ditë, pazarit mulla Xhevdeji, kunati i Mirteza agajt, zuri Haxhi efendinë "Të ënjten që vjen, kemi nigjahë" i tha, "Atë kartën nga Muftiu e mora". "Peqe, peqe, kur do që të doni, kur do që të urdhëroni..." u-përgjegj babai i vajzës.

Erdhi dita e shënuar dhe tek an' e vajzës u-mbluadhnë burat. Ishin nga të di anët. Të gjithë pinin cingar dhe pritnin imamin e mëhalesë. Xha Ismeti, veqili i Xhemilesë kish zënë krejnë dhe s' flit fare. Ivzi efendiu dhe Fahri agaj, të di shahitët e Nexhipit, kuvëndonin me zë të lartë. Nga një herë, hidhesh në fjalë edhe Ferdi agaj, veqili i djalit. Gë... gë qeshte dhe haup hapte gojën. I pëlqenin shumë shakatë. Eqremi, kushërirri i parë i Xhemilesë dhe Shefqeti, nip i shtëpisë venin e vinin nëpër këmbë. I zuri hera dhe ata të bëheshin shahitë për Xhemilenë.

- "Ç'u-bë jahu, ki njeri" thosh Haxhi efendiu. "Tuaf dhe Zoti na ruajtë. Sikur si thaçë të viç me kohë. Pa ngreu, more djalë, dil e shih një herë" dhe i kthehesh Eqremit...

Nuk hariti të soste fjalën kur imami hiri në oda. Të gjithë u-ngrenë në këmbë, i lëshuan krejnë. Ai fshiu ballin me jemeni, ndreqi sarëkun, ngriti cepin e xhubesë dhe më në funt u-ul. I dha Shefqeti një cingar. Ai vuri dorën në gjoks dhe "hejvalla nuk pi evlat" i tha.

Prunë kafënë...Burat zunë kuvëndin dhe gratë rinin prapa derës të dëgjonin. Teto Qibrua, kish marë Xhemilenë n'odan' e zjarit dhe e kish ulur mbi fron. I vuri musafë mbi kokë, këmbët në legen me ujë të vakët dhe një flori në gojë.

- "E" dajkua i djalit "të na trashëgonen dhe nigjahu u-bëftë me 700 grosh".

- "Jo mor Zot" u-përgjegj xhaxhaj i vajzës, duke dredhur mustaqet, "mos e thuj atë fjalë prapë, efendëm. Bah, punë që s'bëhet kjo. Aqë shitet një lopë".

- "Mos e prishni" tha Ismeti "e pë bënëni me 900 grosh". Nga hapte gojën, mbillte një si. Të gjithë vështruan atë plak. Dukesh si i humbur. Kish di si të fucqosur, një hundë sa një palltëxhane e të zezën kokë, tabak. I kishin mbetur di fill lesh sa për be... Rin sa rin dhe shtrëmbëronte buzët e frinte bulçitë. Të gjithë i mori gazi.

Ivzi efendiu, bur' i lehtë, i vuri kapakun e fundit. "Një mil' enjë grosh dhe le ta mbarojmë këtë punë" tha.

Pijtin nga një qelq me sherbet. N'atë kohë u-ngre imami në këmbë. Kruajti zënë, vuri gjozlluqet në malë të hundës, ngriti një çikë mëngët e xhubesë. Vështroji nga ana e djathtë dhe pjeti "ti veqili i djalit, e do për nuse, vajzën e Haxhi efendiut te Nexhipi, i biri i Mirteza agajt?" "Si urdhëron" u-përgjegj xha Ismeti. E pjeti tre herë me radhë. Mblodhi vetullat imami dhe e kthi nga ana tjetër: "ti veqili i vajzës, e do për burë, Nexhipin të birin e Mirteza agajt për Xhemilenë, vajzën e Haxhi efendiut?" "Si urdhëron" u-përgjegj ai. U-bë tre herë prapë kjo punë.

U-ngrenë të shtëpisë dhe prunë kart' e mellan. I shkruan të gjitha. Shahitët e të di par anëve vunë imzanë. Më në funt e mori Haxhi efendiu kartën, e palosi më katërsh dhe e futi në xhep të palltos. Ndënjën dhe një çikë dhe u-ngrenë. Një nga ta mori copën e nigjahut me vehte. E njeri pas tjetrit xërmuan shkallat. Muarnë udhën e pazarit.

U-mbarua dhe kjo punë. Teto Qibrua e mblodhi mënden fare. Tani pala i kish mbetur pa mbaruar.

Xhemileja që atë ditë ra përmbis pas të qepurit. Gjithë ditën me gjëlperë në dorë. Nuk ngriti kokën fare, sa dhe punët e shtëpisë ja bënte nëna. Pastaj, qenë plot kushërira dhe dorë më dorë i mbaronin. Ishin të gjitha pela, me shpatulla të gjera sa porta.

Pala, pala, ajo i hante kokën nënës. Me të drejtë, se ajo do të dëftonesh në botë. Nuk e donte më të ligë nga të shoqeve, po si e si më të mirë. Vajzën e kish të vetëm dhe don ta krente si zonjë.

Nëna ngriti pazarin. Burin, vërtet të kursier e kish po ajo ja kish thënë që në krie punën. Po pastaj moj të keqen dhe ai për vajzën, sikur me grushte të hidhte paratë, si dukesh gjë. Hë, vetë në mos këtë dhe atë. Si kështu dhe gruaja vetë çuditësh. Ble atë e ble këtë po gjërat s'kishin të sosur. U-harua kjo, e dil prapë. Hë, s' u-bë e mirë e ble një tjetër. U-bë i ngushtë, toto Qibrua shkulte faqet. U-bë i gjerë, ca më mirë. Eshhtë për sot, po edhe për mot. Ç'ti bëç të voglës, pa të madhes...

Xhemilesë i ra shëndeti. Shkriu si kripa në ujë. Faqet e kuqa si molla, u-bënë si lejmon, po gjëlpërën se linte. Jo, jo, nuk qe nga puna vetëm. Vajza mendonte. Për së shpejti do martonesh dhe do të linte këtë shtëpi e njerëzi. Nga një herë kur binte, xhur i venin lotët dhe e bënte qull jastëkun. Vjehrin ashtu i kishin thënë ca, e kish hujli. Kjo dridhesh. Si do të bënte me ata njerëz, me atë plak. Mban shtëpinë me një milë të mira, i kish thënë një ditë nëna, po kjo kishte frikë. Po, kishte frikë të madhe. Po buri, si qe? I vinte turp nga vetja kur mendonte kështu dhe mbulonte kokën me jorgan. I dukesh sikur e shihte njeri dhe i kuptonte atë q'i shkonte në mënde. S' e kish parë kurë, as nga vrim e portës, as nga ndonjë penxhere e hallës q' e kishte shtëpinë afër me atë të Mirteza agajt. U-zu te buri, s' dolli më nëpër udhë, as e mbuluar se ashtu donin nga shtëpia e Mirteza agajt. Ç' do thoshte vjehra, sikur të dëgjonte?

Kushurirat, Zulua i vinin gjithënjë. Kur kishin punë e ndihmonin. Kur ishin vetëm vajzat e vajzat, qeshnin e kukuriseshin. Xhemileja që dukesh aqë e urta e hapte gojën kaq kur ishte vetëm me shoqe. A po s'ja u kthente: "hë, hë pa dhe ju do të martoneni, një ditë. Për së shpejti dhëntë Zoti e të bëneni shoqe me mua. Marçi nga një plak". Ha, ha, të gjitha. Nxiheshin në gas. Kur hinte në oda teto Qibrua, ulnin kokën me një herë dhe bënin sikur punonin. Ajo kthente krahah, hop në këmbë Zulua. Zin e përqueshte njerën e tjetrën. Eshhtë e vetëmja sa për ashtu. Ecënte si nus' e Ustrefit dhe fliste me gjismë zë e të hollë "katënzhikë, uë... e pse u-lodhe zotrote, pse jam unë?" Pastaj nusëronte, si nuse Shefqetit. "Mos ma sha" i thosh Xhemileja "se e kam nusen e kushuririt. Ri mirë se do t'i thom. Do të të vejë në tropil, në grikë të topit. Zulua punën e saj. Përqueshte edhe nënën e saj, kur dil e u-flitpulave, me çitjanë në duar "u pu pu kallogreja, mos më gjejë dhe njeri kështu. U... u... bie porta, mos e hap vajzë, ja ja..." dhe gu gu të gjitha bashkë.

Ditë me radhë, kjo punë. Njerëzia akoma vinin për të uruar dhe teto Qibrua çdo ditë prite një xhevap nga shtëpia e burit për marëlë.

Ç'të bëjë njeriu, këto kanë vajzat. U pu pu, sa t'i zëç tek buri, pastaj duan martuar. Më mirë të bëjë njeriu krimba se sa fëmëra. Pesqint andralla. Nënata sa i kanë të pa zëna, u ikën mëndja. U del gjumi natën. Ikën kjo, vjen martesë. Nuk mbaron me kaqë. Nëndë muaj nuse dhe barku plot. Bëhen vogëlinat, tjetër palë. Dërgonen të ngrënat. Mbaron këtu? Jo. Shkon me burë nuk shkon me vjehër. Ajo e prapë, vjehri me huje, nusja e pa dëgjuar. Të gjitha

këto i mendojnë nënat, të gjitha këto janë për nënat. Të gjitha këto vinë nga vajzat.

Kështu flite teto Qibrua me vehte dhe këto u thosh motrave. E puno natë e puno ditë. I rëndesh kësaj që kishte një vajzë po ç'të bënin nënat që kishin nga tre a katër? Po gjithë se kush për vehte.

Gdhihesh dita, ajo në qilar. Ngrisesh ajo atje. Kështu shkuan sahatet, kështu ditët dhe kështu muajtë. Xhemileja qindiste dhe teto Qibrua nasqiriste.

## PER SE SHPEJTI KEMI DASMEN!

Katër muaj apo më shumë kishin Shkuar? Po katër muaj e ca ditë kishin ikur, që kur teto Qibrua zuri vajzën tek buri. Shpejt iku koha, po me punë. E zonja e shtëpisë e shkonte ditën me të qepura se i zin dora. S'kish vënë këmbë jashtë shtëpisë.

Një ditë u-ngre që në mëngjes dhe bëri niet për të dalë. Qe turpëruar me njerëzinë dhe më shumë e më shumë me krushkën. Pika në kokë kësaj e kush e di se ç'mendonte dhe ajo. Hë, sa kish hall të zinte vajzën dhe tani as që duket fare do thoshte me vete.

U-vesh mirë, më mirë se çdo herë tjetër. Kish ditë që koha qe bërë pambuqe pambuqe. S'bënte as ngrohët, as ftohtë. I tha vajzës se ku do vente dhe nga pasdrekeja mori udhën për në shtëpin e Mirteza agajt. Kokë ulët shkoi nga mesi i pazarit. S'e njihte njeri. Pastaj dhe ç'e hiqje gjith' atë udhë troiro e troiro. Po zhang-xhing udhët. Erdhi tek shtëpia e krushkës dhe teto Ruhua e priti mirë e më ç'ti bënte.

Ndënji një copë herë dhe në mes të fjalëve i thotë teto Ruhua: "Xhiko Qibro, dasmën e kemi në ditët e para të shëmitrit".

- "U" - tha kjo "si kështu? Si ma thua këtë fjalë? Vajzës s'i kam bërë dhe gjë? Po prapë zotrote e di vetë dhe si t'a gjeç të udhës". Nuk e zgjati më shumë. Kjo ishte nëna e vajzës, e do bënte si t'i thoshin nga shtëpia e dhëndërit.

- "Jo xhiko Qibro mos folë kështu, s'është gjë shpejt" zuri prapë kuvëndin teto Ruhua. "Dimëri erdhi dhe dua të kem nusen në shtëpi për Bajram. Është Bajram i parë dhe dua ta gëzoj, më mirë nga vitet e tjerë. Po s'e mora tani, mbetet për nga behari. Në mes të Bajrameve, vërtet nigjahun e kemi të bërë, po prapë nuk dua dasmë. E pse të më hijë nusja në shtëpi në kërkthizë të dimrit? Si e di dhe zotrote, jam dhe pa njeri fare. Si kukua në gjithë këtë shtëpi të madhe. Burat s'mblidhen fare, gjithë kohën e shkojnë në dhënt... Vetëm, s'ua dal dot punëve të shtëpisë. Jam si e sëmure". Vërtet dukesh dhe nga surati. Nuk ishte ajo e para. Qe bërë lejmon e kish një buzë të pjekur.

"Me hakë, me hakë" u-përgjegj Teto Qibrua. Mbi ato fjalë, u-dëgjuan



këmbë në divan. E zonja e shtëpisë vate andej. Se me kë foli, nën' e Xhemilesë, nuk e mori vesh. Ajo erdhi prapë në oda, dhe nisi kuvëndin e parë.

- "Kuj e laçë ljalën?... e pastaj Ramazani erdhi. Ç' mbenë? Ç' ditë. Unë e agjëruar jam, dhe po të kem nusen në shtëpi e shkoj më mirë. Jam njeri pa njeri. Kam motrat, po lark. Motrat e burit, ato kanë hallet mbi kokë".

- "Me hakë, me hakë" përgjigjesh teto Qibrua. "Njeriu mos qoftë kur pa njeri. S'rohët vetëm. Sa ke punë, koha shkon, po pastaj s'rihet me duar lidhur. Duhet një ljalë, një kuvënd... Me hakë, zotrote je fare vetëm. Fill' e kat në gjithë këtë shtëpi..."

Prapë u-dëgjuan këmbë jashtë. Ishte Shukua me Haxhona. Mojtë keqen ku qenë pjekur të di gjuhustrat? Kjo e fundit me ta futur kokën në oda: "Të zura" i tha Qibros. "Duhemi keq korbë, kudo që vemi, piqemi".

U-uhnë në dhe të katëra bashkë dhe nisë kuvëndin.

- "Lark qoftë në mes të Bajrameve" tha teto Shukua. "Vërtet shumë janë martuar dhe s'kanë pësuar gjë, po unë kam marrë llahtarën nga djali i Arshi agajt. Si tani më kujtonet. Isha akoma vajzë nëpër udhë. U-martua dhe me gjith' atë dasmë. Atje qoftë, sa u-tundjeta. Tre javë pas martesës u-qetua djali. As hangri, as piu. Mbeti në dhe dhogë. S'lëvizte, as këndeje, as andej. Dhogë ju thom. Jo magji, jo ashtu, jo kështu, plot thanë mojtë keqen. Po rahmet pastë nëna thoshte gjithënjë: mori nusen në mes të di Bajrameve. E kështu, djali u iku nëpër duar. Vërtet ju e keni bërë nigjanë, po prapë pse? Të keqen, e keni në dorë".

- "Jo, mos e dhëntë Zoti" u-huadh Haxhua, që me zi i erdhi radha të flit. "E ç'janë ato? Nëna ime don të më mbante nga buri, kur donin të më mirmin. Mojtë më kishin mbajtur që atëhere, do të qe dit' e bardhë. Fët, në mes të Bajrameve. Punë që s'bëhet..."

- "Eh, tha Ruhua" ne dasmën e kemi në mënde ta bëjmë në funt të muajt me uratën e Perëndisë".

Të thuaç sa për ashtu, mirë e kish ajo nikoqire. Shirat zunë, vapa u- ul. Jo vetëm kjo, po dhe teto Qibrua, vajzën e kish me palë e me roba. Po s'munt t'i thosh krushkës me një herë, mere, se mirë thua. Si ajo, që hë, sa të vijë dita dhe ta lips nga shtëpia. Teto Qibrua nuk flite kurë pa vënt dhe nuk shkelte kollaj në llogë të kalbët.

- "Kemi në mënde të bëjmë dhe një çikë dasmë. Gas' i parë" - tha prapë Ruhua.

- "E lumja un' e lumura", shtoj teto Haxhua "Dasmë nga të di par anët. Mojtë korba, shi kini mënden mos haroni të më thritni. Ta dini, se kam për të ardhur vetë. S'pres. Ju mora shpirtin pastaj".

Duke folur shkoi koha. U-ngrenë në këmbë. Teto Ruhua, i shkuli që të rinin akoma, po ato nuk u-uhnë prapë, se darka. Të trea bashkë, muarnë udhën më të poshtë. U-bë zëxi me një herë. Një erë e ftohtë frinte e ato ecnin dhe vështronin nga të gjitha anët. Pemët kudo ishin të xhveshura, rushtë

pjekur, gra të tjera, me ferecxe e të mbuluara me çarçaf të bardhë ktheheshin në shtëpira. Dhe ato i kishte zënë darka nëpër udhë.

Haxhvia me Shefkon nisën kuvëndin. Teto Qibrva ecte me to, po mënden e kishte gjekët. Një muaj, jo asnjë muaj s'i kish mbetur. Vajza e vetëm do t'ikënte nga shtëpia. I dukesh e pa besuar. Kur shkuan kaqë shpejt vitet që Xhemileja u-rit? Ajo, që gjer dje lonte nëpër udhë? U-bë për burë kaqë shpejt? Do të mbetesh vetëm! Po prapë djemtë i kish të ritur... i zinte nuse të madhi! Ç' të prite më? I mbushi të njëzet e tre vjeçët. Motrën po e martoi. Pastaj një radhë vajza i kishin ardhur me krushqi. Për të zgjedhur kishte mbetur puna.

Haxhvia i ra në krah: "Ç' të gjeti moj nikoqire" i tha "pse s' mbërthen gojën. Nuk dëgjon se ç' thuhet këtej? Nuk e dëgjon se ç' dëfton Shukua?"

- "Oh ae vrrarë" i tha teto Qibrva "e unë kam punët e mi... e ç' më lipsen ato të botës. Mua më një më ikën mëndja e ti më flet broçkolla. Unë do të kreu vajzën nga shtëpia".

Ecnë dhe një copë udhë bashkë. Pa hirë në udhën e pazarit, u-ndanë. Teto Qibrva vate poshtë nga hani i Çenes. Xhehnem udha, thien hundët njeriu.

Erdhi në shtëpi dhe gjeti të gjitha punët të bëra. Nëna hoqi ferecshenë, pastaj ja kallli vajzës në vesh punën. U-fut drejt e në qilar, vuri futanë në mes. Pa, zjari qe llezur po jo dhe aqë mirë. Shtiu urët me cimbill dhe vuri ca të çara. Holli ujë në tenxhere dhe e vuri mbi zjar. Sa të ziente, ajo vate në haur përjashta. Kreu n' avli kazanin dhe pirostinë e madhe. Ngriti kokën lart e pa. Koha ishte e mirë. U-fut prapë në haur. Kreu magjen e këmishëve dhe e mbushi me ujë gjer në mes. Të zbuteshin arallëqet, që mos të ridhte nesër. Tek muri kumbisi drurin e këmishëve, vuri drutë tek vëndi. Mbushi kazanin plot me ujë. Brënda hodhi qesen e finjës. S' kish haruar gjë.

Erdhi prapë në qilar. Ujët bënte klluk-klluk. E hoqi tenxherenë. Tëk e tëk, në tigan kaurdisi rizin, me një lugë gjalpë dhe e hodhi në ujë të përvëluar. Prapë e vuri tenxherenë mbi zjar. E la atje sa piu ujët. Mori një çikë me malë të lugës. E pa. U-ë kishte haruar kripën. I hodhi di koqe, një lugë tjetër të së ngrënit me gjalpë. Fët e fët, u-bë pilafi, u-bë darka.

Vajza shtroi sufranë, nëna u-fut në katoq, dhe mori, ca dru. Pastaj vate sipër dhe kreu gjithë gjërat e pa lara. Qenë mbledhur këmishët kulupi.

Burat nuk dukeshin. S'i u-ndënj teto Qibros. Futanë në kokë, e tek nëna e Zulos. I tha dhe asaj, për martesën... e të tjera e të tjera.

Darka e mblodhi në shtëpi. Në mes të bukës e hapi fjalën. Porositi burin dhe djemtë për gjërat që do të blenin. Kishin dasmë për herën e parë dhe një milë frondilla në kokë. Dasmë dhe dasmë të madhe do të bënte.

"Për së shpejti kemi dasmën" i tha teto Ruhua, teto Qibros. Nga të di par anët hillnin gjërat brënda, ato që qenë për të blerë. Të tjerat i mvarnë hua nëpër gjithone.

## JAVEN QE VJEN.....

Një mëngjes, Teto Qibrua qe përveshur dhe lante vin' e avlisë... me një fshesë të vjetër. Nga krente ujët tek pusi, pulat i muarnë shpirtin. I bënë gocile nga të gjitha anët. Ashtu, tek ven' e vin nëpër avli, dëgjoi këmbë jashtë portës. S' priti që të binte porta po e hapi vetë "U, Hedo Evgjitija? Si kështu? Ç' erë të pruri nga kjo anë? Dolle nga zapanatë e xha Ustrefit dhe s' u- duke më".

- "Eh, moj zonjë, të marça të ligat, këto ka fukarallëku. Bot' e me skoturë. E nuk e di moj zonjë, që tani haurin e kam afër shtëpisë së Mirteza agajt? Dita një milë asaj nikoqires, se më jep gjithënjë nga një çikë gjë. I laj këmishët, i shpie bukën në furë. Thuaj si të duaç, po Xhemon e mora në mëhalen t' ime. Atë ditë q' e dëgjova, për kokë të fëmijës, s' të gënjej, që u-gëzova shumë. E ke zënë mirë vajzën".

Flit dhe i hill sitë shtëpisë nga të gjitha anët. Po ajo shtëpi, po ato mure, po ajo avli. Si i kish lënë vite më parë, ashtu i gjeti. Zonja e saj e parë, qe plakur një allaj. I qe fishkur surati dhe sitë i qenë futur brënda. Mirë thonë që pleqëria është për të gjithë si për agan dhe për fukaranë. Hiri brënda dhe vështrojtë drasat e dëndivanit. Sa herë i kish larë. U-ul në funt të shkallave.

- "Moj zonjë, ç' e do se ç' shtëpi që është ajo e Mirteza agajt. Zonja s' ka të sharë. E urtë dhe s' dëgjonet në mëhale. Pjetmë mua, që kam kaqë vite andej dhe i njoh që të gjithë. U di dhëmb e dhëmballë... Si erdhi dita kështu! Xhemo kanakaren ta mar nuse të agaj t' im? Xhemo kanakaren ajo që më ka bërë kaq herë shurën në pëqi? E mban mënt moj zonjë se si përpigte këmbët kur qe e vogël? E bie në hatër se si e frëngëllonte bukën, kur ja ipje me djathë? E dua me zahar ulurinte e vu lotët e zeza. Pik, pik, pik, i kullonin tek mjekra.

Mori cingarin që i dha zonja dhe e vuri në buzë. Paf e puf e krente timin nga hunda, si burat. Teto Qibrua u-pataks kur dëgjoji fjalët e evgjitkës. Të drejtën i erdhi dhe mirë e i tha asaj "e po mirë moj Hedo u-gëzova dhe unë tani që më thua kështu. E di që Xhemileja gjithënjë të kujton? E ku ta dijë ajo që të ka afër! Do të fluturojë nga gazi. Ke kohë pa e parë. Tani është ritur e bërë nuse".

Këmbë dëgjohesh sipër në oda. Vajza ndreqte gjërat. Hedo evgjitija mbaroi cingarin dhe nisi nga fjalët "më dërgoi zonja, Ruho dhe ke shumë të fala. Si e latë dhe fjalën bashkë të ënjen, si dej një javë do të shënojnë ditën. Të trashëgonen moj zonjë".

"Të mirë paç moj Hedo dhe thuaj xhiko Ruhos që dasmën do ta zëmë

kur urdhëron. Mirë që je dhe ti...do më bieç e do më shpieç vajzën".  
Xhemileja erdhi përposh. Kur pa evgjiten në funt të shkallave erdhi e mbajti këmbët. Dhe e njih dhe s' e njih. I dukesh nëpër hajale: një njeri që e kish parë shumë vjet përpara. Nuk e binte në mënde. Kishte të drejtë, e kur u-kujtua iu derdh me një herë. "Më njeh moj Hedo" i tha. "Si këtu? Mban mënt që të kam zënë me gurë? Atëherë kur veje në furë? S'je plakur fare. Ajo e para".

Hedua mbeti me gojë hapët. U-çudit! Sa që sbukuruar vajza? E kish dëgjuar që qe bënë si drita, po jo dhe kështu. T'i mirje kokën dhe t'ikje. E puthi në të di faqet dhe duke e vështruar në si i tha: "ti je bërë nuse. Të të kisha gjetur udhës, për Perëndi nuk të kisha për të të njohur. E di, që Shefkua, fëshnik me ti, më vdiq. Po s'qe kismet". Mbushi sitë me lotë.

Në këtë kohë, teto Qibrua vate andej dhe erdhi me një sahan me miell të kallamboqtë. I hapi pëqinë Hedos dhe ja hodhi. I dha një cingar tjetër dhe Xhemileja i bëri kafënë. Në të dalë teto Qibrua i dha një frangë.

Plot tuje iku evgjitka. Mirë që i dha atë çikë miell. Në darkë do ta bënte një kulaç në hi, e ta han me gjithë fëmilë.

\* \* \*

Hedo evgjitja iku. Teto Qibrua kishte djalin e motrës në shtëpi. Me të dërgoi fjalë nëpër motra e nëpër kunata. U tha që nesëret në mëngjes do të hulloheshin bakllavatë... Nënë e Zulos e kish pranë. Mbesat e mbëdha i vinin fët. Shumë qenë po dhe shumë punë kish për të bërë. Ç'kish mbetur? Një javë kohë. Pala e vajzës qe në dhe, gjashtë bakllava për të bërë. Nuk shkoi shumë kohë, kur u-duk në funt të patit teto Neslija, nën' e Zulos. Ajo, ishte e ç' ishte e dhënë për punë. Nuk i rëndesh kurë e kudo punonte si në shtëpin' e saj. Vajza e vogël, i ngjante nënës, pa të mbëdhatë, keq kujt i zunë derën. Po ç'të thuaç. Plaka gjitone, iu afrua zonjës së shtëpisë: "shi Qibro" i tha "shtëpinë t'ime e ke të hapët. Ç'të duaç mer. Po e deshe për konak, dhe atë bëne. Nga unë mos u-ndruaj dhe as nga agaj, se ai më tha vetë mbrëmë. Tani mua këtu më ke. Më thuaj se ç'të të bëj. Për kokë të vajzave më vjen mirë, se dhe ti ashtu s'ke përtuar kur kam patur hall unë".

Të dia bashkë shpunë qeret nga poshtë, sipër: në pat të math. Atje kishte vënd të gjerë. Gjijtonj' a kishte prurë dhe të sajnë. Për vete se s'hullonte dot n' atë të botës se kështu i ishte mësuar dora. Teto Qibrua numërojti okllaitë, ndajti niseshenë nëpër sahanë të vogëla. Hapi një mësallë në dhe, dhe t'ek' e t'ek' vuri qeret. Me darkë bashkë i erdhën kunatat dhe motra e madhe. Fëmilën' e kish lënë në shtëpi.

E mërkurë dhe teto Qibrua u-ngre që pa gdhirë. Erdhi në qilar. Me të bashkë motrat dhe kunata e vogël. Vunë futatë në mes. Kjo mbi sunduk uli tepsinë e madhe. E mbushi me ëndë të mirë dhe bëri hesap: për një qint petë, njëzet ve. Fët e fët i çajti. Motra i holli një çikë ujë dhe kjo me dorën e djathtë

e trazoi ngadalë. Në funt i shturi një çikë kripë dhe ngjeshi brumët. Jep e jep me grushte. E punoi, po u-lodh. Iku. Në vënt të saj erdhi kunata. E zuri kjo me gjithë fuqi sa kish. Frap e frap e ngjeshi sa u-bë si fllugë. Tek' e zinte me dorë kërcite. E pa që u-bë. Liejti tepsitë e tjera me vaj, me të di duartë preu çika-çika brumët. Numërojti: aqë copë sa petë do të bëreshin. I mbulojti me tepsi të tjera, që të mos thaheshin. Pastaj u-ul me shoqet e tjera të hante një çikë bukë mëngjes.

Të gjitha qenë ngritur nga gjumi dhe të tjerat erdhën nga shtëpitë. Hoqnë me të shpejtë ferexhenë dhe iu përveshnë punës.

Pa folur u-uhnë në qere. Burat u-ngrenë dhe as që u-dëgjuan fare. Hangërnë bukë nëpër këmbë dhe po dilnin pazarit. Nëna i porositi të mos vinin për drekë. Ustrefi me Hiqmetë e futnë kokën një herë në pat. E po të turet e të turet ishin. Njeri s'u fshihesh. Pastaj duallnë pas babajt.

Në shtëpi mbenë vetëm gratë. Xhemileja, Seqineja dhe të tjera kushërira venin e vinin dhe bënin punët e mëngjesit. Lart të gjitha punonin dhe trakër-trukër dëgjoheshin okllaitë. Teto Qibrua e lodhur siç qe, u-ul tek cepi i minderit. S'i bënin këmbët të ngrihesh. Ngrihesh vetëm për të hapur petët në çarçafe, në divan. I pjete nga një herë "u-lodhtë gjë, të vi unë?"

- "E kur kaq shpejt?" përgjigjeshin të gjitha në një gojë. "S'jemi lodhur gjë. Zotrote, në ke punë tjetër, bëne, pa kjo është për ne".

Bukë drekën e hangërnë me të shpejtë dhe nga pasdrekeja erdhën kushurira të tjera. Ishin të gjitha vajza. Ç' të bënin. Donin të dilnin nga një çikë se dhe brënda nuk rihet gjithënjë. Pëlçet njeriu.

Hullonin gjithënjë. Ulesh njera e ngrihesh tjetra. Njera jepte niseshtenë, tjetra binte kafënë. Kush hapte petët dhe kush rinte në qilar për të gatuar darkën. Në nëndë të ditës erdhi Zulua me tantelle në dorë. U ul mbi minder dhe pranë saj vajzat e tjera.

Nuk mënojti kur u-duk dhe Haxhua. E ku rinte ajo pa dalë. Daf e duf gjithë ditën. Kish mbetur me çarçaf në kokë. Si zakoni dhe jo tani që kishte të drejtë. I bëri lesh e li të gjitha. Fol me njerën, fol me tjetrën. Mblolli buzët dhe "pika në kokë" u-tha "e pse s'këndoni një çikë? Ç'keni pësuar? Mos vallë Qibrua ju ka lënë pa bukë? A ma kështu e doni dhe e gëzoni Xhemilenë? Ju keni dasmë?"

Kjo për tjalë epër shaka është e vetmja. Ja u mbushi mënden. Të gjitha kokë ulur zunë këngën:

*Thëllëza kafas, kafas,*

*Të vi o Nexhip më qas?*

*U të qas' e sis të qas*

*Të pres' me lodr' e me gas.*

*Il' i madh o ku ke qënë?*

*Kam dalë bashkë me hënë.*

*Mos më pe një zogë drënjë?*

*Te porta më shkoi prëmë  
Ta dija ta keshë zënë,  
Në dorë ta keshë dhënë.*

- "Hë" tha prapë Haxhvia "merjani mirë, merjani mirë të shkretën,  
shtruar që të ketë lezet. Hë ti Zulo ktheje, lëshoje zënë". Ajo nisi:

*Dolli ili në Janinë,  
Nexhip beut foli të vijë,  
Të më presë pirpirinë,  
Si kam vetë bukurinë,  
Si kam shtatë dhe japinë,*

E pas kësaj një tjetër:

*Kur mer sitën e gatuan,  
Moj aman aman,  
Mes' e hollë se ç' ma luan,  
Moj aman aman,  
Gatuan për kë gatuan,  
Moj aman aman,  
U gatuaj për bandillë,  
Moj aman aman,  
Bandilli që të vjen brëmë,  
Moj aman aman,  
Pa shikoju në pasqirë,  
Moj aman aman,  
Je verdhur e bërë dillë,  
Moj aman aman.*

Sa e zunë një herë këngën! Pastaj të gjitha thanë nga një:

*Moj e vogëla në lëmë,  
Oj' e vogëlo  
Se ç' të ndritin ato llërë,  
Oj' e vogëlo  
As më jep të bëj gjëlpërë,  
Oj' e vogëlo  
Të të qep fustan e gjërë  
Oj' e vogëlo  
Anë mb' anë me gajtanë,  
Oj' e vogëlo  
Erdhën shoqet e ta panë,  
Oj' e vogëlo  
E griç me shëndet të thanë,*

Oj' e vogëlo  
Ta trashëgoç me jaranë.  
Oj' e vogëlo  
Me jaran' e me dilberë,  
Oj' e vogëlo.  
Me Nexhip buzë sheqerë  
Oj' e vogëlo.

Tha dhe Seqineja të sajnë:

S'ta dal dot me qa  
Po me të këndu  
Letrën t'a dërgova  
Ti se ke këndu.  
A e ke ndërmënt moj?  
Në bashket e tu  
Na sevdaja jote  
Mbete pa martu'.  
Na sevdaja jote  
Humba djalërinë,  
Ki babai jot moj  
S'na kish kupëtu'  
Si dollap kafe moj.  
Më je lluturu'.

Si mbaroi kjo Zulua me këngë tjetër në gojë:

Borzilok që mbiu në derë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.  
Vjen një plak e i mer erë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë  
Shtroi drizë e shtroi ferë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.  
Të shajtonet e të bjerë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.

Borzilok që mbiu në derë  
Tunde moj' shamin' e verdhë,  
Vjen një djal' e i mer erë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.  
Shtroi stromën e shtroi çiltënë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.  
Të bjer' i gjori të bjerë,  
Tunde moj' shamin' e verdhë.

U-ngre në këmbë dhe zgjati kokën nga penxhereja. I bënë veshët sikur bin njeri tek porta. Dhe qe me të vërtetë. I tha nënës dhe vate në shtëpi. Ishte Hasani, djali i dajkos. I mori boshtanë që kish në kokë dhe e shpuri brënda.

Qëndija. Tek xërmojti përposh hiri në qilar. Futi kokën te dollapi dhe mori një çikë bukë e djathë. Hangri sa u-ngop dhe erdhi prapë tek Xhemileja. Kënga qe prerë. Kur hiri në oda i tha teto Qibrua "e di Zulo që ti mban këngën? Lumi këture të tjerave. Mirë që të kam ti. S'më ke për të turpuruar. Po të të ngjëret zëri të kam për të mbajtur me ve rufka". Ajo qeshi. U-ul afër Seqinesë. Pleksi për in demise në gjisht dhe me citë zuri tantellen. Nisi këngën:

*Mike lerënxa në det. Oj' lerënxo.  
Lëshoj deg' e lëshoi fletë Oj' lerënxo.  
Te ajo degëz' e parë Oj' lerënxo.  
Vari beu dufekn' e larë. Oj' lerënxo.  
Tek' ajo degëz' e ditë. Oj' lerënxo.  
Më do beu si të di sitë. Oj' lerënxo.  
Tek' ajo degëz' e tretë. Oj' lerënxo.  
Më do beu' me të vërtetë Oj' lerënxo.*

Kur perëndoi dielli, një nga gratë ngriti perdhetë e penxhereve duke zënë këngën:

*Ditën e marsit kur dolla,  
N'udhë poqa ca mes holla.  
Holla sit' e i shikova.  
Më shikuan me tërbim.  
Më thanë ç' shikon o trim.  
Atë ditë që ra zbora.  
Në divan krihesh mes holla.  
Kullauzin ja dërgova.  
Kullaut në je i fortë  
Nxirmë mikenë në portë.  
Diç t'i them pa të më thotë.  
Pa ta mar të dalim poshtë*

Qielli qe veshur me re të zeza. Njerëzia shkante udhës dhe mbante këmbët. Dëgjonte këngën "Ç'është?" pjete njera. "Tek Haxhi efëndiu hullojnë bakllavatë. Për së shpejti kanë dasmën e vajzës" shtonte tjetra. Brënda këndonin:

*Tatëpjetë malit vinje  
Jelek verdha veshuro. (di herë)  
Thaçë se vije tek unë,  
Dolla duke qeshuro*



*Me duar përveshuro.  
Ti vajte tek kishe punë,  
Hira zëmëruaro  
Me duar lëshuaro.  
Mlike në të mbeti qejfi,  
Kthenem në të shkuaro. (di herë).  
Bota janë vrar' e prerë  
Dhe janë palcuaro. (di herë)  
Ne as vrar' as prerë jemi  
Fjalë s'kemi ndruaro. (di herë)*

E mirë kjo. Dhe një tjetër pastaj:

*O moj ti hajmali ergjëntë,  
Pa dil një çikë në lëmë,  
S'më lënë more s'më lënë,  
Babai me xhaxha qënë,  
Edhe nëna një zullape,  
Më thot ku vete azate.*

Zunë një tjetër. Eshtë e Seqinesë kjo:

*Xërmon plaka malito,  
Dhiple, dhiple manajko,  
Me të trea bilato,  
Dhiple, dhiple manajko.  
Pa pjetni të madheno,  
Dhiple, dhiple manajko.  
Pjeteni se ç'burë do,  
Dhiple, dhiple manajko.  
Ajo do burë kati,  
Që t'i hjerë gjulaki.  
Pa pjetni të mesmeno,  
Pjeteni se ç'burë do.  
Ajo do burë qatip,  
Që të hajë ar e fiq.  
Pa pjetni të voglëno,  
Pjeteni se ç'burë do.  
Ajo do burë kasap,  
Që t'i shpjerë mish' e cjan.*

U-shkulnë së qeshuri. E po është për të qeshur. Po këjo tjetra:

*O ç'u-rëzëkua mali, Nëna ime  
O ç'zuri tre dilberë, Nëna ime*

Po të më kish zënë mua,  
Nëna ime?  
Sa vjet zi mbajë për mua,  
Nëna ime?  
Sa të flit guri me mua,  
Djali imë.  
Po të më kish zënë mua, Motra ime?  
Sa vjet zi mbajë për mua, Motra ime?  
Sa të zbardhej pënd e korbit Vëllaj imë.  
Po të më kish zënë mua, Shoqja ime?  
Sa vjet zi mbajë për mua, Shoqja ime?  
Shtatë dit' e shtatë net, Zoti imë.  
Të tetënë në mëngjes, Zoti imë  
Lahesho, krihesho  
Vështroje për tjetëro  
Der' i biri derito  
I biri gomareso  
Shoku i kamarjareso.

Zunë nga këngët e mira tani:

Te qisha ndënë kabanë, Ta maro lumi ta marë  
Lum' e deti le ta marë.  
Shkon një vashë duke qarë, Ta maro lumi ta marë  
Lum' e deti le ta marë.  
Kërkon nënën e babanë, Ta maro lumi ta marë  
Lum' e deti le ta marë.  
Kërkon motrën e vëllanë, Ta maro lumi ta marë  
Lum' e deti le ta marë.

U-ngrenë në këmbë të gjitha se mbaruan. Ato që kishin hulluar shkundnë futatë. Ngritën qeret dhe i përpoqnë mbi mësalë. Njera i shpin në qilar, tjetra ngrin tepsitë. Sqeqneja mblodhi sahanet, motra e teto Qibros hoqi robot nga sheshi. Xhemileja rëmbeu fshesën dhe fësh e fësh hoqi të shumat. Në qilar brënda lajtën duar e faqe.

Ashtu, siç ishin, Zulua e lëshoi dhe një herë zënë:

Ç' trëngëllitë xhameto,  
Moj dora me bezeliqe.  
Ç' dolle në udh' e më prite,  
Moj dora me bezeliqe.  
Diç më the, diç më porsite,  
Moj dora me bezeliqe.  
Për një pal' vathë naziqe,

*Moj dora me bezelike,  
Në Jaminë ç' i porsite,  
Moj dora me bezelike.*

Mbaruan dhe gjithë se kush kërkonte fereksenë e saj.

Teto Qibrua me Xhemilenë i shqiejtin i nduknë që të rinin për darkë. Mbetën vetëm motrat e burit. Motrat e saja dhe vëlleshat s'ndënjën. Ndruheshin nga Haxhi efendi, pastaj katënxhikat se dinin.

Shkoi dhe kjo ditë. Bakllavatë u-mbaruan. Mbenë vetëm për furë. Bireqet i lanë për javën e dasmës. E në kohën e darkës, shtëpia që gjithë ditën kishte gjëmuar nga kënga, dukesh sikur kish rënë në gjumë. Nëna me vajzë dhe hallat e mbëdha vanë sipër me llambë në dorë. Dritë nëpër shkalla e divane e këmbë të lehta dëgjoheshin që ecnin nëpër disheme. E në avli porta u-mbill. Ishite plaku me djelm që ktheheshin nga pazari.

## DITA E VETULLAVE

Shkoi një javë, një javë, me punë. Të mërkurën mbrëma, teto Qibrua ra për gjumë pa kohë. I shkreti s' e zuri gjithë natën. Në mëngjes u-ngre me llambë. Zgjoi dhe vajzën. Shtëpinë, desh Perëndia e kish plot. Kërllëgani bëneshin. Vërtet të turet e të turet po ishin një rallë kushërira. Atë mëngjes, kur' i pa radhë radhë u-mendua që kishte plot njerëz. Le të tjera se çdo të ftonte gjatë javës.

Dit' e ënjte... dita e shënimit. Nuk shkojti shumë erdhi Kako-Pinua. Gjithënjë njësoj kjo kallogre. S' u mblak kurë. Hiri në oda të madhe, zuri vënt në krie. Afër i u-uhnë ca gra dhe zunë nga kuvëndi. Kur erdhi Xhemileja u- ul përpara bullës. Ajo kreu nga xhepi i çitjaneve pënë dhe e fërkoj mir' e mirë me dillë. Pastaj i mori faqen. Xhemileja e duronte po nga një herë hillesh përpjetë. I dhimte. Po s' mendonte kështu Kako-Pinua. I flit: "ri moj e mallkuar, ri mos u luaj... Të vjen mirë të martoneç e të të bëjmë dasmë të madhe. Do të duroç dhe këto". Vajza u-turpërua. Nuk luajti më nga vëndi.

Kako-Pinua i mori vetullën. Pastaj i bëri suratin me raki. I pjek lekurën. I vuri koqinallin, i shkojti hollë hollë sqafillin. Kur mbarojti, Xhemileja u-ngre në këmbë. Vate te nëna dhe i zuri dorën... Ajo nuk e puthi se s' don t' i prishte stolinë.

Të gjitha kushërirat, qenë ngaha nuk qenë erdhën në funt të odasë. Ca nga ato i vanë prapa Xhemilesë, në odan tjetër. Ajo veshi sadenë trandafili e nuk zuri më punë me dorë. Ven e vin nëpër këmbë. I dukesh çudi të rin me duar-lidhur.

Mbushur shtëpia. Të vogjëlit nëpër këmbë venin e vinin posht' e lart. Dielli kish ardhur në mes të avlisë kur Hedo evgjijtja hiri portën, me një djalë nga dora. Ishte Mustafai, nipi i vetëm i teto Ruhos. Gratë e shtëpisë i futnë në oda. Të gjitha gëzonin djalin. Kush ta mirte më parë në duar. "Mashalla" i thoshë teto Qibrua "Mashalla! Ti u-rite, u-bëre burë. Uah... uah, kush ti ka blerë këto roba, kaq të bukura? Si të thonë? Pa më thuaj një çikë". Ai turpërohesh, ulte kokën dhe vinte gjishtin në gojë dhe bënte të ngrihesh. Sa ikënte nga duartë e teto Qibros e rëmbente tjetra. I gëzonte leshrat, i shkulte faqet, i thoshte fjalë të mira.

- "Le se ç' djalë është" tha Hedo evgjijtja "kur ha e dëndet në shokë s' gjendet" dhe tundi kokën. "Kokë nga këmbët bën. T' u rojë se e kanë të vetëm. Si thua Mustafa? Unë bëj shaka moj zonja, pa njeri se ka këtë djalë".

Mbi ato fjalë hiri Xhemileja në oda. I zuri dorën Mustafajt. Ai e vështrojti në si dhe i dha dhe dorën tjetër. Ja puthi dhe atë, pastaj Hedo evgjites. Për vehte zuri vënt në funt t'odasë. Ndënji në këmbë.

Pas një çike u-ngre Hedo evgjijtja. Tek krei i shkallës prapë Xhemileja u zuri dorën. Teto Qibrua i dha Mustafajt një jemeni të madhe me pemë. Edhe një evgjitkës.

Ata ikën dhe dreka s' mënojt. U-shtruan sufragatë. S'kishin mbaruar mirë kur graria zunë të vinin. Plot nuse të ra e vajza. Ç' të bënin. Kishte kohë që s' dëgjohej dasmë gjekundi. Plasnë brënda. Po njeriu s'ka dhe ku të vejë. S'rihet dhe gjithënjë në shtëpi. Duan të kullosin sitë nga një çikë. Pa po u-derdhën këtu.

U-mbush odaja gjer në griqë. Ç' të shikojë. Ardhur nga an' e Dunavatit e nga fundi Manalatit. Mbledhur të gjitha në shtëpin e nuses. S' bënësh ndrishe se krushkat ishin të ftuara tek buri.

Zunë çuçu me njera-jetrën: Fol për njerën si ishte veshur. Pika në kokë: ajo që rinte në krie t'odasë, kish vënë një okë të kuq në surat. Po ajo, të keqen, që rinte në malë të penxheresë? që mbante gojën hapët. Me një i hinin mizat. Hasibesë së Mirtezajt i varesh kombolizoni një pëllëmbë. E ç' të tjera. T' i nëmëronte njeriu nuk do të soseshin gjer në darkë.

U-afraua koh' e krushkave. Një e shtëpisë zuri këngën:

*Këndon birbili këndon*

*Mbi një degëzë lejmon.*

*Neve dasmënë e nismë*

*Ndo këndo, ndo mos këndo.*

*Thirmë gjithë far' e fisnë*

*Ndo këndo, ndo mos këndo.*

*Thirmë gjithë miqtë t' anë*

*Ndo këndo, ndo mos këndo.*

*Ngaha qenë nga çdo anë*

*Ndo këndo, ndo mos këndo.*

E past :

*Të xhuma për të xhuma  
Stolisetë mikija  
Shkon vetë të nënija  
Ç' tundetë fodullija  
Se ka robotë të ra.  
Tundu moj fodulle tundu.  
Tundu moj se ç' të ka hije  
Posi dielli kur hije  
Si hëna në mes të ile.*

Në divan ja thoshin:

*Tundu shkundu moj lofatë  
Të bjer' ajo jetë-gjatë  
Ti shoh sit' e vetullatë.  
Vetullatë pse t'u-nxinë  
Sikur ke vënë mazinë.  
Jo jo jo për Perëndinë  
Po kam vetë bukurinë.*

Penxheretë e odave dhe të divanit ishin veshur. Ca vështronin dhe ca këndonin. Së largu dëgjonesh një avaz:

*Bën konak moj gjeraqinë. Bën konak,  
Ne u-nism' e do të vimë. Bën konak.  
Bën hajzër odan e mirë Bën konak.  
Ormiz verën e rakinë Bën konak.*

- "Krushkat, krushkat" uluritë vajzat e vogla, që vinin me vrap nga udha "po vinë. Për Zotin i pamë" dhe hë... hë... hë mirmin frimë thellë. Të gjitha gratë u-ngrenë në këmbë dhe lëshuan zënë:

*Ç' jan' ato që dukeno, moj nëno.  
Krushqit e Nexhipito, moj bijo.  
Vinë të të shohino, moj bijo.*

Sa të thoshin ashtu e kështu hijtun krushkat në avli. Ati e përpjetë shkallave duke kënduar:

*Ku ngrehe çadëreno, Nexhip be.  
Atu në shesh të pllakëso. Xhemile.  
Pëlqeye si zezëno. Nexhip be.  
Xhemo bukurosheno. Nexhip be.*

Nusja me tele i priti tek krei i shkallës. Gratë, rrotull saj i këndonin:

*Xhemile siri filxhan  
Bukurija të dha nam  
I more shoqetë bram  
Nga bukurija që mban.  
Nga bukurija që ke,  
Përmbi gjithë shoqete.*

N'atë kohë e sipër Kako-Pinua çau e ndau dhe erdhë afër nuses. I ndreqi telet nga të di anët, i ngriti akan e sadesë. Pastaj lagu gjithin me pështimë dhe vuri llambbron në mes të ballit se i kish rënë e para. Krushkat u ngjiten dhe Xhemileja u puthi dorën. Ato u futën në oda të mirë dhe u zunë drejt në valle. Motra e teta Ruhos mori Xhemilenë nga dora dhe e zuri këngën vetë:

*Te pëlqen nusija  
Kumatë Merushija?  
Më pëlqen si s'më pëlqen  
Eshtë muse Nexhip beut  
Eshtë e bukur e dheut  
Eshtë ili shënëndreut.*

Sa mbaruan këtë këngë halla e vuri nusen në mes të odas. Tetua e saj i lidhi një futa të mirë tek qafa dhe e uli në një skami. Kako-Pinua i vuri mazi me bosht në vetulla. Xhemileja nuk luajti as andej as këndej. Sitë i mbante të mbërthiera në dhe. Të tjerat venin e vinin në valle dhe i këndonin:

*Vur moj muse bojanë  
Se të ri nënija pranë.  
Vure moj muse  
Me shumë naze.*

Krushkat s'kishin pushuar mirë, kur Zulua zuri këngën tjetër nga fundi i odasë:

*Uromë baba uromë  
Gëzomë baba gëzomë  
Tani që vë bojanë.  
Uratë paç moj bilë (di herë)  
M'u-plakç m'u-trashëgofç,  
M'u-bëfç një zonj e madhe.*

Krushkat erdhën kaq herë reth e reth odasë sa u lodhnë. U-uhnë në kric të minderit. Po plasnë nga vapa. Vërtet vjeshtë po ziente brënda. Njera krente jemeninë dhe bënte erë, tjetra thoshte hapni penxherenë. Po dëgjonin ato që

kishin afër? Dhe si ta bënin atë gjë? U-binte në kraha dhe s'kishin në mënde të mirnin ndonjë zabave. Seqineja, veshur pingël dhe bërë krollë në surat u-pruri sherbetin. Vajzat në divan këndonin:

*Ç'këndon birbili këndon  
Në një bashte me lejmon  
Këndo o birbil këndo.  
Mua më këndoneto  
Nexhipi martoneto  
Të na trashëgoneto.*

Pas kësaj kënge s'u lanë radhë të shtëpisë. Pse, të thoshnin krushkat se ishin të humbura? E një këngë:

*Qan me lot vasha jetime ,qan me lot.  
Qan me lot krua më krua ,qan me lot.  
Se u-rit e u-bë grua, qan me lot,  
Thotë kush më marton mua ,qan me lot.  
Thotë kush më palon mua ,qan me lot.  
Kush më bën si shoqet mua ,qan me lot.*

E të ditën këngë:

*Tëkër tëkër n'ato gurë  
Gushë-kuqe moj thëllëzë  
Gushë-kuqe dallandushe.  
Kadale mos shkel në lucë  
Gushë-kuqe moj thëllëzë  
Gushë-kuqe dallandushe.  
Se leros ato këpucë  
Gushë-kuqe moj thëllëzë  
Gushë-kuqe dallandushe.  
Pa të vjen Çelua prëmë  
Gushë-kuqe moj thëllëzë  
Gushë-kuqe dallandushe.  
Pa të thotë ku ke qënë  
Gushë-kuqe moj thëllëzë  
Gushë-kuqe dallandushe.  
Ku ke qënë oj ballë-hënë  
Gushë-kuqe dallandushe  
Gushë-kuqe moj thëllëzë.*

Tek nisë të tretën këngë të shtëpisë ja u muarnë nga goja krushkat:

*Në divan kur dolle  
Nuse moj levende*

*Pse kaq u-rëncove, nuse moj levende.  
Nga beu që more, nuse moj levende?  
Atë bej që more tinë, m ojj levende  
Atë që zigjas florinë, moj levende.  
Atë bej e çikë djalë, moj levende  
Atë që zigjas paranë, moj levende  
Atë Nexhip kapetanë, moj levende*

U-ngrenë në këmbë, duallnë nga odaja, po këngën nuk e prenë. Nusja u zuri dorën tek kreqj' i shkallave. Xërmuan përposh po dhe atje kënduan për të qeshur:

*Një fole, di fole  
Shkallatë me gocile,  
Pse si fshin moj Seqine.*

Pastaj:

*Pse s'na bëtë një kafe  
Na marçit të keqene.  
Apo s'kishit teneqe  
Na marçit të keqene.  
Pse s'thoshit të binim ne  
Na marçit të keqene.  
S'ja u-thomi për mëri, moj krushka.  
I thomi për dashuri, moj krushka.*

Duallnë në avli, kur graria nga sipër ja u kthien:

*Krushka ertë Krushka iktë,  
Ndonjë fjalë nuk gremistë  
Duket q'ishitë të fistë.*

Krushkat muarnë udhën. Kënduan ç'kënduan në shtëpi të nuses dhe pastaj e pipnë. Burat me futa në mes, rinin ca përpara e ca prapa. Këto me njera-jetrën nishnë nga fjalët: "si dritë nusja" "ç' e kish shtatin". I thoshte tjetra shoqes "ç' qe ai i zi sherbet ashtu? Dhe një çikë më erdhi anagulë. Kur se krevea sot se kam për të krier kurë." Pëshë-pëshë me njera-jetrën erdhën tek porta e Mirteza agajt. Ja dhanë këngës:

*Sihariq nënë një lirë  
Nuse Nexhipit e mirë,  
Dhams e feks posi pasqirë.*

Teto Ruhua me llërë përveshur, me buzë në gaz dolli te dera. Zgjati kokën. I qeshnin sitë. Gratë e mëhalesë iknë dhe të turet e turet u-futnë brenda.



Njerëzia nga të di anët u-pakëcua. Të shtëpisë bënin punë dhe këndonin. Apo si shtinte vetë teto Ruhua:

*O Nexhip ili sabahut,  
Me perço në mes të krahut,  
Ja krihe ja hille prapa,  
Se ta djek diell' e vapa,  
S'jam në diell e në vapë  
Po jam në tel të krisaftë (di herë).  
Mblidhja nuse në kuiti,  
Kur të dali në xhami,  
Të thonë ç'është ai?  
Nexhipi me trimëri,  
Me gjithë shokë të ti.*

Pas kësaj zunë një tjetër:

*Dhelpëra përtej në fushë , dhelpëro moj minxore,  
Dhelpëro minxëryjare.  
Zoqt e pulësë m'ÿ more , dhelpëro moj minxore,  
Dhelpëro minxëryjare.  
M'i more dhe s' më le fare , dhelpëro moj minxore,  
Dhelpëro minxëryjare.*

Kur mbaruan, ç'kishin për të bërë të gjitha bashkë duallnë n'avli të çanin pishën. E me këngë:

*O shoko se ç'paçë sot  
Di thëllëza tek një shtok  
Jap' e jap e si zë dot  
E vogëla qan me lot.  
E vogël e sa të thuaç  
Nënës e babajt i ruaç  
Edhe mua të më duaç  
Të më duaç derëzinë,  
Se për ti prisha shtëpinë  
Edhe gjithë prokopinë.*

Djelmuria, nga ana tjetër ja mirnin:

*Aje poshtë n'ato puze ,moj lale moj lule.  
Ç'këndojnë një rallë nuse ,moj lale moj lule.  
Gjithë me shami të kuqe ,moj lale moj lule.  
Zgjidhe moj se na këpute,moj lale, moj lule.  
Na këpute, na mahnite,moj lale, moj lule.*

Kur ja dhe vajzat e vogëla, s'mbenë pas. Kallogriçkat, që u preftë Zoti ditën dhe mos u-bëfçin më mirë. Apo s'këndonin ditë-prerat:

*Ç' e heq vallenë qelesi  
Me kacille gjer tek veshi  
Përpiq këmbëtë te sheshi  
Kadhogrea si e deshi.  
Shoqe ma vutë të remë  
Që raha burënë prëmë.  
Në e raha paça nëmë  
I futa me një pëllëmbë.  
I thaçë hajde dhiz zjarë  
I raçë me një të çarë.  
I thaçë hajde mil dhitë  
Me cimbill i krevia sitë*

Sa mbaruan atë, nisë një tjetër. Më të bukur. Apo s'është:

*Ç' më gënjeu qen çobani, moj nëne  
Më mori përpara kalit, moj nëne  
Më shpuri te der' e stanit, moj nëne  
Më mori florin' e ballit, moj nëne  
Më vuri potkojn' e kalit, moj nëne.  
Më çveshi pallton' e krahut, moj nëne  
Më veshi çipun e krahut, moj nëne.  
Më hoqi brezin e mesit, moj nëne  
Më lidhi gjalmën e thesit, moj nëne.  
Më çveshi skarpinato, moj nëne  
Më veshi opingato, moj nëne.*

Këngë, këngë dëgjonesh nga çdo anë. Prapë djelmurija këndonin:

*Mike me shami më nj'anë, moj mike,  
Mos mike se dogje fshanë, moj mike.  
Ç' i bëra fshatit të shkretë. Un' e mjera?  
Ra zjari dhe u-dog vetë, Un' e mjera.*

Jo vetëm te Mirteza agaj kërcenin e këndonin po dhe në shtëpin e Haxhi efendiut. Punët i bënin grat' e shkuara dhe vajzat u-ngjitnë sipër. Muarnë Xhemilenë dhe e vunë në mes "Hë" i thoshin "këndo dhe ti se s'është njeri". Vërtet njeri i huaj s'qe dhe ajo këndonte me to bashkë:

*Ç' këndon qiçja në shkëmb  
Ç' këndon e se ç'ja thotë  
Ç' këndon ç'ja kthen me griçë.  
Për ca plaka që la vjet*

I la vjet, s'i gjen sivjet  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.  
Lanë bushaqetë shkretë  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.

Ç'këndon qiqija në shkëmb  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndon ç'ja kthen me grikë.  
Për ça pleq që la vjet a vjet  
I la vjet s'i gjen sivjet  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.  
Lanë bastunetë shkretë  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.

Ç'këndon qiqija në shkëmb  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.  
Për ca trima që la vjet  
I la vjet s'i gjen sivjet  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono ç'ja kthen-me grikë.  
Lanë armëtë shkretë  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndono, ç'ja kthen me grikë.

Ç'këndon qiqija në shkëmb  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndon, ç'ja kthen me grikë.  
Për ca nuse që la vjet  
I la vjet, s'i gjen sivjet  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndon, ç'ja kthen me grikë.  
Se lanë palënë shkretë  
Ç'këndono e se ç'ja thotë  
Ç'këndon, ç'ja kthen me grikë.

E shtruan më mirë. Teto Qibros vërtet i pëlqenin këngët pleqërishte po nuk i la. "Zeni një tjetër, na ato të tanishmet", u-tha duke dalë nga odaja. Seqineja

zuri një tjetër:

*Mike pse je treturo, mikja ime  
Ç' maras të ka mbeturo, xhanj' a ime  
Kolla me të therturo, mikja ime  
Ç' ilaç i ke gjeturo, xhanj' a ime  
Rushaj, bardhaj pjekuro, mikja ime.  
Ç' bën verë të bukuro, xhanj' a ime.  
Pinë trimat, deheno, mikja ime  
Dalim e kërcejëno, xhanj' a ime.  
Tek një shesh i luleve  
Zimbile e zelikade  
Tek një shesh i luleve  
Trandafil' mamushaqe.*

Pas asaj e zuri Zulua:

*O birbil more birbil  
Zogu me kraha jeshil  
Të vi sonte misafir?  
Eja po bënu tevdi  
Nga penxherja hir' e dil  
Hir' e dil si zog birbil  
Zog birbil në lis të thatë  
Muhabet që bëjnë gratë  
Si plakatë dhe të ratë*

“Eh... sado, eni përposh tani” uluriti teto Qibrua. E pushuan këngën dhe xërmuan.

Koha e bukës. Në të di shtëpitë u-pre kënga. Bura e gra hanin bukë darkën. Tek Mirteza agoj kishin brumët dhe tek Haxhi efendiu ndreqnin gjërat. S' dihesh mund të vinin krushqit.

Pritnin... vështronin nga udha mos dukesh ndonjë dritë, mos dëgjonesh ndonjë këngë. Ati këtu këmbë... ndonjë portë që hapesh e mbidhesh prapë. Një dritë u-duk në shtëpin e Zulos dhe nëna e saj ecënte në divan. Dhe jashtë frinte një erë e lehtë dhe degët e pemëve tundeshin e larg... larg në shtëpin e Mirteza agajt burat dilnin me brumë e me mashalla përpara e me këngë e valle. Mirin udhën...

## NATA E BRUMIT

E ënjte mbrëma, nata e brumit tek Mirteza agaj.

Hanin bukë përposh në pat, kur njerëzia zunë të vinin. Të gjithë me nga një fener në dorë. Gratë vanë në gra dhe burat vanë në konak jashtë. Atje

ene të ftuarit bënë strangolle. Nuk hanin, po pinin. Pinin e pinin pa pushuar.  
nin e ja mirnin këngës:

*M'u te kroi stanero, manaj manaj  
Mbiu një lis, një fanero, manaj manaj.  
Koqet i bën sunbullo, manaj manaj.  
Ejni ju nuset e ra, manaj manaj.  
Të përmbliidhni flutura, manaj manaj.  
Ejni ju trimat e ri, manaj manaj.  
Mblidhni sunbulla për gjë, manaj manaj.*

koma vinin gra e bura. Të shtëpisë u-ngrenë nga buka shpejt. Një evgjite  
blodhi krodhat, hoqi lugët dhe ngriti sufratë. Shkundi sufrabezët dhe i dha  
ë të fshirë odasë.

Odaja e dimrit u-mbush plot me gra. Papsën njerëzia. N' atë kohë hiri  
ë oda Mustafai. Ecënte si i ngrirë. Në duar mbante një sitë veshur shamaturë  
ga jashtë. Gjër në mes mbushur me miell e shtatë qiri të dhezur. Eci me çape  
i vogla dhe çdo njeriut i zgjate përpara sitën e të gjithë hillnin nga një para  
ë miell brënda. Kush një pesare, kush një kacille. Ca bënë sikur nuk shikonin  
he nuk jepnin fare e kush hidhte një grosh nga të Italisë, me vrimë në mes  
ër t'ja lidhur maçes në qafë, se nuk shkonin.

Mustafai, vin troiro dhe të gjitha këndonin:

*Uromë baba uromë,  
Gëzomë baba gëzomë.  
Sonte që zëm' brumëto,  
Me mjalt' e me qumështo.  
Uratë paç' o bir,  
M'u-plaqç,  
m'u-trashëgoqç  
Sarajn' me djelm' e mbloqç.*

urat dualinë në avli dhe zunë vallen. A ma të gjithë qenë bërë thumb. Ustrefi  
e bocë në dorë e pinte dëng' e dëng rakinë. Me dorën tjetër drillte shaminë  
he fiu përpyetë dhe fiu përpyetë. Hiqte valle. Abidini ja mbante dhe ja kthente:

*Një vasho, moj një vasho,  
Një vasho andej nga fundi,  
Tre sahat vallen' e tundi.  
Tunde moj të martë lumi,  
Se shoqet' i zuri gjumi.  
Le ti zërë se si dua,  
Se ato s'janë për mua,  
E heq vetë si ta dua.*

Një nga burat pa teto Ruhon që dilte nga dera. U-lëshut vëllai i saj dhe me pahir e pruri në valle. "Hajde, merja një herë, të gëzojmë moj motër. Zë një këngë Abidin dhe ktheje mirë, për zonjën e shtëpisë". "Uh, ri more përmbisur" i thosh teto Ruhua, "Iermë të keqen Bido". Don ta hiqte dore po e lin ai? E kishte mbërthier mirë dhe se lëshonte. Deshi, s' deshi plaka, ha gojën dhe këndon bashkë me ta. Ndaç të mos këndonte:

*N'atë qoshk që llizesh pisha*

*Thëllëzo e mjero*

*Shpirt moj zëmëro.*

*Nusesë ju dogj këmisha*

*Thëllëzo e mjero*

*Shpirt moj zëmëro.*

*Mos ja dogji katërxhika*

*Thëllëzo e mjero*

*Shpirt moj zëmëro.*

*Në ja dogji lanet pastë,*

*Ajo në xhenet mos vafte,*

*Xhenazeja mos iu faltë.*

Toqet me hire e me val të gurit mbi mure qenë llezur. Llamburi shtëpija nga të gjitha anët. Të vegjëlit kishin hipur mbi mure e mbi pem Grarisë nëpër penxhere u shquante surati. Qe bërë nata ditë.

Nexhipi qe futur rëzave. Shkojti një herë anës e anës së murit. Nus shtitnë njera-jetrën, vajzat zgjatnë kokën "dhëndëri, dhëndëri. Ai mi, ai, c flet me nënën" thanë nëpër buzë.

Me gra bashkë qe dhe Haxhua. Me një e shtipnin, po ajo vëndin s lëshonte çikë. E krente kokën jashtë si të breshkës dhe vështronte posht n'avli. "U"...u-tha "po ju kallogrera, pse nuk këndon një çikë. Nuk shikon burat? Po ju ç'bëni? Hë merjani një herë. Merjani nje herë. Ashtu mirë... Ato s'e bënë fjalën di:

*Dielli rëzës së malit.*

*Shelege Bejko-çobanit.*

*Moj ti s'jeshe për çobanë,*

*Po për Nexhip kapetanë,*

*Që e mban festen më nj'anë.*

"Tek nusja, tek nusja të vemi" uluritnë burat "përpara, te nusja". Dambanosnë të di kanatet e portës dhe ashtu, në valle duallnë jashtë. Ca me mashalla vanë përpara dhe ca mbenë nga prapa. Të vogjëlit duallnë me një pishë të llezur në dorë. Duke shtirë njeri jetrin zunë uhdën. Një shtëpisë. Meto ziu, torolloz, shtinte gomarë. E kishnë vënë të ruante pishën. Për atë që e kishin porositur e bënte mirë. Mashallatë uleshin dhe ai hidhte pishën.

Burat kërcenin e këndonin:

*Në krua të Qersoratit  
Ç' mbliidheno çupat' e fshatit  
Me baluka si të atit.  
Frim era ja u hell suratit*

Ustrefi me një bocë në dorë, me një filxhan në tjetrën u-jipte të pinin raki. Uap...e kthenin me njësh. Ah, e prënte gërnazin dhe këndonin:

*Seizi që ri në shkallë  
Moj si zes' e gushë bardhë,  
Florinë që ke në ballë  
Moj si zes' e gushë bardhë,  
Falma mua që jam djalë  
Moj si zes' e gushë bardhë,  
Se jam djal' e duroj shumë  
Duroj plum edhe barunë.*

ec në një copë udhë pa këngë. Qe vëndi i ngushtë dhe vargan nga dora shkuan. Ec' e ec, ca mbenë prapa dhe ca u-kthien në shtëpi. U-mirëshin këmbët dhe "hë ktheuni" thoshin. Bidua, bën sa bën dhe u hidhte nga një si djemve. I numëronte, ishin apo s' ishin që të gjithë:

Duallnë në vënt të gjerë dheë nisnë prapë këngën:

*V'ino një ditë nga mali  
Nëpër vapë rënjë dali  
Gjeçë mikenë te zalli.  
I fola s' më foli dot  
Ajo qe me shoqe plot  
Të di qajtimë me lot  
Mbushmë di mandile plot.*

Udhës shkonin dhe zgjonin njerëzinë nga gjumi. Të gjithë të përgjumur, gjismë të veshur ngriheshin. Kush dil tek penxhereja dhe kush dil tek porta. Gratë me futa në kokë, rinin përbrenda portës dhe plakat u-uhnë të praku jashtë. "Ç' është?" pjeti njeri gruan "kush martonet?" "Kush ka brumët sonte" shtonte tjetri në avli të tij dhe auaq gogësinde. E haptë gojën sa një kamare. "Mirteza agaj ka brumët e djalit" i përgjigjesh burit. S' mbarojti tjalën kur një t' ikur me të katra. Djali në djep qe zgjuar dhe karkallosesh. Llahtarisë në fëmilën, që lanet-paçin. Na krien gjumin ulërinte një plakë që më një e zinte gjumi në këmbë. Po gomares mirë iu bë, se nuk ndënji sipër të flinte po don të më shinte. Pastaj të vjen dhe të shan.

Kutja i hapeshin dhe kutja i mbillleshin sitë. Kush fërkonte kokën. Ç' të shikoje portërat. Plakave të shushatura u-kish ikur jemeniu nga koka. Të

vogjëlit vështronin me si të përgjurmur.

Vallja u-largua dhe se i cili një nga një futesh brënda. Dëgjoheshin portëra që mbidheshin dhe zëra që thoshin: "U-lanetiçin, se na krien gjumën". Me pula bien në Gjirokastër. Ç' të rinë, apo të djegin valin e gurit? E pse këtë kusur? "Ta marrë djalli, ta mari" tha një burë dhe ha pështiu. Një ballgam holla te muri. "Ç' është këta të vatur tek nusja" ulurinin plakat e "ç' sehir i bukur" thoshin të ratë. Dhe së largu dëgjohesh kënga:

*Dolla një ditë mono  
Për ngjallat' e detito  
Kishin dalë çupato  
U pupu ç'ishin ato  
Bil e Haxhi agaito  
Kapetane përmbi to.*

Erdhën tek shtëpia e krushkut dhe mbenë në avli. Haxhi efendiu me djem i pritë mirë. U dhanë raki dhe këta zunë këngën:

*O ngre baluket,  
Vurija gëshetit  
Mos u hiq fodulle,  
Si zonj' e Përmetit  
Kur më shkon sokakut,  
Posi ros' e detit,  
Kur më del në derë,  
Si lule Xhenetit.  
Mos u hiq fodulle,  
Si zonj' e Përmetit,  
Se ç' më ka shtëpinë,  
Pranë huqumetit,  
Mos u hiq fodulle,  
Si zonj' e Përmetit.*

"Një tjetër këngë" tha Ustrefi "një tjetër, se s' dal këtëj":

*Dolla një ditë nga fusha,  
Paçë një tufë me çupa.  
Vallë cila qe m' e mirë?  
Ajo që përdill shaminë.  
Shami lara pika-pika.  
Te ur' e lumit të prita.  
Me tre gurë të godita,  
Të vrava me rastë pika,  
Gushën e bardhë ta lipa.*



“Një këngë për Haxhi efendinë” tha prapë Ustrefi. Me një binte në  
he “Ktheje Abidin”. Nuk ja prishnë qejfin dhe këtë rallë:

*Aman bardhushë ku vete  
Vet' e bardhë e hundë grepe  
Ç'të të vulos vula në xhepe  
Atje në gjumë tek fjetë. (di herë)  
Ç'të humbi e shkreta feste.  
Shkove ti o mik ma gjete.  
Ç'kuvëndon mike për lumë  
Si ta mar festenë unë  
Ç'kuvëndon mike për dera  
Si ta mar baluke prera.*

he pa mbaruar mirë këtë këngë muarnë udhën për në shtëpi. Në të kthier ishin  
ë lodhur dhe si të shushatur. Të vogjëlit flinin nga ecnin. Mashallatë u-uhnë.  
Një i pirë u-vuall e u-shkretua. Ca gjismë të dehur këndonin nëpër dhëmbë:

*Do vete të ri mbi krua  
Të më vij' ajo që dua  
Ajo që më deshë mua  
Moj leshverdha përmbi thua.  
Moj leshverdha dega-dega  
Moj faqe-kuqe, si shega.  
Çupë vetulla kurorë  
Në të zënça dot me dorë  
Do të tret si top me zborë  
Do të ha si koqe mollë*

U-afëruan tek shtëpia dhe Muhameti zuri një tjetër këngë:

*Ç'më ndjek e bukura prapa  
More shokë  
Më kërkon florinj' të gjatë  
More shokë.  
Bënija, Nexhip be,  
Bënija  
Bënija për adalet  
Për inat të shoqevet  
Për inat të motravit.*

Hijtin në avli dhe gratë i pritnë me këngë:

*Mike lerenxa në kopshtoj, oj' lerenxo  
Mos më nga se jam një foshnjoj, oj' lerenxo.  
Në paça kismet të ritem*

*Un' Nexhip beut si shqitem  
Nga qosteku do ti ngjitem.*

“Edhe një për mua, një për mua. Edhe një tjetër këngë për mua. Ta këndon!” tha Ustrefi, që ecënte zvara. Di veta e mbanin nga krahu. Leshërat i kishin rënë suratit, festija gjer në vesh dhe sitë i mbante gjismë të mbillura. Vinte gjishtin përpara, sikur do t'ja kdhite njeriut në si dhe up i binte dhe për vete me një thiesh në mes dhe ulurinte “këndoni, këndon i bura. Vallahi, bilahi u-vras. U-vras të gjithëve” dhe u ikte nga duartë atyre që e mbanin. S'që fare në vete. S'priti po e nisi vetë:

*Dolla një ditë për gjah jaman shoko, jaman jaman*

*Paçë di të bukura, jaman shoko, jaman jaman.*

*Cila ish m'e bukura jaman shoko jaman jaman?*

*Nuse Nexhip beuto jaman shoko jaman jaman*

*Ajo ishte për mbi to jaman shoko jaman jaman.*

Se sosi dot Ustrefi dhe një të shtrirë bëri në dhe. Qe bërë xurxull. Nëna, kur e pa n'atë ditë e futi në pat. I vuri një legen përpara. Ai futi gjishtret në griqë dhe me nder zotri s'uaj u-vuall vu e vu. I u-hapnë një çikë sitë. Pastaj u-shtri trash e gjerë dhe me vete këndonte:

*Ç' bien ca muzika*

*Ç' bien duke qarë*

*Ç' bien ca djelmsha*

*I bien të vrarë.*

*Ç' të ju qaj e zeza*

*Ç' të ju thom më parë*

*Njerin e kam nip moj*

*Tjetrin e kam djalë.*

*Ballukatë t' uaj*

*Se ç' rinë më nj' anë*

*Ç' të ju qaj e zeza*

*Ç' të ju thom më parë*

dhe pas një çikë gërhitit. Në avli burat u-përhapnë. Hijtin në konak. Andej dëgjonesh kënga

*Dolla një ditë nga mali*

*Paçë një të bukuro (di herë)*

*E bukura më pa mua*

*Vrap e mbilli derëno. (di herë)*

*Mos e mbill moj lule zajme*

*Për mua të mjerino (di herë)*

*Të të shoh moj lule zajme*

*Të di sit' e shkruaro  
Ndaj të perënduaro. (di herë)*

Merushja, motr' e vogël e teto Ruhos si u-kthien burat nga shtëpia e Haxhi elëndiut holli miellin në magje. Futi një unazë të florinjte dhe "eja të keqen" i tha djalit "mbilli sitë dhe gjeje unazën. Zeje me dhëmbë". Mustafai u-afua dhe pas i rinin shokët e tij. Ai futi kokën dhe këta ja dëndën brënda. Nëna me dorë nga brënda gjeti unazën dhe fët ja vuri djalit në gojë. "E gjeti" u-tha dhe hop ngriti kokën e Mustafajt. Të tjerët s' donin të dinin. Mirnin grushte me miell dhe ja hillnin njeri-jetrit. U-bënë kurkut nga të gjitha anët. Nuk u-shquante as koka, as këmbët. Le qilari kudo që hillje këmbën miell shkelje. Mustafaj vërtet u-bë ashtu dhe vrau një çikë hundën po nga ana tjetër u-gëzua se mori të gjitha paratë.

N' atë kohë hiri Ibrahimî. Mori magjen dhe e vuri në kokë. Dollin' avli. Shokët e tjerë, në mes kishin bërë një zjarr të madh ku kishin hedhur gjithë pishën që kish mbetur. Frangale dhe "hë" i thanë "kapërceje". Hop një herë Ibrahimî dhe "një... një... një, halla, halla" ulurinin të gjitha. Erdhi reth edhe një herë tjetër "di...di...di, halla, halla". Për të tretën herë... "tre... tre... tre halla, halla". Flaka, sa ven e bëneshe m' e madhe. Llamburitnin suratet e të gjithëve.

Kur ja, zunë të gjithë, njeri pas tjetërit, fiu e fiu, fiu e fiu, kapërce e kapërce zjarin. Sa u-lodhën, sa u-ul zjari fare.

Ibrahimî e pruri magjen brënda dhe Merushja e mori. Holli miellte në tepsi. E mbrujti tëk e tëk. E shtrojti prapë në funt të magjes. Atë e vuri në gjirmën e odasë së dimrit. Me gisht hapi nga një çikë vënd dhe vuri qiritë e dhezur. E mbulojti magjen me një çember të kuq. Vajzat e vogla vështronin me gojë hapët. "Mos e ngani me dorë" u tha kjo "se s' bën muartë vesh?" Ato tundën kokën. "E shini këtë brumë? Me këtë do bëjmë kulaçin e nuses. Hë dilni përjashata tani." Merushja i vuri përpara dhe hoqi derën. U-ngjit lart dhe vate me të tjerat bashkë. Nëpër dier lëvonte kuvëndi dhe në oda ziente kënga?

*Ç' të ndrit balli moj Hesma,*

*Jarna jarna jarna na na*

*Fiu e fiu e tarnana.*

*Nga mazia o aga*

*Jarna jarna jarna na na*

*Fiu e fiu e tarnana.*

*Ç' të ndrit gusha moj Hesma*

*Jarna jarna jarna na na*

*Fiu e fiu e tarnana.*

*Nga florinjte o aga*

*Jarna jarna jarna na na*

*Fiu e fiu e tarnana.*

*E kush t'i bleu moj Hesma  
Jarna jarna jarna na na  
Fiu e fiu e tarnana.  
Vet zotrote o aga  
Jarna jarna jarna na na  
Fiu e fiu e tarnana.*

Dhan' e dhanë duke kënduar:

*Moj si zez' e kaço-prerë  
Siri jot një lir e verdhë  
Faqija si koqe-mollë  
Del në penxhere si zonjë  
Tek potis vasilikonë.  
Dil në penxhere nga udha  
Me di qelqe si kushulla  
Si kushulla e Stambollit  
Bejk e malit Kondispolit.  
Moj bejko Kondispolite  
Në feste treqint mexhide  
Varur ballit kriqe kriqe  
Në beson Kristonë hiqe  
Hiqe moj se na shalltise.*

e kështu zunë tjetrën:

*Njëzet e pesë kalorë  
Nexhip beu pasha mbi ta (di herë)  
Mori bastunin në dorë  
Shkoi vate te nusija, (di herë)  
E rëmbienë na krahu  
E shpunë në bash oda (di herë)  
Dhe sininë që i vunë  
Me sheqer e me hurma. (di herë)*

edhe një për herë të fundit:

*Kur do vesh për Elbasan, asaman o mik o xhan  
Të lutem për një fustan, asaman o mik o xhan  
Fundin me kristo gajtan, asaman o mik o xhan.  
Ta vesh Bajram për Bajram, asaman o mik o xhan.  
Kur të vish nga Elbasani, asaman o mik o xhani  
Do gëzonem nga fustani, asaman o mik o xhani.*

Po më në fundi mori gjumi. Kënga u-pre dhe shtëpia mbeti shut. Nëpër

odara kishin shtruar radha radha, Kush veshur e kush zhveshur ja mori poshtë. Gjymë kudo, Dëgjohesh vetëm ndonjë grua që gërhinte, ndonjë foshnjë që qante e trakër trukur një djep që tundesh nga dora e nënës.

## DITA E KENASE...

Iku nata e brumit tek Mirteza Agai. Një ditë e re u-gdhi. Qielli qe veshur me ca re të vogla, të bardha si pambuk. Një er' e ftohtë frinte dhe të ngjethte nga një çikë. Ati këtu, dukesh një zok që fluturonte. Shkoi mëngjesi. Pas dreke; koha u-bë m' e ftohët. Tek Haxhi efendiu dualinë n' avli dhe çanin pishën duke kënduar.

*Uromë, baba uromë,  
Gëzomë baba gëzomë,  
Tani që çajmë pishën.  
Uratën paç moj bilë,  
M'u-plakç, m'u-trashëgoçç,  
M'u-bëfç një- zonj' e madhe.*

si kënduan dhe një tjetër:

*Të gjeta te porta, me duar në gji,  
Moj me tarnana, moj me tirmini  
Me pahir më shpunë, brënda në shtëpi, m  
Moj me tarnana, moj me tirmini.  
Më kreve glikonë, e hangërmë të di,  
Moj me tarnana, moj me tirmini.  
Ti më hapë gojën mbushur me flori,  
Moj me tarnana, moj me tirmini.*

dhe shpejt hijtën brënda se nuk rihesh jashtë.

\*  
\* \* \*

Në shtëpin' e Mirteza agajt, qepesh kënjaja. Vajzat e mbëdha ishin mbledhur n' oda të madhe. Njera kish shtruar një sixhade në mes dhe pup e pup u-uhnë të gjitha. Hatemi si pruri gjërat, u-ul dhe për vehte. Mori dhokohartën, me të bëri pesë qese të vogla dhe tre të mbëdha. Të tjerat këndonin:

*Uromë baba uromë,  
Gëzomë baba gëzomë,  
Tani që qepim këncanë.  
Uratën paç mor bir.*

*M'u-plaqç, m'u trashëgofç.*  
*M'u-bëfç një zonjë e madhe.*

Ato këndonin dhe Hasua mori kartën e bardhë e mbi të vuri dhokohartën. Më në funt shamaturën. E preu me gërshërë dhoturalle, dhoturalle. Kur e mbaroi ja dha Merzos. Ajo mbushi qeset me këna. Mbi qeset më të madhe vuri lulen. Pastaj mori kllabodonin dhe e përdrodhi me mëndafsh të kuq. U-bë si kosë. Një të prerë i bëri dhe dolli si xhufkë. Këtë ja qepi lules sipër dhe i qepi një flori të vogël pesë groshar. Qasi afër sinin e verdhë dhe i vuri të gjitha gjërat brënda. Nga xhepi i sadesë kreu një kuti me di bezelique. E vuri dhe atë bashkë me të tjerat. I mbuloi me boshta të mirë dhe "urdhëro teto Ruho" i tha "të trashëgonen". Zgjati duartë dhe ja dha, duke kënduar:

*Ç'ra një lirë në sini, moj në sini.*  
*Kush e shturi atë flori, atë flori*  
*Nexhipi me trimëri, me trimëri.*  
*Me gjithë shokë të ti, me trimëri.*

Pastaj në gjunjë gjëmtoi pënjërat e pënjërat. Kënga s'pushoi:

*Në funt të bashtesë, o moj pendo pendo*  
*Ngre funt'e sadesë, o moj pendo pendo.*  
*Se t'u lag me vesë, o moj pendo pendo.*  
*Ballëtë me djersë, o moj pendo pendo.*  
*Kush ta fshiu mëngjesë, o moj pendo pendo.*  
*Nexhip' i pa besë, o moj pendo, pendo.*

Punë s'kishin për të bërë, prandaj nuk e prenë këngën:

*Un kam tre sahat te dera*  
*Hape moj se me griu era.*  
*Hape moj qëne e qënit.*  
*Se më griu er' e shkëmbit.*  
*Er' e shkëmbit, er' e malit.*  
*Më hirë gjithë kufarit.*

Se ç'vante shtruar dhe bukur:

*Ndënë penxhere të shkova, bir vetullat e holla.*  
*Ngrita sit'e të vështrova, bir vetullat e holla.*  
*Ç'të ra gjëlpëra nga dora, bir vetullat e holla.*  
*Ndëra dorën e ta mora, bir vetullat e holla.*  
*Në gjergjef se ç'ta lëshova, bir vetullat e holla.*

pastaj:

*Një flori moj vashëzo, një flori të jap në muaj.*  
*Sa të shkoj moj vashëzo, sa të shkoj në portë t'uaj.*

*As flori, as dizme, në portë mos shko more,  
Se vjen babai pa i thom, portën se bëjmë dhrom.*

E kështu kënduan gjer sa u-ngris.

Erdhi darka, tek Haxhi efëndiu qe brumët e vajzës. Dhe atje këng e valle si një natë më parë tek Mirteza agaj. Në shtëpin' e djalit ranë shpejt për gjumë. E nesërmja i prite si kishin kohë të këndonin e të kërcenin.

\*  
\*  
\*

Një ditë e ngrohët u-gdhi me diell. Afër drekës, në shtëpin e Mirteza agajt u-mbluadhën të vogjëlit. Mashalla plot. S'kish mbetur njeri pa ardhur. Thirur e pa thirur. Hedo evgjijtja u-tiliks me çarçaf pembezar. Vuri sininë në kokë dhe me të doli tek porta. Vajza e djelm të vegjël i vanë prapa. Jashtë, në udhë i prite Ustrefi dhe Muhameti. Të di me futa të mëndafshhtë përpara. Njeri doli përpara dhe tjetri ndënji prapa. Zunë udhën me këngë

*Un të holla rallë ti më dolle plot,  
Aman trandafile, aman borzilok.  
Ç' të ra havale moj, një i shkretë zok,  
Aman trandafile, aman borzilok.  
Të kreu nga rënj'a, s'la farë për mot.  
Aman trandafile, aman borzilok.  
Janë mbledhur çapat, e qajnë me lot,  
Aman trandafile, aman borzilok.  
Janë mbledhur nënat, si pushojnë dot  
Aman trandafile, aman borzilok.*

Ecën një copë udhë. Pushuan një herë ku qe vëndi thikë e kishin mënden se mos gremiseshim. Duallnë në udhë të drejtë. Vajzat, birbil zënë:

Zunë këngën:

*Vashëza në zall të lumit, vashëzo e mjero.  
Tutje vashë se del lumi, vashëzo e mjero.  
Le të dal e të më marë, nënëzo e dashuro.  
Se kam një burë të marë, nënëzo e dashuro.  
Sos' të mar' e sos të çalë, nënëzo e dashuro.  
Nat' e ditë lot kumarë, nënëzo e dashuro.*

U-foli Hedo evgjijtja: "Eh, në keni në mënd të këndonin si është për të kënduar, mir' se mirë, në mos po pushoni. Ç'është kështu? Pse lëshoni këtë zë?" E shtruan mirë dhe kënduan me radhë:

*Dridhe përdridhe, shaminë me lule.  
S'kam me se ta dredh moj, shkremoj shkretëno.  
Me atë fustan moj, gjerroj gjerëno.*

*Un fustan e gjera, jam e nukë jam.  
Burënë që kështa, ma muarnë nizam.  
Më dërgojti kartë, s'më vuri selam.  
Më martë të keqen, m'u-bëftë kurban  
Jato çun' e vogël, jato te ke kam  
I marça të ligat, ju bëfça kurban.*

"Ecn mirë dhe vështroni përpara" u-foli Mahmuti. Shkuan nga pazari dhe i ranë mes për mes... Burëria lanë punën dhe duallnë përpara diqaneve. Ca ruar e ca pa ruar ishin. Vështruan sa hijtin n'udhë tjetër të vogjëlit e sa s'dukeshin fare. Vetëm kënga dëgjonesh:

*Ç'ke vito që mbushe sitë,  
Radhë radhë i ke florinjte  
Gjithë dupje venetike  
Ti bëri agai të ra,  
Gjithë sullan-Mustafa.*

U prishnë prapë këngën. Ca e linin, ca zinin një tjetër. "Lereni tani, sado" u-tha Ustrefi, "mos këndonni hidhnin këmbët shpejt. Kur te vimë afër shtëpisë së nuses atëherë zejeni". "Ashtu de" ja ktheu Hedo evgjijtja "ja u-bëri mirë. Ja u-bëre mirë djalë të keqen. Këto maçe të ngordhura". E mori nga dora Mustafanë se ai u-lodh. "Hë dhe një çikë, se erdhëm" i thosh kjo atje ku do vemi, nusja do të të zëjë dorën. E pe sa e bukur është nusja e dajko-Nexhipit? Duallnë në krie të udhës. Erdhën tek sheshi. Ja porta e madhe me di sufa. Ati afër fiku i egër.

"Hë këndonni tani" u-tha evgjijtja, "dhe këndonni mirë se na qeshin". Ato e zunë:

*Mineja rëzës së malit, hajde, hajde moj Mine,  
Sa e bukura që je.  
Duke mbajtur frën' e mushkës, hajde, hajde moj Mine,  
Sa e bukura që je.  
Duke dhënë sisë djalit, hadje, hajde moj Mine,  
Sa e bukura që je.  
Duke mbajtur frën' e mushkës, hajde hajde moj Mine,  
Sa e bukura që je.*

Erdhën përpara portës. U-zunë nga dora dhe u mbluadhnë grusht të gjithë. Ashtu kapërcien prakun e portës. Të tjerat nga penxheretë këndonin:

*Vogëlushe hane dane,  
Aman mike kapetane.  
Të kam thën' moj naze-madhe  
Vish robat si parizjane,*



*Leshërat si evropjane,  
Të kam thën' moj naze madhe,  
Zëmërën ma more fare.*

Zunë dhe këto na-poshtë:

*U-ngreçë nga gjumi, dolla te burimi,  
Lava sit' e zes, me uj trandafili.  
Më humbi sahati, më mbeti zinxhiri.  
Mos ki keq moj çupë, se ta blen bandilli.  
Se ta blen bandilli, Nexhip be veziri.*

Hjtin në avli dhe këngë tjetër nisë:

*Unë mantonë ta preva,  
Ta kam varturë te dera,  
N' do eja, ndo mos eja  
N' do mejtoju gjer pastaja.  
Si të bëj që të mejtohem,  
Kam frikë mos turpërohem.*

Hjtin brënda, me këngë:

*Moj e vogëla mexhite, mexhite,  
Pataksem se kur u-rite, mexhite.  
Jesh' e vogël e s'më dite, mexhite.  
E vogël e naze shumë, gjithë ditënë me punë  
Gjithë natënë me gjumë.*

Ngjitën shkallat. Te kreu' i priti Xhemileja. U puthi dorën. Motra e teto Qibros i mori Hedo evgjites sininë nga koka. I futi të gjitha n'oda. Djem e vajza u-uhnë mbi minder. Ca mbenë në këmbë. Zun' e shtinin njeri-jetrin. Po këngën s' e lanë:

*Pse ke dal e ri në shkallë, o pullumb o kraha bardhë?  
Një Perndi që ma di hallë, o pullumb o kraha bardhë  
Për di çupa që kam parë, o pullumb o kraha bardhë.  
I kam parë në mëhallë, o pullumb o kraha bardhë.  
Lipa njerën e s'ma dhanë, o pullumb o kraha bardhë.  
Leje çupë fukaranë, o pullumb o kraha bardhë.  
Tutje o bandill më thanë, o pullumb o kraha bardhë.  
O shoko ç'është sevdaja, m'e keqe se fukaraja.  
Fukara dojë të jeshë, po sevdanë mos ta keshë.*

Hiri Zulua me sherbet dhe iu dha të gjithëve. Ata e pinin dhe sitë i mbanin te nusja. Ajo nusëronte në funt të odasë. E vështronin dhe i këndonin:

*Moj kumbulla zerdeli, zerdeli.  
Pse lëshove që tani, zerdeli.  
Më mban beu në kuti, zerdeli.  
Më mbulon me jemeni, zerdeli.  
Më potis me gjulaki, zerdeli.*

Ndënjën pak dhe u-ngrenë. Shkoi e para Xhemileja dhe të vegjëlit nga prapa. U-shtipnë tek dera. Teto Qibrua me një kamistër përpara u-ndante bukëlugë. Di bashkë Mustafajt dhe nga një të tjerëve. Motra e saj i dha një frangë evgjites dhe i vuri sininë mbi kokë. I ndreqi boshtanë se qe kthier nga një anë dhe dukeshin bukët. Tre komata të mbëdha i kish vënë brënda.

Trapër trupër e brambër brumbër nëpër shkalla. Me një gremiseshin. Shtinin shoku shokun dhe nuk vështronin ku vinin këmbën. Me buk' e lugë në dorë, këndonin:

*Ju prunë këna me lule,  
Na dhatë bukë me krunde.  
Neve s'jeshmë për këtë.  
Na marçit të keqenë.  
Po jeshmë për zariko,  
Na marçit të keqeno.*

Pastaj:

*Rethi rethi shoshësë, moj e bil e dosësë.  
Rethi rethi sitësë, moj bil e evgjitesë.  
Rethi rethi butito, moj bil e harbutito.*

dhe ato na sipër ja thoshin:

*Moj vitoria në shkërb,  
Kur dëgjova zënë t'ënd,  
Shalltisa mbeta në vënt.  
Pallë lara me ergjënt  
Gjezdisurë vënt më vënt.  
Pallë lara me savat,  
Gjezdisurë fshat më fshat,  
Në Janin' e në Berat.*

Duallnë jashtë portës dhe erdhën tek sheshi me këngë:

*O ç'vjen lumi trubullo, trube trubulluaro,  
Ç' kren një trim të mbituro, trube trubulluaro.  
Ç'i vjen nëna dhoturo, dhotur' e ksedhoturo.  
I bën rixha valëso, trube trubulluaro,  
Kremë valë djalëno, trube trubulluaro,  
Se e kam të vetëmo, trube trubulluaro.*

Ecën drejt sokakut dhe dualnë në krie të udhës. Ustrefi u-holli një si. Ishin të gjithë. Vetë shkoi përpara me cingar në gojë. Muhameti vin nga prapa si dhe më parë. Kruante zënë, dhangaste buzën dha hak një pështimë në dhe. Hoqi festen nga koka e kruajti një çikë. E vuri prapë. U-lodh, vërtet dasmë dhe gas, po të drejtën të bien këmbët. Hajde eja, hajde eja. Pa le të dëgjosh gjithënjë avazin:

*Ç'u-niçë për në Janinë, natëno, vetëmo.  
Vajta mu te der' e hanit. natëno, vetëmo,  
Hape hanxhi derëno, natëno vetëmo.  
Nuk e hap se është natë, natëno, vetëmo.  
Hape se këndoi birbili, natëno, vetëmo  
Lëshoi lule trandafil, natëno, vetëmo.*

Eshtë një çikë turi der ki Muhameti. Ogursuz dhe në shtëpi. Si qesh kurë nuri. S'guxon njeriu të bëjë një shaka se i hidhet në kokë. Le se ç'heqin të zezat motra që ka brëndë. I pi të gjalla po t'i gjejë një çikë në penxhere. S'flet kurë. Po dhe në dasmë, ki zanat. Iu frinë zorët. Nuk iu ndënj dhe UHarin" u-tha. "Mbaroni këtë dhe mos u-dëgjoj prapë. Ecn tani dhe me të katra. Dreka". Ec e ec e s'kishte të sosur. Udh' e largët. Në vatur ishte gazi i nuses dhe iu bënin këmbët po tani u-dukesh m' e gjatë. Pa le q' i griu dhe uriya. Një i vogël theu qafën. U, të qarët. Zoti na ruajtë. Tjetri e ngriti nga cepi i palltos. Ai nga inati i futi një grusht.

I lau uriya dhe s'u-durohesh më. Vrësht hoqnë bukën nga luga dhe mbushnë gojën plot. S'bënesh ndrishe. Vët e vët e thapsën të gjithë. Me lugë vetëm iu afruan shtëpisë. E lëshuan dhe një herë zënë:

*Më dërgoj babaj me shqera, un' e mjera.  
I kullota nëpër fera, un' e mjera  
I kullota nd'anë lumit, un' e mjera  
Gjeçë të birin e mbretit, un' e mjera  
Desha ta mirja për burë, un' e mjera  
Ai më zuri me gurë, un' e mjera*

dhe për herën e fundit:

*Vure këmbënë në grazhdë, susajmeni,  
Shkova vajte te dilberi, susajmeni.  
Pa të thotë hajt të vemi, susajmeni,  
Hajt të vemi në Virua, susajmeni,  
Të marrim një degë stua, susajmeni,  
T'ja japim Nexipit grua, susajmeni*

dhe u-ndanë. Gjith se kush në shtëpi të tij. Evgjitja me Mustafanë nga dora

u-fut brënda që t'u dëftonte zonja ve që 'se kish lëshuar çikë.

Zonja e shtëpisë i mori sininë nga koka. I hoqi çarçafin pembezar nga sipër dhe "ulu" i tha. I mbushi pëqinë me bukë e me gjellë. Ç' të bëjnë fukara e zezë, këtë ditë presin, që të njomin një çikë gurmazin. Pastaj iku e gëzuar Hedua.

Dolli Merushja n'avli. Mori djalin nga dora dhe e gëzoi. "Të marça të ligat" i tha "djali" i nënës, prokopi e nënës. M'u-bëre dhe ti për nuse si shokët" dhe mac mac e puthi në faqe. Me zi e kish këtë djalë dhe mezi i kish kujtur. Kish hequr gjëmët kur e bëri. Po s'iu duknë gjë se i kishin vdekur një radhë. Pra e pjeti: "të keqen, të pëlqeu nusija e dajko Nexhipit? Ta puthi dorën?" "Më mori uria" i tha ai. Uri t'i kish djali, pa të liga le t'i bënte sa të donte nënës. Të ritesh e të bënesh, pa të gjitha ja duronte nëna. Të gjitha të mirat për atë qenë. "Eja t'u bëfça kurban të të japë nëna një copë bired dhe një copë bakllava. Mos ha shumë. Sonte jemi thirur për dërkë tek nusja". E shpuri andej. I dha për të ngrënë e me drekë bashkë iku dha dita e kënajt.

## NAT' E KENAJT...

Pasdrekeja iku me një herë. Pa punë. "Ngreu Merushe" i tha teto Ruhua motrës, "në ke për të vatur, koha është. Buka haet shpejt se kanë kënanë e ti e di vetë. Eshtë e tepërtë që ta thom unë". Kishte të drejtë motra e madhe. U-ngris. Në do vente të vente se koha që.

Nga Haxhi efendi kishin thirur gjithë shtëpinë e djalit. Njeri s'vente. Kush kish punë e kush që me të vogël. Vetëm Merushija do shkonte bashkë me Mustafanë. Kjo e kish të përkëmbur djalin. Në qafë s'i binte dhe sidomos kur vente gjëkund bënesh pulë. S'ndihesh fare, sikur s'që ai. Merushia q'atë kohë u-ngre. Veshi djalin, u-vesh dhe për vete. U-nisnë të di. Udhës porosite djalin "Atje ku të vemi, shi, mos bëç të liga, se na qeshin" dhe e mbante nga dora.

Erdhën në shtëpinë e Haxhi efendiut. Mirë i pritën dhe në krie të odasë i shpunë. Kallaballëk. Dëngëza shtëpia. Edhe divanet plot. Kjo në krie për një copë herë mbeti vetëm. S'njihte njeri. Ishte e pa dalë e zeza. S'i kish qeshur buza nga shëndeti. Kur na katallahu i zuri siri Haxhon. Ajo vate dhe iu-ul pranë. Nisnë kuvëndin. U-ngrenë nënë dhe u-veç vetëm kur i thirnë për bukë.

Të gjitha në këmbë vanë në odanë tjetër ku qenë shtruar di sufra të para. Krushkën me djalë e vunë në krie. Afër i ulnë Haxhon. Të tjerat ndënjën reth e reth. Të parën vunë çorvën. E kishin përvëlur mirë. Tek muarnë lugën e parë, ato që rinin në këmbë zunë këngën:

Hani moj zonja,  
Moj hundë-mbëdha,  
Hani zonja mos u-ngoçi,  
Në shtëpira mos u-soçi,  
Hani zonja, turp mos kini,  
Lugëtë mos i lëpini,  
Sahanetë mos i fshini.

Hoqnë tasin e çorvës dhe Zulua vuri sahanë me paça. Seqineja nisi këngën e ditë:

O ç'vjen dhoturë qiriri,  
Nënësë iu prish fiqiri  
Ngaha gjithë këto mika.  
Me se ti ngosi këto mika?  
Plakatë me mumuliga,  
Të ratë me qollopita.

Kur ja dëgjonesh zëri i teto Qibros: "urdhëro xhiko Merushe, ha, ha. Zotrote, s'ha fare. Hë, jepi djalit. Ha, ha, mos ki turp". Kur Seqineja ja dha:

Ha Merushe mos u-ngoç,  
Në shtëpi si zonj u-soç.  
Ha Merushe turp mos ki,  
Lugëtë mos i lëpi,  
Sahanetë mos i fshi.

I erdhi radha kabunisë. I kënduan Haxhos:

Haxhua është magrurë,  
Kërkon bakllava me lule,  
Edhe hoshof me bajame,  
Edhe lugë me merxhane,  
Bakllava me lule s'kemi,  
Çorvë me fasule kemi,  
Hoshaf me bajame s'kemi.

Ca qenë shtruar moj të keqen dhe hanin sa për tre veta. S'është as për të thënë, po e bënin veten si të limaksura. Një lugë e vinin në gojë pa e shkuar mirë e më të poshtë atë dhe hop zgjatnin dorën për të marrë tjetër.

Të shtëpisë këndonin:

Hani moj zonja,  
Moj hundë-mbëdha,  
Hani zonja korokaqe,

*Hant qofte bobollaqe  
Apo s'ju duket e mirë?  
Eshtë me jeurt të dhirë.*

Të gjitha qeshnë. Zulua ven' e vin me futa në mes. Pruri tepsinë me birek.  
Pa ngritur kokën zuri këngën.

Ja kish vënë në bina teto Haxhos:

*Lumi ti more birek  
E Haxhua nëpër xhep.  
E kanë porsiturë.  
Haxho moj të keqenë.  
Birek nga të dasmësë.*

Teto Qibrua kreu ca thela nga mesi dhe ja vuri përpara krushkës dhe "ha" i thosh. "Na, edhe një copë tjetër. Këtë për Mustafanë". Prunë bakllavanë. Kësaj nuk ja lanë radhën bosh:

*Lumja, ti noj bakllava,  
E Bibia në tamlla.  
E porsiti nënua,  
Bibi moj të keqenë,  
Bakllava të dasmësë.*

Bibia kur dëgjoi këto fjalë ju futnë sitë brënda nga të qeshurit. Gjer atë kohë s'qe ndier fare dhe njeri s'e kish kujtuar. Mirë thonë kur njeriu s'është për në mejdan, ç' do që del në dhe. Po ç' të bëjë e zeza. Vërtet me gjismë mënde, po e kish të afër Haxhi efendinë. Vajzë e shkreta e me nje nënë të sëmurë. Qe plakur brënda. S'qe për burë ajo. Qeshi një çikë dhe zuri prapë nga të ngrënë.

Ngritën tepsinë dhe thanë:

*Në sufra, ndënë sufra,  
S'latë thel' e kokolla,  
S'latë kërcë bakllava.*

Në funt hangërnë muhalebinë dhe u-ngrenë. Të gjitha lajtën duartë dhe vanë në oda. **Krushka hiri dhe Xhemileja** u-ngrit në këmbë. Mënj'a ni telet dhe ndënji shtruar. "Ulu nuse" i tha. Ajo ashtu bëri.

Koha qe e mirë. **Krushkat** pritëshin. Hëna kish dalë në qiell dhe illet ndriçonin. Teto Qibrua mendonesh se ku do të fute gratë. Ku të rinin? Odatë qenë gjer në grikë. Me fjalë, i kreu njerëzinë nga odaja e dimrit. Do vinë burat u-tha. Mbilli derën me haps dhe vate përposh. Po s'është e madhja në këmbë s'bënet puno. Pa le evgjitkat e zeza që të kruajnë. U-fut në pat dhe "hani shpejt" u-tha grave të shtëpisë "se krushkat janë në të ardhur e sipër. Shpejt

Zulo të keqen, se ti e mban këngën. Ri një çikë pranë Xhemilesë". E që Zulua sa për të gjitha. E dhënë sa për ashtu dhe e pa përtuar. Kishte ngjarë nënën e saj.

Sipër kishin zënë këngën:

*Xhemile të bëj rixha, të ngrihesh që në saba  
Të vëç punën në sëra, të ngriheç që në mëngjes,  
Të març, ibrik' e legen, t'i shtëçë vjehrito,  
Që të lajë faqeto, të japi uratëno.*

Në divan u-zu një valle tjetër:

*Nd'anë lumit bie flë, vjen një zogz' e më ngrë.  
Ngreu o bej të keqenë, se vallë piqemi më,  
Me Hanko Xhelilenë, buzë karafilënë,  
Ikë hanko se do vi, vi piqemi në shtëpi.*

Pas të mbëdhave edhe të voglat:

*Dizet kollonata, preva një fustan,  
Mjerë un' e mjera, me kë do ta mbaj.  
Me gërshër e preva, me lot do ta qaj,  
Dhe burën që kisha, ma muarn'ushtar  
Mjerë un' e mjera, me kë do ta mbaj.  
Më dërgojti kartë, s'më vuri selam.  
Mjerë un' e mjera, me kë do ta mbaj.  
Më dërgojti kartë, më vuri selam,  
Lumja un' e lumura, kam me kë e mbaj.*

Sa mbaruan atë, zunë tjetrën:

*Ç' që një kullë në Berat, o baba more baba,  
Rin i bukuri mbi shtrat, o baba more baba,  
Ta kesh un' e varfëra, o baba more baba  
Ja kushuri, ja vëlla, o baba more baba,  
Jahot burë me nigja, o baba more baba.  
Kërkon mil' e palë shumë, bila ime.  
Palë shumë e roba shumë, bila ime.  
Taksi shumë e jepi pak, o babai ime  
Një tenxhere pa kapak, o babai ime.  
Një sunduk pa kapërçhak, o babai ime.  
Një kopshtë me karthëla, o babai ime,  
Një hashte më lakëra, o babai ime*

Më mirë këndonin këto se sa ato që ishin brënda. Prapë ja muarnë:

*Një lejmon që nxori lumi,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.*

*Ju që veni, ju që vini,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban  
Nexhip benë mos ma ngini,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.  
Se Nexhipi është t'imi,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.  
Larë me ujë floriri,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.  
Kur të shkoni, mos ma zgjoni,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.  
Me jorgan të ma mbuloni,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.  
Se Nexhipi është toni,  
Moj aman aman, ju bëfça kurban.*

E kështu tjetrën:

*Të prita bandill të prita, të prita.  
Shtrova stravec dhe e ngrita, të prita.  
Shtrova bukën dhe e ngrita, të prita.  
Shtrova stromën dhe e ngrita, të prita.  
Të prita sa u-gdhi dita, të prita,  
Të prita të rasti pika, të prita.*

Teto Qibrua mbarojti punët dhe hiri n'oda. U-ul në fut të minderit. Seqineja me ta parë, zuri këngën:

*Xhemo të bëneç e mirë  
Të nderoç baban e mirë.  
Ashtu si ke kadiminë,  
Si ke fisnë e si ke farë,  
Nga dajko, nga xhaxhallarë.*

Nëna mbushi sitë dhe vështroi vajzën. Mblodhi buzët dhe shkoj pështimën më të poshtë. Mbajti lotët. Zulua e pa dhe i tundi kokën. Zuri një këngë tjetër:

*Ç'mbiu një lejmon në derë,  
Trandafi për të mar erë,  
Trandafil jeshë vërtetë,  
Korba që s'pata kismetë,  
Për një burë me lezet,  
Të dil në shok' e në brek,  
Të bën lodr' e muhabet.*

“Krushkat” thanë. Të gjitha krien kokën nga penxhereja. Qe një kohë qelq.



Ca fenerë dukeshin së largu dhe një zë i thellë vinte:

*Kur dolla në lëmë, hënë moj hënë  
Të dëgjova zënë, hënë moj hënë.  
Hajde lart moj hënë, se mua s' më lënë,  
Shoqetë më panë, ç' bën ashtu më thanë?  
Puthem me jahranë.*

U-afruan më shumë. Të gjitha gratë brënda u ngrënë në këmbë. Vajzat e vogëla që qenë nëpër avlira ngjitën shkallat. Krushkat hijtin portën me këngë:

*Bën konak moj gjerqinë, nën konak.  
Bën konak se me një vimë, bën konak.  
Bën hazër odan' e mirë, bën konak.  
Ormis verën e rakinë, bën konak.  
Se u-nismë e do të vimë, bën konak.  
Të të vëm' kënanë t'inë, bën konak.*

Teto Qibrua i futi në odan e dimrit. Shpuri andej krushkën Merushe dhe Haxhon. Futi Xhemilenë e nga prapa i vate Kao-Pinua. Krushkat u-zunë në valle dhe me këngë:

*Moj portokalija t'ëndë, shumë se ç'të qënë vënë,  
Po ai kail s'qe hënë, qe kismet për t'ënë  
Moj portokalija taze, moj e ritura me naze,  
Me naze me kanaqi, me babanë në shtëpi.*

Me to bashkë këndonte dhe Merushja. Gjer atë kohë rinte si e ndruajtur po tani me të sajtë u-çel. A po s'këndonte:

*Ku je ritur e je bërë, nuse zerdeli-ergjëntë,  
Në Stamboll a mos ke qënë? Nuse zerdeli ergjente.  
Mollë t' ëmbla mos ke ngrënë? Nuse zerdeli ergjëntë.*

Nga odaja tjetër nuk e prenë këngën:

*Shtatëdhjetë floring ballit, moj Mahmude, ç'më këpute.  
Ngreu Mahmude, ngre biro, se të prunë robato.  
Jam sëmurë moj nëno, jam sëmurë e dergjemo.  
As sëmurë as dergjem kurë, ja bëj babaitë për dhunë,  
Të më bëjë palë shumë, palë shumë e roba shumë.*

Në oda erdhi Hatemi. Mori Xhemilenë nga dora dhe e shpuri andej. I veshi një palë roba të tjera, si në zëmër të pjeprit. Prapë e pruri te krushkat. Ato s'elanë në dhe po e muarnë në valle:

*Ulu mal të dalë hëna, të stolisetë kadëna,  
Të vishetë allafrenga,  
Të vishet me të bardha, të lulëzojë si dardha,  
Të vishetë me të holla, të lulëzojë si molla.*

Dhe nga divani dëgjonesh:

*Ç'më mbiu një ftua në Hoxhat, në Hoxhat,  
Moll' e kuqe në Bejkat, në Bejkat.  
Dërgoi ftoi te molla,  
Të mari mollën e kuqe, t'ja japu Nexhipit nuse.*

Për të tretën herë e ndruan Xhemilenë. Herën e fundit e veshnë me roba shqiptarçe. Seqineja, ashtu nëpër këmbë i shkoj një cfongar me sqafill në surat. I ndreqi çitjanet dhe i ngriti mëngët e këmishës dhe nga dora e shpuri në odan e krushkave. E futi në valle. S'priti të tjerat, po e nisi vetë këtë radhë këngën:

*Moj e holl' e buzë gaze,  
Ç'më mban tumanet me naze.  
Me naze ma mban tumanë,  
Si djali fodull fustanë.  
Me naze ma mban jelekë,  
Si djali fodull qostekë.*

Zunë krushkat të ngriheshin. "Edhe një tjetër" tha Merushija:

*U-nise u-bëre il, Xhemo guri xhevahir  
Vur festenë me tirtir, Xhemo guri xhevahir  
Babai të bën sehir, Xhemo guri xhevahir.*

*U-nise u-bëre il, Xhemo guri xhevair,  
Vur festen me tirtir, Xhemo guri xhevahir  
Nëna se ç'të bën sehir, Xhemo guri xhevahir.*

e pas kësaj një tjetër:

*Moj hunaza reth flori, reth flori  
More burë trim të ri, trim të ri.  
Ta kanë shoqet zili, shoqet zili.  
Moj hunaza reth me ar, reth me ar.  
More burë trim me arm, nim me arm.  
Ta kanë shoqet nakar, shoqet nakar.*

Me këngë duallinë te divani. Xërmuan shkallët po duke kënduar:

*Ikullo, ndrikullo, koha për të ikuro.  
T' ikim se na zuri nata, pa na mer florinj' e gjata.*

E nisnë dhe një herë po e thanë më të gjatë:

*Ikullo, ndrikullo, koha për të ikuro.  
Mori i rinu të renë, e Alushi Mergjuzenë,  
Vanë në funt t' urësë, zuri ura dridhëshë.  
Ç' ke moj urë që po dridhe, ç' ke moj nuse që po dridhe,  
Ç' ke moj nuse që po sille? Sillem se të kam ti plak,  
Nga më njohe që jam plak?  
A fjekërshit mustaqeshit, dhëmbëshit, dhëmballëshit,  
Ngriti kali këmbëto, e më theu dhëmbëto.  
Frijti era miellto.  
A lë zbardhoi mjekër' e mustaqe, sa s'më mbeti fill në faqe.*

Po kur dëgjuan këngën:

*Si e kemi nuseno, moj krushka,  
Të mir' e të zgjedhuro, moj krushka,  
Jo mos keni djalëno, moj krushka  
Të çal, a të verbëro, moj krushka?*

S'e lanë pa ja u-kthier:

*Turtulu moj faqe kuqe, ç' kërkon në ato sunduqe?  
Kërkoj kadife të kuqe, t'ja var kalitë dosduqe.  
Dozduqe për dhëndëri, Nexhip galë shtrëmbëti,  
Ai se ka të shtrëmbëto, na marçit të keqeno.  
Mos ta keni nuseno, të çal a të verbëto.*

Këndonin mirë. Qenë ca nuse veshur le se ç' qenë veshur. E gjith' ato bengje me florinj, q'i mbanin me duar se mos ja u vidhte njeri nëpër shkalla.

Me të ikur krushkat, të shtëpisë u-futnë brënda. Me të shpejtë vanë në oda. Tetua e Xhemilesë, në mes të odasë vuri një jastëk. Atje e uli mbesën që qe veshur me një sade hindja. Halla, e saj i vuri përpara një legen të verdhë. Atje zbrasi kënanë e qeses së madhe. Dhe u-ul në shesh edhe për vete. Mënj' a ni çitjanet dhe i shkoi bezeliquet ne të di duartë asaj. Florin pesë groshar ja vuri në pëllëmbë të dorës së djathtë.

Xhemileja rin me kokë ulët. Xhur-xhur i venin lotët. Zulua i vin kënanë mala mala. I leu gjishtin e shehadeit gjer tek i madhi. Reth e rotull vuri një unazë, ur' e Xhenetit si thonë plakat. Pastaj vulën në mes të dorës dhe gjismë hënzën në funt të pëllëmbës. Shoqja e vështronte në si dhe i binte me bilur. Seqinea me gratë e tjera i këndonin:

*Erdhi koha për këna, Xhemile fat madhija  
Ç' këputu nga vallija, Xhemile fat madhija.  
Lum babai se ku të dha, Xhemile fat madhija.  
Në saraje të mbëdha, Xhemile fat madhija.  
Vur kënanë moj, trendelinë moj.  
Vure Xhemile, me shumë naze.  
Vure Xhemile kënanë, se të ri nanaja pranë.*

Nga ana tjetër teto Qibrua qante dhe i kërcente gjoksi. Të tjerat këndonin:  
*Gjithë reth e reth të jemi, moj unazë.  
Gjithë far' e fisn' e kemi, moj unazë.  
Po Hamdinë ku e kemi, moj unazë.*

Atëhere teto Qibrua qajti dhe më shumë. Iu kujtua vëllai mbetur në Amerikë.  
Kur zunë këngën tjetër:

*Edhe sonte jam këtu, roj-broj  
Pa nesër ngarkoj e shkoj, roj-broj.  
Babanë do ta lëshoj, roj-broj.  
Aganë do ta gëzoj roj-broj.  
Edhe sonte jam këtu, roj-broj.  
Pa nesër ngarkoj e shkoj, roj-broj.  
Nananë do ta lëshoj, roj-broj.  
Katërxhikën ta gëzoj, roj-broj.*

atëherë s'iu mba të qartë nënës, me të madhe sa e panë të gjitha. Nëna qante. Xhemileja qante dhe halla e saj i vuri lesh mbi këna. Ja futi duartë në di qese, ja lidhi te qafa. Kur mbaruan Seqineja e ngriti në këmbë Xhemilenë, e mori nga krahu dhe e shpuri andej. E vuri për të tjetur bashkë me djalin e dajkos së saj, tetë vjeçar. Të bënte djem atje ku të ven e të mbushte shtëpinë plot. Nëna q'ekishte ndjekur nga prapa e mbulojti mirë, i zgullosoi krahut me jorgan. "Fli tani" i tha. I uli llambën për gjismë dhe me mala të gjishtrëve dolli jashtë. Pa mbajti këmbët, futi prapë kokën në oda e pa dhe një herë vajzën. Më në fund e hapi derën dhe "shë...shë... ë" u-tha së tjerave "kadale ecni dhe mos folni nëpër dier se flë Xhemileja".

Kur dielli lëshoi rezet e para dhe buza e malit zbarlloi, era e lehtë e mëngjezit largoi edhe retë e paka që ishin në qiell, në shtëpinë e Haxhi efendiut akoma këndonin. Qenë gdhirë gjithë natën dhe të zgjuara i gjeti mëngjesi.

## NEN' E VAJZE...

Ndaj të gdhirë... këmbë të lehta dëgjoheshin në divan. Ishte teto Qibrua, që ecënte me kadale. Shtrak kllçon dhe hapi derën e odasë atje ku flinte vajza. Xhemileja dhe ajo ishte i zgjuar. Ngriti me një herë kokën. Qe akoma erësile dhe nuk shqoi kush hiri. Një dritë e verbuar hinte brënda nga xhamet e penxheresë. Nëna iu qas pranë dhe "Xhemo" i tha me zë të ulët, "flë akoma?". Ajo u-ngre përgjismë dhe vështroi nënën në surat. Nuk foli.

Mirë frimë thellë. Kosat i qenë ksepleksur dhe i mbulonin supet. Leshërat i kishin rënë në surat. Sadeja përpara i qe sberthier. I dukesh gjoksi gjism' i hapur. I ulesh e ngrihesh nga mirë frimë dhe i çquanin kokallat e qafës. Në kohët e fundit ishte prishur një allaj. I kishte mbetur suratit sa një karvele. Me dorën e djathtë shtëmëngi leshrat.

Teto Qibrua u-ul tek cepi i stromës. Vështroi e vështroi vajzën. Kish katër ditë e katër netë që bënesh dasmë e zonja e shtëpisë s' kish patur kohë të ndronte di fjalë radha me Xhemilenë. Nënë gjithë natën se kish zënë gjumi. Mendonte të nesërmen. Ishte dita e fundit e dasmës dhe vajza do t' i ikënte nga shtëpia. Do t' ikënte nga shtëpia, të linte nënën vetëm! Për këtë qajti gjithë natën sa e bëri qull jastëkun dhe e zuri një kokë që vetëm ndaj të gdhirë kur zbardhi buza e malit e lërojti. S' iu ndënj më pa u-ngre në këmbë. U-vesh dhe vate erdhi një copë herë të madhe nëpër oda. Më në fund s' iu durua më dhe doli jashtë e vate tek vajza, si thamë dhe më parë u-ul tek cepi i stromës.

Si ndënji një çikë ulur një të ngritur bëri në këmbë. Vate te penxhereja, hapi xhamin dhe ndëri kokën jashtë. Akoma s' kish dalë mirë dielli. Rezet e para ngriheshin dhe humbitnin në qiellin e veshur me re të murme që dalë nga dalë po ecnin nga njera në për në tjetrën duke lënë hapët atë këtu nga një copë qiell të kulluar.

Teto Qibrua si ngriti perdhjetë u-ul prapë pranë vajzës. Vështroi reth e rotull e tek rin ashtu pa folur i erdhi në mënde që shtatëmbëdhjetë vjet më parë po në këtë oda kish lerë Xhemileja. Ja, atje mbi atë minder një natë dimri kur jashtë binte shi me të madhe e gjëmonin bubullimat e epikat e shiut binin kaq shumë mbi çati e xhame sa zëri i saj nuk u-dëgjua jashtë. Në këtë oda kish rënë lehonë shtatëmbëdhjetë vjet më parë, shtatëmbëdhjetë vjet shkuar qe bënë nëna me vajzë.

Teto Qibrua nuk flite po vështronte dhe shpirti i saj dukej sikur shtipej nga një peshë e rëndë dhe sikur një gjë e zinte në griqë. Në kohën që lotët i binin njeri pas tjetrit nëpër faqe përpara sive i dilnin vitet e shkuara dhe i dukej sikur dëgjonte një të qarë "uah e uah..." ishte Xhemileja foshnjë dhe mamia

n' atë kohë e lidhte kollopan. Ja ajo në këmbë që i thotë me zë të hollë "vajzë, vajzë, vajzë, me këmbë të mbarë".

"Vajzë...! Bjer mata shoh një çikë" foli nëna me sa kishte fuqi, sa haroi që vjehra i rinte pranë Po mënden s' e kishte ati. Me të dia duartë e rëmbëu foshnjën. i hapi buzlën. Qe akoma e kuqe në surat, sitë të mbillura, me buzë të ndërura. E mbulojtë prapë dhe e shtrëngoi fort, fort në gji. E ngrohu me frimën e saj duke pandehur se kështu të ftohtit e asaj nate. të atij dimëri të madh nuk do të hinte në trupin e njomë. Donte ta mbante më shumë po iu këputnë duartë dhe iu pre fuqia. Iu veshnë sitë dhe u-bë dillë nga surati. Bëri në kohë të jepte foshnjën dhe një të shtrirë bëri. Humbi e kështu e zalisur mbeti njëzet e katër sahat. Iu prenë navzet dhe një natë e një ditë nuk hapi sitë sa pandehnë se vdiq. U-sëmur rëndë për një kohë të gjatë sa që njeri s' pandehi të shpëtonte. E kështu Xhemileja gjith' atë kohë u-rit pa pirë qumësht nga të nënës.

Nëna u-druall e tëra. I ra në mënde kur vuri vajzën për herë të parë në kraharor. Ç' të pinte e zeza foshnjë? Mp...mp i bënte buzët e vogla dhe e godite me dorë tek gjoksi. Donte të pinte po nuk gjente një komb qumësht. I kish ikur i gjithi.

E ç' nuk bëri nëna! Vari gur te qumështi. Pa sarandisur nga tre kurorë mori miell dhe e bëri kulaç dhe me këmbë të dredhura vate në grop të musllukut në shtëpin e teto Zulos. Atje u-ul, ndëri këmbët, hapi një çikë fitin dhe la sa të pikonte ujët. Për vete zuri të hante kulaçin. Ha e pik pik ujët dhe "ashtu më artë qumështi dhe mua" thoshte me vehte. Po ç' që e bërt dhe këtë? Vajzën se shinte dot kur qante e i këpute shpirtin. Ha lakranat e ditë e vet pilaf me presh. Pastaj u-këndua e u përmbis, po dhe këto s' i bënë gjë.

Kështu, teto Qibrua e riti vajzën me bocë. Hoqi një çikë në të parë se me nder zotri s' uaj dilte gjithnjë shtok. Ndroi qumështin. Nuk shkuan di muaj i vdiq djali i tretë. Nëna e riti vajzën me hillërime e me lotë. E riti vajzën me frikë se i kishin vdekur një radhë sa kishte mbudhur dhenë. Djalin e madh do ta kishte burë me fëmilë po ç' e do që si rojti. Se ç' heq i ziu njeri në këtë botë. Tani që mendonte të gjitha këto i dukesh sikur vajzën nuk e kishte qeverisur mirë, sikur e kish ritur jetime.

Mbushi sitë me lotë për vajzën. I dukesh sikur dëgjonte ato këmbët e vogla pëtë pëtë nëpër divane e nëpër dier që ndiqte nënën nga prapa dhe e ndukte nga cepi i çitjaneve. Dhe e vogël që qe s' bënte kurë të liga, s' dëgjonesh fare nëpër shtëpi. Bello! Pa le kur e linte në djep dhe kjo bënte gjithë punët. S' ndihesh fare Xhemileja, se si do q' u-rit pa gji kish ardhur e mbarë. Nëna kur lante këmishët e vinte në një kanistër në mest' avlisë. I fute në gojë llastikën dhe në dorë lilën. Harohesh dhe vetëm kur vinte koha e së pirit grindesh një çikë.

Dhe teto Qibrua e vështronte vajzën që kish përpara. I dukesh patai q' ajo Xhemile aq' e vogël u-rit shpejt e u-bë aq e madhe. E pse e martoi kaq shpejt? Mos vallë nuk e donte sa djemtë? Pse s' e mbajti dhe ca kohë brënda?

Dhe i dridhesh buza e shkonte pështimën më të poshtë. E po s'bie lumi gjithënjë kucura dhe vëndet e mira nuk gjënden kollaj, i bënesh një zë sikur i flite me ngadale në vehten e saj. Të vogël e martoi? Jo, jo, si gjithë shoqet e saja. Po kësaj pse i dukesh kështu? Me hakë se sot pasdreke e ikënte vajza nga shtëpia, fluturonte zogu nga folea për të bërë vënt gjetiu. Në nëntë të ditës do të vinin krushkat ta mirnin. Dita e nesërme do ta qjente nënën vetëm. Pa njeri në shtëpi. Nuk do dëgjonte tëpër tëpër këmbët e vajzës nëpër divane e nëpër shkalla zërin e s'aj. Si do te bënte! Teto Qibrua mblodhi supet dhe me dorën e mëngjërtë mbuloi sitë, uli kokën. I erdhi për të qarë po komb e shkoi më të poshtë.

Një erë e lehtë frinte jashtë dhe n'oda bënte një çikë ftohët. Teto Qibrua u-ngjeth. U-ngre në këmbë dhe hapi musandaranë në funt t'odasë, kreu pallton e saj, ja hollu vajzës në kraha. I futi mirë jorganin tek këmbët dhe më në funt i foli. I foli me zë të ulët dhe si me të qarë e me zi i mbante lotët "me mënt vajzë atje ku të veç. Hap sitë dhe bënu e mirë me vjehrin e me vjehrën. Dhe me gjithë njerëzi. Nuse ata e ti te dera. Vetëm lepe peqe".

Xhemileja u-druall e tëra dhe shtrëngoi mirë pallton krahave dhe uli kokën. I hollu sitë një herë nënës dhe i uli në dhe pastaj. Dhe kësaj i vinte për të qarë kur pa nënën aqë të honepsur nga surati. Sitë i qenë bërë lila lila dhe i-dridhesh buza. Po nëna nuk e preu fjalën "si të vijë puna, ti si më e vogël mos folë. Eshtë, ç'eshtë, e mirë, e ligë ti mos hap gojën se ke më të mbëdhenj mbi kokë. Mos kërcë në fjalë dhe folë me mënt. Atje ku vete, ajo shtëpi është e pa dëgjuar. Nuk dua të miret në gojë në ditën t'ënde. Bota për ti do thotë të liga dhe mos haro se njeriu nuk i gjen të gjitha atje ku vete. Dhe shi, në mëngjes njerziti e shtëpisë kur të ngrihen të të gjejnë në këmbë e ç'gjen përpara mos e ler atje po hiqe, ngreje nga dheu. Thonë pastaj se nusja i ka duartë të thara..."

E preu fjalën se u-dëgjuan këmbë nëpër divane. Gratë qenë ngritur, të vogjëlit bashkë me të mbëdhatë. Kush qante, kush ulurinte, kush kërkonte nënën e kush kërkonte bukë. Një rëmullë e madhe.

Dera u-hap. Një grua futi kokën brënda, vështroi po për të hirë brënda s'hiri. Nëna u-ngrit në këmbë dhe "hë" i tha vajzës "ngreu tani se ke për të larë duartë. Po dale se të është hapur qeseja e dorës së mëngjërtë. Ki mënden mos të të bjerë. Mos e hiq pallton nga krahat se bën ftohët".

Xhemileja u-ngre me një herë. Zuri të dilte nga odaja po hiri motra e teto Qibros me legen në dorë. "Mu këtu në funt t'odasë, se janë të gjitha nëpër këmbë", i tha kjo. Uli legenin dhe ibrikun. I zgjidhi qesete Xhemilesë nga duartë, i hoqi leshin që kish mbuluar kënanë. Kënanë që i kish zënë nishan e më shumë e më shumë dora e djathtë.

Xhemileja i shplau duartë më parë me ujë të gërques që t'i thellonte kënanë dhe kështu të mbante më shumë. Pastaj u-sapunis mirë me ujë llagar.

Teto Qibrua vate andej e kur pa shtëpinë n'atë ditë iu duk si pazar i

prishur. Jashtë e brënda këmbë këmbë, shkallat, divanet, odatë pisë. S'kish mbetur çarçaf në vënt, makat në vënt. Stromëra, jorgane nëpër dhe, plot gjëra nëpër udhë. Kush hinte, kush dilte. Gra me djepe nëpër duar, kush me ferexhe veshur, nisur për në shtëpi.

Kështu u-gdhi dita e nuses. Të ftuarat njera pas tjetrës u-ngrenë e iknë. Të shtëpisë iu përveshnë punës. Jashtë, një kohë e bukur. Qielli bënë qelq, dielli mbuluar dhenë. Era nuk frinte si ndaj të gdhirë. Bënte një kohë si behar.

## DIT' E NUSES.....

Në shtëpin e Haxhi efendiut graria punonte. Nasqiriste nga të gjitha anët. Jashtë udhët plot, burëria dilte pazarit e porta e Haxhi efendiut hapur të di kanatet. Akoma dilnin gra. Iknin shpejt që pas dreke të kishin kohë të ktheneshin prapë.

Xhemileja lau duartë. Kënaja, si thamë dhe më parë, i kish zënë mirë. Tani ven' e vin nëpër shtëpi dhe i dukej sikur çdo gjë i ikente tutje dhe ajo u vente prapa e si arrinte dot. Po sa të hapje e të mbidhje sitë iku mëngjesi, dhe ati afër drekës erdhi Hedo evgjitja me boshta të mirë në kokë. Atje brënda teto Ruhua kish vënë me radhë e me radhe: robat e nusërisë të nuses së djalit. Ja kishte bënë të ra. S'don të mirte hua se djalin e kish të vetëm. S'kish gas tjetër më të afërtë për të.

Teto Qibrua e shpuri evgjiten brënda, ja mori boshtanë dhe në dorë i vuri ca të holla. Ajo si piu kafenë u-ngre e iku. Me të bashkë doli nga shtëpia sepeti i vajzës. Ustrefi kish ardhur e me të bashkë dhe një hamall.

Teto Qibrua, me motra e me kunata zunë pexherene. Vështronin jashtë dhe shihnin sepetin që kish marë udhën. Atje brënda qenë robat e vajzës. I kish bërë me duartë e saja. Si të vjen atë kohë. Të vjen si të qarë. Të duket sikur do të ndërç duartë e ta zëç që mos ta lëç të iki. Nënata gëzohen të martojnë vajzat, po prapë, atë kohë që gjëri del nga shtëpia, u-duket sikur e shesin. Kështu i dukesh atë kohë dhe teto Qibros.

Sepeti u-largua dhe Kako-Pinua hiri derën. Drënjë! Ecënte si zonj' e madhe. S'kish lënë njeri pa nisur me duart' e saja. Ajo i niste, ajo i qindiste dhe ajo i shpinte në shtëpin e burit.

Hiri në dëndivan. S'pa njeri nëpër këmbë. Bam bam i ra derës me dorë. "Urdhëro brënda" u-dëgjua një zë nga sipër. Ajo me dorën e djathtë tek parmaku u-ngjit sipër, u-fut drejt e në odan e madhe. Plot fëmilë nëpër këmbë. I vështroi me buzë të drellura dhe duke ngritur nj' anë të çitjaneve u-ul në krie të minderit. U-pjet me të gjitha. Vështronte andej e këndej po gjëkund nuk shihte Xhemilenë. "E ku e ke këtë djall vajzë?" i tha teto Qibros. Nuk shkoi shumë, kur ajo hiri derën. U-ul afër saj e Kako-Pinua zuri nga puna.



Të gjitha pushuan e vështronin nusen që nisesh. Bulla i vuri te kuqtë në mollzat e faqeve, i shkoi sqafillin me cfongar. E pa mir' e mirë dhe "mos u-tund" i foli, "mos i mba ato si ashtu". Të mos qaç sot moj e mallkuar se të prishet stolia. Ashtu duke folur, kreu një kuti të vogël nga xhepi i çitjaneve. E hapi, mori gjëlpërën dhe e futi në filxhan me zam. Andej në tel të grirë. Me atë i qindisi ballin. Më parë i bëri një degë qiparis pastaj degë të tjera më të vogla. S'i pëlqeu njëra dhe fësh e prishi me gjisht të vogël. E bëri prapë. Në faqe i qindisi nga një dardhë. Në funt, me një fill shpirtu vuri tëk e tëk llambrot. I shkoi mazinë vetullave, të kuqtë buzëve dhe "ngreu" i tha. Xhemileja vate andej, të voglat iu derdhën kësaj. Kush të zinte më parë vëndin përpara Kako-Pinos. "Edhe mua, edhe mua" ulurinin. Ajo cave u-bëri nga një lule në ballë. Të tjerat i la. S'kish tel të grirë. Pastaj, po t'u bënte së gjithave s'kish për të sosur kurë.

Me drekë bashkë, të di palë shtëpitë zunë këngën. Njerëzia zuri e vinte. U-mbushnë pak e nga pak odatë e divanet. Sot kishin ardhur e ç'kishin ardhur. Qenë shkukur nga të gjitha anët.

Tek Mirteza agaj, graria ishin nëpër këmbë. N'atë kohë porta u-hap nga të dia anët. Hiri një hamall me çireqe në duar, një dash përpara, me nishan të kuq në ball. "Ç'është, kush e dërgojti këtë peshqesh?" pjeti njera. "Xhaxhai i djalit" u-përgjegj një nga kushurirat e shtëpisë dhe zuri këngën:

*Tori furka li e lesh,*

*Vjen xhaxhai me peshqesh.*

*Xhaxha ta paçimë hua*

*Në shtëpi të zotri suaj,*

Tek Haxhi efendi vishnin Xhemilenë nuse. Zulua i holli saden si në flori dhe e zuri nga hunda. Të martonesh shpejt. Seqineja ja uli nga fundi. I derdhur i rinte, i gjatë deri tek siri i këmbës. Përpara e kish të prerë me një jelek, të qindisur me ruaza. Tek jakaja nëna i citisi një lule të xhevahirtë. Halla i vari një benk me florinj pesë lirëshe. Në mes i dukesh nishani. I shkuan në duar bezeliquet dhe në gjisht një unazë me fron. E gjithë gurë të xhevahirta. "Po tjetrën ku e ke?" e pjeti nëna? "E kam unë", u-përgjegj Seqineja dhe hop ja vuri në gjisht. I veshnë xhurapet. I mbathnë këpucët e bardha me nga një fjongo përsipër. E vritnin se e shtrëngonin në mala. Ca i kish të ngushta dhe ca rizi me para brënda. Njera i ndreqi leshërat dhe tjetra i vuri festen me florinj. Dukesh si nuri.

Këtu nisesh e stolisesh nusija dhe n'odan tjetër këndonin:

*U nis beu për gurbet, Hanko nënj'a pse s'i flet?*

*Vuri robat në hejbet, Hanko nënj'a pse si flet?*

*Erdhi kali në avli, Hanko nënj'a, ç'bën e ri?*

*Vuri këmbën në zengji? Hanko nënj'a ç'bën e ri?*

*Kapërceu port' e avli, Hanko nënj'a ç'bën e ri?*

Dhe këto që i rinin për reth këndonin:

*Pse e mban kokënë vjerë, moj si zes' e kaço-prerë,  
Ne të dham në proto-derë, moj si zes' e kaço-prerë.  
Të dhamë burë dilberë, moj si zez' e kaço-prerë.  
Ne të dhamë Nexhip benë, moj si zez e kaço-prerë.  
Që është nga proto-derë, moj si zez e kaço-prerë.*

Pastaj në vënd që të thoshte Xhemileja e thanë ato vetë.

*Pjergulla në fik të bardhøj, pjergullo,  
Do iki të lë vatanøj, pjergullo,  
Do lë nënën' e babanoj, pjergullo.  
Do lë hallën e vëllanë, pjergullo.*

E mbaruan së veshuri dhe e krien në oda me gra. Të gjitha qenë zënë në valle. Mbajtën këmbët, pushuan për një çikë këngën. Vështruan nusen; i lëshuan vëndin. Zulusa i vente nga prapa. Ngriti nga mesi i odasë ca vajza të vogla dhe e uli këtë në një skami. Pranë i ndenji Kako-Pinua. Rin sa rin dhe i ndreqte nga një çikë festen me florinj. I vin gjishtin tek mjekra, i ngrinte kokën. Pastaj i bënte erë me elbeze. Të tjerat venin e vinin në valle:

*Dhe nigjahunë ma holle, dhe ditënë ma shënove,  
Pse s'më mer more, more Nexhip be?  
Unë kam vënë bojaxhitë, të më liejnë shtëpitë.  
Dale moj nuse, dale moj lule.*

\*  
\*  
\*

Në shtëpin e Mirteza agajt ishin nëpër këmbë. Ca thoshin që do ruhet dhëndëri dhe ca jo. Nëna don në pat dhe halla në avli. "Në avli, në avli" thoshte ajo, ata shohin të gjithë. Ta gëzojmë. Duam t' i këndojmë. Koha është e mirë. S'bën ftohët."

Nexhipi qe veshur me roba të ra. Të shtëpisë i rinin pranë. Qe nguqur në surat nga turpja. Më parë i puthi dorën babajt, nënës. Pastaj hallave, e kështu me radhë. Dolli nga odaja, të vogjëlit vu nga prapa. Te krei i shkallave tek zuri të xërmonte halla Qero iu qas. I holli duartë në qafë dhe e puthi. Nexhipi tek vuri këmbën e parë tek shkalla, holli një grusht para. U-lëshutë fëmijët. O bura kush të mirte më parë. Dhëndëri çau e ndau e me zi dolli në avli, kokë ulët. Atje e prite Huzni berberi me krehër e me gërshërë në dorë e të tjerët me këngë:

*Berberi jasht' n'oda, dolli Nexhip-beu e pa,  
Me vrap babait i tha, o baba, baba i im,  
Do berberi darovin.  
I jap unë djal i mirë, i jap grosh edhe flori.  
Un e shtie mu te porta, që të pataksetë bota.*

Nexhipi u-ul në skami. Berberi zuri ta ruante dhe të tjerët s'pushuan së kënduari:

*O Nexhip lule-lejmon, urdhëro e ri në fron.  
Të të laj e të të ndroj, të të nis dhe dhëndëro.  
Pres të mar uratëno, uratën e babajto,  
Uratën djalë ta dhaçë, ruhu dhëndëro të thaçë.*

Dolli teto Ruhua tek dera e qante nga gazi. Ustrefi kur e pa me shokë nisi këngën:

*Lulija në kadife, në kadife.  
O Nexhip i kutja je? I kutja je?  
Gjer tani isha i nënesë, tani jam i Xhemilesë.*

Berberi i prite leshrat. I hidhte livando. Dhe ata këndonin:

*Hidh o be livandono, të lieç xullufeto  
Për inat të trimave, që flënë lëndinave  
Jastëk vënë gurëtë, jorgan hedhin gunënë,  
Dishek kanë tokënë.*

Pas kësaj Muhameti nisi një tjetër:

*Gjeram sot kishe vadenë, Nexhip-be.  
Haje pije përmbi bejnë, Nexhip-be.  
Bije, slije përmbi shpelloj, Nexhip-be.  
Po veç sot e kësaj dite, Nexhip-be.  
Ti vëç veshinë shtëpisë, Nexhip-be.  
Se u-bëre vet' i ditë, Nexhip-be.  
Mot si tani vet' i tretë, Nexhip-be.  
Ta thomi me të vërtetë, Nexhip-be.*

Dhe gratë këndonin nga ana tjetër:

*Në malë të lajëthisë,  
O Nexhip kulmi shtëpisë.  
Xhivish robot e djalërisë,  
Vish robot e dhëndërisë.  
Ti ka nëna në kanistrë,  
Në kanistrë të fildishtë,  
Në sepet të telatinjtë.*

Tek këndonin tjetrën:

*Të dielë në saba, dolli fut' ergjëndija.  
Na prishi nga mëndija, na bëri për texhera.  
Texherahu te jatroj, tek një Pani Nikolloi*

*Pano Nikollo heqimi  
Të më çani të më shini, të më dalë hillërimi.  
Hillërimi më ka dalë, për një çupë që kam parë,  
Më ka nxir' e më ka tharë, më ka bërë si jongarë.  
O jongar' o dru i thatë, ç'engledis të bukuratë,  
Ato qafë fluturat, ato mes këputurat.*

E lanë përgjismë. "Ç'është? Ç'është?" pjeti një nga gratë. "Do viç tek nusija? Do viç se unë do vete". Kështu pjeteshin me njera-jetrën. Krushkat muarnë udhën, për në shtëpi të nuses me këngë:

*Ç'këndojnë gjashtë birbilë,  
Tre të verdh' e tre jeshilë.  
Çili të pëlqen moj bilë?  
Ai që këndon më mirë,  
Që ka zënë fluturillë.*

"Këndoni dhe një këngë", u-tha Ustrefi "dhe pushoni pastaj":

*Ç'bëje drunë kërcëllimë, moj leshverdha trendelinë.  
Shkarko drut' e lidh shaminë, moj lesh verdha trendeline.  
Iknë shoqet e s'të prinë, moj lesh verdha trendelinë.  
Të pres te lisi në brinjë, moj lesh verdha trendelinë.  
Ku e ke burinë t'inë, moj lesh verdha trendelinë?  
E kam zabit në Jaminë, moj lesh verdha trendelinë.  
Pse si bën haber të vijë, moj lesh verdha trendelinë.*

Mbaruan këtë dhe pushuan. Në të hirë të pazarit gratë mbërthien mirë petat përpara. Futnë duartë brënda dhe ecnë kokë ulur. Flitnin me ngadalë me njera jetrën. Kur u-afruan në shtëpin e krushkës, atje kërcite kënga:

*Dallandushe bisht gërshtë, lum nëna që të ka bërë.  
Të ka bërë përmbi shoqe, si qiparizi me koqe.  
Ulu qipariz me koqe, ati primëni moj shoqe.  
Moj shoqe moj kolonjare, diç t'ju them e diç t'ju qahem.  
Nga babai do të ndahem, e agait do t'i falem.  
Ti riç agait në gjunjë, të të vari florinj shumë.*

Dëgjuan këngën ja dhanë dhe këto:

*Se ç'mbiu një lule në ferë, asaman moj lule-verdhë.  
Hapur e mbuluar dhenë, asaman moj lule-verdhë.  
Mbuluar gjithë bashtenë, asaman moj lule-verdhë.  
Ju lule sado që jini, të parën lule kë kimi?  
Të parë trandafilënë, të ditën manushaqenë,  
Të tretënë Xhemilenë,*

“Zini një këngë për të qënë tani” tha Merushija. Njera e lëshoi zënë:

*O Nexhip lule-lejmon,  
Urdhëro e ri në fron,  
Moj muse lule lejmu,  
Moj dega vasilikua,  
Le baban eja me mua.*

dhe brënda s' e pushuan çikë këngën:

*Dhe ditën ma shënove,  
Dhe kënanë ma dërgove,  
Pse s' më mer more,  
More Nexhip be,  
Un kam vënë tavanzhinjtë,  
Të më ndreqinë shtëpitë,  
Dale moj muse,  
Dale moj lule.*

Krushkat erdhën tek porta e Haxhi efendiut. Gratë ngritnë peçetë, kapërcien prakun e portës dhe zunë një tjetër këngë:

*Bën konak moj gjeraqinë, bën konak,  
Ne u nism' e do të vimë, bën konak.  
Neve s' vimë për të parë, Xhiko muse  
As për të vënë bojanë, Xhiko muse  
Po ne vimë për të marë, Xhiko muse.*

Pa e prerë:

*Erdhëm të të marimo, o moj lule shegëso.  
Ç' sade të të biemo, o moj lule shegëso.  
Saden' e pasheshëso, o moj lule shegëso.  
Ç' kalë të të biemo, o moj lule shegëso?  
Kalin e vezirito, o moj lule shegëso.  
Avazn' e birbilito, o moj lule shegëso.*

Dhe brenda këndonin shtruar:

*Ç' jan' ata që dukeno, moj nëno?  
Krushqit e Nexhipito, moj bijo.  
Vinë të të marino, moj bijo.*

Kur dëgjuan këmbë nëpër shkalla, të shtëpisë kënduan një tjetër:

*Ç' u-mbush mali plot me rush, plot me rush.  
Thotë nënj'a janë krushq, janë krushq.  
Në janë krushq të dalino, si zezëno ta marino.*

*Ç'u-mbush mali plot me mollë , plot me mollë.  
Thotë nënj'a janë dasmorë,janë dasmorë.  
Në jan' dasrnorë të dalëno, si zezeno ta marino.*

dhe krushkat këndonin:

*Në penxhere t'ënde, se ç'këndon gjinkalla  
Nga sevdaja jote, çeli portokalja,  
Në penxhere t'ënde, se ç'këndon birbili,  
Nga sevdaja jote, çeli trandafili.*

Nga odaja e zjarit, këndonin:

*Ç'jan' ata që niseno, er e karafleso.  
Krushqitë ormiseno, er' e karafleso,  
Mos më dërgo asqer shumë, Nexhip-be.  
Se kam palënë në udhë, Nexhip-be,  
Pa ma prish ma bën rëmullë, Nexhip-be.  
Në ta priça ta ndreq unë, Moj nuse re.*

Këndo krushkat:

*Pse i mban sitë mbi mua, more djal  
Se ti mua s' ma ke hallë, more djal  
Dua roba për të dalë, more djal.  
Robotë hajzër t'i kam, eja moj aman aman  
Eja mos u-bën pishman , të kam shpirt e të kam xhan.*

e këndo të shtëpisë:

*Në mes të pamporit, zuri një furtunë  
Kokon' e Stambollit, ku vete kështunë?  
Mu te Nexhip beu, kam një çikë punë.  
Kam një fjalë për të thënë, kam një mollë për të ngrënë.  
Mollë jam e s'haem kurë, Nexhip be.  
Jam ilaç për të sëmurë, Nexhip be.*

Krushkat erdhën sipër. Panë nusen dhe i kënduan:

*Ke ballëtë brigje brigje, na ndrite nuse na ndrite.  
Na ndrite moj manushaqe, sos me gush e sos me faqe  
Sos me bukuri që pate, sos me shtat porsi bajraqe.*

Në divan këndonin:

*Nusja jonë Venetik.  
Ç' t'u-bë Nexhipi ashik, Venetik.  
Babanë ta zuri mik, Venetik*

*Nuse nga hatëri it, Venetik.*

U-puthi dorën Xhemileja. Këto këngën s'e pushuan:

*Sheg' e kuqe plot me lule, plot me lule.*

*Ç' u-këput e ra në dhe, plot me lule.*

*Vallë kush shkoj e këputi, Nexhip be kësulë kuqi.*

*Vate te port' e kalasë, duke rënë kumbarasë*

*Gjeti nusenë tek luan, luaj moj thëllëzë luaj.*

*Luaj pse të mos të luaj, mermë Nexip be kaluar.*

*Të më shpieç ku të duaç.*

Hijtin n'oda. Dhe ato i gjenë me këngë:

*Lum se ti ku do të veç, Xhemo-zonja .*

*Atje tek këndon bilbili, Xhemo-zonja .*

*Tek shkarkon Nexhip veziri, Xhemo-zonja .*

*Gjen shtëpinë me uratë, Xhemo-zonja .*

*Katërxhika gojë-mjaltë, Xhemo-zonja .*

E zunë këngën dhe këto:

*Mos u-rit vasiliko, vasiliko.*

*Se shkojnë dasmorëto, vasiliko .*

*Shkojnë e të këputino, vasiliko*

*E të vënë xhepeve, vasiliko.*

*Xhepeve, jeleqeve, vasiliko.*

Muarnë Xhemilenë në valle:

*Nusja jonë arbërore, arbërore,*

*E bardhë si qumështore, arbërore.*

*Mesi saj posi kalore, arbërore.*

*Gush' e saj si top me zborë, arbërore.*

*Faqetë si koqe mollë, arbërore.*

*Lum kush ta marë gjitone, arbërore.*

*Lum kush e mer në shtëpi, arbërore.*

*Do shkojë jet' e zoi, arbërore.*

Ja u-muarnë të shtëpisë nga goja:

*Krushka ju kemi të falë, thoni këngëtë me radhë.*

*Dhëndërin e bëmë djalë, të na hij e të na dalë.*

*Të vijë drekë për drekë, ti bëjë vjehra qoftetë.*

*Të vijë qindi për qindi, të bëjë vjehra qifqi.*

U-rëmbien krushkat. E muarnë vetë këngën këtë herë:

Nerohiti ile, ile, naha ke të keq moj bilë?  
Nga babai kam të keq, ka flori e mua s'më jep.  
Zgjedh kallbet e m'i jep mua, ç'ke baba që qesh me mua,  
Florinj të kallbe si dua, se i mar i hell në prua.

Këtë mbaruan dhe zunë tjetrën:

Ike, ike more dhenë, moj thëllëzë,  
Çave dhen' e more bejnë, moj thëllëzë.  
Kapërceve mëhalenë, moj thëllëzë.  
Kush t'i bëj babajt kafenë, moj thëllëzë?  
Unë laçë Seqinenë, moj thëllëzë,  
Që t'i bëj babajt kafenë, moj thëllëzë.

Këtë herë e zuri këngën Merushja. Vështronte nusen në si, i shtrëngonte dorën dhe i thosh:

Nuse të të thom një këngë,  
Motër mos e mer për rëndë  
Agai ka huj të rëndë  
Ai jasht e ti në këmbë.  
Ai brënda ti çiltënë,  
Me vrap ti ndërtoç kafenë.

Ja mori Zulua nga goja. Rin në funt të derës dhe reth i qëndronin të gjitha vajzat. Këndonin me gjithë shpirt si do që u-qe ngjërur zëri:

Më rite baba më rite, më rite.  
Me karvele me simite, më rite.  
Erdhi koha dhe më shite, më rite.  
Më rite more i mjerë, më rite.  
Më rëmbienë të tjerë, më rite.

Hiri Seqineja me sherbet në duar. Të tjerat këndonin:

Mbai lot e mos i derdh, moj karafile,  
Se babajtë keq si vjen, moj karafile.  
Se të dha një burë bej, moj karafile,  
Burë bej e çikë djalë, moj karafile.  
Që të gjelldiç anë mb'anë, moj karafile.  
Të haroç nën' e babanë, moj karafile.

Krushkat pinin sherbetin e fshinin buzët. Zulua me shoqe këndonte:

Ç'mbiu një karafil në derë,  
Jasht në prak të derëso, jasht në prak të derëso.  
Ritu, ritu karafil moj,



*Sa të të mar erëno, sa të të mar erëno.  
Babai që të kreu tinë,  
Ç' e gjeti të mjerino, ç' e gjeti të mjerino  
Agai që të pret tinë,  
Ç' do të hapë derëno, ç' do të hapë derëno.*

Këtë radhë e muarnë krushkat:

*Moj muse koqe-lajthi,  
Ato që thanë për ti,  
T' u-bëfçin kurban' e hi,  
Gjithë bota fjalë thanë,  
Xhiko-muse moj sulltanë,  
Ne të muarm' e s' të lamë,  
Xhiko-muse moj sulltanë*

Dhe në divan kënga ishte e pa prerë:

*Në furt të bashtesë madhe, o lejmone protokale  
Shkojnë dhëntë valle-valle, o lejmone protokale.  
Nëma një ta bëj manare, o lejmone protokale,  
Ta gjezdis male më male, o lejmone protokale,  
Ta ushqej me bukivale, o lejmone protokale.*

Kur mbaruan tjetrën:

*Pse u-thave moj bajame, bajame.  
Ja ritu, ja thau fare, bajame.  
Do të ndaj gruan e parë, bajame.  
Do ta mar Leskoviqare, bajame.  
Ato kanë naze shumë, bajame.  
Naze shum' e stoli shumë, bajame.  
Veshin robotë mbi gjunjë, bajame.*

U-mbluadhnë të gjitha të shtëpisë dhe zunë këngën:

*Fustani me tel moj lale, fustani me tel.  
Brezi me qemer moj lale, brezi me qemer.  
Të di duart plot moj lale, të di duart plot.  
Një me trandafil moj lale, një me borzilok.  
O ç' kam mall për ti moj lale, o ç' kam mall për ti.  
Të të shoh me si moj lale, të të shoh me si.  
Të kam bler me grosh moj lale, të kam bler me grosh.  
Kur kam qën sarhosh moj lale, kur kam qën sarhosh.*

Pastaj:

*O divit more divit,  
M u-duk java sa një vit,  
Java sa një vit m u-bë  
Të vi sonte natënë?  
Të më preç të keqenë  
Na muri do qepemë  
Ta di që të vritemë  
Me plumb të goditemë  
Me ti do të pëqemë.*

“Të ngrihemi” thanë krushkat “se koha”. “Të ngrihemi” tha Merushja. E kuptoi tetua e Xhemilesë dhe i foli xhiko Qibros. Motra e madhe e Haxhi efendiut erdhi në oda me një kulaç në duar. Çau vallen mes për mes dhe me Kako Pinon bashkë e muarnë Xhemilenë nga krahu. Gratë u-shtëmëngën një çikë. Në mes të odasë e mbajtën nusen në këmbë. Halla i theu kulaçin mbi kokë dhe të di copat ja vuri ndënë herë me radhë kërshi Qabesë dhe ashtu si e kish fare. Kako Pinua e fali tre herë me radhë kërshi Qabesë dhe ashtu si e kish e kreu jashtë nga odaja. Të gjitha gratë i vanë nga prapa.

Nëna e futi vajzën në odan e dimrit, gratë e të vegjëlit dualinë në avli. Teto Hatixheja e preu kulaçin copa copa dhe e ndau në të gjitha që ndërnin dorën e kush të mirte më parë. Të hanin të pakën nga një kapshatë kulaç nga i nuses, nuk të zë koka.

Krushkat dualinë me këngë nga odaja:

*Më more Nexhip më more, më more.  
Më more me të vërteta, më more.  
Me dasmë sa u-tunt jeta, më more.  
Me joli e me gërnetia, më more.  
Më rite baba më rite, më rite.  
Me karvele, me simite, më rite.  
Erdhi koha dhe më shite, më rite.  
Më rite more i mjerë, më rite.  
Më rëmbienë të tjerë, më rite.*

Duke xërmuar shkallat zunë tjetrën:

*Moj nëno si shkruaro,  
Flë apo je zgjuaro, vajzënë ta muaro,  
Mereni ju ruato, e t'ju trashëgoneto.  
Mereni ja u-dhaçë vetë, t'ju trashëgonet për jetë.  
Pa ne marim t'onato, nusen' e Halilito.*

Në odanë tjetër i vishnin ferexhenë Xhemilesë. I hodhën fundin në të parë, në kokë i vunë peçenë e pastaj i lidhnë petën. “Me javashni” u-thosh

Kako Pinua "se fmos i prishni stolitë".

Nëna qante. Vu i venin lotët nëpër faqe dhe i mblidheshin të gjitha tek mjekra si pikat e shiut. Vajza kur pa nënën qajti dhe ajo. Qante vajza se linte nënën, se linte shtëpinë e gjithë njerëzinë. E çdo gjë që kishte reth e rotull i dukesh sikur i flite asaj e i qajej pse e linte. Qante nëna se i ikënte vajza nga sitë. I vente në shtëpinë e jetës. "Mos qaj" i thoshte njera "mos qaj Xhemile se t'ikën sqafilli" dhe krushkat i këndonin jashtë derës:

*Mos na qaj nuse moj dritë, mos na qaj.*

*Se të prishenë stolitë, mos na qaj.*

*Mos na qaj nuse moj nure, mos na qaj.*

*Mos na qaj se na sëmure, mos na qaj.*

"Mos qaj Xhemile, s'bën kështu? Edhe ti si gjithë shoqet. Mbaje një sikë veten" i thoshte halla e i ndreqte fundin e ferexhesë ashtu e përçarë dhe për vete. Tetua i ndreqte kokën dhe lotët i lagnin faqet. Zulua qante e qeshte. Vetëm Seqineja rinte e s' flite fare. E vështronte në si dhe qe bërë diç e verdhë në surat.

Dera u-hap. Xhemileja e veshur me ferexhe holli çapin e parë. Ja dha prapë së qarit. E pa nëna dhe mendoj se po të qante dhe kjo do të bënesht lugat fare vajza. E mbajti veten. Xërmoi bashkë me të shkallat. Erdhën në dëndivan ku ishin mbledhur të gjithë bashkë të shtëpisë, burra e gra. Nga një anë Haxhi efendi, nga ana tjetër oxhallarët e dajkot. Xhemileja vate te babaj, i zuri dorën. Vate te nëna, i zuri dorën dhe asaj. Ajo e puthi në të dy faqet dhe babai luajti nga vëndi. Nuk i rihesh e vështronte gjithënjë nga jashtë. Tetua e Xhemilesë me një ibrik me ujë të zier përvëlloi prakun e derës. Zoti na ruajtë nga magjitë. Zoti na ruajtë nga njerzit e liq.

Xhemileja eci dhe hoqi këmbën zvarë në të dalë të derës. Të mirte vajzat e pa martuara nga prapa e të martoheshin sa më parë. Nga një krah e mbante xhaxhai i math dhe nga tjetri vëllai i vogël. Vëllai i math e prite përjashta ku hapi të di kanatet e portës mirë.

Vajza, që dilte nuse nga dera e babajt kapërceu prakun e derës, pastaj të portës, duke hedhur këmbën e djathtë më parë. Dhe krushkat i këndonin:

*Ike ike more dhenë, moj thëllëzë.*

*Kapërceve mëhalenë, moj thëllëzë.*

*Çave dhen' e more bejnë, moj thëllëzë*

*Kush t'i bëj babajt kafenë, moj thëllëzë?*

*Unë laçë Seqinenë, moj thëllëzë.*

*Kush t'i bëj hizmet si ti, moj thëllëza në kuvli?*

Duke ecur ngadalë erdhën tek sheshi i vogël me këngë:

*Mir ç'ja bëmë krushkësë,*

*Q'i muarmë vajzënë.*

*Ballën e fëmilësë,  
I shëmtuam derënë  
Zbukuruam t'onënë.*

dhe të shtëpisë që kishin dalë tek porta duke qarë e duke fshirë sitë me jemeni ja u-kthien:

*Mereni ju ruatë  
E ju trashëguatë  
Po ne kemi t'onatë  
Nusen e Qemalitë.  
Mereni ja u-dhamë vetë  
Të trashëgonet për jetë.*

Me zi u-dilte zëri. Ato mbaruan dhe krushkat nisë tjetrën:

*Telet e kordheleto, Xhiko nuse,  
Haro përkëdheleto, Xhiko nuse,  
Se këtu s'të shkojëno, Xhiko nuse,  
Se kjo udhë ka zahmet, Xhiko nuse,  
Të ngrihesh që në mëngjes, Xhiko nuse,  
Të vëç futënë në mes, Xhiko nuse.*

Krushkat u-larguan nga sheshi i vogël. Zulua me Seqinenë me to bashkë. Donin ta shpinin Xhemilenë gjer në shtëpin e burit. Nga porta e Zulos, nëna e saj mbante një pasqirë në dorë dhe "dritë u-duktë nusja, dritë u-duktë nusja. Dritë herë me radhë.

Krushkat u-larguan e nga pas Hedo evgjitja me sundukopullo ndënë squetull.

"Teto Qibrua, hallat, tetot kishin mbetur tek porta e qanin. Shinin vajzën që largonesh dhe ca gra që kishin mbetur ati kënduan për herë të fundit:

*Moj ç'të thaç' e ç'të porosita, bila ime  
Moj na kali mos xërmo, bila ime.  
Më xërmojnë me pahir, nëna ime  
Ata janë zotërinj, nëna ime  
Më gënjejnë me florinj, nëna ime.*

Krushkat nuk dukeshin më. Nëna me kokë tek muri qante e qante. Pas një çikë e ngriti e me kunata e motra zuri të hinte brënda po nuk i bënin këmbëtë. I dukesh avlija e shkretë. Muret sikur dhe ato largoheshin. Shtëpia dukesh e vogël e sikur po humbite nga që nuk dëgjonesh asnjë zë. E ato pemë në kopsht pse ishin ashtu pa fletë? Ca të paka? Sikur qenë më shumë ca ditë më parë? Jo, jo. Qe dasmë e çdo gjë këndonte, po tani që iku vajza nga shtëpia s'u-mbaheshin më lotët. Së largu dëgjonesh avazi këngës:

*O shoko more shoko  
 Dhënt e mija kush i do  
 Do t'i shes të shkretato  
 S'kam kush të vejë me to  
 Do të ri me nusen.  
 Nuse qafë tre pëllëmbë  
 Te porta të shkova prëmë  
 Me gjalmë ta lidha qënë.  
 Gurë mbi shtëpi të holla  
 Edhe qenin ta helmova.  
 Dolla te dera të fola  
 Të fola s' më fole fare  
 S'më lanë more s'më lanë,  
 S'më la nëna me babanë,  
 Shtriga hallë me vëllanë.*

Ca gra të paka mbetur pa vatur me nusen bashkë i u-afruan teto Qibros. E uruan dhe një herë dhe muarnë udhën për në shtëpi të ture. Dëgjonesh avazi i këngës që vinte nga ana tjetër. Krushkat kishin ndruar udhën. Xhemileja ecënte me ngadalë. Në dorë mbante një umbrellë hapur. Ecënte dhe mirte frimë thellë. I dridheshin këmbët. Gratë këndonin:

*Më kërkon një bej në portë,  
 Thom ta mar,  
 Thom mos ta mar,  
 Më thonë që lot kumar,  
 Nuk e dua, nuk e mar  
 Nuk e dua nuk e mar  
 Trimatë ashtu e kanë,  
 Ashtu e lozën kumarë,  
 Mere lule mos iu nda  
 Mere lule mos iu nda.*

Teto Qibrua akoma e dëgjonte këngën. S'i bënin këmbët të hinte brënda. Qante e i dukesh shtëpia e shkretë. Një javë këngë e valle dhe tani s' dëgjonesh as një zë. U-mbarua dasma e vajza u-muar. Shut nga të katër anët. Vajza u-martua dhe nëna u-gëzua po tani i dukesh sikur e shiti. Iku vajza nga babai, iku vajza nga nëna. Kënga u-pushua, dasma u-mbarua dhe krushkat udhës këndonin:

*Nga na vjen andej-këndeje, moj nuse re  
 Humba udhën e s'e gjej, o Nexhip be.  
 Ç'më jep mua të ta dëftoj, moj nuse re?*

*Ballin e qindisuro , o Nexhip be  
Për ti e kam nisuro. o Nexhip be.*

Teto Qibrua me kunata dhe me motrat u-fut brënda. Odatë, divanet dukeshin rëmullë. Nëna ngrinte një gjë, ngrinte tjetrën dhe qante. Po krushkat këndonin udhës se kishin nusen me vete:

*Frijti era të vërviti, Xhiko nuse,  
Të vërviti nga xheneti, Xhiko nuse,  
Në derë te huqumeti, Xhiko nuse.  
Pa pastaj mu te Nexhipi , Xhiko nuse.*

Këndonin dhe s'pushonin çikë:

*Në kafas të penxheresë  
Ç'frin' një er' e ç'bin një vesë,  
Kish dalë zonja bashtesë,  
Përmblihd trandafil me vesë,  
Ç'i do ato trandafilë?  
Të gënjej at' bandillë  
Të gënjej dhëndërin  
Nexhip gojë shtrëmbërin.*

Xhemileja ecënte ngadalë. Xhaxhai i la vëndin nipit të math. Tani e kishin nga krahu motrën di vëllezërit. I dukesh akoma sikur ishte si në shtëpi të saj. Nuk qante po hidhte çapet si e dehur. Hidhte çapet e mendonesh. Jolitë binin përpara dhe graria këndonte:

*Preva fik e dolli molla  
Të bukur nuse që more.  
Krushq e daulle përçolla  
Mora llambën e të shikova.  
Ç'më shikon more i mjerë  
Si e vetull s'ma ke blerë.  
Ta kam bler' si s'ta kam blerë,  
Ta kam bler' me lir të verdhë.*

Erdhën në mes të udhës vëllezërit e lanë motrën, Ustrefi me xhaxhan e Nexhipit e muarnë nga krahu. Krushkat këndonin:

*Nexhip me jelek të verdhë,  
Florinjte gjirit tu derdhë  
Del nusija t'i përmbllë  
Ti shkojë vergje në qafë  
Të dalë zonja në dasmë  
Të thonë cila është ajo,*

*Nuse Nexhip beuto,  
E bukur e dheuto,  
Ili shënëndreuto.*

Ec e ecë e s'kish të sosur. I ranë prapa e prapa bashtesë së Teqesë dhe kënga s'pushoi çikë. Burat me futa të mëndafshita rinin prapa e përpara. Kudo që kalonin gra dilnin nëpër penxhere, nëpër portëra, mbi mure. Tek Mirteza agaj marin nusen thoshin. Krushkat largoheshin dhe këto ktheheshin në punën e ture.

Duallnë në udhë të hapët, me këngë:

*Hipi bufi mbi goricë,  
Zimbile-zimbilaqe,  
Koqe-margaritare,  
M'e mirë nga xhiko bufi,  
Zimbile-zimbilaqe,  
Koqe-margaritare,  
M'e mir nga xhiko kunata,  
Zimbile-zimbilaqe,  
Koqe-margaritare.*

Iu afruan shtëpisë. Atje brënda ziente kënga. Odatë ishin plot sa s'kishe ku të hidhje mollën. Grave koka kish mbetur jashtë. Kur panë krushkat në funt të udhës, zunë këtë këngë:

*Bram bëri dufeku,  
Prapa atij bregu.  
Dil moj nënë dil,  
Dil të bëç sehir.  
Se ç'të pruri djali,  
Nexhip kanakari,  
Zogën e beharit,  
Thëllëzën e malit  
Bie shiu me kënatë,  
na zuri nusenë jashtë.  
Shiu me pika t'ergjënta,  
Nuse mos t'u-laktë këmba  
Sa të hiç në saraj brënda.  
U-lage muse u-lage  
Jo, jo, jo, nënë s'u-laga,  
Keshë efendinë pranë,  
E më holli mushamanë.*

Të vegjëlit nëpër shkalla njeri pas tjetrit duallnë jashtë. Gratë lanë kuvëndin

dhe duallnë nëpër avli. I tillë kallaballëk s'qe parë gjëkund. Të mos qenë shtëpitë të ra, për Allah qenë për të thier dishemetë. Të shtëpisë duallnë tek dera me këngë:

*Prina baba trimi prina  
Se vjen Ustrefi me trima.  
Prina nënë krushkë prina.  
Se vjen xhikua me trima*

Nusja vinte në shtëpi dhe Mirteza agaj rinte në këmbë tek praku i portës me tas në dorë. E kish mbushur me riz' e me para. Kabardisesh. Fanella përpara i dukesh e bardhë shkumë. Mëngët e kondosë i kish të gjera. Tek xhamadani i varesh qosteku. Boturet e zeza i rinin mirë. Brezin e bardhë e të leshtë e kish rotulluar tre herë pas mesit. I çquanin gajtanet. Dizbait e kuqa, lidhur tek gjufi dhe kalcat i kish nga më të mirat. Këpucët, me kapak të drejtë i rinin pas këmbës. Ven e vin tek porta. Nusja kalli këmbët dhe vjehri i holli rizin mbi umbrellë. Djemtë, kush të futesh më parë, të gjenin para. Me zi i larguan sa të shkonte nusja. Ajo holli këmbën e djathtë kapërceu prakun e të shtëpisë i kënduan:

*Ku na kalle këmbëto, Xhiko-nuse,  
Të rafçinë dhëmbëto, Xhiko-nuse.  
Dhëmbët e dhëmballëto, Xhiko-nuse.  
Eshtrat' e kokallato, Xhiko-nuse.*

Hiri nusja në avli. Nexhipi qe në konak me bura. S'bën të shihte Xhemilenë atë kohë.

Erdhi nusja tek dera dhe teto Hasibeja e mori nga krahu. Tek praku, i futi gjishtin tek tasi. Ja ngjiejti me mjaltë e ja fshiu te mbi dera. Mjaltë pastë gojën nusja në shtëpin' e burit. Shkoftë me të gjitha.

Të gjitha pritnin nëpër këmbë. "Ku është nusja?" pjetnin. I humbi nga sitë. Atë e kishin futur në një oda. Atje i hoqnë ferexhenë. I vunë duvakun, mantin i kuq në kokë dhe i mbuluan suratin. I ndreqnë sadenë përpara dhe pastaj e krien andej. E shpunë në odan e mirë. Te dera e odasë i prenë kulaçin. E falnë tre herë me radhë, si në shtëpin e babajt. Pastaj teto Nexhmijeja e shpuri në krie t'odas dhe e la në këmbë. Kako-Pinua i rin pranë. Nusja nusëronte me duvak. Të gjitha i këndonin:

*Dolle nuse dolle  
Na ato kasolle  
Hire nuse hire  
Në këto sehire.*

Erdhi Mustafai në oda me di okllai në duar gjithë shamatura. Gratë këndonin:



*Lum ku erdhe ti, moj hëna flori.  
Në di par shtëpi, moj hëna flori.  
Janë zotëri, moj hëna flori.  
Në di palë shkalla, me di par' avli.*

U-afrua më shumë djal' i zonjës Merushe. Ndënji përpara nuses.  
Nëna e ndihmoi dhe ai i ngriti duvakun me të di okllaitë. Gratë kënduan:

*Lahe lahe hilalla  
Thoni gjithë mashalla.  
Mashalla nuse që je.  
Shtat e surat që më ke.  
Për mbi gjitha shoqetë*

I u-duk surati nuses. Sit' e saj të zesa pisë i mbante ulur në dhe. Hunda e saj e bukur i dukesh si qiri. Të gjitha e vështronin dhe shtinin njera-jetrën e donin të dilnin përpara, ta shinin më mirë dhe i këndonin:

*Nusija që vjen këtu, bie shkop ndënë duvak.  
Të përzëjë miq e mika, xhikora e katënxhika.  
Pa në qofç e mira, jonë, Xhiko-nuse.  
Bash odanë ta lëshojmë, Xhiko-nuse.  
Nexhipin do ta dërgojmë, Xhiko-nuse.  
Mashalla nuse që je, mashalla shtat që më ke  
Mashalla gjozdejmesën, që s'na vate dasma dëm.*

S'kishin mbaruar mirë këtë këngë kur teto Ruhua hiri derën, "Dritë nusja" tha me zë të lartë, "dritë, dritë nusja". Vate në krie. Ajo i zuri dorën dhe katënxhika e puthi në të di faqet. Të tjerat këndonin:

*Moj vjehrë moj kanerinë  
Ta mbushi nusija sinë?  
Ma mbushi për Perëndinë,  
Do të më ndriti shtëpinë.*

Ca gra duallnë nga odaja. Të tjera hijtin e teto Hasibeja këndonte pa u-lodhur:

*Merushe mos u-splinis,  
Nuse Nexhipit t'la bisht.  
Le më lërë pras e qish.  
Edhe un' ashtu e dua,  
Që të jetë përmbi mua.*

Zuri të saj në Merushija:

*Nusija e vogëlo, e vogëlo.  
Agai ashtu e do, ashtu e do*

*Për kafe e për gliko, ashtu e do  
Që t'i presë shokëto, ashtu e do.  
Që ti fshijë odëno, ashtu e do.  
Që ti shtrrojë sofrëno, ashtu e do.*

Pastaj me buzë në gaz nisi tjetrën:

*Moj nuse moj mes kalore  
Lunja ti se ç'burë more  
Babanë se poshtërove  
Po më lart e lartësove  
Hodhe mollën dhe e zgjodhe.*

Në divan:

*Pse i mban sitë në dhe, moj faqe protokale.  
Turp t' vjen a frike ke, moj faqe protokale,  
As turp e as frikë kam, ja vjehrënë tek e kam.*

Zunë graria t'ikin. Të largëtat hodhnë ferexhenë shpejt' e muarnë udhën për në shtëpi. Kur mbenë vetëm të ftuarat, hiri prapë n oda Mustafai. Vate te nusja, i kreu këpucët dhe i veshi një par sheshëla. Me të vatur andej, shpejt zbrazë ristë, mori paratë dhe me një herë i futi në xhep.

N'oda këndonin:

*Motë mot' e gjism viti,  
Duheshmë, njeri s'na diti.  
Dhe një plakë që na diti,  
Dhe ajo s'na martorisi  
Në xhenet i vafitë shpirti*

Edhe në avli kërcite kënga:

*Zura një mike sulote, naze naze puna jote.  
Me një mes posi janjote, naze naze puna jote.  
Leshverdhë si kardhiqote, naze naze puna jote.  
Me gajtan ja mata mesë, naze naze puna jote  
Në Janin i porsita brezë, naze naze puna jote.*

Hiri derën Merushja dhe vate në krie të odasë. Me dorë ndreqi okllaitë tek muri, shtrojti sixhadenë dhe e uli nusen mbi di jastëqe të kokës.

Përposh punonin. Mishrat kishin ardhur nga fura. Bejekua u-për cëllua tek zjari duke gatuar. Mezetë që bëneshin në qilar njera pas tjetrës venin në konak tek burat.

Gratë me futa përpara venin e vinin herë në qilar dhe herë sipër. Kudo

punë. Sufratë do shtroheshin, darka do haesh dhe teto Qibrua me haps në bres ven e vin dhe jepte kumandë. Ajo kudo në këmbë, në qilar, sipër, përposh, në oda të juqeve. Lipsët ajo, e jep kjo. Mungon gjëri e kre nga dollapi. Sipër kënga vente shtruar:

*Moj hunaza me tre gurë,  
S'të vente në mënde kurë,  
Të mirje të tillë burë,  
Të mirje të tillë djalë,  
Një lirë e ka një fjalë.*

Sufrabezët u-shtruan në shesh dhe sufratë u-vunë, mbi to. Di në patin e math dhe një në patin e vogël. Dhe të tjera në divan. Teto Hasibeja erdhi përposh, kreu bireçet e bakllavatë. Merushja mbushi sahanet me kabuni. Të tjerat hidhin gjellët nëpër sahanë.

Natë, një erë e ftohët frin jashtë e tunt pemët e kopshtit. Këmbë dëgjohe nëpër avli. Hismeçitë venë e vinë me gjëra nëpër duar. Djelmuria ka zënë lodrën te porta. Vajzat e vogëla janë nëpër këmbë dhe sipër dëgjohe një këngë e ulët:

*Moj kunadhija leshverdhoj, leshverdho.  
Dimëron përtej në shpëlloj, leshverdho.  
Në shpell' e në shtëpi tënde, leshverdho.  
Na lajkose me kuvënde, leshverdho.  
Na ktheve në besën tënde, leshverdho.  
Besajote, besë qëne, leshverdho.*

Nusja ngrihesh në këmbë sa herë që hin e dil njeri. Ulesh në shesh vetëm kur i thoshte Kako-Pinua ose ndonjë e shtëpisë. Dhe atëhere me zi e si ti thoshje një milë herë "ulu ulu nuse". Mirë e kish. Pse ta mirmin në gojë njera e tjetra? Si kishin bërë gjithë ashtu bëri dhe kjo.

Iku dhe kjo ditë. Nusja erdhi në shtëpi. Tani atë gëzonin dhe për atë këndonin. Këtu gjëmonte kënga dhe te Haxhi efendiu kishin mbetur pa njeri. Akoma u oshëtinin veshët. U dukesh sikur këndonin. U dukesh sikur Xhemileja do të hinte derën. Po ajo ishte lark, në një shtëpi tjetër. Tani nusëronte dhe rinte në krie t'odasë. Njerëz të tierë i rijnin reth e rotull. E hante nga një çikë sitë. Vështronte dhe të tjerat i këndonin:

*Nusija na hapi sitë,  
Na vështroj gjithë shtëpitë,  
Se nusija s'i kish parë,  
S'kishte hir' e s'kishte dalë*

Gratë mbaruan këngën dhe zunë kuvëndin kokë më kokë. Ca vajza të vogla hijtin derën. U-afruan nënat dhe u-thanë në vesh se shtroheshin sufratë, me

gjellë të mira. "Ka edhe birek" thosh Manushaqja vogël "do të ha di thela".  
"Pusho" i foli "se është turp" dhe e uli pranë vetes.

Kako-Pinua hapi penxherenë që kish pranë dhe vështroi një herë jashtë. Pastaj i foli në vesh nuses. E ajo uli sitë vetëm. Andej dëgjoneshin gratë që këndonin. Pritej të hahesh buka.

## NAT' E DHENDERIT...

Darka, të ftuarat vanë për të ngrënë. Me to bashkë edhe Kako-Pinua. Nusja mbeti n'oda. Afër saj u-ul Merushja. E pjeti në se donte gjë. Ajo tundi kokën që jo. Tani vështronte nga një herë dhe lëvizte nga një çikë. U-lodh. Kish gjithë ditën që rin si e karfosur. Gratë hangrën bukë përposh dhe erdhën sipër. Nusja u-ngre në këmbë. U-mbluadh në të gjitha dhe me një herë zunë këngën:

*Zoti që moj nuse zonja,  
Zoti që të jaratisi,  
Qe në nge moj nuse zonja,  
Qe në nge që të stolisi.  
Me kalem moj nuse zonja,  
Me kalem të zografisi.  
Gjoksi jot moj nuse zonja.  
Gjoksi jot tre ok' ergjëndi.  
Duke që moj nuse zonja,  
Duke që je bilë nëne  
Si ili që del pas hëne.*

Tani e zunë këngën dhe s'e lanë më:

*Dhelpëra, dhelpëra,  
Përtej në arë.  
Drill bisht  
E bën kordhele.  
Moj kujt ja bën ato naze.  
Nexhipit, Nexhipit  
Që s'ka çapraze.  
Kur të vejë, kur të vejë  
Gjithë naze.  
Kur të vijë, kur të vijë  
Me çapraze.*

E pas kësaj:

*Luan, luan dhelpëra  
Në grur e n'elhëra  
Drillet e përdrilleto  
Jalla ç'jam e bukuro  
Si nuse Nexhipito.*

kështu me radhë:

*Ç' të të thom moj nuse motra,  
Ç' të të thom ti e di vetë.  
Si nderohen moj nuse motra,  
Si nderohen të mbëdhenjtë.  
Me pirun moj nuse motra,  
Me pirun e me peçetë.*

Ne konak burat hanin meze dhe këndonin. Ustrefi dhe Muhameti qenë nëpër këmbë. Kishin punë për gjithë natën. Strapeci stravec. Sahanet me qofte dhe me mishra të pjekura sa viheshin të plota në mes të sinisë zbrazeshin me një herë. Mustafaj i vogël qe futur në bura. Qe ulur tek gjunjët e babamadhit. Ai nga një anë këndonte:

*Ditën e Shën Kollit, prisha panairë,  
M' humbi hunaza, me gur xhevahirë.  
V'allë kush ma gjeti, bakhshish ka një lirë,  
Çupa nga Përmeti, martuar Hoshtëve  
Te Kallo Qirjaku, derë proto-derë.*

dhe me dorën tjetër mbushte grushtin me bajame të zbardhura e ja vinte djalit përpara. Në funt t'odasë qenë ulur jolixhinjtë. Ali evgjiti, i zi nga surati i bin gëmetës dhe ja kthente me griqë. Rapo evgjiti me si gjismë të mbidhura duke ngritur gëretën lart ja mirte i diti. E Lilija, me sitë që i lëshonin shkëndila i bin qemanes. E dam defit Filia, sa i vareshin balukat në balle, e i zinin sitë. E tundesh dhe vetë herë përpara e herë prapa. Shemija afër derës, i bin qemanes së madhe. Të gjithë këndonin me burat bashkë:

*Ç' mi ke ballëtë me lule,  
Moj bardhule.  
Luleto jepi hua,  
Ballëno nëma mua.  
Luleto jepja dilberit,  
Ballëno mua të mjerit.  
U më ke faqenë me lule,  
Moj bardhule.  
Luleto jepi hua,  
Faqeno nëma mua.*

Luleto jepja dilberit,  
Faqeno mua të mjerit.  
Ç'më ke gushënë me lule,  
Moj bardhule,  
Luleto jepi hua,  
Gushëno nëma mua.  
Luleto jepja dilberit,  
Ballëno mua të mjerit.

e binin jolitë. Mirteza agaj, lagu një tallëro. Ja kolisi në ballë Ali evgjtit. Pas tij edhe Shaqir efendi një beshllëk. Ç'i mbaje evgjitet kur në odanë tjetër udëgjua një xhavallozmë. Ferdi agaj qe bërë xurxull dhe shante Xhafer efendinë. Të di të pirë. Fol njeri e fol tjetri. Hijtin të tjerët dhe i ulën. I shpunë nëpër odara të ndrishme. Se kudo që piqeshin këta të di, çkrenin inatet e shkuara.

U-uhnë gjakërat dhe kënga u zu prapë:

Në malë të malito  
Trendelina zariko.  
Lulet e beharito,  
Trendelina zariko.  
Eja o behar ku je,  
Të dergjemi n'ato qe.  
N'ato qe, n'ato bashte,  
N'ato bashte plot me mollë,  
Ato mollë ç'qenë t'ëmblla.  
Qen di vajza griqë-zëna.  
Të mbuloninë me mënga.  
Me mëngat e sqetullavet,  
Të keqen e vetullavet.  
Vetullatë pse t'u-rxinë,  
Apo ke vënë mazinë?  
Jo, jo, jo, për Perëndinë,  
Po kam vetë bukurinë

Në gra hiri teto Hasibeja me Nezaqetë nga dora. Ajo ishte veshur me një sade të kuqe gjithë fruda. Në kokë, lidhur një pikë fjongo. Me zi i dukesh surati. Ecënte me turp. Fshihesh prapa nënos. "Hë" i thoshte kjo "se nusja do të të puthë dorën". Duke folur vanë të dia përpara nuses. Ajo i puthii dorën. Kako-Pinua i dha vajzës një jemeni të kokës. E po teto Qibrua zakonet ja bëri vajzës gjer në një ç'e mbaje Nezaqetin. Sa qe n'oda brënda rinte rëzave po sa dolli në divan u-mburesh shoqeve. U-dëftonte peshqeshin. Ato sa afroreshin ta shinin hop kjo e fshihte prapa klahave. I pëlcite. Ja u-bënte pizili.

Gratë n'oda këndonin:

*Kam di net' e sonte tri, un' e mjera.*  
*Kam rënë në silloi, un' e mjera.*  
*Si do bëj në këtë shtëpi, un' e mjera.*  
*Me këtë dhëndër të ri, un' e mjera.*  
*Babaj më bënë pors, un' e mjera.*  
*Çupë mos flaq me njeri, un' e mjera.*  
*Ti mbaç motë mot mëri, un' e mjera.*

Shkoi dhe një copë here. U-bë sahati di i natës allaturka. Hismetçinjte nga një herë dukeeshin nëpër dier. Evgjitkat plotë pëqitë, krolla me bukë e me mishëra venin tek porta. Atje i printe ose ndonjë i shtëpisë. Ç'të bënin. Me dasmë bashkë hanin dhe to.

Zëra u dëgjuan dhe ca fenerë dukeshin nëpër avlira. "Burat... dhëndëri... po burrat janë, ata..." Sipër n'oda e muarmë vesh. Të gjitha u ngrenë në këmbë. Nuset që kishin vjehrat me huje, burat hujli duallnë jashtë nga odaja. Ç'ti dëgjoje pastaj. "Pse i dolle burit të botës, Ç'e kishe ti. Po, kështu doni ju të mireni në gojë". Një e shtëpisë ndreqi minderet dhe lëshoi vëndet afër nuses. Vinte dhëndëri me njerzit e tij. As një zë në oda. Të gjitha pritnin me gojë hapët. Merushija ngriti nusen në këmbë. I hollu duvakun në surat. E vështroi mir' e mirë nga koka gjer në këmbë. I ndreqi jakanë, bengjet me florinj. I kreu bezeliquet mbi mëngën e sades. I tendosi mirë jastëqet, ku qe ulur nusija më parë.

Burat erdhën në funt të shkallës. Nexhipi qe përpara dhe shokët prapa. Hoxha i rin në krah dhe i këndonte duanë arabisht. Me zi mbaroi. "U-trashëgojtë" i thanë. Nexhipi u-nguç nga surati. Holli ca çape. Mori qirinjt e llezur nga dora e Mustafajt dhe tek vuri këmbën në shkallën e parë shokët e zunë me dumka. Iku me të katra. Ashtu me vrap erdhi tek der e odasë. Një i mori qirinjtë nga duartë. Hiri brënda. Nuset i ngritnë duvakun. Kako-Pinua e nduki nga prapa e i dha të kuptonte se ki ishte dhëndëri dhe mos ti puthte dorën si të tjerëve.

Nexhipi u-ul karshi nuses me kokë ulur. U-mbush odaja me bura. Të gjithë këndonin:

*Ana pemë të këndojmë, dhëndëro,*  
*Nusenë të ta gëzojmë, dhëndëro.*  
*Pa pastaj të të urojmë, dhëndëro.*

Ustrefi zuri një tjetër:

*Ti Nexhip që ri në odë,*  
*Pse s'bën muhabet me shokë*  
*Se nusen e ke si zogë.*  
*Dhe zogë të mos të ish.*

*Muhabetë mos e prish.  
Dhe zogë të mos të qe,  
Muhabetë mos e le*

Teto Ruhua me kunata puthi Nexhipin. Merushija nga ana tjetër holli një çikë endë në tas dhe futi qirinjtë e llezur. I ndreqi mirë. Ashtu si qenë i vuri mbi sergjen. mbi kokën e nuses. Tek u-ndër për një çikë shkau. I mbeti këngë përgjismë. Të tjerat ja mbaruan:

*Pse ri zëmëruaro, kanakari dhëndëro?  
Mos të shajtin nusen, kanakari dhëndëro.  
Esht' e mir e zgjedhuro, kanakari dhëndëro.*

I halla, tha dhe ajo të sajnë:

*Dolli hëna për kusarë, dil moj hënë.  
Vodha çantën e katiut, dil moj hënë.  
Ja shpuri Nexhip be kriut, dil moj hënë.*

Pastaj:

*I venë lotët rëke, tarnana ternene.  
Pse s'ja fshin o Nexhip-be, tarnana ternene.  
U ja fshi, po s'kam me se, tarnana ternene.  
Me mëngën' e dorëse, Nexhip-be.  
Çervën e pisqollëse, Nexhip-be.  
Esht' e holl' e griseto, kllabodon kseftiseto.  
Qindis nëna tjetëro, për Nexhipn' e vetë.*

Dhe këtë:

*Bubulline malet, ja lele, ja bobo  
Plasnë manushaqeto, ja lele, ja bobo  
Vallë kush na ri mbi to, ja lele, ja bobo  
Nexhipi me zonjëno, ja lele, ja bobo.  
Me atë boj hollëno, ja lele, ja bobo  
Të kuqe si mollëno, ja lele, ja bobo  
Të hardhë si zborëno, ja lele, ja bobo*

U-ngre Nexhipi. Pas tij të tjerët. Vanë prapë në konak. Pleqtë pinin dhe këndonin:

*Pa dëgjoni ju meçlis,  
Diç t'ju thom. ç'iu mollois,  
Mëndija m'u-çakërdis  
Tek një vajzë m'u-kondis.*



U-uhnë dhe këta në tok, me të tjerët. Në oda të grave nusija xërmoi nga krei, u-zuri dorën së gjithave, sa qenë ati. Pa Merushen, që hiri derën me tepsi me sherbet. I doli përpara. Ja mori nga duartë. Ja u-dha tëk e tëk së gjithave e me frikë se mos i derdhesh sipër. Eci nga prapa dhe ndënji në funt t'odasë, sa ta pinin. Në funt mblodhi filxhanet dhe sa holli çapin e parë. Manushaqija, kushurira e teto Ruhos, ja mori tepsinë nga duartë. Vate andej dhe gratë në valle këndonin:

*Do të heq një valle nure,  
S'kam fustan po me poture.  
Mos më qeshni shokë juve,  
Se un' jam çoban i ri,  
Jam ritur në erimi  
Pa kandile, pa foti.*

Zunë një tjetër:

*Thieju moj disheme  
Të bën Nexhipi të re  
Me xhame me çerçive.  
Thieju more divan,  
Të vë Nexhipi dajan.*

Teto Ruhua qeshte me to. Teto Haxhua kish zënë vënt në një qoshe dhe kuvëndonte me një plakë. Se ku e kish psunisur atë rokozhinë! Teto Xhevrua, nga rin falesh. Zakoni. E ka huj në shpirt. Se mos e do dhe ajo. Të ratë zunë një tjetër:

*Thaçë një,  
Do të thom dhe njëzë  
Zuri korbi një thëllëzë.  
Ç'e do korb atë thëllëzë?  
Të loz e të qesh me tëzë.  
Si e mer e ku e shpie?  
E shpie në shtëpi t'ime.*

Teto Xhevrua gogësi. Uli jemenin e kokës, luajti nga vëndi se rinte liksht. "Mindere zeza me bar" thosh me vete "të vrasin". Si s'ka një të zezë çilte. Mumulljakë kjo zonj e shtëpisë. Ka frikë se mos t'i prishen. I ka qçitur me dizet palhapse". U-përmënd mirë plaka. Pa gratë. I vështroi si e çuditur. "U... ja bëri e pse s'këndoni? Ç'bëni?" "Ou u-zgjove?" ja plasi gazit Haxhua. Eshtë pishë-vënë. "Thuaj tani që s'tjete fare. Nuk zihemi në valle dhe ne plakat një herë. Ta tundim. Të patakshen këto të ratë". Ktheu kokën nga ana tjetër dhe ja bëri me gjisht Nezaqetit. "Ik biro" i tha "ikë foli dhëndërit të vjijë këtu. Thuai që të do nëna, se ka një fjalë. Kështu de. Pse si të ngordhura? S'është as

ramazan që të thomi se jeni të agjëruara.”

U-ngre në këmbë teto Haxhua. Mori nga dora teto Xhevron e grap teto Ruhon. Në atë kohë e sipër hiri Nexhipi n'oda. Vunë dhe nusen e dhëndërin pranë e pranë dhe zunë këngën:

*Se ç'ka hije vallija,  
Ç'është zënë nusija.  
Ç'tundetë fodullija,  
Se ka burinë në krah.  
Tundu moj fodulle tundu,  
Tundu moj se ç'të ka hije.  
Posi dielli kur bije,  
Si hëna në mes të ile.*

Pastaj e nisi vetë teto Ruhua:

*Trandafili fletë-fletë,  
Ç'i do Nexhip kadifetë?  
Dua muse si jam vetë.  
Si je vet, ashtu e ke.  
Nexhip-be o Nexhip-be.  
Një çikë m'i mirë je,  
Nexhip-be o Nexhip-be.*

A ma kështu është? E po dale:

*Nusija e mirë e mirë,  
Dhams e feks posi pasqirë,  
Dhëndëri si kec i shtirë.  
Nusija kallëp sapun,  
Dhëndëri surat majmun.*

Don t'ikënte Nexhipi po këto s'e këputnë këngën:

*O Nexhip ç'u-pashilove  
Pse u-vjase, ç'u-martove.  
Hamdiu që s'u-martua,  
Më shumë u-zbukuria.*

Edhe një tjetër:

*Me kadale vallenno, more çelo.  
Dalezë kadalezo, more çelo.  
Se ngrihetë pluhuro, more çelo.  
Të fëlliq dozduqeto, more çelo.*

e lanë këngën:

*Tir tir moj valle madhe,  
Ngreu Nexhip luaj valle  
Në mos fort po me ngadale.  
Mer dhe nusenë nga dora  
Në mos dashtë që të lozë.  
Hille në mustuk si rosë,  
Të lozë si bretëkocë.*

U-ngre Nexhipi dhe iku. Tek xërnoi përposh, nëna e ndoqi nga prapa. Nëpër shkalla u-ljalosën bashkë. Të di vanë në konak. Atje odatë qenë mbushur me tim. Me zi shquanin njeri nga tjetri. Paf puf venin të gjithë. Teto Ruhua s' hiri derën po u-ngjit në dhipato ku qenë dhe gra të tjera. As njera s' flite se kishin frikë se most i mirin vesh q' ishin ati. Ku futeshin pastaj. Nga prapa kafazeve vështronin brënda. Xha Ivziu në krie t' odasë, nisi këngën:

*Kur bëje sokakë tutje.  
Tunde moj Qerime tunde,  
Tunde moj xhokenë tunde,  
Tunde të shkretënë tunde.  
Të digjesh muri në supe,  
Tunde moj Qerime tunde,  
Tunde moj xhokenë tunde,  
Tunde të shkretënë tunde.  
Jo me kraha po me supe,  
Tunde moj Qerime tunde,  
Tunde moj xhokenë tunde,  
Tunde të shkretënë tunde.*

Nga strapeci tjetër dëgjonesh:

*O moj pata pjesë pjesë,  
Të vran o Pasha në besë.  
Të vran o qent' e pa besë.  
Shanishaja ulëriti  
Treqint taborë i ngriti.  
O moj, simi e florumjtë,  
Ç' i ushqen ata jezitë  
Kur s' i ke për këtë ditë.*

E shkurtër kjo. Zunë një më të gjatë:

*Moj Gjirokastra me vulë,  
Ç' e bëre Shemo hajdunë?  
Moj në grackë se ç' e zunë  
Njëzet e di topa shtunë*

*Që zunë Shemo hajdunë,  
Lidhur ne Janin e shpunë.  
Pasha të të thom një punë  
S'më vjen keq sepse më zunë  
E bëra si desha unë.  
Vrava turk, preva kaurë  
Vrava Muhedinë vulë.  
Që kur vrava Muhedinë  
Nuk më vajti timi mirë.  
Janino të erdhi biri  
Hiri brënda tek Mushiri  
I tha djal' ku e ke bananë,  
Hajdut e kam në Trihallë  
Lufton me Huzni pashanë.  
Primë Huzni pasha primë  
Të shoç Shemo mjekër zinë  
Të shoç se çë bën talimë  
Të shoç se çë heq martinë.  
Mu në shesh e në Trihallë  
Hajdut o Shemo me pallë  
Ngrite djemtë me dhaskalë  
I ngjite përpyjetë malë  
I u-kërkove ksegoranë,  
Treqint lira për një djalë,  
Gjashtëqint përmbi dhaskalë.  
Shemo të erdhi gjuleja Shemo  
si do riten djemtë,  
Ashtu si jam ritur vetë.*

Teto Ruhua vështronte. N'oda Xha Ivziu ndëri dorën. Mori një çikë mish dhe e futi në gojë. Duke maçalisur nisi këngën tjetër:

*Manxuran e penxheresë,  
Foli plakë gomaresë,  
Një qint vjeç e s'munt të vdesë.  
I ra havale së resë,  
S'e lë të loz e të qeshë,  
S'ja lë robatë t'i veshë.*

U-ngre teto Ruhua dhe me kokë ulur xërmoi përposh. Mori udhën për në shtëpi, te gratë. Po avazi i këngës dëgjonesh:

*Moj nëne më qan Shemshija, Shemshija.  
S'mu pre mirë pirpirija, Shemshija.*

*U-pre si fundi fustanit , Shemshija.*  
*Mbuloi gjismën e divanit, Shemshija.*

Dhe një avaz tjetër vinte nga odaja, që kish ballët nga avlija. Teto Qibrua mbajti këmbët dhe dëgjoi:

*Vajte në krua për ujë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Me bucelë përmbi supe,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Dhe shaminë mbi bucelë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Ç'iu qepno tre djelm dilberë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Të këputnë bazubenë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Bazuben e hajmalinë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Hajmalin me tre zinxhirë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*  
*Me tre gurë xhevahirë,*  
*Hanko-pashë, Hanko-nure,*  
*Hanko ferexhe me lule.*

Teto Ruhua eci prapë dhe erdhi në gra. I gjeti ato që këndonin:

*O moj protokale zonja ,*  
*Këjo natë është t'ona,*  
*Të qajmë halletë t'ona,*  
*Hallet e dertet e t'ona,*  
*S'kanë të sosur akoma.*  
*Hallet e dertet e mija,*  
*Mi ka zemërë mavrija.*  
*Hapu moj zem-r' e shkretë*  
*Hapu bënu fletë-fletë*  
*Të dalinë marazetë.*

Me zi këndonin. Cave me një u-mbilleshin sitë mu tek venin e vinin në valle.  
Cave u-hapësh goja sa një kamare nga të gogësiturat. Qenë bërë si të  
shushitura... Ca kishin rënë me fëmijë bashkë dhe këto që kishin mbetur,  
këndonin sa për si e sa për faqe.

*Ç'u-rit barbarozi,  
Zuri penxherenë,  
Moj namë një degë,  
Sa para të ketë,  
Sa para të ketë,  
Ta paguaj vetë,  
Në mos paça vetë,  
Dal e mar në çetë.*

Si të ngordhura këndonin:

*Duarto, plot merxhane,  
Gushëno, plot gjordane  
Buzëno, karafite,  
Faqeto, trandafite.*

E panë që s'u-dilte zëri e lanë për një copë herë këngën. Merushija,  
që këndonte shtruar e mirë nuk ishte në oda. Të tjerave u-kish rënë flama. Këto  
qenë që do të gdhilleshin për gjithë natë? U-uhnë në shesh dhe ato të paka që  
qenë në valle. Rinin me duar lidhur. S'bënin as fjalë, as kuvënd. Kur ja, njera  
e lëshojti zënë tek rin. Për të fol mos qoftë të tjerat i vanë pas:

*Moj pse rini pse s'këndoni,  
Nuk e dini kë martoni?  
Ne martojmë Nexhip benë,  
I muarm' xhiko nusenë.*

Nga një çikë e nga një çikë u-dolli gjumi e i u-bë siri pishë. Zunë  
këngën më shtruar. Si më parë. Atë kohë erdhi dhe Merushija. E lëshojti zënë  
bashkë me to:

*Ndënë penxhere të shkova, moj muse vetullë holla,  
Di tre fjalë t'i dëgjova, moj muse vetullë holla.  
Te agai i tregova, moj muse vetullë holla.  
Ti që më tregove mua, u aganë do ta dua.  
Duaje moj bukuroshe, të të var floring me qoshe.  
Duaje moj kanakare, se të var flori manxhare,  
Pohë me margaritare.*

“Safë të qan djali” foli një nga fundi derës. Ajo u-ngre, shoqet i  
kënduan:

*Të qan djali jepi sisë,  
Jepi sisë të pushojë  
Moj si zez e kaço fjollë.  
S'ka gojë të kuvëndoje  
Moj si zez e kaço fjollë.*

Kur ja, erdhi n'oda Hajrijeja me djalin në duar dhe të tre vajzat nëpër këmbë.  
E mbanin nga sadeja. E panë dhe asaj i kënduan:

*Moj e holla si bari,  
Si koqe margaritari,  
E kullucara si ari.  
Moj pse s'të rojnë fëmila?  
S'më rojnë nga bukurija.  
U pu pu shoqet e mija.  
U pu pu ç'është fëmila,  
Eshtë jet' e prokopija.  
Ngrohosira te shtëpia.  
Gjithë shoqetë me djepe,  
Un' e mjera nga të vete?*

Dhe qeshnë të gjitha.

U-lodhnë duke kënduar me zë. U-dukesh sikur vinte në gjumba kthien kaurçe  
këtë radhë:

*Moj shtëpia pa katua,  
Kusht e zonja diç' e dua?  
Ka vatur e lan në krua.  
Lan këmishët e ashikut,  
Me sapun të Venetikut.  
Lan këmishët e jaranit,  
Me sapun të Elbasanit.  
Laj mike laj  
Me sapun kallaj.  
Thaj mike thaj,  
Nëpër dega maj.  
Mblidhi mike mblidhi,  
Në kanister hidhi*

Me këngë bashkë dhe nusja në krie të odasë u-çel. Kënga vinte  
shtruar.

*Te porta me di sufa,  
Di kunata krah më krah,  
Ç'ka e vogëla që qan?*

*I muarn' burin nizam.  
Në mos artë proto mucaj,  
Mer shoqet e dil e luaj  
Në mos artë gjer në vjeshtë.  
Mer gërshëren e pre leshtë.  
Në mos artë mot si tanihë,  
Mer urën e digj shtëpinë.*

S'kish mbaruar mirë kënga kur erdhi prapë dhëndëri. Hajde, hajde!  
I dëndëroi udhët. Si rillesh pa parë një çikë nusen. Graria me taparë e muarnë  
në valle. Tani këndonin më mirë:

*Atje poshtë në taban, moj në taban,  
O ç'mbiu një margaritar, margaritar.  
Nexhip beu tha do ta mar, do ta mar.  
Do ta mar faqe-kuqenë, do ta mar.  
Mil'e palë kur t'i kenë, do ta mar.*

E me radhë:

*O moj kumbulla vlonj'a te  
Hajde moj, eja moj  
Hajde se të erdhi nuri  
Hajde moj, eja moj.  
Dhe në vjen miser që vjen  
Odënë shtruar e gjen  
Dhe në erdhi pra s'e qish.  
Unë vallen nuk e prish.*

Me të dëgjuar n'odanë tjetër se kish ardhur dhëndëri u-ngrenë dhe ato  
që kishin rënë për gjumë. Erdhën shpejt, u-bashkuan me shoqet e tjera.  
U zunë në valle dhe kënduan me to:

*Ç'këndojnë di zoga,  
Përtej n'ato kodra,  
Bukurë këndojnë,  
Nexhip-ben' e zgjojnë,  
Nusen e gëzojnë.*

Kështu kënduan dhe tjetrën:

*Ç'u niçë, moj nga Berati  
Për një çupë te sahati,  
E bukurë nga surati,  
E'hol! e gjatë nga shtati  
E mirë nga tabiati*



Sa e zunë dhe s'e lanë prapë:

*O çuno festë më nj'anë,  
Hajt' tëvemi në Tiranë,  
Të shikojmë kasabanë  
Sa xhami e sa diqanë  
Sa të bukura që janë.  
Kur del çuni nga xhamija,  
I vetëtin hajmalija.  
Kur del çuni nga diqani,  
I vetëtin jatagani.  
Kur del çuni nga teqeja,  
I vetëtin fermeleja.*

"I këndonin një këngë Majnurit" u-tha Teto Haxhua "i këndonin dhe kësaj së zezës". "E po mirë moj teto Haxho" tha Manushaqja "s'ja prishim qejtin". Dhe ja tha:

*O moj ti që kore melë,  
As më gjete desdemelë.  
Desdemelë t'im të hollë  
Qindisurë mollë-mollë,  
Rahurë gjithë Stambollë.  
O Stamboll more i shkretë  
Rëntë zjari dhe të djektë,  
Që na mban burat përpjetë.  
Stamboll u-djekç anë mb'anë  
Që na mban buratë t'anë.  
Qiraxhi të ngortë mushka,  
Që pëlçet këto bardhushka.*

Nexhipi ndenji sa ndënji dhe u-ngre prapë. Dolli n'avli. Tek ecente dhe një çikë ra. I dolli dega e fikut përpara e deshi e s'i hiri në si, se udha që prapa e prapa për në shtëpin' e Mulla-Xhevdetit. Në konak burat i gjeti që pinin akoma. S'kishin në mënde të hanin. Mezetë sa venin e shtoheshin, shishetë sa venin e mbusheshin me raki. Edhe këngën se linin pas:

*O moj dardha dimërore, dimërore  
Ç'e bëre beun që more, dimërore.  
Ë dërgova në Janinë, për di tufa trendelinë  
Një për mua, një për tinë, kur erdhi haroj shtëpinë*

Pa e këputur:

*Kur veje nëpër bejlerë, rije tre sahat në derë,  
Sa të të krejnë haberë, zot Emin aga*

Trim me plagëra  
 Moj xhiko Lela, pika që të ra  
 Kur veje nëpër meçlizë,  
 Të dukeshin bota si mizë,  
 Zot Emin aga  
 Trim me plagëra  
 Moj xhiko Lela, pika që të ra  
 Kur shkoje nëpër pazare,  
 S' të dukeshin bota fare,  
 Zot Emin aga  
 Trim me plagëra  
 Moj xhiko Lela, pika që të ra  
 Kur veje në hajsomer,  
 Të dukesh bota er,  
 Zot Emin aga  
 Trim me plagëra  
 Moj xhiko Lela, pika që të ra.

Dhe në odanë tjetër, kënga që e pa prerë:  
 Dallandushe vogëlo, dale-dale,  
 Primë sa të ritemo, dale-dale,  
 Të bëhem sa shoqeto, dale-dale,  
 Sa Libohovëteto, dale-dale  
 Sa Gjirokastriteto, dale-dale,  
 Të vemi në kasaba, dale-dale,  
 Të zëm shtëpi me qira, dale-dale,  
 Me xhame e taraba, dale-dale,  
 Jashtë e brënda me boja, dale-dale.

Në Gjirokastër të gjithë kishin rënë për gjumë. N'asnjë vënd nuk dukesh dritë, vetëm në shtëpin e Mirteza agajt, ku këndohej dhe llamburitnin odatë. Jashtë dëgjohej avaz i bukur i këngës. Era e pakë e natës e përhapte kudo. Hëna në qiell bënte dritë për mbi çatira dhe iletë kërcenin nga njera anë në tjetrën.

Brënda këndohesh e në valle i gjeti mesi i natës.

## MES' I NATES

Ra sahati në funt t'odasë tik... tak... tik... tak... Të gjitha gratë ngritën kokën dhe mbajtën këmbët në valle. Mes i natës. Don kohë sa të gdihesh. Nuk do flinin, po do këndonin gjer në mëngjes. Teto Hasibeja kish bërë be

kë të gjente fjetur do ta qepte dhe do ta nxinte. Do ta bënte gamile në surat.  
Merushija vate në krie t'odasë dhe mori nusen. E shpuri n'oda të re.  
Ja bëri me kokë dhe kako-Pinos, E ndoqi nga prapa ajo. I futi të dia brënda.  
U kishite shtruar radha-radha. Të diave u-kish hedhur nga një jorgan akillas.  
Merushija ndihua Xhemilenë sa kreu robot. Veshi ato të natës. Ra. Xhikua e  
re e mbuloi mirë. Ndënë jastëk i futi frën e kalit. Me të do flinte nusja gjithë  
natën. Të kishite gjuhën e shkurtër dhe frë nga vjehra, ashtu si ka urdhëruar  
Zoti, ashtu si kanë bërë dhe të parët.

Me nusen bashkë ra dhe Kako-Pinua. Merushija e mbuloi mirë dhe  
këtë. Uli llambën për gjismë dhe dolli jashtë. Nga ecënte hapte diertë e odave  
të tjera. Odaja e zjarit plot. Nga një anë një djep, mbi minder një vajzë e vogël.  
Ati afër një grua që flin. Një i vogël qante dhe kërkonte nënën. E mbilli deren.  
Oh, ç'të donte të bënte. Nënë afër e kish, le të zgjohej. S'kishte kokë për të.  
Kish punët e saj. Andej u-fut në pat të math. Një radhë qenë shtrirë dhe ati.  
Pa llambën ngritur. vate dhe e uli. Të gjitha flinin si shqerat... Në funt vate  
në pat të vogël. Ç'të shohë! Merzua me një shoqe tjetër nxinin gratë që flinin.  
I kishin bërë lugat në surat. Ato me ta parë atë që hiri derën, ikën me të katra.  
Tatëpjetë shkallave dualinë në avli.

Merushija tek mbilli derën tundi kokën dhe gogësi. Qe e lodhur dhe  
e këputur. Vdiq. Një javë të tërë në këmbë. Kur ja dëgjoji një zë. E hapi prapë  
derën dhe hiri brenda. Ja dha gazit. Këtë radhë me të math. Teto Haxhua kish  
fjetur, po e kishin qepur me jastëk bashkë. Bën të ngrihesh e s'ngrihesh dot.  
Jemeniu i kish ikur nga koka dhe leshët i kishin rënë në surat. Eh, mallkonte.  
I vate pranë Merushija dhe e shqepi. "Biro të keqen" thosh plaka dua ta di se  
kush ma bëri. Ma punoi mirë. Po ku ma gjeti anën? Eh, të shkretën, se  
s'ngrihem dot. Thuajmë Merushe, pe njeri të vijë këtu? Dua ta di Ç qesh qe  
mos qeç kurë. Nga flit ngriti kokën. Po tani Merushija ja dha gazit më shumë  
akoma. E kishin nxirë dhe në surat në të dia faqet bashkë. E pastaj? Ajo u-  
xhingos më shumë. Ashtu e përgjumur, vate përposh në qilar të lahesh. Në  
oda këndonin:

*Moj hunaza me tre gurë, se ç'u-bë gruaja burë.*

*Shit' o burë pallëtonë, blemë mua manëtonë,*

*Se do t'iki të të lë, do të mar një tjetërë.*

*Të të lë fëmilënë, djalin edhe bilënë.*

Ja u-preu këngën përgjisem Merushija kur hiri derën. Don të flite po s'e lin  
gazi. Më në funt ja u tregoi punën e teto Haxhos. Atëhere qeshnë të gjitha.  
Fejzieja që flin andej kur dëgjoji kukurizmat u zgjua. Vate të shin se ç'bënesh.  
Me si të qepura hiri n'oda. Shoqet e tjera kur e panë ashtu, i kënduan:

*Shkoi një lepur*

*Një sakat*

*Ku vete more sakat?*

Vete tek Mehdi agai.  
Ç'ke Mehdi aga me mua?  
Kam Fejzien e s'e dua.  
Esht' gjumashe e s'bën për mua.  
I shkreti Mehdi aga,  
Vet i mirë e grua s'ka.  
Gjori ç'është mbituro  
Me një të shalltisuro.  
Një këmbë xvarisuro,  
Për ta lukurisuro.  
Nga krei Këcullëso,  
Gjer në sunt të udhëso.

Pas kësaj tjetrën:

Vitori t'u-bëftë nëna moj  
Me se të të dojë zëmra moj  
Një shami me mollë t'ëmbra moj.  
Shamija një napolonë moj  
Foli zabitit me gojë moj.  
Turçe dhe Gërqisht i fola moj  
Dot nga gjumi nuk e zgjova moj.  
T'i flitnj'a më dridhesh goja moj  
Ta zija me dridhesh dora moj.

U-erdhi qejfi e u-dolli mirë gjumi. Edhe pse jo? Teto Afesaja pruri një fron të vogël n'oda. Nga prapa bil' e saj e madhe vin me një tepsi në duar. Me zi e mbante. Hop këmbën, e hop këmbën. Eshtë vrënge fare bina-dala. Në tepsi kishte di tabaqe të mbëdhda me bukuvale pika, i kish marë dhe të tëra njëherëshit. Ç'pret nga njeriu me gjismë mënde. Mirë ja kishin gjetur vëndin në qilar. Gorobiste gjithë kohën. Lan e fshin sa i prëjti të shtëpisë. I pa Perëndija. E zeza të vinte dhe keq. Sos e çalë po dhe zullape nga surati. As di të vishet, as di të flasë.

E vuri tepsinë mbi fron. Nëna e saj, minxirjare, e gjithë tru u foli grave. Ato sosnë këngën që kishin zënë.

Ç'u-ngreçë saba me natë,  
Mora shportënë në dorë.  
Vajta tek një dege molle.  
Ikë tutje vajz e hollë.  
Mos më merr koqetë mollë,  
Se në të paça kure,  
Do të të zë me gurë.  
Ç'u-ngreçë saba me natë,

*Mora shportënë në dorë,  
Vajta tek një degë dardhë.  
Ikë tuje vajz' e bardhë,  
Mos më mer koqetë dardhë,  
Se në të paça kurë,  
Do të të zë me gurë.  
Ç' u-ngreçë saba me natë.  
Mora shportënë në dorë,  
Vajta tek një degë pjeshkë,  
Ikë tuje vajz' e zeçkë,  
Mos më mer koqetë pjeshkë.  
Se ne të paça kurë,  
Do të të zë me gure.*

u-uhnë të gjitha troiro e troiro. I u-shtruan bukuvalet. Apo s'qe bërë e mirë, apo s'kishin uri. Me të drejtë, kishin ngrënë bukë darkë me ditë bashkë. Tani u-qe bërë barku hon. Me gjith' ato këngë e valle që kishin bënë e kishin hallall. Sa mbushnin njerën lugë dhe e vinin në gojë, ndërmin dorën për së diti. Ha e këndo:

*Bukuvalia tope-tope,  
Moj Haxho moj kokë-bode.  
Bukuvalia jenete,  
Jenete thërmoneto,  
Haxhua tërboneto.*

Në një çikë herë e thapsën. Në funt hangërnë pemët e zariкотë. Me ato në duar kënduan:

*Moj sinija veseli, veseli.  
Me pemë lloi-lloi, veseli,  
Zariko e bleblebli, veseli.*

Kur mbaruan së ngrënit u-ngrenë. Fshijtin buzët me jemeni dhe drejt e në valle. Tani t'u-thoshte njeri bini e flini, këto s'venin gjë. U hipi dhe të qeshur! Apo s'këndonin ca këngë që të shkulinin zorët. Nga të isqisë, të Dem baba-Demit. E nisi Zarua një:

*Karkaleci këmbë-gjati,  
Në fletë të kungullit  
Në fletë të kungullit.  
Pse më thoni këmbë gjatë?  
Un' kur isha djal i ri  
Vija festenë mbi si  
Vija festenë mbi si.*

Teto Xhevrúa që rin në krie të minderit si pulë u-tha të këndonin këngën e Tatushes. "Këngën e Tatushes?" i thanë këto dhe u vështruan në si me njëra-jetrën. U-menduan, po as njërës nuk i binte në mënde. "Të Tatushes" u-thotë prapë. "Tatushes, humbi tasi, moj Tatushe". S'u binte në hatër për be. Atëhere u-ngre në valle. E zuri vetë. Ajo thosh e para dhe këto i venin pas.

*Tatushes i humbi tasi, moj Tatushe.*

*Mos ta gjeti bilimbashi, moj Tatushe ?*

*As ma gjeti, as ma mori, bej more bej.*

*As më jep di fill xullufe, moj Tatushe.*

*Të ja vë kalit xhufke, moj Tatushe.*

*As më jep di fill mustaqe, bej more bej.*

*T'i qindis tele në faqe, bej more bej.*

E ç'i din këngët teto Xhevrúa:

*Mos u-mba nuse në sqimë, mos u-mba.*

*Të dimë së ç' baba ke, mos u-mba.*

*Një sarhosh-në kafene, mos u-mba.*

*Kumarxhi të fletëve, mos u-mba.*

*Mos u-mba nuse në sqimë, mos u-mba.*

*Të dimë së ç' nënë ke, mos u-mba.*

*Një kokë pa krehurë, mos u-mba.*

*Pa sumbull' e pa thile, mos u-mba.*

"I dini këto ju"? u-tha ajo, kur mbaruan, "janë këngë të njëherëshme". "Po të Totes e dini?" u-hodh teto Ruhua. Aj dhe s'e dinte teto Xhevrúa. E ajo kur ishte ere, s'kish lënë dasmë pa vatur, këngë pa pa kënduar. E kush nuk e njihte teto Xhevron për këngët e saja? A po s'i këndonte mirë. A po s'din t'i kthente mirë. Eh, sa nuse kish parë ajo e sa darkëra kish ngrënë ajo. Gjithëmonë në krie të valles. Po tani ç' e do, u-plak. Ikin vitet për të gjithë. E zuri dhe këngën e tretë:

*Totija shiti gomarë,*

*Totija moj Totija,*

*Shiti gomarë,*

*Për të kuq e për të bardhë*

*Totija moj Totija,*

*Festë misirjotija,*

*Jo moj Tote, jo e jo,*

*S'janë të mira këto.*

U-ul teto Xhevrúa, u-ngre teto Haxhua. Tha dhe ajo një të sajnë:

*O Hariz ç'i bëre dhëntë, o Hariz, o vezir,*

*Aman dashi bir o bir.*

*Dashi me kumborë frëngë, o Hariz, o vezir,  
Aman dashi bir o bir,  
Zile me gjuhë t'ërgjëntë, o Hariz, o vezir,  
Aman dashi bir o bir.*

Një e të ditën pas:

*Selfo flet' e hudhresë, lepe, lepe.  
Dil foli së bukërësë, lepe, lepe.  
Asaj qafë flutrësë, lepe lepe.  
Perishan këputrësë, lepe, lepe,  
Kush t'i këputi biro?  
Një qatip i vogëlo, ai Nexhip moj nëno,  
Natën e në hënëzo, ditën e në diello.*

Kur ja, hiri n'oda një grua si burë. Kish veshur benevreqe të bardha, një xhamadan përsipër. I rinte i hapur përpara se s'e lin kraharori. Në kokë kish vënë një qilah të bardhë e ulur mbi si. Kish nxirë vetullat dhe vënë di mustaqe bingë gjer tek veshi. Cingari në gojë, bastuni në dorë. Ecënte dhe në krah i vinte një tjetër. Kish veshur një sade të kuqe. Në surat që bërë krodhë nga të nisurit. Leshërat i kish prerë të gjitha përpara e i kish zënë me një paromandë të verdhë. Në dorë të djathtë shkuar një shportë. Dorën tjetër ja kish hedhur shokut në krah.

Të dia ecnin. As flitnin, as kuvëndonin. Thoni si të doni, po në krie njeri s'i njohur. Nuk shëmbëllenin fare.

U-zunë në valle dhe të tjerat këndonin:

*Bretëkocë qafë gjatë,  
Ç'e heq vallen bukuro  
Ç'e heq vallen bukuro.  
Pse më thoni qafë gjatë?  
Un kur isha vajz' e re,  
Vishja sade selime  
Vishja sade selime.*

E u-nxinë së qeshuri. E njohinë atë që qe veshur si grua e re. I raftë pika Merushes e si qe bërë ashtu? S' dukesh fare se ishte ajo. Po tjetra? Bedrua, nuse e djalit të Mulla Refatit. E vunë të kërcente valle. Nisi këngën vetë:

*O Ali, more Ali,  
Çilë nuse na do ti...?*

i thoshin këto. Bedrua përgjigjesh...  
Ajo që ma bën me si...

dhe ashtu siç ishte i u-lëshut nuses së Ibrahimit. Don ta puthte. "Lipsmu" i tha kjo "ikë për kokën t'ënde. Pika Bedro, si je bërë kështu?" Po kë linte gazi atë kohë.

Këndo e qesh:

*Mu në funt të kadërdhëmit, Zejnebi, moj Dudi.  
Se ç'të pati qe duvaku, Zenejbi, moj Dubi  
Si vezirëve bajraku, Zenejbi, moj Dudi.  
Se ç'të pati qe gozhuku, Zenejbi, moj Dudi.  
Si katilerëve qurku, Zenejbi, moj Dudi,  
Se ç'të pati qe sadeja, Zenejbi, moj Dudi,  
Si katiut meqemeja, Zenejbi, moj Dudi.*

E pastaj:

*Trëndafil' në brokërimë,  
Ejni moj shoqe të rimë,  
As të ham' e as të pimë  
Të gëzojmë vashërinë.  
Të gëzojmë dhëndërinë  
Nexhip kokë shtrëmbërin.  
Un s'e kam të shtrëmbëtë,  
Ti më març të keqenë.  
Jam i mir, i zgjedhurë  
M'i mirë nga shokëtë.*

e qesh... Ha ha ha e ha ha hu. E këndo:

*Ç'u-niçë për Elbasan, xhan, xhan more xhan.  
Xha Selimi një selam, xhan, xhan more xhan.  
Xha Selimële me barë, xhan, xhan more xhan.  
Ishalla na bën një djalë, xhan, xhan more xhan.  
Do t'ja vëmë Hekuran, xhan, xhan more xhan.*

Iku dhe një copë natë. Hir e dil e qesh. Dhe kur u-xhveshnë Merushija me Bedron, gazi s' u-mbahej. Teto Haxhua me të sajte. Rin sa rin, pa thosh nga një:

*Thanë se i vdiq babai  
Hatixhes së vogëlo, Hatixhes së vogëlo.  
Dhe në vdiq rahmet mos pastë  
Kurë në xhenet mos vafte  
Tunt moj dado djalëno, tunde të na riteto.  
I thanë se i vdiq nëna  
Hatixhes së vogëlo, Hatixhes së vogëlo.  
Dhe në vdiq rahmet mos pastë*



*Kur në xhenet mos vafte  
Tunt moj dado djalëno, tunde të na riteto.  
I thanë se i vdiq buri  
Hatixhes së vogëlo, Hatixhes së vogëlo.  
U-pu-pu shoqet e mia  
Tani është sendelija  
Përmbis dado djalëno  
Tatëpjetë shkallëno*

“Edhe këtë tjetrën” tha teto Haxhua:

*Te gorica ndënë shullër,  
Na ranë kusarëtë,  
Vallj na muarë gjë?  
Na muarnë bejkenë,  
Bejkenë që s'lanë më,  
Bejken' e çobanitë,  
Po burë lumi ç'u-bë,  
Ka rënë për gjum' e flë  
Lëre ç'vë ujkënë.*

Po tha dhe të tretën:

*Ndënë xhiko Xhekonë  
Gjeçë Çelo Merkonë,  
Bën barjam me Xhekonë,  
Xhiko Xheko na një ftua,  
Çelo Merko nuk e dua.  
Ndroi Ulo, ndroi Sulo  
Ndroi Elena, ndroi Selena  
Dil Bejko nga bedena  
Dil Braho nga baxhaja  
Dil Zilfo nga tarabaja.*

Mbaroi kjo, nisi Bedrua të sajnë:

*Haj të thomi njëzë, të bënenë dizë,  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija,  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë,  
Haj të thomi dizë, të bënenë trezë,  
Tre këmbë pirosija,  
Di sisë i ka dhija, një është Përendija,  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.*

Haj të thomi trezë, të bënenë katër.  
Katër sisë i ka lopa, tre këmbë pirostija.  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë mainë.

Haj të thomi katër, të bënenë pesë.  
Pesë gjithre i ka dora, katër sisë i ka lopa.  
Tre këmbë pirostija.  
Di sisë i ka dhija, një është perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.

Haj të thomi pesë, të bënenë gjashtë.  
Gjashtë këmbë i ka mori, pesë gjithre i ka dora.  
Tre këmbë pirostija.  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.

Haj të thomi tetë, të bënenë nëntë.  
Nëntë muaj i ka djali, tetë ditë i ka java.  
Shtatë këmbë estapoll, gjashtë këmbë i ka mori.  
Pesë gjithre i ka dora, katër sisë i ka lopa.  
Tre këmbë pirostija.  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.

Haj të thomi nëntë, të bënenë dhjetë.  
Dhjetë muaj i ka pela, nëntë muaj i ka djali.  
Tetë ditë i ka java, shtatë këmbë estapoll.  
Gjashtë këmbë i ka mori, pesë gjithre i ka dora.  
Katër sisë i ka lopa, tre këmbë pirostija.  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.

Haj të thomi dhietë, të bënenë njëmbëdhjetë.  
Njëmbëdhjetë hajrusheja, dhjetë muaj i ka pela.  
Nëntë muaj i ka djali, tetë ditë i ka java.  
Shtatë këmbë estapoll, gjashtë këmbë i ka mori.

*Pesë gjishtre i ka dora, katër sisë i ka lopa,  
Tre këmbë pirostija,  
Di sise i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.*

*Haj të thomi njëmbëdhjetë, të bënenë dimbëdhjetë.  
Dimbëdhjetë i ka viti, njëmbëdhjetë hajrusheja.  
Dhjetë muaj i ka pela, nëntë muaj i ka djali,  
Tetë ditë i ka java, shtatë këmbë estapolli,  
Gjashtë këmbë i ka mori, pesë gjishtre i ka dora,  
Katër sisë i ka lopa, tre këmbë pirostija,  
Di sisë i ka dhija, një është Perëndija.  
Zënë që ka birbili,  
Që këndon tërë majnë, që këndon tërë majnë.*

Kur e mbaruan këtë këngë genë të këputura. I lëshuan duartë dhe muarnë frimë thellë. Po kishin qejf prapë për këngë. "Të Lloqinës" tha njera "është e bukur shumë". "Po merjani me zë të ulet, se dëgjonet më mirë". "Jo, më parë atë lart e më lart" u-tha Merusheja. "pastaj të Lloqinës". S'ja prishnë:

*Lart' e më lart, dolla në pazar,  
Bleva një pulë, pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë, Gjoni po këndon,  
Tra më tra ja thotë, tra më tra ja thotë.*

*Lart' e me lart, dolla në pazar,  
Bleva një patë, pata ia pat...pat...pat...  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon,  
Tra më tra ja thotë, tra më tra ja thotë.*

*Dolla në pazar, bleva një rosë,  
Rosa ja bënë roj...roj...roj.  
Pata ja bën pat...pat...pat.  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon,  
Tra më tra ja thotë, tra më tra ja thotë.*

*Lart' e më lart, dolla në pazar,  
Bleva një dele, delja thoshte milme mua,*

Rosa ja bën roj... roj...roj,  
Pata ja bën pat... pat... pat.  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon,  
Tra më tra ja thotë, tra më tra ja thotë.

Lart e më lart, dolla në pazar,  
Bleva një kalë, kali thotë hipma mua.  
Delja thotë milmë mua.  
Rosa ja bën roj...roj...roj.  
Pata ja bën pat...pat...pat.  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon,  
Tra më tra ja thotë , tra më tra ja thotë.

Lart e më lart, dolla në pazar,  
Bleva një plakë, plaka thotë mermë mua,  
Kali thotë hipma mua, delja thote milmë mua.  
Rosa ja bën roj...roj...roj.  
Pata ja bën pat...pat...pat.  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon  
Tra më tra ja thotë , tra më tra ja thotë.

Lart e më lart, dolla në pazar,  
Bleva një çupë, çupa thotë sli me mua,  
Plaka thotë mermë mua, kali thotë hipma mua,  
Delja thotë milmë mua,  
Rosa ja bën roj...roj...roj.  
Pata ja bën pat... pat...pat.  
Pula na bën koqe-venë,  
Nusija hullon birenë,  
Gjoni po këndon.  
Tra më tra ja thotë, tra më tra ja thotë.

Tani të Lloqinës:

Ditën e Pashkës së madhe,  
Hillesho Lloqina valle,  
U-ngre Kostandini vate,

Gjeti Lloqinën në valle.  
 Mis' erdhe Kostë-vëlla.  
 Miser të gjeçë moj motër.  
 Në më erdhë për të keq, Kostë-vëlla.  
 Të vishem si kallogretë, Kostë-vëlla.  
 Në më erdhe për të mirë, Kostë-vëlla.  
 Të nisem si jam kështunë, Kostë vëlla.  
 Ashtu si të zuri hera, moj Lloqinë.  
 Pse më bie erë baltë, Kostë vëlla?  
 Nga hollohët e beharit, moj Lloqinë.  
 Hajde ti Lloqin në portë,  
 Se un do vete në qishë,  
 Se kam haruar shaminë.  
 Lloqina u-fut në portë,  
 Kostua u-fut në gropë.  
 Hap moj nënë derëno,  
 Vjen Lloqin e vetëmo,  
 Tutje moj murtal e zezë,  
 Se më more nëntë djemtë,  
 Nëntë djem e nëntë nuse,  
 Të nënta nuse me djepe.  
 Hap moj nënë derëno.  
 Jam Lloqin e vetëmo.  
 Nëna hapi derëno,  
 Tek u-puthn' e u ngalasnë,  
 Që të dija atje plasnë.

Dhe tek këndonin:

O moj ti me atë mes,  
 Sa e bleve atë bres.  
 Atë bres e atë thikë,  
 Shtatëdhjetë venetikë.

kur njera tha tha "zuri të gdhihet" Të gjith pushuan këngën. Hipnë mbi shtrat, në krie t' odas dh truan jashtë Sa koh' e bukur. S' kishte asnjë re të zezë. Qielli dukesh i veshur me një kadifë të bardhë. Iletë një nga një kishin ikur, vetëm një kishte mbetur. "Të këndojme dhe një këngë" tha njera:

Do thom këngë me sevda,  
 Ta dëgjoje mikija, ballë venetikeja.  
 Moj mike kur ta dëgjoç, mua do të më kujtoç  
 Sit' e zes me lot i mblohtë.

"E ç' është kjo këngë kështu?" pjeti teto Haxhua "për lumë. Zeni një tjetër.

Këndoni Shekos. Nuk e dini që buri i vete n' Amerikë?"

*Te porta me di sufa,*

*Me shëndet mbeçi moj gra,*

*Se do vete në gurbet, ju lë gruan amanet.*

*Imzot me kë më lë mua?*

*Un të lë me plakënë, që t' i març uratënë.*

*Un uratën nuk e dua, ri imzot këtu me mua.*

*Kapërceva portënë, i ziu laç motrënë.*

*Kapërceva lëmënë, i ziu laç nënënë.*

*Kapërceva pruanë, i ziu laç gruanë.*

*Kur vajta në Zharovinë, kujtova djemt e shtëpinë.*

*Mike të kujtova t'inë, s' mbajta dot paraponinë.*

këndonin po mënden e kishin jashtë. Era e ftohët që frinte të ngjethite. Një zok fluturonte e nga lente dielli. rezet e para e kishin bërë kuqurume një copë qiell. Sa venin e po shtoheshin e nga brigjet një cipëzë e bardhë dukesh sikur zbritte për mbi shtëpira e kopshte. Dhe ngadalë e njera pas tjetrës shquanin ato më të afërat e pastaj ato më të largëtat. E dëgjohesh zëri i kokoshit. Një tjetër qi këndonte e përpiqte krahët, e shokët e tij me radhe që i përgjigjeshin nga lark. Ku hapesh një portë, ku një kanat. Këmbë nëpër avli. Udhës një plak me gomar përpara, një djalë me matara krahave, duke fëshëllier me një shkop në dorë që u-binte gurëve që gjente përpara. Zbardhi mirë buz' e malit dhe dielli dolli. Ato këndonin:

*Trënkër-trënk tabaqeto, ngreu nuse laj faqeto,*

*Se zuri e u-gdhi dita, u-gdhi nusija si drita.*

N' oda brënda graria qe nëpër këmbë. Të gjitha u-ngjethnë nga era e ftohtë që hinte nga penxherete. Hodhnë nga një gjë krahave. Ishin bërë nga surati lejmon. Leshrat rënë nëpër faqe e jemeniu i kokës zgjidhur. U-ullnë në krie të minderit, hiri nusja n' oda dhe këto i kënduan:

*Si u-gdhive sot, moj nuse zonja?*

*Si do gdhihem sot-e, si në vënt të huaj.*

*Një natë që fjeta, m' u-duk sa një muaj.*

Merushja i rinte në krah dhe i ndreqte telat. I kënduan:

*Ra sabahu dhe u-gdhi, paçë xhikonë me si.*

*Nuk e di se si ta quaj, njera në shtëpi të huaj,*

*M' u-duk nata sa një muaj.*

Ajo u-puthi dorën ature q' ishin n' oda. Eci kadale dhe zuri vëndin që kish dhe ditën e parë. Ngriti me duar telet dhe ndënji në këmbë. "Ulu nuse" i tha njera. Ajo bëri sikur s' dëgjoiti. "Ulu, ulu" i tha prapë teto Ruhua. Bëri ashu si i tha

e madhja. Zuri vënt mbi jastëqe. Të tjerat këndonin:

*N'ato repe, n'ato trepe, n'ato bashte me lejmonë  
Ç'ke moj nuse që mejtone?  
I mejtonem vashërisë, se u vajzë s'bënem kure.  
Më thonë grua me burë.*

Një tjetër pas kësaj:

*Pel' e bardhë hergjele, për shalë t'ërgjëntë je,  
Pse s'ta bën babai që ke, po vjen e qahë tek ne?  
Po vjen e qahë tek mua, më duket sikur s'të dua.  
Dhe beu që kam s'më bën, jalla korba mos ma nëm.  
Kur të vejë lart me dhënt, raftë e zëntë një shkëmp.  
Kur të vejë lart me dhi, raft e zëntë një shi.*

Po bënin sa bënin dhe kthenin kokën nga penxhereja. Shquanin pemët e kopshteve. Dielli sa ven e ngrihesh lart më shumë. Këto këndonin. Një që të bënin nusen të qeshte:

*Bujku që punon në arë, ai që theri gomarë  
Atje shkoi dhe Haxhi krushku.  
Tha dhe Haxhiu një fjalë  
Kokenë lemani mua, ta bëj paça si ta dua.*

*Bujku që punon në arë, ai që theri gomarë  
Atje shkoi dhe Qibro krushka.  
Tha dhe Qibrua një fjalë, lëkurën lemani mua.  
Ta bëj gozhuk si ta dua.*

U-ngre me të lartë dielli. E panë dhe ja thanë:

*Un' dolla, dielli leu,  
Dolli astriti nga dheu  
Besë qën' a ç'më gënjeu.  
Gënje moj qëne gënje  
Po s'ta bëfça me hile  
Në kohën e bletëve.*

U-ngrenë gratë. "T'iki" thoshte njera "se më qan djali. Nuk e di se ç'më ka. Kallogreja! Kallogreja! do më flasë katënxhika. Më tha e zeza, lema të ta mbaj unë se do ta sëmureç. E ka kokën furë".."Prit dhe një çikë sa të shihet pala, pa gjene dhe ti, se e tepëron nga një herë. Duke që je protare. E sa herë do të sëmuret i vogli aqë të mira qofçin. Ri tani ta bëjmë udhën bashkë. S' të thotë katënxhika pse mënovë". I mbushi mënden shoqja. Një e tretë mblidhte skutinat. E kush ven' e vin nëpër divane.

Nje natë pa gjumë e këmbët u-dhimnin së gjithave. Sitë me një umblidheshin dhe bënin, sa bënin hapnin gojën e gogësinin. Që të shkonte koha sa më shpejt uleshin, ngriheshin, reshtnin fëmijën që rinin me kokë varur nga që s'kishin fjetur mirë natën. Ca kërkonin t'iknin e ca përpiqnin këmbët se donin bukë shpejt, atë kohë. Kush arët që kishte e kush e di se ku i kishin rënë.

Të shtëpisë venin e vinin nga një oda në tjetrën. Dhe këto kërkonin të bënin nga një punë po s'dinin nga ta fillonin. Nusja e re rinte si e ngrirë, teto Ruhua me hapse në duar se ç' thoshte me vete. Merushija flit me kako-Pinon. Të gjitha donin sa me parë të hapesh pala. Të shtëpisë, që të nisnin me radhë nga puna dhe të ftuarat që t'iknin e të venin në shtëpitë e ture, q' u-dukesh sikur nuk do sosnin kurë.

## P A L A...

“Do shikohet kjo palë apo jo?...” thosh Nexhmijeja, me djalë në duar. S'i bënte zëmra t'ikënte pa e parë. Po s'i rihesh as në një vënt. U-fut n'odan e vogël dhe pa. Ishte kako-Pinua me nusen. Hanin bukë. “E zeza nuse, tani i erdhi radha të vejë një kapshatë në gojë. Ka uri, s'ka uri, ajo do prese mëngjesë. Dhe atë kohë se mos...ha” thosh nëpër dhëmbë dhe i kujtohej vetja nuse, që gjithë natën i kishin gurgurisur zoret nga urija sa i kish ardhur të hante jorganin me dhëmbë.

“Eh” ja beri më në funt dhe tundi kokën, “ne presim palën e këto hanë bukë, Na ruat”. Në divan kur dolli vuri djalin mbi sunduk dhe për vete zuri maln e penxheresë. Shihte kush ven' e vin tek porta. Të ngrënat që venin në konak. Burat hanin darkën. Akoma dëgjonesh kënga:

*Me thano se kreve linë,*

*Katero-Katerinë, Katero-gjeraqinë.*

*Kreve tre koqe në ballë,*

*Katero-Katerinë, Katero-gjeraqinë.*

*Më thanë se u-shëmtove, Katero-gjeraqinë.*

*Ti më keq u-zbukurove,*

*Katero-Katerinë, Katero-gjeraqinë.*

Nusja, në shtëpin' e re hangri bukë cim-cim. U-ngre. Vate për të larë duartë. Mustafai i hollu ujë me ibrik të verdhë. Nusja e dajko Nexhipit i dha di franga peshqesh.

Grat' e tjera ishin nëpër dier e pritnin palën sa të hapesh. Epo ç' pritnin zonja te shtëpisë? Dielli mbuloi dhenë. Ç'rinin? Kur panë kako-Pinon të hijë në pat të madh i vanë nga prapa. Teto Hasibeja shtroi në shesh një sixhade. Gratë u-uhnë reth e rotull.



Kako Pino hapi sundukun dhe gratë hapnë sitë. Luajtën një çikë nga vëndi. S' u-durohesh. Ajo kreu një boshta akllas. "Eshtë boshtallëku i dhëndërit" tha duke e hapur... "një këmishë, pesë kut humai. Një parë xhurape, në jemeni të duare". Ajo i ngriti lart një nga një. Të gjitha e panë. Kutja i pëlqeu e kutja jo. Shkuan pështimën më të poshtë. S' munt thoshnin gjë atëkohë. Kako-Pinua mbilli boshtanë dhe e citisi me gjëlperë me kokë të kuqe.

Kreu të tjera... "gjatë sade hindja. Tre dimërore dhe tre beharore" U-hap boshtaja. dualnë gjërat në shesh.

Nexhmijeja, me djalë në duar, "plaç" i thosh atij, "ri mirë, se më more shpirtin". Pastaj hapte sitë mirë dhe pjete... "si the, gjashtë sade?" dhe i numuronte "një...di...tre me vete. "Të mira, nishan... dhe hop vështronte shoqen që kish pranë.

"Këto janë sadet e mira" foli prapë Kako-Pinua. "Nishan, i gristë me shëndet, dhe me djelm..." tha një plakë nga krei "i lumçin duartë, kush i ka qepur." Qenë një palë roba të leshta, me pallto të gjatë gjer në gju. Në qafë dhe në duar u kishin vënë samur nga i miri. E mirë me të vërtetë. U-dolli siri së rave. Njëra shtrëmbërojti buzën. Si pëlqeu hanëmes. Nga zilia, se s' kishte të sharë. Ta kishte pranë teto Haxhua, do ti fute një grusht suratit, për Perëndi. E donte se qe një haçkelë që as hundët s' dinte të fshinte jo të më vishte ato roba. Hem qeros e hem fodull.

Teto Hasibeja e ngriti në këmbë, se e donin ta shinin ca nga fundi. E mirë për mostër. Le të hapnin sitë ato që kishin vajza për të martuar. Plaka tek e mbante ashtu, Nexhmijeja e zuri me dorë. Kazmir qe, nga ai i miri. "Po ajo tjetra ç' është mi kako-Pino?" tha një nga fundi i radhës... "Sade pupulinë me lule". Dhe kjo u-pëlqeu. Të prerët e kish të bukur shumë. Pastaj di sade të mëndafshita dhe tre copa të pa prera. Këto ç'ka qënë.

Kako-Pinua kreu pallton e mirë, belluz. Ja kishte dërguar dajkua nga Amerika. Ta bleç këtu, do një grusht para... Pastaj ferexhe një të mirë të mëndafshitë dhe një të ditë. Ta kish për të vatur në shtëpin' e babajt dhe në njerzit e saj.

Kreu boshtan e mirë dhe të tjera qindizma. Mori një kuti. E hapi. Dhjetë par xhurape lligari. Këto të bëra me dorë e të gjata, për dimër. Gjashtë par të tjera, fildikoz nga i miri Ujë këto.

"U-lodhe kako-Pino? Të të ndih unë moj?" i tha teto Hasibeja. Eja dhe mos prit fare" u-përgjegj kjo.

Zuri halla e Nexhipit tok e tëk. Një kuti tjetër: gjashtë gaze me huja zimbile. Turli-turli bojara. Ca ishin si këmb' e patës. Gjashtë jemeni të kokës, tre buzla me ruaza të kuqja dhe tre buzla me llambro anë mb'anë. Haroj për një çikë pa dëftuar një pallto të leshtë për mëngjes.

"Hapi shpejt" i tha njera "se s'pret puna. Iku koha". Dhe vështronte jashtë.

"Këto janë të ndruarat" tha prapë halla e Nexhipit "njëzet këmishë,

gjashtë par brekë, di sade të natës, di kombolizone. Di pazene të mira për dimër". I mir nga një anë dhe i vinte në krah të djathtë. Gjërat, shkumë të bardha. Azhuret punuar bukur. Pa le fistot. Punë me merak.

"...Katër fanella, gjashtë jeleqe" thosh ajo... "një takëm të hamamit. Di futa për shtëpi, një futa të mëndafshitë.

U-ngrenë ca e ndënjën në këmbë. I u-lodhnë gjunjët... "këto janë robat jelekshit..." dëgjonej zëri i teto Hasibesë.

"Të mira, të mira" thoshin nëpër dhëmbë. Çitjanet xhanfës. Ormaçet dhe këmbat me stefene, fanella e pambuktë, këmisha birixhik. Mëngët dhe përpara qenë të qindisura me tel. Jeleku i mirë kadife manushaqi. Dhe ki mirë qindisur: me notra t'ergjëntë. Një avgellë përpara dhe nga një kokosh nëpër xhepe. Një kordhë nga prapa. Me roba bashkë dhe një par sheshëla, qindisur më krisaf. Një gaz si në lejmon. Anë mb'anë me huja, si këmb' e patës.

Teto Hasibeja kreu di par këpucë të udhës dhe një par për brënda. Një kuti me pasqirë. Brënda: sqafill, koqinall, gjërat e të qepurit po jo gjëlperë. Një cfongar, arë për vetulla, buzë për buzë dhe ca hollëriño.

"Një çarçaf pembezar" thosh teto Hasibeja "një qese për këpucë, kokoreth për boshta të mirë"... e i ngrinte të gjitha lart... "një kreher, një llanar, di boca me livando, një kuti me moskosapune". U ëh, bëri e në funt shkoi pëshitimën me të poshtë, mori frimë thellë. Vdiq, u-lodh, i u-këput mesi.

Palambaroi. U-ngrenë të tëra. Kush të vishesh e të dil më parë. Erdhën në dëndivan. Uruan për herë të fundit teto Ruhon me motra e me kunata. Me të shpejta muarnë udhën. E fundit dolli KakoPinua. Tek porta zonja e shtëpisë i futi në dorë një grusht të holla. 50 franga s'qenë pak. E po der' e parë. Para kishin dhe halli nuk u qahet.

Gra nëpër udhë. Di nga di e tre nga tre. Ishin të gjitha keq për gjumë. Me zi ecnin po fjalët jo se i linin. "Të mirë e kish palën... Plot e plot i kishin bërë" thosh njera. "U e pa gjenë" u-përgjegj tjetra "e ç' i kishin bërë? Palë si gjithë bota. Janë me mall e me gjë. U dit e zezë, ç' qenë ato këmishë pazane? ato copa si t' evgjitkave?" Gratë ecnin... "I mban mënt Nexhmije lulet Ue boshtasë së kuqe?" e pjete shoqja që kishte në krah. Ishte vajz' e zënë tek buri. I kish mbetur siri tek ato robat e leshta. Se mbante mënt mirë se qenë me samur në duar e në qafë apo me elma. Jo jo me samur qenë.

Kush më afër e kush më lark më në funt erdhën nëpër shtëpira. I u-duk se cilës sikur lindi prapë. Qenë të këputura. Një natë pa gjumë, llamaniset njeriu e bënet keq.

U-futnë brënda. Koka u-kërkonte jastëk. Bënë ç' kishin për të bënë dhe hë pritnin sa t'u-thoshte katenxhiku ngreuni e bini. Pa kush ishte e vetëme e shkojti ditën si qeni. Shtëpija ka punë dhe s' do të dijë se nikoqirija ka ljetur a s'ka fjetur. Pa fëmila ka skoture.

Re te zeza kishin dalë në grikë të Tepelenës. U-bë sterë në një çikë herë. Për...për...zuri shiu. Në shtëpin' e Mirteza agajt i u-përveshnë punës.

Nusja rin në këmbë. Si e huaj në shtëpin e saj të re. Një çap hillte dhe i dukesh vetja si e reme.

Shtinte sitë nga të gjitha anët dhe i dukesh se s'qe e vërtetë që qe martuar. Ardhur në shtëpi tjetër! Në njerëz të huaj!

Dëgjoneshin të fshira dhe të lara. Robat shkundeshin n'avli, gjërat ngriheshin nga dheu... punohesh me gas se nusja qe në shtëpi.

## E P E S T A

Një javë dasmë e madhe, me këngë e valle. Një javë të tërë gjëmoi shtëpija e Mirteza agajt dhe llamburitën odatë netë me radhë kur Gjyrokastri e gjithë kish rënë në gjumë me kohë.

Këngët pushuan, njerëzia u-përhap dhe një zogëzë e bukur bëri fole te re për jetë, një reze drite hiri n'atë shtëpi dhe tek hin e dil qeshnin nga gazi divanet, muret e çdo gjë që ishte ati reth. Punet u sosnë, gjërat u-vunë nëpër vënde. Dëndivani këmbë këmbë tani vetëtinte nga të larët. Ashtu shkallat, divanet, odatë.

Xhemileja nuse ecënte kadalë. I flitnin, ajo lepe peqe, po e para në punë.

Shkoi dita e parë. Pas asaj e dita, erdhi e treta. Mëngjesi e gjeti të parën në këmbë. Pas asaj u-ngre e vjehra. Hiri në qilar dhe kjo i vate pas. Largoi leshrat që i kishin rënë në ball. Mori frimë thellë e me një të dredhur në zëmër ngriti pak mëngët e sadesë. Vuri futanë në mes. E madhja kreu tepsinë nga prapa sundukut dhe kjo me të shpejtë ja mori nga duartë dhe e vuri mbi sunduk. Vjehra holli ëndë dhe nuk haroi atë të tasit, që Merushja natën e dhëndërit vuri qirinjtë e llezur të Nexhipit që ja muarnë të krej i shkallave, kur hiri dhëndër n'oda. Nusja hodhi sitë reth e rotull, shkoi pështimën më të poshtë. Luajti nga pak buzët dhe kërkonte si e si që mos kuptonesh se i vinte një si frikë. Me duar përveshur zuri brumët. I ulte, i ngrinte grushtet shpejt e shpejt dhe bezeliquet që kishte në duar i trëngëllitnin. Herë pas here ngrinte kokën përpjetë që leshrat të mos i zinin sitë. Zinxhiri me flori varur në qafë i ven e i vin përpara.

Në një çikë herë brumët u-mbrujt, i bëri karkanaqe dhe e mbushi tepsinë plot. Afër drekës, Jacia i nxirë në surat si gjithënjë erdhi t' i mirte. Kur e vuri tepsinë në kokë "dëgjo teto Ruho" i tha "mos më haroç pjesën, se nuk t' i pjek mirë" dhe qeshi. Dhëmbët e bardha zborë i shquanin ne suratin e zi dhe sitë i shkëlqenin. "Ç'ke ti, ç'ke ti" i u-përgjegj teto Ruhua "po vetëm piqi mirë Jaçe ziu se ku fute nga unë pastaj. Të keqen, bjere me kohë se ti e di punën..."

Erdhi qindija dhe dielli që gjithë ditën kishte mbuluar dhenë zuri të ngrihesh pak e nga pak dhe gra hinin e dilnin në shtëpin e Mirteza agajt. Nusja

posht e lart me kafë në duar. Ecënte e sa herë që vinte e vinte vështronte anë mb'anë, gjithë gjërat që t'i mbante mënt e mos lajthite kur ta donte puna... Ecënte dhe si flutur nuk e shije kurë në një vënt. Si vinte rëndë, se gjith'ato të hira e dala për të ishin.

Tak tak ra porta. Ishte djali i furxhiut me tepsi në kokë. Teto Ruhua dolli vetë. I mori karkanaqet dhe kur pa gjithë të vogjëlit të mbledhur ati, e uli tepsinë tek dhoga e pusit dhe "eni këtu" u-tha afrohuni". "Na një ti Tite edhe një ti Asllan. Mos qa Manushaqe se dhe për ti ka. Mos u-shtini se ka për të gjithë". Ndëri dorën dhe i dha një vajzës së vogël që kishte përpara dhe i gëzoi leshrat. Ajo fshiu lotët dhe iku me vrap, me karkanaqe në gojë e duke u-hedhur përpjetë nga gazi. "Dhe ti Shefqet qasu këtu" e tunte kokën teto Ruhua e me gaz në buzë "na dhe ti një ati te muri. Të kemi kushuri po mere, mos ki turp. Një Nurijesë, këtë të bukurën Afesasë së tetos që e dua shumë se është e urtë". Mer njeri e ikë, mer tjetri e ikë. Më në funt erdhi Mustafai. Këtij i dha di bashkë "dhe fute në xhep njerën se ta shohësh të tjerët dhe kërkoni të gjithë" e porositi teto Ruhua. Ai i mori e me të dia në duar dolli te porta. U-ul te praku dhe zuri të hante. I vanë të gjithë të tjerët pranë e me gojë plot vështronin karkanaqen që po u-mbaronesh dhe se lum Mustafai qi kishte di. E hanin nga një çikë e nga një çikë që mos t'u-sosesh. Ca e mbaruan. "Nam një çikë" i kërkoni shokut që kishin pranë. Po njeri s'ipte. "Nam një çikë Mustafa" i kërkoi Aisheja me sitë e saj te zes "se unë e mbarova t'imen dhe e kisha të vogël". Ai i dha një copë. "Nam dhe mua një çikë" i kërkoi Bukuresha. Dhe asaj i dha një tjetër copë. Kështu sa mbaruan të gjithë e zunë nga lodra.

\*  
\* \*  
\*

Erdhi e pesta dhe Xhemile nusja u-ngre gjithë gaz atë mëngjes. Koha që gdhirë e butë dhe qielli qëruar, po vetëm, ati këtu nga një re. Bëri punët e paka që kishte për të bërë si nuse e re që ishte dhe tëk tëk i bënte zëmra. Një gaz kishte brënda vetes dhe sitë i mbusheshin me lotë dhe ajo vetë nuk dinte përse. Një komb i bënes në griçë, kur kujtonte se do vinte te nëna dhe e shkante më të poshtë e i hapte e mbidhte sitë ca herë, i fshinte lotët me duar dhe kërkonte të rinte sikur s'kishte gjë. Mos dihte njeri nëpër dier e të thoshte ç'kish nusja, pastaj!

Pesë ditë nuse dhe ajo kish mësuar gjithë odatë se ku qenë, din ku miresh peshqiri, ku vihesh legeni, ku shtrohesh buka, po prapë vetja i dukesh si botë. Si botë, dhe i dukesh sikur nuk do mësonesh kurë ati. O zot dhe dridhesh e tëra. Do vete te nëna dhe gëzonte. Në darkë do vinte prapë ati, i dridhesh zëmra dhe këmbët s'i kishin fuqi. E mblodhi veten. Një derë u-hap. Dolli teto Ruhua, ecënte nëpër divan me atë të vështruar të vrërët që e tremte një çikë nusen, me atë të ecur kadal kadalë që Xhemileja rinte gjithënjë mbi gjëmba e i dukesh sikur do ta gjente në një punë që ajo s'e dinte ta bënte. I

dukesh se ajo plakë, që gjer atë ditë nuk i kish thënë një fjalë të keqe, i këndonte në ball gjith ato që nuses së re i shkonin në mënde dhe kur e shihte përpara nguqesh në surat.

E madhja e shtëpisë vuri ujët të afroresh dhe kur u-bë nusja hiri në hamam dhe u-la. Pastaj, veshi sadenë si në lilak, atë që deshi katënxhika. Krehu mirë të di kosat dhe lidhi një gaz të mirë me huja zimbile-zimbile. Si mbaroi së veshuri i puthi dorën vjehrës dhe kunatave të saja që kishin ardhur që mbrëmane për t'i përcjellur nusen në të parë.

- "Nuse, në boshta vur dhe saden e nusërisë. Nga pasdrekeja, po të bëjë koha e mirë vishe që të të gëzojë dhe nëna" i tha e madhja dhe ajo uli kokën dhe e shpuri në vënt fjalën e vjehrës. I bëri robat palë palë, i vuri në boshta të mirë. Atë kohë erdhi Merushija me djalin që e ndukte nga dora. Kish ardhur i përçarë Mustafai, e sitë mbushur me lotë. Nëna e mirte me të mirë "heshtë" i thoshte "se do veç tek babai i nuses" dhe i ndreqte këmishën përpara "shi, të marça sëmundlën se mos bëç gjë të liga atje. Dëgjon, se mua ma thotë zogu. Ja thotë pastaj babajt dhe bashkë ku futemi. Per ti më zbon nga shtëpia dhe mua". I fshiu lotët. I krehu dhe një herë leshrat, i mbërtheu pallton përpara dhe i lidhi gjalmën e këpucës që i qe zgjidhur që në udhë.

Nuse re hodhi ferexhenë e mirë. Hedo evgjitja vuri më parë kokorethin në kokë, pastaj boshtanë e mirë dhe prite në dëndivan. Xërmoi shkallat Xhemileja. Tek dera u-zuri dorën së gjithave e me Mustafane pranë, me evgjitkën përpara u-nis për në derën e babajt.

Evgjitja përpara.. dhe nusja me Mustafanë nga dora ecnin udhës po udha Xhemilesë i dukesh e gjatë, e gjatë e sikur nuk do sosesh kurë. Këmbët nuk i dridheshin si pesë ditë më parë. Sitë nuk i mbante ulët e nuk lëshonin lotë si atë ditë që la nënën. Gazi i kish dalë mbi roba e një gjë, vetëm një gjë mendonte tani sa të sosesh.

Ecënte dhe kokën s'e kthente as andej, as këndej. Vetëm vështronte me bisht të sirit. Veshët i mbante të ngrehura dhe dëgjonte se ç'pëshpëritnin nëpër portëra: "nuse Mirteza agajt vete për të pestë...ajo që u-duk si drita?... vajza e Haxhi efendiut" e largohu kjo e mbidhu një portë e një tjetër afër saj hapesh "Xhemileja kjo mi?... ajo më duket" Ec' e më poshtë "vajza e teto Qibros kjo... duket. E gjatë si nëna... për të pestë. Po ai djalë që ka nga dola i kujt është?... I Merushes..."

Xhemileja ecënte dhe i hapte sitë e i bënte katër nga ndënë peçeja. Kur njihte një shtëpi i dukesh vetja e lumtur. Ja ajo e xha Tahirit. Mbase Aisheja e vështron nga prapa kafazit. Dëgjonte një zë që e njihte i dukej sikur kësaj i flite dhe i vinte t'i hidhte duartë në qafë. Dhe gurët e udhës i dukeshin sikur i thoshin do veç tek nëna... për këtë gëzon...për këtë gëzon.

Eci e eci, dollari në krie të udhës. I hidhesh zëmra përpjetë nga gazi. I luante gjithtret e dorës brënda petës së ferexhesë dhe me zi mirte trimë. Aferojti! I u-drodhën këmbët dhe sitë iu-mbushnë me lotë. Ja udha e ngushtë...

ja sheshi i vogël... ja fiku i egër. Një jetë i dukesh sikur s'i kish parë.

Eci e nga dora çelo Mustafanë. U-afrua, më shumë tek sheshi i vogël. Ja, di porta, një andej, një këndej. Njëra m'e madhe, tjetra m'e vogël. Ja, të di sufatë e portës së saj. Sa herë qe ulur ati, sa herë në qindi kish ngrënë bukë me djathë. Sa herë e vogël kish lojtur me klluka. Xhemileja ecënte dhe ngrinte kokën lart. Ja, muret e shtëpisë, kafazet e odasë së dimrit, andej nga vështronte se kush shkonte udhës.

- "Erdhi Xhemileja" uluriti Shanaue e vogël, me bukë e djathë në dorë. Dëgjoi zëra nëpër avlira. U-gëzua shumë, se erdhi në shtëpinë e babajt! Atje ku kish lërë e qe ritur. Porta u-hap. E para doli teto Qibrua, hallat, tetot... Pa në mes të ture ndërte kokën, që të shikonte, motërmaja e saj, Zulua. Ajo që s'kish lënë këngë pa kënduar. Të gjitha e pritnin me krahë hapët.

Vajza-nuse kapërceu prakun e portës, ngriti peçenë e të gjitha i u-huallnë, kush ta puthte më parë. Njera e pjete "si je Xhemo?" tjetra "si shkove Xhemo?" Po vajza nuk hapte gojën e të qeshte. Ishte e urdhëruar, nga dora kishte çelo Mustafanë, pak më tutje Hedo evgjiten që në mes të avlisë i muarnë boshtanë nga koka.

Të gjithë u-ngjitën sipër në divan. Xhemileja hoqi ferexhenë dhe veshi një sade të ditë. Mëngjes qe, e njeri s'vinte atë kohë. Vate drejt e në odan e madhe. I puthi dorën babajt. U-pa me vëllezër.

Shtëpija e Haxhi efendiut qe gjithë gaz se kish ardhur vajza nuse në të parë.

Hedo evgjitja iku, Mustafai i vogël doli jashtë me shokë që gjeti ati dhe tani Xhemileja flite pa frikë. Qeshte e kuvëndonte si më parë. E bënte shakara me Zulon. S'kishte njeri nga të burit pranë. Sa rin një çikë ulët, ngrihesh. Vente andej... Hapte, mbidhte diertë. Hinte nëpër odara. Si më parë. U fut në odan e dimrit, ndreqi çiltenë e krejt që rinte shtrëmbët, uli perdhëtë. Vështroi një herë nga penxhereja jashtë. Reze dielli kishin hirë ati dhe në një rëze "Bardhushija", maçja e shtëpisë flinte. E mori në duar, gëzoi qimen e bardhë, i friu me frimë dhe ajo vënde vënde hapesh e i dukesh lëkura e prapëbënesh e shtruar si më parë. Maçja bënte rën rën rën, i hapte e i mbidhte sitë dhe i fërkonte gjurin me kokë. Xhemileja si e gëzoi mirë, e vuri prapë te vëndi, në diell dhe doli nga odaja. Tatëpjetë shkallave e përposh. I dukesh vetja çudi. Ecënte, po i dukesh si kur do t'i dilte vjehra përpara... vjehri... o Nexhipi që e vështronte gjithënjë me bisht të sirit. Ngrinte supet dhe qeshte me vete, duke tundur kokën. S'qe në vete! Hiri në qilar. Teto Qibrua e ndoqi nga prapa dhe i tha "vajzë të keqen do një çikë gjë për të ngrënë? S'ke uri? E pò mirë, një thelë bakllava." Pa mbaruar mirë ljalën, hapì dollapin, kreu një thelë dhe ja vuri përpara. Ç'të bënte nëna, kanaqepste vajzën, jo se e kishte të pa ngrënë, jo, jo Zoti mos e dhëntë kurë, po i vinte mirë. I dukesh sikur do vinte një çikë mish e më shumë e më tani që kish kulluar në këmbë si qiriri. Mirë thonë kur ha fëmila nënës i bënet gjak.

Xhemileja nga një anë zuri të hante, nga ana tjetër i përgjigjesh nënës kur e pjeje. Si i gjeti të shtëpisë? Mirë... Vjehri, vjehra?... mirë. T'i thosh vajza nënës për ata të vështruar të teto Ruhos që e trëmtë? Jo... jo... më mirë ta mbante në funt të zëmërs. E për plakun që qe gjithënjë i vrërët e s'flite kurë me njeri. Jo... jo... më mirë ta din ajo vetëm. Pastaj s' dihesh mbase s' qe ashtu si e pandehte kjo. E pse t' i ngrinte mënden nënës? Po për Nexhipin që dukesh i urtë e që kishte frikë nga nëna ta vështronte në si, po kur e gjente vetëm i bënte buzën në gaz. Jo... jo... sa e marë. Çila vajzë i thotë nënës të tilla ljalë. Këto s' thuhën se është turp... Mirë... mirë nënë... të gjithë të mirë... pastaj... shpejt... po prapë mirë... mirë. Teto Qibrua e vështroi në si, se mos t' i fshihte gjë. Po nuk kuptoi e mori frimë thellë.

Xhemileja mori di a tre kapshata sa t' i bënte hatërin nënës dhe dolli në avli. I u-afrua Mustafajt dhe e pjeje "Çelo Mustafa u mërzipte gjë? Të mori gjë urija?". "Jo, jo nuk kam uri, dua të joz" dhe i gëzuar dolli te porta me shokë. Kjo u-ngjit sipër.

Draka... të gjithë bashkë hangërmë bukë. Qenë të ftuar të gjitha hallat, tetot dhe xhaxheshat, Zulua me nënë. Ato hanin e flitnin po zëri i Xhemilesë dëgjonesh më shumë nga gjithë "Çelo Mustafa do një çikë tjetër?" dhe i vin përpara një qifqi. "Do një thelë bîrek, të ta vë këtu në anë dhe ta haç kur ta duaç?". Eja teto Qibrua i krente një nga mesi i tepsisë. Të gjitha më ç' ti bënin djalit të vogël. Zoti na ruajtë nga të vogjëlit. Të ven në shtëpi e të thosh se atje ku vajta nuk ma vunë veshin, ç' i mbetesh pastaj Xhemilesë me nënë? Kur u-ngrenë nga buka, nusja e dajko Nexhipit i lajti duartë, nëna e saj i mbushi xhepet me arë e me bajame. Tek zuri të dil në avli prapë Xhemileja e ndoqi nga prapa "Çelo Mustafa do të veç gjë andej?" dhe i tunte kokën "dëgjon, të më thuaç. Mos ki turp" dhe pësh pësh në vesh.

Nga pasdrekeja Xhemileja u-vesh një copë herë me sadenë e nusërisë dhe nëna s' e la të dilte derën. Bënte ftohët. Po të mirte ndonjë zabavë? Dhe ajo i lipsesh. Puna s' kish mbetur për këtë se kishte plot duar andej. Gaz të kishte e të punonte atje ku kish vatur e vihesh re. Zulua i rinte pranë dhe vesh më vesh se ç' thoshin, se ç' thoshin njeri s' ja u mori vesh. Gjithënjë qeshnin. Kishin kohë pa u-parë ato të dija që piqeshin tre katër herë ditën.

Pak nga pak zunë të vinin gra, të gjitha ato që qenë ftuar në dasmë, me nga një peshqesh.

Qindija dhe koha u-prish. Re të zeza në qiell dhe koha u-vrër shumë sa që dukesh sikur do zinte shiu. U-vra teto Qibrua. Edhe shiu lipsesh. Mbeti nëpër penxhere e një çikë e një çikë vështronte kohën. Iknin retë nga një anë, hapesh qielli bënte buzën në gaz kjo. Mbushesh koha, vrërësh kjo më shumë akoma. Mbi gjithë të tjerat u-ngre dhe një erë e ftohët që të ngjethte n' oda brënda dhe degët e pemëve tundeshin. Le të frinte, po shi mos binte, sa të vente Xhemileja në shtëpi. Të qe për nënën e kishte për ta ngritur që atë kohë, po si ta bënte këtë? Evgjitija pa ardhur pastaj. Po sipër n' oda kuvëndonin shtruar,

Teto Ruhos nuk i rihesh në një vent. Nënji një çikë me gra dhe u-nda nga shoqet. Erdhi përposh, vuri bakllavanë e madhe, që ja jepnin nga shtëpia në një kanistër dhe e mbushi me pemë anë mb'anë. Në kanistra të tjera më të vogëla, vuri tepsitë e tjera me t'ëmbëla. Ishin pëshqeshe, dërguar njëra e tjetra. Në një kanistër të madhe vuri gjithë copat, xhurapet etj. Florinj e hunaza i futi në një kuti që me kohë dhe ja vuri në xhep vajzës: "dhe ki mënden" i tha "s'e mos t'i humbasç..." Tek froni kumbisi një jemeni të madhe me pemë.

Erdhi evgjitija për të marë nusen. I qe bërë hunda si palltëxhane dhe "shpejt" tha "se mos na zërë shi. Zonja Ruho nga frika më dërgoj më parë". Xhemileja u-ngre. Nëna i veshi përposh një pallto të shkurtër. Kjo hollri ferexhenë dhe dolli në avli. Të gjitha gratë i vanë pas. Nëna i vuri boshtanë e mirë Hedo evgjites në kokë dhe sitë i mbushi me lotë. Hamallët muamë kanistrat e tjera e Mustafaj jemeninë me pemë.

Xhemileia me Mustafanë nga dora u-nis për në shtëpin e burit e nëna me Zulon e përcuallnë gjer te kalldrëmi tutje. Ajo hidhte ca çape e kthente kokën sa erdhi në krie të udhës.

Dielli kish ikur nga shtëpia e Haxhi efendiut dhe një hije e lehtë kishte mbuluar ballët. Malat e maleve e kalaja e Shëndrijallës shquanin mirë se retë qenë larguar dhe venin tutje, nga pjesa e sipërme e Gjirokastrës. Grika e Tepelenës u-qërua, po era frinte e mala e hundës së Mustafajt i u-bë si qershë e kuqe, e ballukat përpara i uleshin e i ngriheshin dhe hundët zunë t'i kullonin. Bënte sa bënte dhe i rufiste dhe i lodhur ecënte dhe thoshte me vete sa të vete në shtëpi, të shoh se ç'më kanë vënë në këtë jemeni që rëndon kaq shumë.

Erdhën tek fura dhe Jaçia i zi si gjithënjë pinte cingar te dera dhe të vogjëlit që lonin te sheshi përpara, lanë lodrën dhe uluritën "erdhi nusja" e me vrap për në shtëpin e Mirteza agajt. Mustafaj donte të vente me ta po Xhemileja nuk e lëshonte nga dora. Di çape më tutje, erdhën në shtëpi, hijti n'avli dhe atë kohë nusja ngriti peçenë. Vate drejt te vjehra, i puthi dorën. Pastaj me radhë së tjerave.

E zonja e shtëpisë mori një nga një brënda të gjitha kanistrat. I shpuri në divan sipër që t'i shinin ato që pritnin. I u-afhua teto Hasibeja dhe e ndihu. Teto Ruhua mbushi duartë me zariko dhe i ndau në të vogjëlit që pritnin te krej i shkallës.

Merushija mori Mustafanë dhe e shpuri n'oda të zjarit. I hapi jemeninë, i pa pemët, i mbushi xhepet me arë e me bajame, se plot, plot i kish vënë xhiko krushka. Të tjerat i futi në dollap dhe zuri ta pjeje "Si shkove sot? U-mërzite gjë? Ç'hangre në drekë? Të pëlqien gjellët?" Ai s'flite fare. S'i haronte bacën që i kish futur në mëngjes dhe që e kish zënë me cimba udhës, kur qante. Po, po nuk i haronte dhe ja kishte për të thënë të gjitha babajt.



Merushja kur hiri n'oda të madhe i gjeti gratë që shinin gjërat. Dëgjonej zëri i teto Hasibesë: "Një flori pendeliron dhe një hunazë të florinjte nga shtëpia me gjithë vëllezër. Xhaxhai i math di anapolona... xhaxhai i vogël një copë të mirë për roba dhe një bakllava. Tetot nga një anapolonë dhe halla e vogël një bezelik të florinjte". "Po halla e madhe?" pjeti njera. Xhemileja i foli me zë të ulët xhiko Merushes dhe kjo e tha fort "kanë vënë vulën nga shtëpia e saj. As marin, as japin."

Teto Hasibeja mori gjëra të tjera nëpër duar "halla e babajt një copë beharore, Seqineja një palë xhurape e një bocë me livando." Kush një gaz, kush moskosapune dhe buzla, kush xhurape, jemeni të dorës... dorëla. Plot kishin dhënë po dhe plot muarnë.

Iku dhe e pesta. Erdhi darka. Ishin të gjithë kushurinjtë të afërtë, u-mbluadhnë tok si burat me gratë dhe zunë këngën:

*Ç'u-zu vallija në fshat, dhe çobani në mal lart.  
La vallija vallen, mbani vesh xamareno,  
Se ç'thotë xamarija.  
Tha çobani dua bukë, tha vasha i shpie unë.  
Ri vasho sonte këtunë.  
Nukë ri more çoban, se kam burënë nizam,  
Xhoku dëgjon pa më ndan.*

Kënga kreu këngën. Zunë të ditën:

*Shtëpit' e bardha karshi,  
Një vajzë me si të zi, hin e del nëpër avli.  
Lum nëna që të ka bërë, të ka bënë moj ballë-hënë,  
Si hëna pesëmbëdhjetë, kur del ti shalltisen djemtë.*

E kështu dhe të tretën:

*Shkon i riu më një plak,  
Që të di vejnë për pashk, që të di vejnë për pulë,  
Gjenë çupënë n'udhë.  
Tha plaku do ta mar unë, tha djali jo ti po unë.  
Tha çupa se dua plak, i ranë dhëmb'e dhëmballë  
I tha dhe plaku një fjalë  
Ri çupë të të qaj hallë, të të thom si më ka gjarë.  
Keshë një kalë të bardhë, më ktheu kali samarë,  
Më theu dhëmb'e dhëmballë.  
Kishë qënë millonçchi  
Friu era miellitë, më zbardhi mjekr' e mustaqe,  
Sa s'më mbeti fill' në faqe.*

Pijtin dhe një çikë tjetër burat. U-dehnë dhe zunë këngën bashkë me gra:

*Ku më fjetë sonte, moj Manushe zajme?  
Ku më fjetë sonte, dallandushe zajme?  
Ndënë qoshk përposh, nën'e zeza nënë  
Ç'ëndërë pe sonte, moj Manushe zajme?  
Ç'ëndërë pe sonte, dallandushe zajme?  
Paçë oj nëno ç'paçë, paçë tre jaranë.  
Paçë tre jaranë, tre pişqolla ranë.  
Tre pişqolla ranë, shoq me shoq ç'u-vranë.*

U hiri lezeti më shumë sa kënduan dhe pas buke:

*Zonja ne sarajeto, thom t'i vete apo jo  
Thom t'i kërkoj faqeno, thom t'i vete apo jo.  
Faqenë e kam për vete, ik o bej të zënçin ethe.  
Faqesë i u bëfç kurban, ja ruaj beut që kam.*

*Zonja në sarajeto, thom t'i vete apo jo.  
Thom t'i kërkoj kaçono, thom t'i vete apo jo.  
Kaçonë e kam për vete, ik o bej të zënçin ethe.  
Kaçosë i u bëfç kurban, ja ruaj beut që kam.*

*Zonja në sarajeto, thom t'i vete apo jo.  
Thom t'i kërkoj gushëno, thom t'i vete apo jo.  
Gushëno e kam për vete, ik o bej të zënçin ethe.  
Gushësë i u bëfç kurban, ja ruaj beut që kam.*

Pas kësaj Ustrefi zuri këngën e tij. Për inat të gruas. Pëlcite ajo kur ja këndonte:

*Vajta një ditë në krua,  
Të më din e zeza grua, s'i m'u-bë palltua mua  
Un të di aizi aizi, që kur s'të kam në shtëpi.  
Un të di oi varfëro, që kur s'të kam afëro.*

Mehmeti zuri tjetrën, që ta bënin më shumë me inat nusen e Ustrefit. Ajo shkumonte fare.

*O moj ti që s'të do buri, pa dil një çikë te muri.  
Ise ti, ise kunata, ja e holla, ja e gjata.  
Ja e holla si fisheku, ja e gjata si difeku.*

“Edhe një këndonë” u tha tetë Ruhua “dhe të biem pastaj. Eshtë mes i natës”. Kur nusja hiri deren me tepsi me filxhane Nexhipi e veshtrioi në si dhe Ustrefi i këndoi:

*Shoqeni, motrami, ç'është buri në shtëpi,  
Kucuri në buhari, nat' e ditë pi raki.*

Zot' i im të preç rakinë, se do na priçë shtëpinë.

Qeshnë të gjithë bashkë. Kënduan dhe një tjetër:

*Ç' u-niçë për Mesollonjë,  
Dolla moj mike moj zonjë,  
Moj gushë-bardha beronjë  
Sa vjet ke bërë në Konjë,  
Dolla moj mike, moj zonjë,  
Moj gushë-bardha beronjë,  
Katër vjet bëra në Konjë,  
Dolla moj mike, moj zonjë,  
Moj gushë-bardha beronjë,  
Shtatë vjet në Mesollonjë,  
Dolla moj mike, moj zonjë,  
Moj gushë-bardha beronjë.*

dhe pas kësaj u-ngrenë. Ranë për gjumë. Për pak zuri shiu. Pikat binin mbi drasat e çatisë dhe frap e frap vetëtimat.

Era frinte dhe degët e pemëve me një thiheshin. E bumbullimat dëgjoneshin njeri pas tjetrit dhe shiu sa ven e binte me të math. Brënda, të gjithë të lodhur i zuri gjumi me një herë.

## DASME... SA U-TUNT JETA

Iku dhe e pesta ditë. Të gjashtë në mëngjes erdhën njerzit e vajzës, babai me djelm, në shtëpin e Mirteza agajt dhe teto Ruhua i priti mirë. U-vuri bakllava përpara dhe kur ikën u-tha gjithë ato tjalë të mira për nusen e djalit të saj të vetëm.

Shirat zunë dhe e vunë në radhë. Në shtëpin e Mirteza agajt hinin e dilnin gra për të uruar. Nuse e re i prite me buzë në gaz dhe u-binte kafënë dhe tek hin e dil vjehra hidhte sitë dhe kësaj i shkonte një të dredhur që nga mala e kokës gjer në funt të këmbëve. I dridheshin duartë. Sa të mësonesh. Nuk shkuan shumë ditë dhe zunë nga davetet, një natë të dajkua i math ku u-gdhinë me këngë e me valle. Një natë te halla e vogël, pastaj në teto me radhë. Në funt fare te dajkua i vogël, sa i erdhi djali nga Saranda. E po për dasmë s' u-gjënt po të pakën tani t' i gëzonte. Edhe atje u-gdhinë me këngë. Kudo gaze e të qeshura. Gëzonin Nexhipin me nuse dhe ditët iknin dhe s' i kuptoje fare.

Po davetet u-mbaruan dhe nusja u-shtrua në shtëpi. Zuri nga punët, sot një të lehtë e nesër një më të rëndë. Pak nga pak shtëpija e re i dukesh si e saja dhe kur hidhte këmbën dinte se ku e vinte e ç' kërkonte. Sa herë që vjehra

bënte një punë, kjo hapte sitë ta shihte që t'i vinte pas. Si e donte odanë të fshirë, si i vinte gjërat, që kur ta bënte kjo mos t'i luante nga vëndi. Nga një herë, në kohë të darkës ndërte kokën nga penxhereja dhe vështronte jashtë. Nuk shihte shtratin e erdhisë, as pusin, as derën e vogël që shpinte në kopsht po një avli, anë mb'anë me kuti me lule që vetë teto Ruhua kur ngrihesh dielli u-hidhte ujë që mos thaheshin si do që të paka kishin mbetur nga të ftohtit.

Dasma u-mbarua dhe nusija zuri nga jeta e re, po njerëzija fjalët moj të keqen nuk i la. Kush u-martua dhe s'u-gëzua? Dasmë pa mishra s'bënet, dasmë pa hatëre të mbetura s'ka. Vërtet kërcien e kënduan një javë të tërë, e me një milë të mira po teto Neliseja ja vuri në xhep teto Qibros që s'i thiri vajzën e vetme me lëmilë për natën e kënjat. Ajo s'ish keq për një darkë bukë, po nikoqirja nuk duhesh ta ndante nga shoqet se s'gjë më e largët nga të tjerat. Po ajo që i bënë Ifos së Lutfullaut, ç'qe? S'ellogati fare teto Ruhua. As nderoi dhe kur e pjeti të shkalla me zi hapi gojën. Zonja në martonte djalë dhe s'i pëlqenin ngjizil e burit më mirë mos t'i thrite fare. Pastaj e vunë për të ngrënë në sufran e ditë. Mirë që s'e lanë fare në të fundit. Pa le që një djep s'i gjenë për djalin q'e gdhiu në duar si qeni gjithë natën. Po dhe teto Xhevros i kishte mbetur hatëri. Vërtet e kishin gjithë javën, e nderuan po të drejtën e donte nusen se dhe ajo e shtëpisë qe. Mos kishte tjetër, pa familë, një çikë kushurirë nga nëna binte. Vetëm për natën e dhëndërit! Qe dhe dasmë e madhe, të thuaj sa për ashtu. Këtë s'e bëri mirë nikoqirja. Pa le të xba Ustrefi haruan pa thirur plakën. Vërtet e ngulur e s'ngrihet dot nga vëndi, po prapë ajo ta bënte të sajnë, pa kjo s'vinte gjë.

Shtëpi e Mirteza agajt dhe ajo e Haxhi efendiut u-bënë krushq. Pastë këmbën e mbarë ajo nuse e mbushtë shtëpinë me djelm atje ku vate. Dasmë të madhe bënë po Haxhi efendiut e dëftoi neqesllëkun e tij. Vërtet palë i bëri, po jo no një më të mirë nga shoqet. Si gjithë bota e pastaj se mos kish vajza të tjera. Mirë thonë kush ka shumë do më shumë e i dridhet dora edhe për një lekë. Le t'i ruajë, le t'i ruajë e t'i marë nga prapa atje ku të vejë. Ka di djelm po dhe vajzën mos ta ndante.

Po në shtëpinë e Mirteza agajt ç'qe ajo që bëri teto Ruhua? E thonë grua me mënt e citë tru. Nuk u këru grave stromë që të flinin, as jorgane me se të mbulonëshin? U-gdhinë kaq gra mbi mindere me bar që u-vate mesit? A po s'bënte dhe ftohët. Ja-, Rehon e zuri një kollë, e shqeu e nduki. I vate dhe një gjak nga hundët sa tha se vdiq. Kaq ditë ndënjë rënë. Ta dinte ajo kështu s'kishte për të vatur për një milë vjet. Në duan të bëjnë dasmë, të mos u dridhet dora për një gjë të vogël, se nuk ja u hante njeri robat e ture.

Në shtëpinë e Haxhi efendiut u iku vajza nga sitë. Nëna e paloi, e martoi dhe e gëzoi me gjithë të mirat. Po qe frirë nga evgjitkat. I kruajtin, i kruajtin-shtëpinë. Moj s'i lane gjë pa i marë. Moj mirë kjo, po ato kushurirat që një javë të tërë erdhën e u shtruan e nuk zunë punë me dorë! Po kësaj ç'i thonë? Turp s'qe, se nuk ishin në botë. Po vetëm për thela. Thiri nusen e djalit

të dajkos e s'i erdhi. Pse? Pse s'e thiri për gjithë javë. "Kurë mos artë" tha teto Qibrua kur e mori vesh. "Nuk e dua. Të mos më shkeli më në shtëpi. Kur s'më erdhi të më gëzonte Xhemilenë qe me zi e kam këtë vajzë ç'e dua! Të mos më vijë se e kam për ta zbuar". Vërtet kjo nikoqire e shtëpisë, po burit nuk i dilte përpara. Ajo qe një këmbë më jashtë nga të tjerat. Pastaj njerzit e burit janë gjithënjë me të afërtë. Këtë duhet ta dinte ajo se dhe për vete është e martuar e me një-radhë fëmilë. E ka tru në kokë se s'është e marë. Mirë edhe kjo me të tjerat. Nuk prish dhe aqë punë.

Po teto Ruhos ç'i bënë ashtu? I kishin vjedhur perdhën e odasë së dimrit? Hulera e zëntë atë që e mori. Sa fëlliqi dorën pa ç' do ta bënte, se kjo as zengjino bënesh, as fukara s'mbetesh. Po teto Nurkua thirur me burë e me djalë mos t'i bjerë peshqesh? Kjo kur martoi vajzën e madhe shpuri, kur martoi djalin, prapë. Ra lehonë Mergjuzeja kaq kutija me llokume i vate. Po këndej e tutje t'i thahet dora gjer në rëzë në shpuftë prapë. Jo se kjo kishte mbetur keq për ndonjë okë zahar e kafë ose tjetër gjë po të bëjnë budalluqë. Moj mirë kjo po kunata e vogël sepse t'i linte ca dite vajzat e mbejdha ati nuk qe gjë, se në shtëpinë e dajkos qenë. Ato vinin e shtroneshin me parë netë me radhë jo tani që qe gazi në dhe. U-gdhi e hëna në mëngjes, u-ngre nëna me vajza, mblyadhnë gjërat, i vunë në boshta, u mblyuan dhe "do t'ikim" thanë "kemi lënë shtëpinë vetëm e djemtë të lodhur duan të hanë e të flënë" e iknë me të huajat bashkë. Moj nuk ja u-donte punën, në u shkante një gjë e tillë në mënde po te pakën edhe për si e për faqe të botës. Të rinin me nusen që e varfëra s' dinte nga të vente se të gjitha të tjerat u muarmë me punë sa prunë shtëpinë në udhë... Po ç' të thotë njeriu se i ka dhe njerzit e tij. Keto kanë punuar gjithë jetën, po s'munt të vinin daulen. I zoti e di ku i pikon shtëpia, mirë thonë.

Teto Qibrua me teto Ruhon u-mbidhnë brënda kaq kohë që të pritnin gratë se njeri s'kishin lënë pa ftuar. Pastaj ku kanë qënë gazet dhe vdekëlat vatur kishin. Në u-qafçin i vret Perëndija. Po s'u erdhën që të gjitha. Kur qe dasma u-shtruan një javë të tërë, hangërnë, pijtin. U-mbarua, kthien krahat e s'u-dukën më. Kur i haruan aqë shpejt gjith' ato të mira? Apo s'i mbajtën në pëllëmbë të dorës e kur donin t'u-thoshin ndonjë fjalë, uflitnin sikur u luteshin. Nga ana tjetër lëshuan dhe fjalë posht e përpyetë.

E kush s'bëri dasmë? Ana e djalit a po ana e vajzës? Kush tha se nuk i pritnë mirë, si burat dhe gratë? Si thanë, nuk bënë dasmë të madhe? Jo, jo këtë s'e tha njeri. Bënë dasmë të madhe, një javë të tërë, me këngë e me valle. Dasmë... sa tunt jeta.

## F U N T

## DUKE MBARUAR...

Vëndi ku ke lerë e je rritur është dashuria e parë që hedh rënjë në zemrat t'ona. E shkuara, ëndër e bukur. Qyteti i vogël, botë e madhe e që s'ka shoqe për të miturin që hedh këmbët e para në jetë. Kujtime të pa haruara të moshës së parë që kalojnë përpara syve si ujët e kulluar të lumit që rjedh, gjithënjë rjedh e s'kthehet më. Botë e perënduar, zhdukur pak nga pak me rezet e fundit t'asaj kohe e duar, zhdukur pak nga pak me rezet e fundit t'asaj kohe e që prej saj lindi një botë tjetër. Shkëmbinj besime të kota, zakone, mbeturina të kohëve të para u-rëzuan nga tufanet e jetës dhe u lanë vëndin ditëve të reja ku mbruhën hidhërime e gëzime, në listë me jetën që është jeta vetë.

Gjirokastra - bota e madhe, pa funde që s'kish shoqe për moshën t'ime të parë. Gjirokastra trime, anë mb'anë me shkëmbinj e udhët plot gurë. Gjirokastra e përpjetëlave dhe e tatëpjetëlave. Gjirokastra plakë e regjur në njerime e varfëri, në ditët e nxehta të verës që afshi i ngrohët del nga drasat e çatime e djersa kullon nga balli i atij që me torvë në kraha ngjitet për në shtëpi, në netët e ftohta të dimrit, rreth zjarrit e që nga jashtë dëgjohet fëshëllima e erës së tërbuar që thyen degë e pemë bashkë, e gjëmon nëpër mazgalle e bacxhara, ndjekur nga prapa nga oshëtimia e hubullimave e drita e vetëtimave dhe shiut të madh që bie i pa prerë. Gjirokastra e kujove dhe e këngëve që buçitnin një herë e një kohë nga dritaret e mëdha të shiëpive, buzë përronjve, ndënë hien e rëndë të kalas s'Ali Pashës, anës e anës udhëve të shtrëmbëta me një mijë të hyra e të dala, rëzë kodrave, shtëpi që ngajjnë njera mbi tjetrën, shkalla shkalla nga maja e shkëmbinjve të Këcullës që duket sikur e mban qytetin në pëllëmbë të dorës dhe q'andëj përshëndet malet e Lunxhërisë, në mëngjes kur lind dielli dhe në mbrëmje kur përëndon, me rezet e fundit sa humbasin fare.

"...Sa u-tunt jeta" pasqyrë e një bote të perënduar, shtegu i kapërcimit nga vajzëria, në mes të këngëve, në nusëri për ta hedhur gruan prapë në vargonjtë e rëndë të robërisë së fanatizmit.

\*  
\* \*  
\*

Shumë vjetë më parë, kur ne s'kishim lerë, kur nënat t'ona ishin vajza të reja, në Gjirokastrë jeta ishte e ndarë më dysh: ajo e burrit dhe ajo e gruas. Dy jetë, bashkuar e para për të gëzuar dhe e dyta për të robëritur.

N'ato kohë, që një ditë nuk ndryshonte nga tjetra gëzimet ishin të pakta gjithashtu dhe zbavitjet. Martesa zinte vëndin e parë dhe në një rasë të tillë jeta mirte tjetër ngjyrë.

Martesa, tregëti për të dy par'anët. Nëna kërkon t'i japë burrë të pasur vajzës e në shtëpi të mirë e nëna tjetër do të martojë djalin, të marrë nuse për punë të shtëpisë e për të qeverisur të mëdhenjtë. Dy të rinj, që nuk njihen, nuk shihen, një ditë

bashkohen, se ashtu është gjëndur dhe njeri s'ka mbetur pa u martuar.

Nëna e vajzës rri me veshë ngrehët e me sy hapët. Kur dëgjon që një djalë nga shtëpi e mirë zë nuse - nuk vihet re djali sa vihet re shtëpija dhe pasurija - vë me kurshqi për vajzën e saj. Krushqarja vete tek nëna e djalit, tek një teto ose hallë, me lutje mos dali fjala, i thotë emrin e vajzës, e lëvdon dhe nëna e djalit e hedh në tok. Se janë vajza të tjera të vajtura me krushqi dhe ajo si e mat mirë punën, pyet andej këndeje, zgjedh njerën "ajo që ta ketë kismet, se punët e Zotit!" E lum ajo. E lum nëna e saj që hoqi një ferë nga dera - që është vajza -, hoqi një barë nga krahat - se vajza për nënën është përdhe në sy.

Vajza fejoheh e me një herë hyn në urdhërin e shtëpis së burrit. Del pak, ose po të mos duan nga ana e djalit nuk del fare. Burrin nuk e sheh, as ay atë.

Pas fejesës bëhet nishani. Krushqit vinë dhe kur hanë hasude ose pijnë kafe marin lugë, pjata të vogla, filxhane fshehura. Të dy shtëpitë ndrojnë nga një nishan. Gjyrat kthehen të pestën ditë kur nusja vjen në të parë në derën e babajt. Pas nishanit nëna e vajzës e ka zëmren të ngrohët.

Pas nishanit hidhët nigjahu, një farë kontrate duke caktuar një shumë të hollash e cila, në rasë se vajza ndahet nga burri ky i fundit duhet t'ja japi. Vajza atë ditë vë këmbët në ujë të vakët dhe musafin mbi kokë, që të trashëgoheh. Pas nigjahut nëna e vajzës mbledh mëndjen, mer frymë thellë dhe fjalët e botës nuk e trëmbin më.

Dasma bëhet kur duan nga ana e djalit. Kurrë në mes të Bajrameve se nuk trashëgoheh. Fillon ose ditën e diel dhe mbaron të ënjtën ose të ënjtën dhe mbaron të dielën. Niset kënga nga dita e shënimit, tek nata e brumit me mashalla nëpër udhë e me pishë të ndezura të vegjëlit në duar, si nga ana e djalit ashtu dhe nga ana e vajzës. Pastaj dita që qepet kënjaja, dita tjetër që shpihet dhe të vegjëlit kthehen me bukë e lugë në dorë. Nata e kënjajt, dita e fundit që miren sepetet në mëngjes e pas dreke në kohën që ruhet dhëndëri krushkat venë të marrin nusen.

Nusja del nga shtëpija dhe zakonet e besimet e kota shtohen. Pragu i derës përvëlohet me ujë të zier nga frika e magjive të botës. Kur del jashtë e kapërcen prakun me këmbën e djathtë dhe e heq zvara që të martohen të pa martuarat. Jashtë portës një grua i mban një pasqyrë që atje ku të vejë të duket e bukur. Rruga ndrohet prapë nga frika e magjive.

Nusja vjen në shtëpin e burrit. Kur hyn hedh këmbën e djathtë dhe tek porta vjehri i shtie mbi umbrellë oriz me para. Të ketë këmbën e mbarë. Tek dera një grua i lyen dorën me mjaltë, ja fshin mbi derë që të ketë gojëne ëmbël. Në odë i presin kulaçin që gratë hanë nga pak që mos t'u dhëmbi koka - dhe e falin tri herë nga ana e Qabesë. Nusëron nusja në krye të odës, i ngrihet duvaku, i krejnë këpucët ku ka riz e të holla. Në darkë hyn dhëndëri midis grushteve q'i japin mbas shpine shokët. Nusja natën kur flë me bullën, i vënë frën e kalit ndënë jastëk që të jetë me urdhërat në shtëpi. Në mëngjes ha bukë me bullën, lan duartë e i hedh ujë një djalë me ibrik të verdhë dhe kjo i jep dhuratë disa të holla. Shihet paja ku nuk vihet gjëlpërë se mos bëjë vajza.

Shkojnë ditët e para. Të tretën nusja bën karkanaqe dhe të pestën vetë në të parë në derën e babajt dhe kthehet në darkë me bakllava të madhe e me dhurata nga

të gjithë.

\*

\* \*

Mbaron dasma dhe nis jeta e ngaherëshme. Njera ditë i ngjan tjetërs dhe ëndra e shkurtër pak e nga pak bëhet si zëri i një muzike që dëgjohej nga larg e sa vetë e largohet, sa humbet fare.

"...sa u-tunt jeta" është ëndra e shkurtër e pak ditëve të vajzës gjirokastrite që pas asaj, ajo vihet ndënë thundrën e vjehrës, rron ndënë tmerrin e vjehrit, me frikën e burrit që fjala e tij është urdhër për të.

Lulja e re që do dritë dhe diell të lulëzojë zë të vishket nga cipa e zezë e zakoneve dhe e përshtjell mirë e mirë gjer sa vdes e s' i lë shteg të lirë të dalë pa qënë e zonja vetë: ajo bindet për çdo gjë. Martohet me një burrë, plak ose të ri e për 24 orë nuk slet me të dhe kur janë vetëm. Aje e pyet e ajo s' përgjigjet. Shkojnë ditët dhe ajo s' guxon t' i flasë përpara njerëzve të shtëpisë ose t' i japi filxhanin me kafe përpara të tjerëve. E mira e saj është të ngrihet që pa gdhirë, pa zbardhur buz' e malit e të bëjë gjithë punët, përndryshe është vjehra ajo që i bie dyshemesë nga poshtë që të mari vesh se u-bë vonë.

Gruaja që ka lidhur jetën me burrin e saj, nuk e zë në gojë emrin e tij. Ajo fjale varroset me të në var pa dalë kurrë nga buzët e saj nga nëna e fëmijës, që me gjoksin e saj u ka bërë ballë gjithë vuajtjeve të jetës.

Nusja bëhet nënë - lum ajo kur bën djalë e bie në zi shtëpia kur bën vajza - se kur lejnë vajza nxihen qepët - dhe emrin e fëmijës së parë nuk duhet ta zejë në gojë, as që duhet ta gëzojë jo vetëm kur ka një po dhe më shumë se është trup.

Jeta e saj kështu vazhdon. Ajo tek babai vete kur i thotë vjehra. Rri sa i thotë ajo. Ne njerzit e afër të saj gjithashtu. Vesh robot që i thotë e madhja e shtëpisë.

Nusja e re kështu e nis jetën dhe me frikë e mbaron, se për një gjë të vogël dërgohet andej nga ka ardhur, se kur del dera është e madhe po kur hyn është e vogël.

Nga bota e besimeve të kota, të zakoneve, mbeturina të fanatizmit oriental, pas shumë brezave, pas shumë sakrificave, pas shumë të rejave të varrosura së gjalli nga ndryshku i jetës prangat e forta të robërisë së kohës së shkuar me mundime të mëdha më në fund u-thyen. U-thyen për të lindur jeta e re, jeta e vërtetë me hidhërime e gëzime ku gruaja mer pjesë vetë, është e ndërgjegjshme për atë që bën dhe kërkon të rojë krah më krah me burrin e saj, jo e robëruar si një herë po shoqe e vuajtjeve të përbashkëta, të lidhur ngushtë me njeri-jetrin për të kapërxyer shtigjet e ashpra të jetës, duke kërkuar ngrehjen e familjes së mbështetur në ndjenjë e dashuri.

Gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme zuri udhën e saj dhe kërkon të jetë përgjegjëse për vehten e saj dhe të marë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës, kërkon të dijë se ku rron e përse rron në jetë për të drejtën që ka, si pjesë e pandarë e saj që është.



## FJALOR' I LIBRIT

"...sa u-tunt jeta"

### A

**Akllas-i:** copë si e mëndafshhtë.

**U-bë Ali:** gratë u-veshnë si burra për të qeshur.

**Je prishur një allaj** (turq.): je tretur shumë. I dha një allaj pemë: i dha shumë pemë.

**Bën allaj** me të: tallet me të.

**Allonar** (greq.): muaji Korrik.

**Amë:** epmë, më jep

**Ana:** na jep.

**Anagulë-a** (greq.): të vjellur. Më vjen anagulë: më përzihet. Ç'është ajo anagulë ashtu: ç'është ajo e shëmtuar ashtu sa që kur e sheh të përzihet.

**Angjillë-a** (greq.): gjëmb ose spicë. Për një angjillë u-bë ajo: për pak u-bë e kursyer.

**Një angjillë** dha: dha fare pak. **Sa mal' e angjillës:** e vogël shumë.

**Anëlatë:** (përdoret po thuajse gjithënjë në shumës) janë rroba ose sixhade të ngushta e të gjata që vihen mbi mindere ose anës e anës odës së dimrit.

**Anicirë:** të ndotur. Të vjen anicirë: të vjen ndot ta shohësh. Prishur shumë, bënë anicirë: tretur shumë sa që të vjen ndot ta shikosh. Shëmtuar tepër.

**Anteri-u:** jelek me mëngë të mbledhura pak tek supi dhe me kapak një gjisht të gjerë ose më shumë në fund e të ngushtë sa dora. **Anteri pleqerishte:** anteri me harxhe të zeza përpara. **Anteri nusërishte:** anteri qindisur me notra dhe rallë herë me tel. **Anteri hare:** anteri prej cope të mëndafshhtë me lule.

**Arallëk-u:** vënd shumë i ngushtë që mbetet ose bëhet me kohë midis dy drrasash të dyshemeve ose të tavaneve.

**Arrë** për vetulla: arrë e pjekur. Arra piqet me lëvozhgë sa digjet kjo e fundit. Thelbi i arrës lëshon vaj vetë. Këtë e vënë në një kuti dhe e përdorin nusët në Gjirokastër për të nxirë vetullat.

**Asaman** (turq.): të lutem

**Aspo:** çdo të jetë, ç'pret nga ay njeri! (aspo=a se po). Ka di kosa ashër: ka dy gërsheta të trasha. (Përdoret në këtë rasë).

**Azhur-i:** fije të hequra në kambrike a pupulinë për ta qindisur.

**Avgellë-a** (greq.): ushujcë, shushunjë.

### B

**Ball'e** fëmilës: fëmija më e mirë. **Ballët** e shtëpisë: pjesa e përparme e shtëpisë. Në ballë vënt: në vëndin më të mirë. **Ball'** i dimrit: mesi i dimrit.

**Barku** hon: barku i zbrazët. **Barku** plot: me barrë.

**Bosh-oda** (turq.): oda më e mirë. Oda e pritjes.

**Bazube-ja:** dua që varet në qafë, për mos marrë sy.

- Baxha-ja:** dritare e vogël që është në çati në një odë që nuk mund të ketë dritare në mure. Baxhë.
- Bekri-u** (turq.): njeri bandill. i dehur.
- Bello:** qingj. Esht bello: është e urtë.
- Belluz-i:** peliçe kastor.
- Beng-u:** një varg me florinj që varet në qafë. **Bengje** mo florinj: shumë radhë me florinj që i vënë nuset ose vajzat në qafë në dasmë.
- Beronjë-a:** një farë barishte që bëjnë dhe sarma në Gjirokastër. Gushë-bardha heronjë: gushë e bardhë e ngjallur dhe e bukur.
- Beshllëk** (turq.): pesë grosh. Më ç'ti bënte: kërkonte si e si ta kënaqte sa më shumë.
- Bibi:** shkurtim i emrit Zejnebi.
- Bilë-a:** vajzë.
- Bilimbash-i** (turq.): major.
- Bilur-i:** bryll.
- Birinxhik-u:** copë e mëndafshhtë që përdoret për çarçafe e për këmishë të grave
- E la bisht:** ja kaloi, ja shkoi. E la nga prapa. Sa një **bobollaqe:** grua e shkurtër dhe e vockël.
- Bocë-a:** shishe.
- Boshta** e mirë: bohçe prej kadife dhe e qindisur bukur me kllabodon. I jepet vajzës në pajë. U bëra **boshta:** u-shtipa e u-bëra si e plogët.
- Boshtallëk:** bahçë ku janë robat e burrit që nusja ja bie si dhuratë nuses.
- I more shoqetë **bram:** ja a-kalove shoqeve nga virtytet ose nga bukuria. Ja tha **bram:** ja tha fjalën në sy, pa u-ndruajtur.
- Breg-u** i Baba-Manes: bregu ku është teqea e Baba-Manes përmbi kishën Orthodokse të Varoshit të poshtërmë.
- Breron:** bie shi i madh dhe i paprerë. I ranë **brezat:** vdiq për të ngrënë.
- Brezat** e shtëpisë: pjesa e poshtërme e mureve që bashkohet me dyshtemenë që në Gjirokastër gratë i bëjnë vetë dhe shumë herë me ngjyrë tjetër për bukuri.
- Brokollo:** kokra të vogla.
- Broçkolla:** fjalë pa vënd e pa mënd. Lëshon **broçkulla:** flet pa menduar **Broçkollis:** flas kot së koti. Them budallallëqe.
- Buhasi-ja:** stofë prej pambuku nga një anë e shkëlqyer e nga një anë jo. Ka në çdo ngjyrë.
- Buk'e** lugë: bukë me një lugë të drunjtë shkuar në mes që i jepet të vogjëlve ditën e kënajt nga anë nuses.
- Brokërimë:** e shkatëruar.
- Bulçim:** vapë që të zë në grykë e me erë të ngrohtë.
- Bullë-a:** a një grua që gjatë javës e nis nusen në shtëpin e babajt, ditën e nuses e mban nga krahu dhe e shpie në shtëpin e burit. Natën e dhëndërit flë me nusen bashkë dhe në mëngjes ha bukë me të. Pastaj ikën. E paguajnë nga ana e vajzës po më shumë nga ana e djalit.
- Burë-lumi:** burrë ziu. Burrë jo për të qënë.

**Eshtë bushtrë:** është e prapë. Dizet **bushtra:** plot vajza të prapa brënda e të pamartuara.  
**Buzë-pjekur:** e ka buzën me një cipë të zezë sipër nga që ka qënë e sëmurë.  
**Buzlë-a:** napë e hollë dhe e bardhë. Faqol.  
**Buzlë për buzë:** buzlë ngjyer me bojë të kuqe që blejnë nuset në Gjirokastër për të lyer buzët.  
**Buxhak-u:** qoshja si nga e djathta ashtu nga e mëngjërta e minderit afër gjirmës ku dimrit trinë pleqtë. mbasi e zë më mirë zjarri dhe është më ngrohët. Ka zënë **buxhakë:** është plakur shumë sa s' del pazarit ose është i sëmurë dhe s' luan dot nga vëndi.

### C

**Cfongar:** cfyngjer. I shkoi një cfongar sqafill: i vuri passqafill me cfongar në fytyrë.  
**Hane cim, cim:** hante pak nga çdo gjë. Hante sa që të dukesh se hante.  
**Cimbill-i** (greq.): mashë.  
**Cipun-i:** jelek pa mëngë, i leshtë që e veshin çobenjtë.  
**Citë-a:** grep për tantellë ose për çarape. **Citis:** e zë në një vënd.

### Ç

**E çapit, e vrapit:** e shkathët, e gjallë. E zonja dhe e hedhur në punë.  
**Çapraz:** i ngatëruar, i trazuar, jo i kthjellët. Mos e thuaj **çapraz:** mos e thuaj fjalën e ngatëruar. Thuaje drejt. Thuaje hapët.  
**Të çara:** copa dërrasa të holla e të shkurtëra që vihen në mes të druve në zjarr që të mari shpejt.  
**Çarçaf-i:** mbulesë e bardhë që përdornin shumë vjet përpara gratë në Gjirokastër.  
**U-çel nusja:** nuk rri më si e mbirë. Nuk rri si e ngrirë.  
**Çelo:** emër që i vihet për nder nga ana e nuses çdo mashkulli që gjen në shtëpinë e burrit, qoftë dhe djal' i vogël. Më parë thotë çelo pastaj emrin e vërtetë.  
**Çember-i:** faqol, buzël.  
**Çerçive-ja:** dy pllaka të vogla prej hekuri me dy a tri brima ku shkojnë gozhdat, për të mbajtur dyertë dhe dritaret tek muri.  
**Çerve-ja:** shami prej mermeri e qindisur me tel ose me kllabodon. Po të jetë e vogël sa një shami e mbajnë nuset në dorë për bukuri. Po të jetë e madhe e varin në mur për të zbukuruar odën.  
**Çirek-u:** bukë në formë të rrumbullaktë që e nxjerrin vetëm furxhinjtë në Gjirokastër, nga një okë, gjismë oskë deri më tri okë.  
**Çok-jasha** (turq.): rroftë shumë.  
**Çu çu çu:** të folur me zë të ulët e kokë më kokë në mes të grave.  
**Çull-i:** robë e leshtë e me flokë.

### D

**Daf e duf** gjithë ditën: bredh gjithë ditën. Del dëndur.  
**Dambano:** hapur krejt.  
**Darovi:** dhuratë.

**Davet** (turq.): gosti.

**Dej**: pasnesër.

**Dem-Baba-Demit**: prej shumë kohe.

**Demise**: pë i hollë e i bardhë, për të bërë tantellë.

**Heq derën**: mbyll derën.

I **u-derdh** me një herë: i u afruar me një herë. Ri e **derdhur**: rrit drejt. E ka **derdhur** mirë hunazën: e ka punuar mirë unazën. I **u-derdh** si arushe: i u vërsul dhe i foli me inat.

Janë **deti**: janë shumë.

**Dëngëza**: plot.

**Dëndëroj**: i blej më të shpeshtë. I **dëndëroj** udhët: vjen më shpesh, vjen gjithënjë.

**Dëndivan-i**: hajati ndënë divan, në të hyrë të derës.

**Dërëlizma**: fjalë të kota **Dërëlis**: flas ç'më vjen në gojë, pa menduar.

**Dizbai** (turq.) lidhse që lidhen për ndënë gju për të mbajtur kalcat: Tizbaq.

**Kur ngrihet dielli**: kur perëndon dielli.

E **ditë**: nuk është nga e mira fare. E pa n'atë **ditë**: e pa n'atë gjëndje. S'i kanë dhënë **ditë** të bardhë: e kanë vënë gjithënjë në punë, s'e kanë lënë pa punë.

**Divit**: një farë kallamari i gjatë prej tunxhi. Në pjesën e gjatë vihesh penda prej kallami edhe në majë kish një vënd për ngjyrë. Ata që shkruanin e vinin në bres dhe e përdomin sa herë që kishin nevojë.

I **zë dora**: di të qepi, ose i vjen mbarë për çdo gjë. I **dinë duartë**: di të qepi. E kanë futur në **drekë** e në **darkë**: e kanë futur në gatim, e kanë mësuar për të gatuar. I kanë lënë në kokë të bëjë **darkën** dhe **drekën**.

**Bërë si drita**: zbukuruar.

**Duhen keq**: duhen shumë.

S'ka **duk gjëri**: harxhohet shpjet gjëri.

**Dumkë-a**: grusht. E zuri me **damka**: i ra me grushte. E-bë **damkë**: u-ngjall.

**Dupje**: florinj gjysmë pendeliron. Dy napolona e gjysmë ar.

## DH

**Dhangë-a** (greq.) të kafshuar. E **dhangasi**: e hëngri me dhëmbë. E kafshoi.

**Dhez**: ndez

**Dhëmbëshit, dhëmballëshit**: nga dhëmbët, nga dhëmballët (rasë rjedhore).

E **dhifisi gjumi** (greq.): e zuri gjumi me një herë.

**Dhipato** (greq.): një odëzë e vogël që është në fund të odës në pjesën që mbetet e zbrazët nga mbi musandra deri në tavan.

**Dhiple-dhiple** (greq.): palë-palë.

**Dhogë-a** (greq.): dërrasë. Mbeti **dhogë**: ngriu në vënd ose i ra të fikët.

**Dhotur**: rreth rrotull.

## E

**Elbeze-ja** (turq.): veritës, veri.

**Elma-ja:** gëzof i mirë që vihet në duar dhe anës së kondoxhupit, në pjesën që duket nga jashtë. Kush do e përdor dhe për manto.

**Ç'erë të pruri?:** ç'gjë të shtiu që erdhe? **Ç'nevojë të pruri?** Ç'që ata erdhe?

**Erësilë-a:** errësirë.

**Ërimi (greq.):** vënd i shkretë, pa njeri. Vetëm.

## E

**Endë-a:** pjesa më e mirë e miellit pasi sitet. I mora **endën:** sitisa miellin për të parë endën.

## F

**Falem:** më zë gjumi tek ri dhe tund kokën disa herë.

**Fanero (greq.):** hapët, në sy.

I mori **faqen:** i hoqi pushin e faqes me pë. Pënë gratë e fërkojnë me dyllë.

**Farfuri:** enë e bukur që vihet mbi tryezë për zbukurim.

**Fatpadalë:** vajzë që s'ka gjetur burrë, s'i ka dalë fati.

**Fermele-ja:** një farë jeleku që është i shkurtër deri ndënë kraharor, prej kadifeje ose mëndafshi. Pa mëngë.**Fët:** e pa mundur, shpejt, kurrë.

**Fërngale:** zjarr i madh me flakë.

**Fëshnik (slav):** vërsnik, në një moshë, moshatar.

**Fill-e-kat:** vetëm.

Qese e **finjës:** trasje ku hidhet hiri dhe vihet në kazan ku zien ujët e këmishave.

**Fiqir-i (turq.):** mëndja.

**Firë:** mangut

**Hapi fjalën:** lajmin ja u tha të gjithëve. Lajmëroi.

**Flamë-a:** një të kuq që bie në fytyrë.

**Fli në një krah:** mos u-bën merak. Mos vrit mëndjen. Mòs ça kokën.

**Flori manxhare:** një farë floriri antikë.

**Fluturoi:** nga gazi: u-gëzua shumë.

E zuri një **fluturillë:** e zuri një dridhmë, i hyri një farë frikë.

**Frangë-a:** leka

**Frap'e frap:** ngjeshi brumët shpejt e shpejt e me një herë.

**Frakazon-i (greq):** brez prej kambriku që shkohet në rrethin e çitjaneve.

**Frëngëlloj:** flak, e hedh tutje një gjë.

Si **frëngu pulën:** e pagoi shtrenjtë.

I qe **frirë barku:** i kish ardhur inat.

**Frito-ua:** bisht e qepëve të njoma.

**Fronfillë-a (greq.):** kokë-çarje

I **fuckosur (greq.):** i fryrë, i ajtur.

**Fundërat:** Janë muret e shtëpisë gjismë metër ose një metër lart nga dyshemeja që gratë në Gjirokastër kanë zakon t'i lyejnë vetë ose me gërqeje ose me një ngjyrë tjetër për bukuri. Brezat.

**Frutë-a:** përparse.

**Futa** e mëndafshhtë: përparëse ardhur nga Stambolli që ka një vijë të kuqe e një vijë të verdhë. E mirte nusja në pajë.

## G

**Gajtanaq-i**(turq.): punë dore e thjeshtë, që e fut thile me gëp.

**Gajtanaq-i:** një dru i lartë e gjithë shirite që lozin maskat valle nëpër oborrë të shtëpive ose nëpër sheshë.

Ngriti **gajtanaqë:** hapi grindje.

**U bë gamile:** u-nxi, u bë e zezë në fytyrë.

**Gaz-i:** shami e mëndafshhtë që bëhet anë mb'anë me huja dhe e lidhin nuset në kokë.

**Gërnjë-a:** grindje.

**E gërshërës, e gjëlpërës:** di të presë e të qepi.

**E hapte gojën** sa një **kamare:** e hapte gojën shumë.

Njeri s'e ka marë në **golë:** s'ka folur njeri keq për të.

**Golë ka e golë s'ka:** është e urtë, nuk flet kurrë. Nuk dëgjohej një që është një që s'është.

**Gorobis:** punoj rëndë. Bëj punë të rënda. (Përdoret vetëm për gra).

**Goxhuk-u:** thuhesh kondoxhupi në kohë të vjetra. Një farë palltoje e shkurtër dhe e gjërë veshur brënda me gëzof (ngjyrë kafë) e anës e nëpër duar me elma. Me dy xhepe përsipër. Kondoxhupi i mirë e ka qafën kadife të kuqe. Kondoxhupi i dytë, prej cohe të zezë ose ngjyrë kafëje.

**Grarishte:** mjekime dhe barna që bëjnë gratë.

**Graxho:** thonjt' e maces.

I hodhi **grazhdot** në surat: i hodhi duartë në fytyrë dhe e grisi me thonj. (Kur zihen dy njerëz.)

**Gremisem:** rëzohem.

Nuk **gremis** fjalë: s'thotë fjalë të shkarë, nuk rrëshqet në të folur, nuk gabon.

**Grumbullore:** e rumbullaktë.

**U mbluadhnë grusht:** u-mbluadhnë tok së bashku.

Prishi një **grusht** para: prishi shumë të holla.

Erdhi **grusht:** erdhi me një herë.

**Gur'i kafesë:** gurë ku shtypet kafea. Ka formën e havanit po më i madh e cila punohet në Gjirokastër brënda: Gratë e kanë zakon që e vënë në dëndivan më të shumtën e herës.

**Gur'i qumështit:** një farë guri sa një kokër tespi, i rumbullaktë ose vezak e gjithë damarë, si damarët e kraharorit. E varin gratë në qafë që t'u-vijë qumësht.

Mbiftë mbi **gur:** mbiftë kudo e mbiftë shumë.

**Gjeram:** gjer më.

**Di gjëlpërë:** di të qepi.

**Ri mbi gjëmba:** nuk rri e qetë.

**Gjëpora:** gjëra të kota, fjalë pa themel.

**Gjilap-i** (turq.): lëng që nxiret nga petales e trandafilles.

**Gjirmë-a:** pjesa e përparme e oxhakut ku vihet lllamarina dhe mbi të në rëzë ndizet zjarr.

**Gjozdamesën** (turq.): që mos ta hanë me sy.

**Gjulaki** (turq.): livando shumë e mirë.

**Gjuhustër:** grua që flet shumë. Që ka shumë gjuhë. Llafazane.

**Gjumashë:** që lte shumë.

**Sepetet për t'i vënë gjunë:** sepetet plot me roba, sa që të mbylten duhet njeriu të vëjë gjurin e t'i uli. Sepetet mbushur shumë. Pajë e madhe.

**Kur ha e dëndet në shoqe s' gjëndet:** është i mirë kur do.

**Hajale** (turq.): nëpër mend, si në ëndër.

**E ka halë në si:** nuk e sheh dot. Nuk e do.

**Hamorillë-a:** uriq.

**Hane-dane** (turq.): shtëpi e mirë, bujare. Shtëpi me të hyra e me të dala të shumta.

**Hante qeni petulla:** kohë kur gjëri që i lirë.

**Do hapë shtëpinë:** do të marrësh nuse të mirë që do të të nderojë shtëpinë.

**Haxhe të zeza:** gajtane të zeza prej mëndafshi që qindisen peshllit e burrave dhe jeleqet e grave të përzitura.

**E heq:** e vë më një anë. **Heq** udha udha është e gjatë. **I heqin** vajzën: flasin keq për vajzën e saj.

**Hindja-ja:** basmë.

**S'më hin gjumë në si:** s'flë dot.

**S'hiri derën:** nuk u-fut brënda.

**Hodhi te rit'** e saj për të: sakrifikoi rininë për të.

**Holas** (greq.): mërzitem.

**Hollë hollë:** lehtë lehtë

Janë **hollë** janë të varfër.

**Hollërina:** gjëra të vogla, si gjëlpërë, pë, gjithtje.

**Hollohë:** lagështirë, llohë.

**Honeps** (greq.): tret

**Huja-ja:** hoje

**Huj-i** (turq.): zakon

**Hujli:** njeri i rreptë.

**Hullon e pikëllon:** di të hullojë mirë.

**Humai:** kambrike.

**Kam një humbël:** kam një si gropë, e ndjej vehten si të zbrazët.

**Është hundë-madhe:** është madhështore.

## I

**Ikullo-ndrikullo:** fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

Isë ti: ose ti.

Isqi (turq.): e vjetër.

## J

**Jahot** (turq.): ose.

**Jamanó** (turq.): aman, të lutem.

**Japi-ja** (turq.) godinë e madhe.

**I jaratisur** (turq.): i krijuar.

**Jarna-jarna:** fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

**Jashtëlinat:** jevga ose gra që marim nga jashtë për të bërë punët e shtëpisë duke i paguar.

**Jelekshihit:** veshur me dimite, me këmishë e me jelek sipër.

**Jenete:** e shkrifët.

**Jato:** ja tek.

**Juk** (turq.): një tok gjëra ose dysheqet kur vihen njeri mbi tjetrin.

## K

**Kabardisem** (turq.): mbahem rëndë.

**Kaço-prerë:** me flokë të prera.

**Kaçup-i:** strajcë prej lëkure ku hidhet vera. Calik.

**Kaçup** nga sitë: i qenë ajtur sytë nga të qarët.

Veshur me **kafase:** dritaret mbuluar me kafas.

**Kail:** s'qe bërë (tirq.): s'i qe mbushur mëndja.

**Kalca:** një farë çarape pa pjesën e poshtëme të këmbës, prej fanelle që vishet mbi çorape.

**Mes-kalore:** mes hollë.

**Kallëp-kallëp:** palë palë.

Ja **kalli** në vesh: ja tha.

**Kallogricka:** vajza të vogla e të zonja (për përkëdhelje).

Vajza e ka fatin në **kamare:** e ka fatin e vet.

**Kamarosem:** bëj naze kur flas, mbahem rëndë.

**Kanakar:** djal i vetëm dhe i përkëdhelur.

**Kanaqeps** (greq.): e ushqej mirë, e kënaq me të ngrënë me ato që do.

**Kanglli** (turq.): i lik, që kërkon të bëjë keq.

Ri e **karfosur** (greq.): rri drejt.

**Karkanaqe:** një farë biskote që bëjnë gratë në shtëpi si dhe nusja të tretën ditë si është martuar.

**Karkallosët:** i vogli qan me të madh duke lëshuar zënë e duke u-skuqur në fytyrë.

**I kartrave** jo: nuk lot me letra.

**Karvele:** çirek i vogël. I mbeti surati sa një **karvele:** u-tret dhe fytyra i u-bë e vogël.



**Katallahu** (turq.): pa pritur

**Katënxxhikë-a:** emri me të cilën nuset e thresin vjehrën.

**Katarah-u:** . Shul i derës.

**Kazmir-i:** stofë e lehtë nga e mira.

**E do keq:** e do shumë.

**Këcullë-a:** breg në Gjirokastrë, në lagjen Palorto.

Të bien **këmbët:** lodhe. **Këmbë-këmbë:** ndotur nga këmbët ose nga këpucët me baltë.

**E kam futur në këmishë:** e kam vënë të lajë këmishë.

**Këpucë** me kapak të drejtë: këpucë që pjesën e sipërme e e ka të pa prerë.

**S'e këputi këngën:** s'e preu këngën. **S'e la këngën për gjysmë.**

**Kërcet kënga:** gjëmon kënga.

**Kërcë:** petë e pjekur dhe e thatë e birekut ose e bakllavasë. Në **kërcë** të vapës: në mes të vapës.

**Kërcëllimë:** natë me shi e me bubullima e me të ftohët. Bëje drunë **kërcëllimë:** mblihdje dru në të ftohët.

**Kërlëgani:** shumë njerës, plot, mori.

**Kliço-ua:** hekur i vogël për të mbyllur derën.

**Kllabodon:** ergjënd.

**Klluk:** ngrohët shumë.

**Pa kohë:** vonë. **Me kohë:** shpejt.

**U kërkon koka jastëk:** kanë gjumë. **I hidhet në kokë:** i flet më inat.

**Kokë hode:** kokë qethur. **Kokën furë:** i djeg koka. **Ka ethe. Kokë-vjerë:** që mban kokën shtërmbët nga një anë.

**Eshtë kokoshe:** njeri që hidhet në fjalë.

**Kokoreth:** një jastëk i vogël dhe i rumbullaktë, shpesh herë me vrimë në mes që djali i furxhiut e vë në kokë kur shpie bukët në furë ose-jevga kur vë boshtanë e nuses me roba brënda, për ta shpurë gjëkund.

**Kolle-kolle** (turq.): togje togje.

**Kollonatë-a:** një pare e vjetër.

**Kollopan** (greq.): fëmijë e mbeshjtjellur me çarçaf e me duar brënda, lidhur me fashqe. Kopanec.

**Komatë-a** (greq.): thelë e madhe.

**Kombolizon:** kombinezon.

**Konak-u:** një shtëpi e vogël në çiflik. Në dasmë është shtëpia e një tjetri ku i zoti i dasmës pret burrat për të ngrënë e për të pirë.

**Kondis** (turq.): zë vënd.

**Kondo-ja** (greq.) këmishë burri.

**Koqinall-i** (greq.): të kuqtë që vënë gratë në fytyrë.

**Korokaqe:** ljalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

**Kosë-a:** gërshetë.

Bëjnë **si krimbat:** pjellin shumë fëmijë.

**Kristo:** Krishti.

**Kristaf** (greq.): ergjënd.

**Krodhë-a:** pjesa e fortë e bukës. Sëmurë shumë. Bërë **krodhë:** lyer shumë në fytyrë.

**Kruajtj:** vodhi.

**Kselhasur** (greq.) që të kënaq sytë. Vënd i madh e i gjerë, i hapët.

**Ksepleksur** (greq.): çthurur.

**Këtheje Zulo:** ktheje këngën.

**Kuko:** vetëm, si qyqe.

**Kukurizma:** të qeshura.

**Kullo** sitë: kënaq sytë. Vështroj një gjë që më pëlqen.

**Kumbisem** (greq.): mbështetem. S'ka ku të **kumbiset:** s'gjen vënd ku të bjeri e të flierë.

**Kurorë:** martesë.

**Kut-i:** një farë mase. Një kut e gjysmë bën një metër.

**Kutja:** kujt.

## L

**Lale:** një farë lule që e ziejnë gratë dhe e pijnë ditën e martë që të marin fuqi.

**I lau uria:** i mori uria shumë.

**Leros** (greq.) fëlliq, ndot.

**I bëri lesh' e li: i ngatëroi, i trazoi.**

**Lëvonte kuvëndi:** vlonte, ziente kuvëndi.

**Lilë-a:** lodër që mbajnë fëmijët në dorë dhe kur e tundin gjëmon. I u-bënë sitë **lila lila:** i u-veshnë sytë si me lotë.

**Limaksur** (greq.): e pangopur për çdo gjë.

**E lirojti koka:** i dhëmb kryet më pak.

**Lug' e dhoktë:** lugë prej druri.

**Lugat në surat:** është i sëmurë është i pa qënë. Njeri që s'vlen gjë.

**Lukuramë:** tatëpjetë, rrukullamë.

## LL

**Llahtaris** (greq.): u-ngrita nga gjumi me frikë. U-trondita shumë.

**Llanar:** krehër.

**Llananisem:** dëshpërohem, çqetësohem.

**U-ngre me llambë:** u-ngre shpejt në mëngjes kur nuk kish lindur dielli e u-shtrëngua të ndizte llambën për të parë.

**Llambro-ua** (greq.): një metal i vogël, i lehtë, i rumbullaktë me një vrimë në mes. Temina.

**Llams e feks** (greq.): shumë e pastër.

**Llastikë-a:** biberon. Thithkë.

**Lligari-ja:** pë i trashë prej pambuku që bëhen çarape.

**S'e llogat:** s'e ka në mëndje.

**Llokohartë-a:** letër e ndritur si ergjënt që mbështjellin çokollatat e që kërcet kur e zë me dorë.

**Llost-i:** hekur i punuar e në fund pakëz më i gjërë. Përdoret për të shtypur kafënë në gur. Llozi.

## M

**Makat-i:** një copë prej pambuku që hidhet mbi mindere.

**Malldarë** (turq.): njerëz me mall. Të pasur.

**Mana** (turq.): qëllim. kuptim.

**Manaj-manaj:** fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

**Manajko:** fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

**Për marëlë:** për të marë nusen.

**Martiris** (greq.): i tha fjalët. ç'kishte bërë.

**Mashalla-ja** (turq.): një farë shuli i gjatë që në krye ka një shportë me shufra prej hekuri.

**Matara-ja:** një farë teneqe që ka një faqe të shtruar dhe të drejtë që të varet mbi kalë ose të vihet në kraha.

**U-mbajti ferexhenë:** U-mbajti ferexhenë në duar duke i ndihmuar në të veshur.

**Mballos** (greq.): arnoj.

**Eshtë mbitur:** është marë në qafë. S'ka marrë burrë ose grua të mirë.

**Maç e maç:** e puti shumë herë.

**Maçalis** (greq.): përtyp. **Maçalis** fjalën: e bie rrotull fjalën sa ta them.

**Meit-i** (turq.): i vdekuri në mes të odës. **Meit** nga surati: i verdhë nga fytyra.

**Mekam-i** (turq.): vënd i shënjtë.

**Meqeme-ja** (turq.): gjyqi.

**Mesëlë:** robë ose qylim që vihet në mes të odës.

**Mëhale-ja:** lagje.

**Ja bëri mënden** fiu: i hoqi mëndjen nga koka. E çmëndi.

**U-mënua:** u-vonua.

**Minxore:** dinake.

**Miser që vjen:** mirë që erdhe.

**I ha mishtë:** i ha kokën. Eshtë e rreptë me të.

**Mjalt' e gjalpë:** duhen shumë. Janë mirë me njera-jetrën.

**Mjekërshit:** nga mjekrët. (Rasë rjedhore)

**Mala-mala:** majat e gjishtreve bërë me këna.

**Monó** (greq.): vetem. tek.

**Mostër:** model.

**Motërma:** motërzë.

**Mumulljakë:** e kursyer.

**Musaka:** gjellë. Presh të grirë e të zier me parë. Pastaj tiganisen. Hidhet në një gjiveç. një radhë presh e një radhë mish. Si mbaron kjo i hidhet lëngu i mishit, vihet në furë që të skuqet pak.

**Mustaqëshit:** nga mustaqet. (Rasë rjedhore).

**Nazarllëk-u** (turq.) nuskë që i varet lëmijve për të mos marë sy. **Ndëra** kokën: zgjata kokën.

Nuk **ndihet**: nuk dëgjohej kurrë të bëjë shamatë. Eshtë e urtë. **Nduk** mandallin: tërhiq mandallin.

Të **ndruarat**: ndresa. si këmishë, mbathje etj. Të brëndëshmet. **Ndroj**: shkëmbej. Fjalë s'kemi **ndruarë**: s'jemi zënë. Të **ndronte** di fjalë bashkë: të fliste pakëz me të.

**Ndruhet**: i vjen turp.

**Neft**: bizir.

**Nerohit-i** (greq.): vëndi ku lahen enët dhe duartë në kuzhinë. **Nerohiti** ile ile: nerohiti i bërë me ngjyrë të kuqe.

**N'do**: në do.

**Nëntë** i ditës: ora tri mbas dreke.

**Ngalás** (greq.): përqafoj.

E **ngas**: e ngacmoj. Tallem me të.

Të **ngrenat**: ushqimet (shumë farë gjellë) që i shpihen lehonës të tretën ditë, kur ka lindur fëminë e parë.

**Si të ngordhura**: pa zë.

**U-ngjeth**: i shkoi një të rënqethur në trup, nga të ftohtit.

**Niq-i** (greq.): qira.

**Notra**: ergjënd i pleksur me kllabodon e bërë si pë i trashë. Me të qindisen jeloqet.

**Rritur e bërë nuse**: rritur e bërë e madhe dhe zbukuruar. **U-nxinë** së qeshurit: qeshën shumë. **U-nxiu** sinë parai: i gënjeu pasuria.

## Nj

**Nj'a di**: një ose dy. Disa.

## O

**U-mbush odaja** gjer në griqë: u-mbush oda plot. **U-mbush oda** dëngëza. **U mbush oda** vingëza.

Ka vënë një **okë** të kuq: ka vënë shumë të kuq në fytyrë. Eshtë lyer tepër në fytyrë.

**Okllai-ja**: dru i hollë e i lëmuar.

**Ormaç-i**: e çara që kanë çitjanet si përpara ashtu edhe nga prapa. Puna është të që kur të shkohet frakazoni në reth. (pjesa e çitjaneve e kthyer nga brënda tek mezi) dhe kur të lidhet bishtat që mbeten të luten tek e çara përpara e mos dukën: e çara e prapme bëhet për ekonomi, se me kohë pjesën e prapme mund ta biesh edhe përpara Ose për bukuri mbasi ka qënë zakon se an' e mb'anë ka qënë zakon se anë mb'anë ormaçeve vihej një copë pllakë e qindisur me notra t'ergjëndë e më gajtan anës.

**Paf e puf** cingarin: pi cingar, njerin pas tjetrit. Pi shumë.

**Palcohem:** pajtohem.

**Palo** (greq.): i keq.

**Palorto:** lagje në Gjirokastër.

**Hundë** sa një **patëllxhane:** hundë e madhe.

**Qe bërë koha pambuqe pambuqe:** qe mbushur qielli me re të bardha.

**Papsi** (greq.): u-pakësua.

**Pat:** odë në katin e dytë të shtëpisë. e cila i ka dritaret më të vogla se të odave sipër.

**U-pataks** (greq.): u-çudit. I u-duk **patai:** i u-duk çudi.

**Paramandë** (greq.): karficë prej kocke që vihet për bukuri në kokë për të mbajtur flokët.

**Paraponi** (greq.): të qarë me të madh.

**U-pashilova:** u-bëra pa shije.

I ngrihet **pazari** në këmbë: e nderojnë shumë sa që kur shkon udhës i ngrihen të gjithë në këmbë. Ngriti **pazarin:** bleu shumë gjëra.

**Pazen-i:** një farë fanellate.

Sa një **pelë:** e madhe nga mosha. **Pela:** vajza të ritura nga mosha e të pamartuara.

**Pembezar-i:** copë që vinte një herë e një kohë nga Turqija. Një vijë e ka të mëndafshhtë dhe një vijë prej liri. Bëheshin këmishë për të veshur dhe çarçafë.

**Pendeliron** (greq.): flori pesëlirëshe.

**Perço-ja** (turq.): flokë.

I pa **Perëndia:** u-kënaqën shumë.

**Perishan-i** (turq.): zinxhir i artë e në fund me margaritare që në kohët e para ja varnin nuses në ballë.

S' e ka për **pesë:** s' do të dijë njeri. S' ka njeri në mëndje. I ven **pes' e pesë:** trëmbet shumë. Flet **pes' e dhjetë:** flet kot së koti.

**Pesëqint** i vunë sipër: shumë fjalë të këqia thanë për të.

**Petëra e osa:** ushqime si makarona që i bëjnë gratë vetë dhe i mbajnë zahire për dimër. I futi një **pëllëmbë:** i ra me një shuplakë. E mban në **pëllëmbë** të dorës: e mban shumë mirë.

Ra **përmbis:** ra pas punës sa nuk ngrë kokën.

E **përcolli:** e shoqëroi deri tek porta.

**Përçmakë:** e shëmtuar.

I **përkëmbur:** i vogël dalë nga të ligat. Që ecën.

E **përçarë:** si e qarë në fytyrë.

**Pingël** veshur: veshur elegant. **Pingëlore:** elegant.

E **pipi:** s' foli më.

**Pirpiri-ja:** një farë pallto me mëngë të hapëta e nga fundi me qinda. Eshtë e gjatë dhe e qindësuar krejt me notra t'ërgjëndë.

**Pizili:** dang në si: ki zili e të goditë në sy.

E bën punën **radha radha**: e bën punën shtruar.

I **ranë** duartë: i u-hapnë majat e gjishtreve nga gërqelija, nga finja e këmisheve ose nga finja e enëve. Gratë që t'u-piqen plagët i lajnë më parë me sinall që të ikin të mbeturat e gërqeles dhe pastaj vënë këna.

**Ranë** me fëmijë bashkë: ranë për të fjetur me fëmijë bashkë.

**U-rëndua**: u-bë e rëndë ose gruaja me barrë hyri në muajt e saj s'mund të lëvizti si më parë.

**U-rëzëkua** mali: ra mali.

Kam një **rodhan** në zemër: **kam një frikë në zemër**.

**Rokozhinë-a**: greminë. Ose shumë plakë që është e krusur.

**U-rop**: u lodh së punuari shumë.

## S

**Sade-ja** (turq.): fustan.

**Samur-i** (turq.): peliçe.

**Sapimë-a**: stofë e vjetër dhe jo e kushtuar.

**Savat** (turq.): një farë pluhuri për të larë sendet e ergjenda.

**Seiz-i** (turq.): trimi që i rri të zotit nga prapa kur ay del me kalë.

**Selime**: fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.

**Sëra-ja** (turq.): radhë.

**Të siferur** (greq.): të sjellur.

**Silloisem** (greq.): mendohem.

Me si të qepura: me një e zë, gjumi. Më doli **siri**: më pëlqeu shumë.

**Skami-ja** (greq.): karigë.

**Skorllan** (greq.): tarator.

**Skutinë-a**: culet e fëmijës që përdoren kur e lidhin kollopan.

**Të hanë shkallat**: të lodhin shkallat.

**E shkrifët**: e butë, e mirë.

Eshtë e **shkuar**: është e madhe nga mosha. Njeri që nuk zihet me të tjerët.

I **shkuli** të rinin: i luti që të qëndronin.

**Shkundi** shtëpitë: fshiu e lau shtëpitë anë mb'anë.

**Shkumon**: pëlqet nga inati.

**E shqiejti** e nduki: i u-lut shumë.

**Shqiptarçe**: vënçe.

Roba **shqiptarçe**: roba jelekshit.

I vanë **shpatullat**: u-lodh shumë.

**Shtëmëng**: largoj.

Dolli **shtok**: e hoqi bark.

Ri **shtruar**: rri në këmbë.

Merjani **shtruar**: këndoni mirë.

Ja kanë **shtruar** mirë pinë raki dhe lozin

I pi të gjalla: i kërcënon tepër, i mban në frikë.

Pleksi (greq.): bëri

Plihur' e dorës: pëlhurë bërë në avlëmënd.

Pllaçko: e shtypur.

Hundë-poç: hundë shtypur.

Pohe me margaritare: një farë rjetë me margaritare që në çdo cep ka nga një flori të vogël. Vihet në pjesën e prapme të festes me florinj që vinin nuset në kokë.

Ja mori poshtë: ra për gjumë.

Poture: një farë benevreqe që vinë të gjata gjer tek gjuri e vishen me kalca.

E' prapë: e reptë.

Pra-se-qish: mirë bëri, ani, s'ka gale.

Qe prerë nga surati: qe verdhur në fytyrë. Preu çorvën: i hodhi ve supës. Të pret me si e me vetull: ka syrin dhe vetullën të bukur.

Eshtë prishur: është tretur.

Protare (greq.): grua që pjell për herë të parë. Proto-derë: derë e parë.

Psunë (greq.): gjëra të blera në pazar. Psunisur (greq.): blerë.

Ri si pulë: s'let.

Eshtë puna në dhe: është puna për të bërë. Punoi ndënë dhe: punoi dhe njeri s' e mori vesh. I punon mëndja atje: e ka mëndjen gjithënjë atje. Ma punoi mirë: ma bëri mirë, më lojti si deshi. Ma hodhi. Pup e pup: u-uhnë njera pas tjetrës e pa shamatë.

## Q

Në qaf' në duar: në jakë dhe në fund të mëngëve.

Theu qafën: u-lips e iku ose u-rëzua.

Qelq koha: kohë e mirë me qiell të kulluar, pa asnjë re.

Iku me qenar: iku anës e anës. Iku me lezet pa e kupëtuar njeri.

Qer-i: një copë dërrasë vezake dhe e sheshtë me një dorë të vogël nga një anë.

Mbi të hullohen petët me petës.

Qese për këpucë: strajcë që i vihet nuses në pajë në të cilën vë këpucët brënda. Pastaj e fut në boshtan e mirë dhe e merr me vehte kur vete gjekundi, për darkë a për drekë.

Më qesh: tallet me mua.

U-qetua: mbeti si e shahtisur.

E shpuri në qiell: e lëndoi tepër.

Qollopitë-a: kulaç i hollë. Miell misri i përvëlur me ujë të ngrohët pasi i ka hedhur kripë në mes. E trazon mirë e mirë dhe si hidhet në tepsi zonja e shtëpisë e bën lugë lugë për bukuri.

Qoshk-u: një e dalë e shtëpisë në divan sipër. Një odëzë e vogël po pa derë e me penxhere ku në verë shtrohen mindere anë mb' anë për të shkuar kohën e vapës dhe për të kënaqur sytë mbasi prej andej duket më mirë udha.

## R

Radha-radha: pran' e pranë. Janë një radhë: janë shumë. Këtë radhë: këtë herë.

Di faqe qe s'i **shuhen**: dy faqe te kuqa qe i rinë gjithënjë ashtu.  
**Shullër**: një vënt faqe dielli, shullë.  
**E shushatur**: e hutuar.

## T

**Tabak** kokën: kokë e qethur, pa flokë.  
**Taban** i kokës: shesh i kokës.  
**Tahtaposh-i**: mbishkalla e mbuluar me dërrasë që në divan duket si tryezë e ngjitur në mur.  
**Tallëro** dollar.  
**Tamlla-ja**: fundi i mbathjeve, i pantallonave dhe i çitjaneve.  
**Tarnana e ternene**: fjalë pa kuptim që përdoret në këngë për asonancë.  
**Tatëpjetë**: poshtë.  
**Tatëpjetelat**: shkallat e dëndivali gjer te dera jashtë në çdo shtëpi.  
**I telatinjtë**: prej lëkure të kuqe e të mirë.  
**S'ka tertip** (turq.): s'ka rregull.  
**Texhara** (turq.): operator.  
**Tëllësm-i** (turq.): i refhtë.  
**Tiliks** (greq.): mbështjell.  
Nuk i vate **timi** mbarë: nuk i shkoj puna mbarë.  
**Tirtir**: një farë ergjëndi si pë që përdoret për të qepur mëngët e këmishës së mirë.  
**Torolloz**: njeri kokë shkretë. Gjysmë budalla.  
**Toz-i** (turq.): pluhur.  
**Trash'e gjerë**: u-ul mirë dhe s'kish në mënd të ngrihesh.  
**Troiro e troiro** (greq.): rreth e rreth. Jo nga udhë e drejtë.  
E vuri në **tropil**: e shau. Foli keq për të.  
E **patruar**: nuk ndruhet. Nuk i vjen turp.  
**Tujet**: gazet.  
**Tumanet**: dimitet.  
**Tura-tura**: rrudha-rrudha.  
**Trululu**: me gjismë mëndje. Budallaçkë.  
**Të turet**: të tyret.

## Th

**E thapsi** (greq.): e hëngri të gjithë e me një herë.  
Bërë **thumb**: dehur shumë.

## U

S'ngoset **ulku** me miza: s'shërohen hallet e njeriut me ndihma të vogla. I lau **urija**:



i mori urija shumë.

V

**Vartur:** varur.

**Veseli:** i ëmbël shumë. **Më veseliti:** më mori zemrën nga të ëmbëlltit e shumë.

**I mori vetullën:** i goditi vetullën, i dha formë të bukur.

**Vëlleshë:** gruaja e vëllait.

**U-vjase (greq.):** shpejtove.

**Vrënge:** e çalë shumë.

**I vret të trasha:** mbahet rëndë, e heq lart.

X

**Xamare-ja:** fyell, cule.

**Xëci:** darka. **U-err.** Koha që gratë duhet të jenë në shtëpi.

Xh

**Xhanfes-i (turq.):** copë e hollë e mëndafshhtë.

**Xhavallosmë-a:** grindje me zë të lartë.

**Ja vuri në xhep:** ja mbajti mënd fjalën.

**Xhoç:** diçka.

**Xhuxhullja:** vapë e madhe.

Z

**Zabavë-a:** të ftohët i madh. **I dha zabavën:** i dha fjalën si qe e i dha udhët.

**Zajme:** e mirë.

**Zapana-ja (turq.):** shtëpi e vogël jashtë oborrit ose ngjitur me shtëpinë ku rri familja.

**Nuk zbërtheu golën:** s'hapi gojën të fliste.

**Zelikade (arab.):** një nga muajt e vitit arab.

**Zënë fluturillë:** zërin e hollë e të bukur.

**I zgullosi krahat:** i mbuloi mirë e mirë krahat me jorgan.

**Jet'e zoi (greq.):** jetë të lumtur.

**I u-frinë zorët:** u inatos.

**Qe e zotëruar:** merak madhe për çdo gjë e pas çdo gjëje.

**Zullape-ja:** e shëmtuar.

**I zuri dorën:** i puthi dorën. **E zuri një kokë:** e zuri koka.

**Zuri vajzën:** fejoj vajzën.